



**Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit  
me kolege dhe kolegë  
të gjuhës gjermane**

Punime të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare

Tiranë, 2024

Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë  
të gjuhës gjermane

Përmbledhje e punimeve të Konferencës Shkencore  
Ndërkombtare

### **Redaktimi**

Prof. dr. Emil Lafe (Shqipëri)  
Prof. dr. Emine Sadiku (Gjermani)  
Prof. asoc. Jonida Xhura (Gjermani)  
Prof. dr. Mimoza Kore (Shqipëri)  
Prof. dr. Brikena Kadzadej (Shqipëri)  
Prof. dr. asoc. Sonila Sadikaj (Shqipëri)

### **Këshilli Shkencor Botues**

Prof. dr. Emil Lafe (Shqipëri)  
Prof. dr.- Akademik Gjovalin Shkurtaç (Shqipëri)  
Prof. dr. Anila Omari (Shqipëri)  
Prof. dr. Victor Friedman (SHBA)  
Prof. dr. Basil Schader (Zvicër)  
Prof. dr. Emine Sadiku (Gjermani)  
Prof. dr. Mario de Matteis (Gjermani)  
Prof. dr. Bardhyl Demiraj (Gjermani)  
Prof. asoc. Jonida Xhura (Gjermani)  
Prof. dr. Monica Genesin (Itali)  
Prof. dr. Matteo Mandalà (Itali)  
Prof. dr. Valbona Toska (Maqedonia e Veriut)  
Prof. dr. Berton Sulejmani (Maqedonia e Veriut)  
Prof. dr. Dhori Qirjazi (Greqi)  
Prof.dr. Brikena Kadzadej (Shqipëri)  
Prof. assoc. dr. Sonila Sadikaj (Shqipëri)  
Dr. Marisa Janku (Shqipëri)

## Pasqyra e Lëndës

### Fjalët përshëndetëse

#### **Prof. dr. Brikena Kadzadej**

Drejtuese e Projektit.....7

#### **Prof. dr. Esmeralda Kromidha**

Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.....9

#### **Prof. dr. Artan Hoxha**

Rektor i Universitetit të Tiranës.....10

#### **Prof. dr. Skënder Gjinushi**

Kryetar i Akademisë të Shkencave Tiranë.....12

### Punimet

#### **Prof. dr. Matteo Mandalà**

Arbëreshët vënë një gur themeltar në ndërtesën e një kulture shqiptare: Eqrem Çabej dhe “italoshqiptarët”.....16

#### **Prof. dr. Emil Lafe**

Shteti dhe Gjuha Amtare në vështrimin e Prof. Eqrem Çabejt.....36

#### **Prof. dr. Akademik Seit Mansaku**

Metodologji shkencore dhe frymë kombëtare në veprën e Çabejt...47

#### **Prof. dr. Akademik Floresha Dado**

Metodologji e veçantë e interpretimit të kulturës dhe letërsisë, nga E. Çabej.....58

#### **Prof. dr. Akademik Ethem Likaj/Dr. Albana Avrami**

Çabej - Zot i thellësive të gjuhës shqipe.....68

#### **Prof. dr. Akademik Gjovalin Shkurtaj**

Nga ideja pionieristike e E.Çabejt për “të folët e grave” deri te gjinia si ndryshore sociolinguistike.....75

<b>Prof. dr. Anila Omari</b>	
Letërkëmbimi i Hermann Ölbergut me Çabejn, një model bashkëpunimi miqësor dhe kontributi të frytshëm në albanologji.....	91
<b>Prof. dr. Mario de Matteis</b>	
Kultura shqiptare dhe gjuha në kontekstin evropian sipas Eqrem Çabejt- Albanische Kultur und Sprache im europäischen Kontext nach Eqrem Çabej.....	100
<b>Prof.dr.Dhori Q. Qirjazi</b>	
Letra të gjuhëtarëve grekë D. Georgakas dhe T. Jochalas për prof. E. Çabenë.....	104
<b>Prof. dr. Dieter Nehring</b>	
E. Çabej dhe M. Lambertz: Disa fjalë rreth pasqyrimin të tyre reciprok.....	120
<b>Prof. dr. Bardhyl Demiraj</b>	
Norbert Jokl-i në letërkëmbim me Eqrem Çabejn.....	139
<b>Prof. dr. Valbona Toska</b>	
Roli i Eqrem Çabejt në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut.....	152
<b>Prof. dr. Shezai Rokaj</b>	
Metoda kërkimore në studimet gjuhësore të Eqrem Çabejt.....	159
<b>Prof. dr. Berton Sulejmani</b>	
Kumtesat shkencore të Prof. Eqrem Çabejt, të botuara në revistën “Jehona” të Shkupit.....	168
<b>Ben Andoni</b>	
Shkrimi i Profesor Çabejt si narracion letrar.....	182
<b>Prof. asoc.dr. Edmond Malaj</b>	
Jeta dhe veprimtaria shkencore e Çabejt nën diktaturën komuniste...191	
<b>Prof. Asoc. Dr. Jonida Xhyra-Entorf</b>	
Emëruesi i përbashkët shqiptar si njësi etnike dhe kulturhistorike në punimet e hershme të Çabejt.....	210
<b>Prof. dr. Mimoza Kore</b>	
Qëmtime në “Studime etimologjike në fushë të shqipes” të Eqrem Çabejt.....	218
<b>Prof. dr. Albert Riska</b>	
Apofonia e shqipes në qëmtimet etimologjike të Joklit referuar nga Çabej.....	226
<b>Dr. Genc Lafa</b>	
Hyrje në sudimin krahasues të gjuhëve indoevropiane - një vepër e	

rëndësishme dhe pak e njohur e Çabejt.....	231
<b>Dr. Elda Boriçi</b>	
Huazimet dhe elementet latine të gjuhës shqipe në studimet e Prof. Eqrem Çabej.....	241
<b>Prof. dr. Brikena Kadzadej /Vezire Krasniqi</b>	
Eqrem Çabej në këndvështrimin e studiuesit Franz Babinger.....	251
<b>Prof. asoc. dr. Sonila Sadikaj/Dr. Marisa Janku</b>	
Kontributi i Prof. Çabejt në fushën e frazeologjisë shqipe.....	260
<b>Prof. asoc. dr. Adriatik Derjaj</b>	
Ndihmesat e Eqrem Çabejt në Turkologjinë shqiptare.....	269
<b>Prof.asoc.dr. Evalda Paci</b>	
Premisa të një botimi tipik kritik e filologjik në parashtrësat studimore të Eqrem Çabejt.....	275
<b>Dr. Irda Dervishi Nesimi</b>	
Personaliteti i Eqrem Çabejt në veprën e Shaban Demirajt: Eqrem Çabej, një jetë kushtuar shkencës.....	284
<b>Prof.asoc.dr. Shpëtim Zymeraj</b>	
Eqrem Çabej-figurë e spikatur në hedhjen e bazave në gjuhësinë shqipe. Ndihmesa tij në fushën gramatikore.....	295



## **Mirësenauerdhët të dashur miq në Konferencën tonë Çabej!**

### **Të dashur profesorë, kolegë, studentë e miq!**

Në kuadër të Projektit në mbështetje të kërkimit shkencor dhe në mbështetje të kërkuesve të rinj të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, UT, organizohet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare për personalitetin e gjuhësisë shqiptare, Prof. Eqrem Çabej. Ky vit përkon me 115 -vjetorin e lindjes së Çabejt.

Ky dijetar i ndritur për afër një gjysmë shekulli dha ndihmesa të rëndësishme në gjuhësinë shqiptare dhe në Arsimin e Lartë.

Fusha ku u përqendrua më së shumti është historia e gjuhës shqipe dhe burimi i saj, vështruar në marrëdhëniet e saj me gjuhët motra indoeuropiane, me gjuhët ballkanike e me gjuhë të tjera, por edhe gjuha e sotme, fjalori, pastërtia e gjuhës, drejtshkrimi.

Vepra madhore e tij është “Studime etimologjike në fushë të shqipes”(vëll. I–VII, Akademia e Shkencave, Tiranë,1976-2014).

Në rrezen e hulumtimeve të tij përfshihen edhe folklori, etnografia, historia e letërsisë etj.

Një falenderim i vecantë është për zonjën Brikena Eqrem Cabej që na ofroi një material autentik për letërkëmbimin e Profesorit me studjues të hapësirës gjermanishtfolëse.

Shkas për këtë ndërmarrje u bë fakti që për herë të parë, me shumë vonesë, bëhet një Doktoraturë për Profesor Cabejn dhe ky shkëmbim shkencor, do të na mundësojë edhe një material të hulumtuar gjatë, me shumë seriozitet nga brezi i profesorëve tanë të shumëdashur që pasuan, u formuan prej Profesorit dhe na shtruan ne rrugën për ta vazhduar këtë mision.

Nuk mund të mos theksojmë ndihmesën e madhe që kanë dhënë dhe japin studjuesit arbëreshë, nga trevat shqiptare Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe studjuesit e huaj për gjuhën shqipe kudo në botë.

Kam mbi tri dekada që punoj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe jam bashkëthemeluese e Departamentit të gjuhës gjermane dhe gjatë kësaj kohe kam organizuar shumë konferenca dhe veprimtari të tjera, si brenda edhe jashtë vendit, por asnjëherë nuk kam pasur këtë përgjegjësi dhe emocion që kam sot, sepse në sallë, para syve të mi, janë emrat e të mëdhenjve gjuhëtarë shqiptarë, janë profesorët e mi, bashkëkolegët dhe studentët që duhet të vazhdojnë gjithë këto vlera.

Kjo gjë është motivuese.

Gjatë kësaj Konference do të dëgjojmë gjëra të reja nga referuesit, tema interesante, të panjohura dhe të patrajtuara më parë nga studjuesit tanë dhe të huaj, që për nder të Profesorit, sot ata do të flasin të gjithë shqip.

Kam dëshirë ta mbyll këtë fjalë të shkurtër me thënien e Prof. Shaban Demirajt:

“... ky dijetar është i pari gjuhëtar shqiptar, që, duke zbatuar me zell e mprehtësi metodat bashkëkohore europiane, bëri që edhe gjuhësia shqiptare ta kapërcente prapambetjen e mëparshme si për nga metodat ashtu edhe për nga tematika...” (Demiraj 2008:8).

**Prof. dr. Brikena Kadzadej**  
Drejtuese e Projektit



**Të nderuar profesorë,**

**Të dashur studentë,**

Jam e privilegjuar sot të mbaj fjalën përshëndetëse në Konferencën Ndërkombëtare “Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolegë të gjuhës gjermane” së pari, sepse bëhet fjalë për një ndër figurat e ndritura të gjuhësisë shqipe dhe së dyti, sepse sot, kjo sallë është e mbushur me personalitete të shkencës së gjuhës dhe letërsisë shqipe, referimet e së cilëve do të jenë një homazh për punën dhe kontributin e Prof. Eqerem Çabej.

Prof. Eqerem Çabej, gjuhëtar, profesor, akademik, “Mësues i Popullit”, është një figurë shumëdimensionale në zhvillimin e mendimit intelektual në Shqipëri, në formimin e specialistëve të Shqipërisë, në zhvillimin e shkencës brenda dhe jashtë vendit.

Për afër një gjysmë shekulli Prof. Eqerem Çabej dha ndihmesa të rëndësishme veçanërisht në arsimin e lartë dhe në gjuhësinë shqipe. Hartoi tekste dhe studime të shumta në gjuhësi, por jo vetëm, edhe në folklor, etnografi, histori të letërsisë. Kërkimet dhe publikimet e tij në fushën e historisë së gjuhë shqipe e vështruar në aspektet e problemet më të ndryshme të saj, kanë bërë të mundur të nxisin më tej kërkimet dhe debatin e studiuesve të tjerë për gjuhën shqipe krahas studimeve të gjuhëve të tjera.

Ai meriton vlerësimin e kërkuesve ndër breza për kontributin e vyer dhe punën studimore të një jete për studimin, standardizimin dhe zhvillimin e gjuhës shqipe.

Faleminderit organizatorëve të kësaj konference për të vënë në pah punën dhe kontributin e një shkencëtari me vlera të rëndësishme për historinë dhe identitetin e shqiptarëve.

Punime të mbara konferencës!

**Prof. dr. Esmeralda Kromidha**

Dekane e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja

## **Profesori i madh e i shquar, Eqrem Çabej**

115 vjet më parë në Gjirokastrë, lindi një nga ata që më vonë do të bëhej nga njerëzit më shquar që punoi gjithë jetën për gjuhën shqipe, historinë e saj dhe që u përpoq ta lartësonte atë, atje ku e kishte vendin e vet, si një nga gjuhët më të lashta indoevropiane.

Çabej ndoqi zemrën e tij që pavarësisht nga cdo gjë i tha të ndjekë atë që i përkiste kombit të vet, gjuhën shqipe, gjë që e drejtoi të kapërcente cdo vështirësi për ta realizuar këtë ëndërr dhe e realizoi në kohën kur shumë pengesa i dilnin gjuhës sonë dhe ishte ndër të parët që ndoqi rrugën e Autorëve të Vjetër të Veriut, të Kristoforidhit, Aleksandër Xhuvanit, të gjithë rilindasve dhe arbëreshve që e ruajtën me fanatizëm gjuhën tonë dhe që u përpoqën, madje sakrifkuan rininë dhe jetën e tyre për të.

Gjithashtu Çabej, krahas tyre, bashkoi luftën e vet me albanologët e huaj që punuan për gjuhën tonë si Johan Georg fon Han, Nobert Jokli, Franc Nopçka, Desnickaja, Robert Elsie etj, etj, deri tek më i riu prej tyre Fidler.

Ai u kthye në Shqipëri për të realizuar ëndrrën e vet që shqiptarët ta ndienin se ishin shqiptarë dhe kishin gjuhën e tyre. Puna e tij nisi në mësimdhënie në artikuj të rëndësishëm, libra mësimorë parauniversitare deri në ditën e madhe në vitin 1957 kur u themelua Universiteti Shtetëror i Tiranës, pra një faqe e re u hap dhe ai së bashku më kolegët e vet punuan dhe shtruan rrugën si për hedhjen e bazave shkencore të gjuhësisë ashtu edhe të mësimdhënies. Ata duhet të përgatisnin një brez të ri.

Vepra e Çabejt mbetet edhe sot një nga vlerat më të mëdha në historinë e gjuhës shqipe. Tekstet mësimore ishin aq shkencorë, sa edhe të lehtë për t'u kuptuar.

Natyrisht Universiteti ynë vazhdon dhe do të vazhdojë ta ketë në qendër të vëmendjes pasurimin dhe pastërtinë e gjuhës sonë, për këtë po luftohet në përmirësimin e programeve tona, teksteve mësimore, në angazhimin e pedagogëve me punë shkencore, bashkëpunimin me studentët dhe studjuesit e rinj, duke i përfshirë ata, sic është rasti në projekte doktoraturash dhe më vjen mirë që sot jemi mbeldhur me lajmin e mirë që Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja po e tregon këtë gjë.

**Prof. dr. Artan Hoxha**  
Rektor i Universitetit të Tiranës

**Të nderuar pjesëmarrës, akademikë e profesorë, studiues e studentë,**

E dashur Brikena,

Pjesëmarrja dhe përshëndetja e punimeve të një konference shkencore është gjithnjë kënaqësi, por, *kur ajo i kushtohet kryeshenjës së akademizmit e të shkencës shqiptare*, anëtarit themeltar të Akademisë së Shkencave, prof. Eqrem Çabejt, *kënaqësia kthehet në një nderim e krenari për vetë Akademinë e Shkencave*. Prandaj ju falënderoj për ftesën e ju përgëzoj për faktin *që keni zgjedhur këtë figurë qendrore të albanologjisë si model për nxitjen e pasionit për kërkimin shkencor tek të rinjtë*.

Për çka përfaqëson profesori e akademiku Eqrem Çabej, si dijetar e shkencëtar; për veprën e tij në fushën e gjuhësisë e më gjerë; do të flasim këtu, më me kompetencë, specialistë nga më të njohurit të fushave të gjuhësisë, ish-studentë të profesorit atëherë dhe profesorë tuaj sot. Por do të dëshiroja të thoshja disa fjalë pse zgjedhja juaj është ajo e duhura dhe më inkurajuesja për brezat e rinj që dëshirojnë t'i kushtohen kërkimit shkencor e studimit.

Eqrem Çabej, pa diskutim, është modeli i një të riu shqiptar, që arriti të kthehet, me përkushtimin e talentin e tij, *nga nxënës i shkollës së parë albanologjike në Botë*, i asaj austro-gjermane, në *përfaqësues nga më kryesorët e saj* në albanologji; nga nxënës i albanologut me të njohur të kohës Norbert Jokl, në lartësinë e profesorit të tij të shquar e më pas ta çojë më përpara veprën e tij. Në këtë kuptim, profesori apo i riu Çabej, ecuria e tij në shkencë, në një periudhë mjaft të vështirë, në atë të Luftës së Dytë Botërore më pas të izolimit e ideologjizimit të skajshëm ideologjik, tregon se *edhe shqiptarët mund të kapin majat e shkencës kur dinë të gërshetojnë*

*pasionin me talentin.*

Çabej dhe bashkëkohësit e tij, studiues e kolegë, bënë që *albanologjia të vinte në shtëpinë e vet*. Në rast se deri atëherë shkenca e albanologjisë e kishte qendrën në Austri e Gjermani, gradualisht, në fillimin e viteve 1970, siç shprehej vetë Çabej, ajo u vendos në Tiranë. Kështu, profesor Çabej me brezin e tij, treguan se *mund të jemi të suksesshëm në shkencë jo vetëm individualisht, por edhe duke krijuar traditën e përvojën tonë, duke formuar individualitetin e deri shkollën tonë*.

Këto janë fazat më të rëndësishme të pjekurisë së kërkimit shkencor, të cilat kanë një vlerë të veçantë në albanologji, pasi në të s' duhet vetëm të arrish e të ecësh me ritmin e të tjerëve, por duhet të jesh në pararojë, e duhet të kesh forcën e ballafaqimit me tezat e kundërta.

Sot ne pohojmë me lehtësi se gjuha jonë vjen nga ilirishtja; se ajo është nga më të vjetrat; se paraardhësit tanë janë ilirët; por vite më parë, në kohën e të riut Çabej, për arsye të mirënjohura, ishin më të pranishme e më agresive shkollat dhe studiuesit që përpiqeshin të propagandonin e të vërtetonin të kundërtën. Qysh në Kongresin e Parë të Studimeve Ilire, më 1972, në saje të veprës së Çabejt, Budës etj., u vërejt me kënaqësi se *kishte filluar të ndryshonte balanca në botën albanologjike, brenda e jashtë Shqipërisë, në favor të tezave tona, të shkollës tonë*.

Vlen të theksohet se në atë kohë institutet e para të albanologjisë, me një numër të limituar kërkuesish, kishin vetëm dy dekada jetë; se ende kërkimet arkeologjike ishin në hapat e para dhe shumë prej siteve arkeologjike ishin të pazbuluara, madje në ish-Jugosllavi ato mbaheshin të mbyllura ose përdroreshin për keqinterpretim. Pra, shkollës sonë të re i duhej të ballafaqohej me shkolla më të vjetra e shumë më të mbështetura në njerëz e mjete.

Në këtë përballje, nëpërmjet Çabejt, shfaqen disa nga tiparet e vlerat kryesore që duhet të ketë kërkuesi e shkencëtari, në dallim nga pseudoshkencëtarët apo amatorët entuziastë, pa u marrë me autodijetarët. Se pasioni në shkencë nuk tregohet duke bërë pohime e deklarime të nxituara, por në punën për gjetjen e provave dhe

fakteve shkencore në mbështetje të tezës që mbron; se teoritë e tezat e gabuara, deri dhe antishqiptare, nuk rrëzohen duke sharë bartësit, por duke i çmontuar e zhvlerësuar shkencërisht ato; se keqpërdorimi i fakteve e dokumenteve është cilësi e të paafitit dhe mediokrit; se patriotizmi tregohet duke e mbrojtur dhe argumentuar prejardhjen e lashtësinë e popullit e të gjuhës tënde me argumente shkencore të pranueshme e të pakontestueshme nga qarqet shkencore, jo duke rendur t'i paraqesësh ato në mënyrë të ekzagjeruar, shoqëruar me teza e prova diletanteske e deri qesharake.

Këtu përforcohet një tjetër tipar kryesor i veprës së Çabejt, si dijetar e kërkues që duhet ta ketë çdo kërkues, veçanërisht në fusha të tilla si gjuhësia, identiteti, historia e arkeologjia, ku shkenca prek kufijtë dhe interesat e politikës së ditës, ndjeshmëritë populiste, deri kufijtë e patriotizmit e nacionalizmit. Ai është modeli që diti t'i qëndrojnë presionit politik e për glorifikim nacionalist në çdo periudhë, me bindjen se e vërteta shkencore duhet të jetë e pandikuar; se ajo, kur është e pandikuar, i shërben më mirë edhe çështjes kombëtare e patriotike; se shkenca shqiptare nuk duhej të ndiqte shembullin e fqinjëve; se ajo s'kishte dhe nuk ka nevojë as ta deformatë, as ta zbukurojë të vërtetën, mjafton që ta mbrojë e argumentojë atë. Kështu, p.sh., ai nuk rendi të shpallë një moshë absolute të gjuhës shqipe, por vërtetoi atë çka lejonin faktet, metodologjitë e teknikat e kohës, që ajo vjen nga ilirishtja dhe është ndër më të vjetrat gjuhë indoeuropiane. Sot, me metodat e reja, duke përfshirë inteligjencën artificiale, ka studime që vlerësojnë se gjuha jonë është ndarë nga trangu i familjes indoeuropiane 6-8 mijë vjet më parë, e kjo nuk ka asgjë kundërtënëse me albanologjinë si shkencë dhe me veprën e Çabejt, përkundrazi, konsolidon arritjet e tyre.

Ndokush që mund të thoshte apo të thotë sot pse nuk u pohua që atëherë se gjuha jonë është mijëra vjeçare do t'i ngjante naivit që pyet *pse Njutoni nuk zbuloi teorinë e Ajnshtajnit*. Ecuria në shkencat albanologjike, shembulli i veprimtarisë e kontributit të Çabejt, janë tregues të asaj që *shkenca dhe kërkimi shkencor zhvillohen në mënyrë piramidale*: kontribuojnë me qindra, shkojnë më lart me dhjetëra, edhe më lart disa, dhe në fund majën e kap më i zoti. Dhe profesori, kolegët e bashkëpunëtorët e tij, ngritën me

shumë mund e profesionalizëm piramidën e vërtetimit të tezës ilire për prejardhjen e gjuhës e të popullit shqiptar. Dhe e kapën majën e synuar. E për këtë do të ketë vlerësimin e të gjithë brezave. Ai ndërkohë parashikoi se në të ardhmen *arkeologjia do të flasë më shumë se gjuha*, pasi materia-objekt i saj është më e ruajtur e më e shtrirë në kohë, ndërkohë që shqipja ishte shkruar shumë vonë. Dhe zbulimet e shumta arkeologjike, gjatë gjithë këtyre viteve, të shtrira tashmë edhe në Kosovë; si dhe futja e metodave moderne në kërkim e datim, të mundësuar prej aplikimeve antro - gjuhësore e gjenetiko - gjuhësore; të mbështetura në ADN-në e gjuhës dhe në inteligjencën artificiale; po ngrenë piramidën më të madhe të studimeve për popullsitë më të hershme, parailire e preilire, apo, siç quhen shpesh, pellazgë. Në shkencë çdo gjë ka e do kohën e vet.

Do të uroja dhe kam besim se shumë prej jush, prej brezave më të rinj, mjaft prej tyre edhe referues sot në këtë konferencë, të synojnë e të bëhen pjesë e kësaj piramide.

**Prof. dr. Skënder Gjinushi**

Kryetar i Akademisë të shkencave Tiranë

Matteo Mandalà

## **“ARBËRESHËT VUNË NJË GUR THEMELTAR NË NDËRITESËN E KULTURËS SHQIPTARE”!**

Eqrem Çabej dhe “italo-shqiptarët”, një histori e gjatë dijeje dhe pasioni

1. Mes studiuesve shqiptarë të shek. XX Eqrem Çabej (Eskişehir 1908-Roma 1980) vlerësohet unanimisht, përveç se si një nga themeluesit kryesorë të albanologjisë moderne, edhe si njohësi më i thellë i botës arbëreshe. Qysh kur, si diplomant i universitetit të Vjenës, një prej universiteteve më të shquara të Europës, ra në kontakt të drejtpërdrejtë me ngulimet shqipfolëse të Italisë, Çabej do të tërhiqej nga trashëgimia kulturore e arbëreshëve, duke e konsideruar atë me të drejtë si një nga burimet më të rëndësishme të dokumentimit historik, gjuhësor, antropologjik dhe letrar të shkencës albanologjike. Më pas ai do t’i qasej asaj duke shtënë në punë metodologjitë më të avancuara të kërkimit shkencor në lëmin e shkencave humane që i kishin përcjellë profesorët e tij të botës universitare gjermanofone. Rezultatet e kësaj simbioze fatlume, që më pas do të shenjojë gjithë karrierën e gjatë dhe të frytshme të Çabejt nga fillimet e formimit deri në pjekurinë e plotë, i gjejmë në studimet e përmbledhura në vëllimin që u botua kohët fundit italisht<sup>1</sup> dhe që përfshin dy botime pararendëse që dolën në Shqipëri, i pari në vitin 1987 përgatitur nga Nelson Çabej<sup>2</sup> dhe i dyti në vitin 2017

---

<sup>1</sup>EQREM Çabej: *Tra gli albanesi d'Italia. Studi e ricerche sugli Arbëreshë*, a cura di MATTEO MANDALÀ, Traduzione italiana di GIOVANNA NANJI, Besa Muci Editore, Nardò, 2021.

<sup>2</sup>EQREM Çabej: *Në botën e arbëreshëve të Italisë. Përmbledhje studimesh*. Parathënia nga MAHIR DOMI, redaktoi NELSON Çabej, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1987.



përgatitur nga autori i këtyre radhëve<sup>3</sup>. Zgjedhja për të botuar në Itali pikërisht këto përmbledhje në morinë e veprave të shumta të Eqrem Çabejt që ende presin të përkthehen e të botohen përtej Adriatikut, i detyrohet vullnetit për të vënë në dukje nderimin e komunitetit arbëresh për kujtimin e përjetshëm të këtij studiuesi dhe miku të madh me rastin e dyzetvjetorit të vdekjes.

2. Eqrem Çabej i vizitoi për herë të parë arbëreshët në fillim të viteve '30, më saktë në verën e vitit 1932, kur shkoi në komunitetin e Horës së Arbëreshëve (asokohe quhej Piana dei Greci) për të studiuar të folmen e këtij ngulimi. Studiuesi i ri kishte zgjedhur pikërisht këtë temë diplome për të kurorëzuar studimet në Fakultetin filozofik të Universitetit të Vjenës, çka shënoi edhe përfundimin e fazës së gjatë e të mundimshme të përgatitjes së tij shkencore .



Në Austri kishte mbërritur 13 vjeçar, pasi kishte fituar një bursë studimi falë rezultateve të shkëlqyeshme në shkollën shtatëvjeçare të Gjirokastrës në vitin 1921. Në St. Pölten, një qytezë afër Vjenës, përfundoi shkollën e mesme, duke banuar pranë familjes austriake Rienmüller, që e kishte mikpritur me përzemërsi si një djalë të shtëpisë.

Me t'u kthyer në Shqipëri pas diplomës së pjekurisë që kreu në Klagenfurt në vitin 1926, Çabej i ri u shty nga i ati t'u hynte studimeve mjekësore dhe të hiqte dorë nga pasioni për albanologjinë. Kështu, aty nga fundi i vitit 1926 u regjistrua në fakultetin e mjekësisë të universitetit të Romës, ku qëndroi rreth një vit. Këtu pati mundësinë

<sup>3</sup> EQREM ÇABEJ: *Në botën e arbëreshëve të Italisë*, botimi i dytë i plotësuar nga MATTEO MANDALÀ, Excipere 30, Botime Çabej, Tiranë, 2017.

të frekuentonte bibliotekat e pasura të këtij qyteti, sidomos atë të Vatikanit, ku ruheshin vepra të rëndësishme dhe dokumente unike për historinë e kulturës shqiptare. Nuk përjashtohet që pikërisht gjatë qëndrimit në Romë studenti i ri të ketë njohur disa eksponentë të kulturës arbëreshe, sidomos nga Sicilia, që në atë qytet jetonin, studionin apo punonin.

Kujtojmë së paku dy syresh, me të cilët Çabej do të lidhë një miqësi të gjatë dhe të qëndrueshme: i pari është bizantinologu nga Contessa Entellina, Giuseppe Schirò (1905-1984), asokohe student pranë universitetit “La Sapienza”, me të cilin Çabej, pas takimit në Romë në fillim të viteve '40, do të takohet përsëri në Tiranë në vitin 1968 gjatë zhvillimit të punimeve të “Konferencës së dytë ndërkombëtare të studimeve albanologjike”; i dyti është bibliofili dhe studiuesi i njohur i shqipes Nilo Borgia (1870-1942)<sup>4</sup>, kryemurgu bazilian nga Hora e Arbëreshëve me të cilin do të shkëmbejë të dhëna të rëndësishme gjatë qëndrimit në Romë.

Me fjalë të tjera, viti i qëndrimit në Romë qe shumë i frytshëm, edhe sepse shërbeu për të krijuar marrëdhënie të reja e për të thelluar disa aspekte të gjuhës e të kulturës shqipe; mirëpo nuk mund të themi të njëjtnë gjë për rezultatet në studimet mjekësore. Çabej jo vetëm që nuk ndoqi asnjë leksion në fakultetin e mjekësisë, por me t’u kthyer në atdhe, pati guximin t’i kundërvihej vullnetit atëror, duke vendosur përfundimisht t’u kushtojë studimeve gjuhësore dhe letrare.

3. Për të realizuar projektin e tij, Çabej u transferua sërish në Austri, ku fillimisht u regjistrua në fakultetin e filozofisë të Universitetit të Graz-it, ku frekuentoi dy semestra të vitit akademik 1927-28, pastaj vijoi studimet në Universitetin e famshëm të Vjenës, ku kishin dhënë mësim studiues të famshëm si Franc Miklošič (1813-1891) dhe Vatroslav Jagić (1838-1923), e ku asokohe punonin profesorë të shquar që patën një ndikim të madh në formimin e tij shkencor, si indoeuropianisti Paul Kretschmer (1866-1956), arkeologu dhe historiani Karl Patsch (1865-1945) dhe mbi

---

<sup>4</sup> Shih: MATTEO MANDALÀ, “Vepra e Nilo Borgia-s, burim i rëndësishëm për historinë e jugut të Shqipërisë” në NILO BORGIA; *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri. Shënime mbi mistonet në Himarë: shek. XVI-XVIII*, me një parathënie nga Matteo Mandalà, “Naimi” - shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë , 2014, f. 7-18.

të gjithë ballkanologu edhe indoeuropianisti Norbert Jokl (1877-1942), i vrarë nga nazistët sepse ishte hebre, i cili mund të themi se ka hedhur themelet e albanologjisë bashkëkohore. Jokl kishte marrë drejtimin e së njëjtës katedër ku dikur kishte punuar Gustav Meyer (1850-1900), edhe ai albanolog dhe studiues i shquar i gjuhës dhe kulturës së arbëreshëve, që i kishte vizituar personalisht, sidomos ngulimet arbëreshe të Puglia-s dhe të Sicilisë<sup>5</sup>. Ndoshta nën ndikimin e kërkimeve të frytshme të zhvilluara nga pararendësi i tij, kur erdhi puna të zgjidhej një objekt studimi për punimin e diplomës së studentit të ri shqiptar, Jokl përfitoi nga rasti për t'i sugjeruar atij të merrej me arbëreshët me synimin e dyfishtë të përshkruante veçoritë gjuhësore të të folmeve të tyre dhe njëherazi t'i qasej trashëgimisë kulturore arbëreshe përmes metodave që kishte përdorur me sukses albanologu austriak për të studiuar kulturën shqiptare të Ballkanit.

Në të vërtetë nuk e dimë nëse pati arsye të tjera, përveç këshillës së profesorit të tij, që e shtynë Çabejin të zgjidhte për të studiuar pikërisht të folmen e arbëreshëve të Horës në Sicili; mund të rindërtojmë me përafërsi vetëm kontekstin historiko-kulturor në të cilin gjendej ai ngulim arbëresh, ndër më të rëndësishmit e më të njohurit. Ishte fshati i lindjes së shumë personaliteteve të shquara që edhe gjatë atyre viteve botonin vepra me interes të madh shkencor, ndër të cilat kujtojmë monografinë monumentale *Populli, gjuha dhe letërsia shqipe (Popolo, lingua e letteratura albanese)*, që u botua për herë të parë në Palermo pikërisht në vitin 1931, me autor papas Gaetano Petrotta (1882-1952)<sup>6</sup>, me të cilin më pas Çabej do të mbajë një marrëdhënie të ngushtë letërkëmbimi. Me siguri përshtypja që pati nga takimet në Romë me Borgia-n dhe Schirò-in do ta ketë përforcuar idenë që studenti i ri kishte krijuar mbi realitetin arbëresh falë leximit të veprave letrare të cilave më pas ai do t'u kushtonte


---

5 Shih: MATTEO MANDALÀ, "Arbëreshët dhe arbërishtja në veprën e Gustav Meyer-it (1850-1900)", në: REXHEP ISMAJLI (përgatiti), *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2018, f. 163-177.

6 Shih: GAETANO PETROTTA, "*Popolo, Lingua e Letteratura albanese*", Saggio Monografico, tipografia Pontificia (Catania), Palermo, 1931 (botimi i dytë është i vitit 1932). Vepra e Petrottës mbi historinë e letërsisë shqiptare është ribotuar me titull: GAETANO PETROTTA, *Studi di storia della letteratura albanese* (vëll. I: *Popolo, Lingua e Letteratura albanese*; vëll. II: *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese*), a cura di MATTEO MANDALÀ, A. C. Mirror, Palermo, 2003.

disa shkrime kritike, duke rimarrë e thelluar tema dhe çështje që kishte pasur rast të trajtonte edhe më parë (kujtojmë këtu, për shembull, studimin e pabotuar *Një shkrim i panjohur i De Radës*, shkruar në vitin 1929).

4. E folmja e Horës së Arbëreshëve u bë kështu objekti i tezës së diplomës që u diskutua dhe u mbrojt në Vjenë në 1933 përballë profesorëve të tij të shquar Jokl, Kretschmer dhe Patsch. Punimi shkencor, i njohur me titullin “Studime arbëreshe” (*Italoalbanische Studien*)<sup>7</sup>, u miratua me vlerësime që ngrinin lart metodologjinë e zbatuar dhe çmonin kontributet risore që sillte në lëmin e dialektologjisë shqipe.



Pa hyrë në aspekte që ende sot ngjallin interesin e studiuesve, sikurse dëshmon botimi këto kohët e fundit i originalit, përgatitur nga kolegët Oskar E. Pfeiffer, Joachim Matzinger dhe Heiner Eichner (Harrassowitz, Vienna, 2017<sup>8</sup>), që shpresojmë të përkthehet e të botohet edhe në italishte, është rasti këtu të shënojmë faktin se gjuhëtari i ri nuk hoqi kurrë dorë nga ajo përvojë e parë kërkimore në terren, qoftë sepse në vitet që vijuan do t’u rikthehet shpesh rezultateve të atij studimi të parë dialektologjik, duke i rishikuar e plotësuar ato, qoftë edhe sepse bota arbëreshe, që kishte lënë gjurmë të pashlyeshme në vizionin shkencor të Çabejt për albanologjinë, vazhdonte të ofronte të dhëna të rëndësishme për studime të

<sup>7</sup> EQREM Çabej: *Italoalbanische Studien*. Dissertation zur Erlangung des Doktorgrades an der Universität Wien, 1933.

<sup>8</sup> EQREM Çabej: *Italoalbanische Studien. Wiener Dissertation aus dem Jahr 1933*, mit Beigaben von OSKAR E. PFEIFFER und JOACHIM MATZINGER; herausgegeben von HEINER EICHNER und JOACHIM MATZINGER, Albanische Forschungen 34, Otto Harrassowitz GmbH & Co. KG (Verlag), Wiesbaden, 2017.

mëtejme. Këtë e dëshmojnë programet didaktike të lëndëve që nisi të jepte mësim studiuesi ynë i ri në gjimnazin e Shkodrës, në shkollën normale të Elbasanit dhe në gjimnazet e Tiranës e të Gjirokastrës, por mbi të gjitha në studimet etnografike që botoi asokohe, si *Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare*, që doli në revistën “Normalisti” në vitin 1934<sup>9</sup>. Vijnë shumë studime të tjera të cilat dëshmojnë ndërthurjen fatlume të disa disiplinave dhe metodave, një lloj hibridizmi epistemologjik që hapte shtigje të reja për studimin e fakteve kulturore e njëherazi zgjeronte horizontet e albanologjisë bashkëkohore, duke përfshirë në të disiplina që më parë konsideroheshin shumë të largëta njëra me tjetrën: gjuhësia dhe dialektologjia ballkanike, filologjia, letërsia, historia dhe antropologjia kulturore. Kjo zgjedhje u ritheksua me forcë në vitet që vijuan (1935-1939), kur dolën në dritë një sërë studimesh dhe monografish, mes të cilave kujtojmë *Tekste italo-shqiptare në Hyllin e Dritës*<sup>10</sup>, *Sitten und Gebräuche der Albaner*<sup>11</sup>, *Mundartliches aus Italien*<sup>12</sup>, *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*<sup>13</sup>, *Albaner und Slave in Südtalien*<sup>14</sup>, *Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut*<sup>15</sup>, *Për gjenezën e literaturës shqipe*<sup>16</sup>, *Shqiptarët n'Itali të Mesme dhe në Napoli*<sup>17</sup> studime të cilat përvijuan një fizionomi të re të kërkimeve shkencore për Çabejn. Ishte fjala për një hapësirë autonome që synonte të eksploronte sektorë në shumë aspekte ende

9 EQREM Çabej: “Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare” në *Normalisti*, nr. 6, Shkolla Normale, Elbasan, 1934, f. 19-22.

10 EQREM Çabej: “Tekste italo-shqiptare në *Hyllin e Dritës*”, in *Hylli i Dritës*, anno XI, nr. 4, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1935, f. 196-206.

11 EQREM Çabej: “Sitten und Gebräuche der Albaner”, në *Revue internationale des études balkaniques*, II (1935), Beograd, 1935, f. 556-572.

12 EQREM Çabej: “Mundartlichen aus Italien. Für die Kretschmer Festschrift”, në *Glotta*, XXV(1936), f. 50-57.

13 EQREM Çabej: *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Tiranë 1936 (ribotim anastatik, Botime Çabej, Tirana, 2009).

14 EQREM Çabej: “Albaner und Slaven in Südtalien” në *Revue internationale des études balkaniques*, VI (1938), Beograd, 1938, f. 555-566.

15 EQREM Çabej: “Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut” në *Hylli i Dritës*, anno XIV, nr. 2-3, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1938, f. 77-85.

16 EQREM Çabej: “Për gjenezën e literaturës shqipe” në *Hylli i dritës*, vjeti XIV, 12(1938), f. 647-661; vjeti XV, 1(1939), f. 8-15; 2 (1939), f. 84-93; 3-7 (1939, f. 149-180, Shkodër, 1938-1939). Në vitin 1939 doli libri me të njëjtin titull *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1939.

17 EQREM Çabej: “Shqiptarët n'Itali të Mesme dhe në Napoli” në *Hylli i Dritës*, vjeti XV, nr. 11-12, Scutari, 1939, f. 542-546.

të panjohur, madje deri edhe të injoruar, të kulturës shqiptare dhe që ndërkohë përbënin një suazë të përshtatshme për zbatimin e vizionit paradigmatic të Çabejt. Me këtë rast duhet saktësuar se nëse marrim parasysh studimet e lartpërmendura nga një pikëpamje globale, do të vëmë re varësinë e Çabejt nga metoda që kishte zbatuar Jokl në veprën e vet me titull *Linguistisch-kulturhistorische Untersuchungen aus dem Bereiche des Albanischen* (1923), vepër kjo që kishte përruruar – sikurse e vuri në dukje me mprehtësi Carlo Tagliavini (1903-1982) – një «model të historisë gjuhësore-kulturore në një lëmë veçanërisht të vështirë»<sup>18</sup> si ai i albanologjisë<sup>19</sup>. Në vizionin e tij shkencor të fundviteve '30, Çabej jo vetëm që kishte përvijuar qartë kufijtë e interesave të tij shkencorë, por mbi të gjitha kishte asimiluar dhe përdorur mjeshtërisht metodologjitë më të përparuara të kohës. Këto merita ia njohu edhe Holger Pedersen (1867-1953), një nga indoeuropianistët më të shquar dhe autor studimesh të rëndësishme në fushën e ballkanistikës dhe të albanologjisë. Duke e falënderuar studiuesin e ri shqiptar për kopjet e studimeve që i kishte dërguar, shkencëtari danez nuk ngurroi ta përgëzonte për kontributet e veçanta, përmes shprehjesh që sot duken si profetike dhe që ia vlen t'i sjellim këtu poshtë:


«Doktori im i mirë! Shumë falemnderit për dërgimin miqësor të studimeve tuaja interesante “Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut”, “Albaner und Slaven in Süditalien” dhe “Miszellen”. Është kënaqësi e madhe që tani (për të parën herë) një shqiptar i lindur po studion gjuhën dhe historinë e popullit të tij duke dëshmuar se e

---

18 CARLO TAGLIAVINI: “JOKL, Norbert”, *ad vocem* në *Enciclopedia Italiana*, II Appendice, 1949.

19 Ja se ç'thotë vetë Çabej: «Në pikëpamje stilistike kjo metodë shfaqet në këtë, që Jokli një paraqitjeje sistematike të thatë i parapëlqen traktatin monografik. Prandaj vlerat vetiake të veprave të Joklit janë thellësia dhe pushtimi i objektit nga të gjitha anët. Një vend me rëndësi në veprat e tij zë dhe konsiderimi i elementeve të kulturës materiale: “Fjalët dhe sendet”, drejtimin e gjuhësisë, që shpalli për të parën herë Jakob Grimm dhe që e themeloi kryesisht Rudolf Meringer, domethënë që krahas me fjalët të kihen parasysh edhe sendet përkatëse, edhe këtë drejtim e përvetësoi Jokli dhe e vuri në zbatim në lëmë të shqipes. Kjo vërehet hap më hap si në artikujt e tij, si sidomos në kryeveprën e tij të vitit 1923, e cila mban titullin „Kërkime gjuhësore-kulturhistorike nga fusha e gjuhës shqipe“. Me këtë mënyrë veprat e tij kanë rëndësi edhe përtej caqeve të linguitikës, në lëmë të etnografisë shqiptare. Materialin etnografik Jokli e ka nxjerrë sidomos nga veprat e F. Nopcsas, shumë herë edhe në bisedime private me këtë njohës të shquar të kësaj disipline shkencore.», f. 15-16.

zotëron plotësisht metodën që përdoret në Europën perëndimore»<sup>20</sup>.



Pa e tepruar mund të themi se vlerësime të tilla dëshmojnë që me Çabejn albanologjia jo vetëm që ngrihej në një nivel të mirëfilltë shkencor, por edhe se, si heroi i baladës arbëreshe, kthehej në shtëpi të vet përmes veprës shkencore të një biri të denjë!

5. Kërkimet intensive, që Çabej zhvilloi fill pas diplomimit, u pasuan nga një veprimtari po aq e dendur shkencore gjatë pesëvjeçarit të parë të viteve '40. Pas pushtimit fashist të Shqipërisë, Çabej u dërgua në Romë dhe gjatë kësaj periudhe të dytë qëndrimi në kryeqytetin italian, mori pjesë në projektin e hartimit të një *Atlasi gjuhësor të shqipes*, për të cilin përpiloi një pyetësor të parë të vëllimshëm me plot 2578 pyetje, që u botua në vitin 1943 nga shtypshkronja e famshme e Manastirit të Grottaferratës edhe falë angazhimit të Nilo Borgia-s, për të cilin më pas Çabej shkroi një nekrologji plot nderim dhe mirënjohje. Ndërkohë e shfrytëzoi këtë periudhë qëndrimi në Romë për të rigjallëruar marrëdhëniet e vjetra të miqësisë me arbëreshët që banonin në atë qytet dhe për të vazhduar studimet albanologjike, duke zbuluar vepra që më parë nuk i njihje. Mes këtyre të fundit kujtojmë veprën historiografike *Tesoro di notizie su de' Macedoni (1775)*<sup>21</sup>, të arbëreshit nga

20 «Sehr geehrter Herr Doktor ! Ich danke Ihnen herzlich für die freundliche Zusendung Ihrer interessanten Aufsätze “Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut”, “Albaner und Slaven in Süditalien” und “Miscellen”. Es ist sehr erfreulich, dass jetzt (wohl zum ersten Mal) ein geborener Albaner die Sprache und Geschichte seiner Volkes mit voller Beherrschung der in Westeuropa ausgebildeten Methode behandelt». Tekstin e cituar të Pedersenit ma dha me dashmirësi Brikena Çabej, të cilën e falënderoj përzemërsisht.

21 NICOLÒ CHETTA: *Tesoro di notizie su de' Macedoni*, Introduzione di MATTEO MANDALÀ, Trascrizione di GIUSEPPA FUCARINO, Contessa Entellina, 2002.

Contessa Entellina, Nicolò Chetta, tek i cili Çabej njohu themeluesin e «një metode kërkimi thuajse moderne dhe globale» të përpunuar «duke shtënë në përdorim përveç dëshmimeve të gjuhës, edhe ato të etnografisë, të historisë dhe të onomastikës» dhe

«duke kombinuar dëshmitë gjuhësore me të dhënat e historisë e të etnografisë: trajtat dialektore edhe emrat e familjeve, të vendeve e të shenjtoreve lokalë të ngulimeve me dëshminë e dokumenteve, të regjistrave kishtarë të tyre, me traditën gojore të gjallë në Shqipëri e në Itali, me elementet e kostumeve, të dokeve e të zakoneve, me disa motive të përbashkëta të poezisë popullore [...]»<sup>22</sup>.

Me fjalë të tjera, kemi të bëjmë me të njëjtën metodë që përdori vetë Çabej, duke kombinuar dy fazat kryesore të zhvillimit të albanologjisë: atë fillestare dhe parashkencore të shek. XVIII dhe atë të pjekurisë së plotë shkencore të shek. XX.

Punimet që u përkasin viteve të fundit të Luftës II botërore, paçka se më të pakta në numër, ruajnë të njëjtin impostim metodologjik multidisiplinar, si edhe dëshmojnë tërthorazi vështirësitë dhe pengesat e shkaktuara nga situata politike e asaj kohe. I detyruar të kthehej me ngut në Shqipëri për shkak të vdekjes së papritur të të vëllait, Çabej përjetoi vendosjen e diktaturës komuniste dhe pësoi kufizimin gradual të lirisë duke u bërë edhe ai viktimë e sistemit shtypës të policisë politike. Mirëpo kjo nuk e pengoi të vijonte veprimtarinë kërkimore, që arriti kulmin me botimin e disa studimeve të cilat me të drejtë sot konsiderohen si “vepra klasike” të albanologjisë. Pa mundur t’i përmend këtu të gjitha, po mjaftohem të kujtoj vetëm ato që përbëjnë monumente të mirëfillta për sektorët themelorë të albanologjisë.

6. Vepra e parë që zbuloi përgatitjen poliedrike të Çabejt ishte botimi kritik i *Mesharit*. Vepra e Gjon Buzukut, meqenëse përbën librin e parë që njohim në gjuhën shqipe, ka tërhequr gjithmonë vëmendjen e studiuesve dhe sidomos ka ngjallur interesin e filologëve. Mes këtyre të fundit, i pari që u mor më të ishte Imzot Paolo Schirò (1866-1941), filologu nga Hora e Arbëreshëve, që pati edhe meritën “ta rizbulonte” përkthimin shqip të Buzukut e të

---

22 EQREM Çabej: *Në botën e arbëreshëve të Italisë. Përmbledhje studimesh*, Parathënia nga MAHIR DOMI, redaktori NELSON Çabej, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1987, f. 62.



njoftonte botën albanologjike për këtë zbulim, duke përgatitur edhe një botim kritik që ka mbetur i pabotuar, përjashtuar një përmbledhje e pjesshme e përgatitur në vitin 1932 nga papas Gaetano Petrotta në një artikull të botuar në *Rivista Indo-Greco-Italica*<sup>23</sup>. Çabej jo vetëm që e çoi deri në fund punën e nisur nga Imzot Paolo Schirò, për punën filologjike të të cilit shprehu vlerësime të larta, por u shty edhe më tej duke përvijuar gjendjen e studimeve ekdotike në Shqipëri dhe duke parashtruar nevojën e përshtatjes së metodologjive filologjike moderne për studimin dhe botimin e teksteve të vjetra të shqipes. Ideja e tij për të vendosur në qendër të vëmendjes tekstin, problemet dhe strukturën e tij, - duke filluar nga gjuha, por edhe stili, pra forma dhe shkrimi - pa lënë pas dore gjithçka që vërtitet rreth tekstit (autorin, kontekstin historiko-kulturor, diakroninë tekstore), përmbliidhte parimet themelore të traditës më të mirë të studimeve perëndimore në lëmë të filologjisë, që Çabej - pa e pohuar haptazi, - i kundërvinte prirjes ideologjike të importuar në Shqipëri nga shkolla sovjetike, që sikurse dihet nuk i vlerësonte qasjet formale. Në fakt, botimi kritik i *Mesharit*, që ishte gati për shtyp qysh nga fundi i viteve '50, por për shkak të vështirësive teknike doli në dy vëllime vetëm në vitin 1968, përfaqësoi një shembull paradigmatic për filologët e brezave të ardhshëm dhe veçanërisht për studiuesit arbëreshë që gjatë viteve '90 të shekullit të shkuar e morën si model referimi për të zhvilluar më tej studimet filologjike.

Krahas punës ekdotike me tekste të vjetra, gjatë viteve '50 e '60 Çabej ua hyri studimeve etimologjike, të cilave do t'u kushtonte pjesën më të madhe të kohës. Në fakt, studimet etimologjike në fushë të shqipes nevojën e të cilave e kishte shtruar qysh nga vitet '50 në artikullin *Gjendja e sotme e etimologjisë së gjuhës shqipe. Përfundime, probleme, perspektiva* (1957<sup>24</sup>), vijuan pa ndërprerje për më se dy dhjetëvjeçarë dhe u përmblodhën në botime të ndryshme: së pari në 28 artikuj që u botuan mes viteve 1961-1968 në *Buletinin e Universitetit Shtetëror të Tiranës*; më pas u përmblodhën në dy vëllimet e para të gjerdanit *Studime gjuhësore* që doli në

---

23 GAETANO PETROTTA - PAOLO SCHIRÒ: "Il più antico testo di lingua albanese: Gjon Buzuku (1555)", në *Rivista indo-greco-italica di filologia, lingua e antichità*, 1935.

24 EQREM ÇABEJ: "Gjendja e sotme e etimologjisë së gjuhës shqipe. Përfundime, probleme, perspektiva" në *Nëndori*, viti IV, nr. 8, Tiranë, 1957, f. 194-206.

1976 në Prishtinë dhe paralelisht në *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëllimi parë i të cilave (A-B, 1976) doli nga shtypi në gjallje të autorit. Gjithë kurpusi etimologjik, që doli pas vdekjes në shtatë vëllime, nën kujdesin e Akademisë së Shkencave dhe të Brikena Çabejt, përbën një trashëgimi të vyer për albanologjinë e sotme dhe bart trajtat shkencore të metodës së zbatuar nga Çabej në një nga lëmenjtë më të vështirë të dijes gjuhësore. Në hullinë e themeluesve të etimologjisë së shqipes – përveç treshes Meyer - Jokl - Pedersen dua të kujtoj këtu edhe Dhimitër Kamardën (1821-1882) nga Hora e Arbëreshëve në Sicili, vepra e të cilit citohej vazhdimisht nga studiuesi ynë -, Çabej e zhvilloi më tej këtë fushë studimesh duke marrë nga kontributi i paraardhësve aspektet më të rëndësishme, sidomos ato që vinin në pah protokollet e ndryshme të diakronisë. Rol të veçantë luajti vepra e profesorit të tij Joklit, nga mësimet e të cilit Çabej nuk u largua kurrë, duke vlerësuar sidomos parimin “Fjalët dhe sendet” (nga gjerm. *Wörter und Sachen*) që e bazon shpjegimin etimologjik të një fjale mbi realitetin, mbi të dhënat e kulturës materiale, të etimologjisë dhe të së drejtës zakonore. Jo më kot Çabej do të theksojë rëndësinë që ka etimologjia për historinë e kulturës dhe për etnologjinë; dhe anasjelltas rëndësinë e këtyre disiplinave për studimet etimologjike dhe për gjuhësinë në përgjithësi. Këto konsiderata të përgjithshme, të shprehura në një artikull përkujtimor, botuar në vitin 1972 me rastin e tridhjetëvjetorit të vdekjes së Joklit<sup>25</sup>, na japin një ide, sado të përciptë, të metodës konkrete etimologjike që ndiqte Çabej në kushte izolimi, por nuk hedhin dritë mjaftueshëm mbi dijet e tij të thella për gjuhët, kulturat, traditat, dhe historinë e popujve të ndryshëm, që e ndihmuan në shumë raste të zgjidhte probleme të vështira të historisë së gjuhës shqipe. Analizat gjuhësore të veprave të Buzukut e të Budit, si edhe studimet e shumta në lëmin e dialektologjisë dhe të gjuhësisë diakronike, kurorëzuan rezultatet shkencore të Çabejt gjatë viteve '60 e '70. Nuk munguan po ashtu kontributet në lëmin e kritikës letrare dhe, natyrisht, as studimet kushtuar arbëreshëve,

---

25 Shih EQREM Çabej: Në tridhjetëvjetorin e vdekjes së Norbert Joklit në *Mësuesi*, 25 tetor, 1972, cituar sipas ribotimit në: NORBERT JOKL, *Studime përmbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes*, përktheu nga origjinali gjermanisht EQREM Çabej, Botime Çabej, Tiranë, 2017, f. 8-9.

qoftë falë miqësisë së vjetër, qoftë edhe për rëndësinë objektive të trashëgimisë së tyre kulturore. Mes këtyre studimeve të fundit po mjaftohemi të përmendim *Poezia popullore e Arbëreshëve të Italisë* (1961)<sup>26</sup>, *Die Herkunftsfrage der albanischen Kolonien in Italien im Lichte vornehmlich der Sprache und der Eigennamen* (1963)<sup>27</sup>, *Su alcuni elementi balcanici antichi nell'Italia meridionale e in Sicilia* (1965)<sup>28</sup>, *Vatra dhe bota në poezinë e De Radës* (1965)<sup>29</sup>, *Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre* (1968-1970)<sup>30</sup>, *Zum Wortschatz der albanischen Mundarten in Kalabrien* (1968)<sup>31</sup>, *Për një shtresim të huazimeve turke të shqipes* (1975)<sup>32</sup>, për të mos zënë ngoje shumë studime të tjera që përmbajnë referime të shpeshta ndaj të folmeve, letërsisë dhe trashëgimisë antropologjike arbëreshe.

7. Eqrem Çabej u rikthye te arbëreshët në prill të vitit 1977, si i ftuar nderi në Javën e Parë të Kulturës Arbëreshe, organizuar në Shën Mitër Koronë nga i paharruari papas Sepa (Giuseppe) Faraco (1936-1998), themeluesi i Shoqatës kulturore “Zjarri” dhe i revistës

26 EQREM Çabej: “Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë” në *Arësimi popullor*, viti XVII, nr. 10, f. 78-81, Tiranë, nëntor-dhjetor 1961.

27 EQREM Çabej: “Die Herkunftsfrage der albanischen Kolonien in Italien im Lichte vornehmlich der Sprache und der Eigennamen” në *Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences. Amsterdam 1963*. Ed. D.P. Blok. Mouton, The Hague – Paris, 1966, f. 70-81. Ribotuar shqip me titullin: “Çështja e prejardhjes së ngulimeve arbëreshe të Italisë në dritën kryesisht të gjuhës e të emrave vetiakë” në *Studime filologjike*, viti XX (IX), nr. 2, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1972, f. 23-33.

28 EQREM Çabej: “Su alcuni elementi balcanici antichi nell'Italia meridionale e in Sicilia” në *Rendiconti dell'Istituto Lombardo di Scienze e Lettere. Classe di Lettere. Vol. 99*, 1965, f. 213-218. Botuar shqip: “Mbi disa elemente ballkanike të lashta në Italinë Jugore” në *Studime filologjike*, viti XXIX(XII), nr. 3, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1975, f. 9-14.

29 EQREM Çabej: “Vatra dhe bota në poezinë e De Radës” në *Jeronim De Rada: me rastin e 150-vjetorit të lindjes*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1965, f. 50-55.

30 EQREM Çabej: “Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre” në *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti-Skënderbeut* (Tiranë 12-18 Janar 1968), III, Universiteti shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1970, f. 107-115.

31 EQREM Çabej: “Zum Wortschatz der albanischen Mundarten in Kalabrien” në *Serta romanica. Festschrift für Gerhard Rohlfs zum 75. Geburtstag*. M. Niemeyer Verlag, Tübingen, 1968, f. 115-124. Botuar shqip me titullin “Nga leksiku i dialekteve arbëreshe të Italisë” në *Studime filologjike*, viti XXXII (XVI), nr. 2, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1979, f. 51-59.

32 EQREM Çabej: “Për një shtresim të huazimeve turke të shqipes” në *Studime filologjike*, viti XXIX(XII), nr. 4, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1975, f. 79-86.

me të njëjtin titull që ai vetë drejtonte.



Në të vërtetë ftesa për studiuesin shqiptar bazohej jo vetëm te emri i mirë që ai gëzonte mes arbëreshëve për shkak të interesit që kishte dëshmuar për kulturën dhe gjuhën e tyre, por edhe te kontaktet që kishte vendosur me grupin e studiuesve të rinj që bashkëpunonin me papas Faraco-n dhe revistën e tij. Pikërisht në dy numra të njëpasnjëshëm të “Zjarrit” të vitit 1976 Çabej botoi studimin *Gli italo-albanesi e le loro parlate*<sup>33</sup>, që në fakt është një version i shkurtuar i kumtesës që kishte mbajtur një vit më parë me rastin e Konferencës XI të Qendrës së Studimeve të Dialektologjisë Italiane (XI Convegno del Centro Studi di Dialettologia Italiana), zhvilluar në Kalabri në datat 1-4 prill 1975, dhe botuar një vit më vonë me titullin *Storia linguistica e struttura dialettale dell'albanese d'Italia*<sup>34</sup>, një nga kontributet dialektologjike më të rëndësishme kushtuar të folmeve arbëreshe. Në kumtesën e tij Çabej nënvizoi “kontributin e arbëreshëve për kulturën shqiptare”, duke i njohur *ante litteram* komunitetit shqipfolës të Italisë meritat e pamohueshme që vetëm

33 EQREM Çabej: “Gli italo-albanesi e le loro parlate” in due numeri consecutivi della rivista *Zjarri: rivista di cultura albanese*, anno VIII, nr. 1-2, San Demetrio Corone, 1976, f. 18-24 e anno IX, nr. 1-2, 1977, f. 3-12. Ribotuar në FRANCESCO ALTIMARI e LEONARDO M. SAVOIA (a cura di), *Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe*, Bulzoni, Roma, 1994, f. 85-105.

34 EQREM Çabej, “Storia linguistica e struttura dialettale dell'albanese d'Italia” in *Problemi di morfosintassi dialettale*, IX, Atti dell'XI Convegno del C.S.D.I. - Cosenza-Reggio Calabria, 1-4 Aprile 1975, Pacini editore, Pisa, 1976, f. 5-30. Botuar në shqip me titullin “Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë” në *Studime filologjike*, viti XXIX (XII), nr. 2, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1975, f. 51-69.

këto kohët e fundit po pranohen edhe në Shqipëri.

Java që kaloi mes arbëreshëve të Kalabrisë ishte një rast më shumë, pas atij të tridhjetë vjetëve më parë në Horën e Arbëreshëve të Sicilisë, për të mbledhur të dhëna gjuhësore, për të thelluar njohjen e traditave antropologjike, për të studiuar të tjera vepra të panjohura a të lëna pas dore nga studiuesit, për të vlerësuar qoftë kontributin e shoqatave kulturore, qoftë veprimtarinë e zhvilluar nga katedra e sapolindur albanologjike pranë Universitetit të Kalabrisë dhe e drejtuar nga albanologu arbëresh papas Francesco Solano (1914-1999). Në vitet që vijuan do të jetë pikërisht prof. Solano, që u bë mik i ngushtë me Çabejn, ai që do të udhëheqë grupet e para të studentëve arbëreshë në Shqipëri, duke sjellë kështu një valë lirie në një vend që atyre viteve ishte shndërruar në një burg në qiell të hapur. Miqësia që lidhën këta dy intelektualë të shquar ka mbetur proverbiale ndër të rinjtë që asokohe po i qaseshin albanologjisë: Solano e vlerësonte Çabejn si

«shumë të përgatitur; ishte më i miri, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Itali [...]; përveçse i ditur dhe erudit i madh, ishte edhe një zotëri i vërtetë, me sjellje europiane, një fisnik [...]; i pajisur me një përgatitje të plotë, jo vetëm gjuhësore. Ishte një njeri i mirë, kulturalisht i pasur në të gjitha kuptimet».

Çabej, nga ana e tij, nuk u mjaftua me fjalë, pasi duke sfiduar rregullat e rrepta të regjimit, nuk ngurroi ta ftonte mikun arbëresh në shtëpi: ajo ftesë që nuk u bë dot e mundur, na dëshmon besimin e ndërsjellë që lidhte këta dy personalitete të botës shqiptare.

Takimet e Çabejt me arbëreshët në fund të viteve '70 qenë tejet emocionuese, pasi ishin të fundit. I sëmurë rëndë, studiuesi shqiptar do të udhëtojë përsëri drejt Italisë me shpresën e kotë se mund t'i shpëtonte fatit tragjik që do të përmbushet më 13 gusht 1980 në Romë, qytetin që e pa për herë të fundit në jetë.

8. Gjatë përshkrimit të këtij profili të shkurtër bio-bibliografik të prof. Eqrem Çabejt kemi ngulur këmbë te karakteri i larmishëm i formimit të tij dhe te zhdërvjelltësia e jashtëzakonshme që shquante metodën e tij të kërkimit. Kjo nuk ka qenë aspak e lehtë, sikurse mund ta konfirmojnë ata që e njohin veprën poliedrike të këtij studiuesi të madh. Mirëpo duhet thënë edhe se kemi të bëjmë me një zgjedhje të vetëdijshme, pasi paradigma hermeneutike, së bashku me

karakterin etik shembullor të mësimëve që na ka dhënë Çabej duhen rivlerësuar veçanërisht sot, kur jemi dëshmitarë të ringjalljes ciklike të sharlatanizmit endemik tipik shqiptar, kundër të cilit u ngrit hapur qysh në vitin 1929 studenti i ri i Universitetit të Vjenës kur botoi artikullin me titullin domethënës *Kundër pseudofilologëve*. Në ato shënime Çabej dëshmonte se kishte asimiluar parime solide etiko-shkencore të cilat, nga njëra anë, e udhëhoqën në përpjekjet për të përvijuar kufijtë e rinj epistemologjikë të asaj shkence ndërdisiplinare që në përputhje me traditën perëndimore dhe europiane parapëlqeu ta quante “Albanistikë”; dhe nga ana tjetër, i pajisën me argumente shkencore pozicionet e tij doktrinare, fillimisht kundër çdo forme diletantizmi, pastaj kundër prirjeve ideologjike të “pedagogjisë popullore” që synonte ta vinte shkencën në shërbim të nevojave divulgative dhe propagandistike të regjimit. Si për të evidentuar këto dy synime doli në dritë botimi i parë i përmbledhjes së studimeve të Eqrem Çabejt: dashuria që albanologu i madh ushqente për arbëreshët dhe për universin kulturor që ata përfaqësonin, përbënte një mjet të dobishëm në shërbim të ruajtjes së shëndetit kulturor të Arbërisë përtej Adriatikut. Këtë fakt e theksoi edhe një tjetër studiues i shquar, prof. Mahir Domi (1915-2000), kur në krye të parathënies së librit kujtoi, nga njëra anë, rolin që luajtën historikisht arbëreshët gjatë procesit të gjatë e të mundimshëm të formimit të lëmenjve shkencorë që përbëjnë albanologjinë bashkëkohore dhe, nga ana tjetër, vetëdijen e thellë që Eqrem Çabej kishte për atë rol dhe atë funksion:

«Gjuhëtari ynë i shquar, prof. Eqrem Çabej, gjatë veprimtarisë së tij të frytshme kërkimore shfaqti interes të përhershëm për problematikën arbëreshe, në radhë të parë për materialin gjuhësor e për folklorin arbëresh, por edhe për letërsinë e kulturën arbëreshe, për historinë e shpërnguljeve arbëreshe në Itali dhe të ngulimeve të krijuara prej tyre atje. Ky horizont i gjerë vështrimi është i lidhur me mendimin e theksuar më se një herë nga Eqrem Çabej se shfaqjet e jetës mendore nuk duhen parë të veçuara, por në bashkëlidhjet e tyre, me një studim shumëdisiplinor, duke u ndriçuar të dhënat e një fushe nga ato të fushave të afërta, duke mos u shkëputur asnjëherë të dhënat gjuhësore nga kushtet shoqërore, nga kuadri historik në të

cilin dalin»<sup>35</sup>.

Edhe për këto arsye parimet rinore të Çabejt, të karakterizuara nga sensi i masës dhe takti, e ruajnë aktualitetin e tyre, çka ia vlen të theksohet: të para në tërësi, ato parime evidentojnë nevojën për të luftuar degradimin shkencor dhe kulturor, e njëherazi kërkojnë modernizimin e metodave, gërshetimin e disiplinave të ndryshme, intensifikimin e kërkimeve organike dhe sistemore, zgjerimin e vizionit historik të dukurive kulturore që shqyrtohen, me fjalë të tjera, kërkojnë që studimet albanologjike të ndjekin rrugën e ndërmarrë nga Chetta, për të cilën Çabej pohoi se «në parim mbetet e drejtë»<sup>36</sup>.

Vëzhgimi dhe interpretimi i fakteve kulturore nuk mund të shkëputet, së paku për sa i përket albanistikës, nga njohja e traditës dhe nga rezultatet e arritura prej brezave pararendës. Asnjë ngrehinë nuk do t'i rezistonte dot kohës po të mos kishte mure të forta dhe themele të thella. Rezultatet e arritura nga Çabej gjatë veprimtarisë së tij të gjatë e të frytshme e kanë kapërcyer këtë sfidë, sepse vizioni i tij shkencor mbështetej mbi një truall të qëndrueshëm. Nuk është e tepërt të theksojmë se një rol të rëndësishëm në studimet e tij albanologjike e kanë luajtur qoftë kontaktet e tij me botën gjermanike, qoftë edhe kërkimet në botën arbëreshe. Ndoshta për këtë arsye ai e konsideronte trashëgiminë arbëreshe një burim të pashtershëm për njohjen dhe studimin e historisë së gjuhës shqipe dhe të përmasave të saj antropologjike dhe kulturore; ndoshta për të njëjtën arsye ai u njohu arbëreshëve meritën se kanë «vënë një gur themeltar në ndërtesën e kulturës shqiptare»<sup>37</sup>. Mirëpo dihet se një gur, sado i rrallë dhe i lashtë të jetë, nuk mund të flasë e të tregojë historinë e tij nëse nuk ka një arkeolog që t'i japë zë: Eqrem Çabej i dha zë historisë së arbëreshëve dhe ishte i pari që vlerësoi rolin e tyre në kulturën mbarëshqiptare, duke theksuar elementet më domethënëse për albanologjinë moderne. Por nuk mjafton me kaq. Nëse këto kohët e fundit albanologët arbëreshë të Kalabrisë dhe të Sicilisë kanë arritur të parashtrajnë argumente të reja në mbështetje

---

35 EQREM ÇABEJ: *Në botën e arbëreshëve të Italisë. Përmbledhje studimesh*, Parathënia nga MAHIR DOMI, redaktoi NELSON ÇABEJ, Shtëpia Botuese "8 Nëntori", Tiranë, 1987, f. 3.

36 *Po aty*, f. 62.

37 *Po aty*, f. 111.

të tezave të Çabejt, merita për këtë u takon edhe përpjekjeve prej pionieri të atij që në kohë të vështira ia doli të davaritë mjegullën e dendur që rrethonte historinë, gjuhën, letërsinë, kulturën dhe etnografinë e arbëreshëve dhe t'u tregojë të rinjve rrugën për një qasje epistemologjike më moderne dhe organike ndaj studimit të çështjeve ende të hapura të botës së tyre. Nga kjo pikëpamje është e drejtë të themi se edhe Eqrem Çabej *ka vënë një gur themeltar në ndërtesën e kulturës moderne arbëreshe!* Dhe për këtë arbëreshët do t'i jenë gjithmonë mirënjohës.

## Bibliografia

BORGIA, NILO: *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri. Shënime mbi misionet në Himarë: shek. XVI-XVIII*, me një parathënie nga Matteo Mandalà, "Naimi" - shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë, 2014.

Çabej, EQREM: "Albaner und Slaven in Süditalien" në *Revue internationale des études balkaniques*, VI(1938), Beograd, 1938, f. 555-566.

Çabej, EQREM: "Die Herkunftsfrage der albanischen Kolonien in Italien im Lichte vornehmlich der Sprache und der Eigennamen" në *Proceedings of the Eighth International Congress of Onomastic Sciences. Amsterdam, 1963*. Ed. D.P. Blok. Mouton, The Hague – Paris, 1966, f. 70-81.

Çabej, EQREM: "Gli italo-albanesi e le loro parlate" in due numeri consecutivi della rivista *Zjarri: rivista di cultura albanese*, anno VIII, nr. 1-2, San Demetrio Corone 1976, f. 18-24 e anno IX, nr. 1-2, 1977, f. 3-12. Riedito in Francesco Altimari e Leonardo M. Savoia (a cura di), *Studi linguistici e storico-culturali sulle comunità arbëreshe*, Bulzoni, Roma, 1994, f. 85-105.

Çabej, EQREM: "Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare" në *Normalisti*, nr. 6, Shkolla Normale, Elbasan, 1934, f. 19-22.

Çabej, EQREM: "Kostandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut" në *Hylli i Dritës*, anno XIV, nr. 2-3, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1938, f. 77-85.

Çabej, EQREM: "Mundartlichen aus Italien. Für die Kretschmer Festchrift", në *Glotta*, XXV(1936), f. 50-57.

Çabej, EQREM: "Ngulimet shqiptare në Itali dhe gjuha e tyre" në *Konferenca e dytë e studimeve albanologjike* me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti-Skënderbeut (Tiranë 12-18 Janar 1968), III, Universiteti shtetëror i Tiranës - Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1970, f. 107-115.



Çabej, EQREM: “Për gjenezën e literaturës shqipe” në *Hylli i dritës*, vjeti XIV, 12(1938), f. 647-661; vjeti XV, 1(1939), f. 8-15; 2(1939), f. 84-93; 3-7(1939, f. 149-180, Shkodër, 1938-1939. Në vitin 1939 doli libri me të një njëjtin titull *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Shtypshkronja Françeskane, Shkodër, 1939.

Çabej, EQREM: “Për një shtresim të huazimeve turke të shqipes” në *Studime filologjike*, viti XXIX(XII), nr. 4, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1975, f. 79-86.

Çabej, EQREM: “Poezia popullore e arbëreshëve të Italisë” në *Arësimi popullor*, viti XVII, nr. 10, f. 78-81, Tiranë, nëntor-dhjetor 1961.

Çabej, EQREM: “Shqiptarët n’Itali të Mesme dhe në Napoli” në *Hylli i Dritës*, vjeti XV, nr. 11-12, Scutari, 1939, f. 542-546.

Çabej, EQREM: “Sitten und Gebräuche der Albaner”, në *Revue internationale des études balkaniques*, II(1935), Beograd, 1935, f. 556-572.

Çabej, EQREM: “Storia linguistica e struttura dialettale dell’albanese d’Italia” in *Problemi di morfosintassi dialettale*, IX, Atti dell’XI Convegno del C.S.D.I. - Cosenza-Reggio Calabria, 1-4 Aprile 1975, Pacini editore, Pisa, 1976, f. 5-30.

Çabej, EQREM: “Histori gjuhësore dhe strukturë dialektore e arbërishtes së Italisë” në *Studime filologjike*, viti XXIX (XII), nr. 2, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1975, f. 51-69.

Çabej, EQREM: “Su alcuni elementi balcanici antichi nell’Italia meridionale e in Sicilia” në *Rendiconti dell’Istituto Lombardo di Scienze e Lettere*. Classe di Lettere. Vol. 99, 1965, f. 213-218. Botuar shqip: “Mbi disa elemente ballkanike të lashta në Italinë Jugore” në *Studime filologjike*, viti XXIX(XII), nr. 3, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1975, f. 9-14.

Çabej, EQREM: “Tekste italo-shqiptare në *Hyllin e Dritës*” in *Hylli i Dritës*, anno XI, nr. 4, Shtypshkroja Françeskane, Shkodër, 1935, f. 196-206.

Çabej, EQREM: “Vatra dhe bota në poezinë e De Radës” në *Jeronim De Rada: me rastin e 150-vjetorit të lindjes*, shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1965, f. 50-55.

Çabej, EQREM: “Zum Wortschatz der albanischen Mundarten in Kalabrien” në *Serta romanica. Festschrift für Gerhard Rohlfs zum 75. Geburtstag*. M. Niemeyer Verlag, Tübingen, 1968, f. 115-124. Botuar shqip me titullin “Nga leksiku i dialekteve arbëreshe të Italisë” në *Studime filologjike*, viti XXXII (XVI), nr. 2, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1979, f. 51-59.

Çabej, EQREM: *Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe*, Tiranë 1936 (ribotim anastatik Botime Çabej, Tirana, 2009).

Çabej, EQREM: *Italoalbanische Studien. Wiener Dissertation aus dem Jahr 1933*, mit Beigaben von OSKAR E. PFEIFFER und JOACHIM MATZINGER; herausgegeben von HEINER EICHNER und JOACHIM MATZINGER, Albanische Forschungen 34, Otto Harrassowitz GmbH & Co. KG (Verlag), Wiesbaden, 2017.

Çabej, EQREM: *Italoalbanische Studien*. Disertation zur Erlangung des Doktorgrades an der Universität Wien 1933.

Çabej, EQREM: *Në botën e arbëreshëve të Italisë*, botimi i dytë i plotësuar nga MATTEO MANDALÀ, Excipere 30, Botime Çabej, Tiranë, 2017.

Çabej, EQREM: *Në botën e arbëreshëve të Italisë. Përmbledhje studimesh*, Parathënia nga MAHIR DOMI, redaktori NELSON Çabej, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1987.

Çabej, EQREM: *Në botën e arbëreshëve të Italisë. Përmbledhje studimesh*, Parathënia nga Mahir Domi, redaktori Nelson Çabej, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1987.

Çabej, EQREM: *Studime filologjike*, viti XX (IX), nr. 2, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë 1972.

Çabej, EQREM: *Tra gli albanesi d'Italia. Studi e ricerche sugli Arbëreshë*, a cura di MATTEO MANDALÀ, Traduzione italiana di GIOVANNA NANJI, Besa Muci Editore, Nardò, 2021.

CHETTA, NICOLÒ: *Tesoro di notizie su de' Macedoni*, Introduzione di MATTEO MANDALÀ, Trascrizione di GIUSEPPA FUCARINO, Contessa Entellina, 2002.

EQREM Çabej: “Gjendja e sotme e etimologjisë së gjuhës shqipe. Përfundime, probleme, perspektiva” në *Nëndori*, viti IV, nr. 8, Tiranë, 1957, f. 194-206.

EQREM Çabej: *Në botën e arbëreshëve të Italisë. Përmbledhje studimesh*, Parathënia nga MAHIR DOMI, redaktori NELSON Çabej, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1987.

JOKL, NORBERT, *Studime përmbi etimologjinë dhe fjalëformimin e shqipes*, Përktheu nga origjinali gjermanisht Çabej, EQREM, Botime Çabej, Tiranë, 2017.

MANDALÀ, MATTEO: “Vepra e Nilo Borgia-s, burim i rëndësishëm për historinë e jugut të Shqipërisë” në NILO BORGIA, *Murgjit bazilianë të Italisë në Shqipëri*, cit., f. 7-18.

MANDALÀ, MATTEO: “Arbëreshët dhe arbërishtja në veprën e Gustav Meyer-it (1850-1900)” në REXHEP ISMAJLI (përgatiti), *Studimet albanistike në vendet ku flitet gjermanisht*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Prishtinë, 2018, f. 163-177.

PETROTTA, GAETANO – SCHIRÒ, PAOLO: “Il più antico testo di lingua albanese: Gjon Buzuku (1555)”, në *Rivista indo-greco-italica di filologia*,

*lingua e antichità*, 1935.

PETROTTA, GAETANO: *Popolo, Lingua e Letteratura albanese*, Saggio Monografico, tipografia Pontificia (Catania), Palermo, 1931.

PETROTTA, GAETANO: *Studi di storia della letteratura albanese* (völl: I: *Popolo, Lingua e Letteratura albanese*; vëll. II: *Svolgimento storico della cultura e della letteratura albanese*), a cura di MATTEO MANDALÀ, A. C. Mirror, Palermo, 2003.

TAGLIAVINI, CARLO: “JOKL, Norbert”, *ad vocem në Enciclopedia Italiana*, II Appendice, 1949.

Emil Lafe

## **SHTETI DHE GJUHA AMTARE NË VËSHTRIMIN E PROF. EQREM ÇABEJT**

Prof. Eqrem Çabej njihet kryesisht si historian i gjuhës shqipe, por ai ka qenë gjithnjë i lidhur edhe me ecurinë e zhvillimit të shqipes letrare dhe mori pjesë në të gjitha veprimtaritë e rëndësishme të organizuara nga Instituti i Shkencave (1946–1957) dhe më pas nga Universiteti i Tiranës e nga Akademia e Shkencave për shqipen letrare, sidomos për përpunimin e normës drejtshkrimore dhe të normës letrare në përgjithësi. E. Çabej dha një kontribut të rëndësishëm në përcaktimin e rregullave të drejtshkrimit të shqipes (projektet e viteve 1948, 1951, 1956, 1967). Gjatë diskutimit të projektit drejtshkrimor të vitit 1967 mori pjesë në një numër takimesh me arsimitarë në rrethe të ndryshme të vendit për të njohur drejtpërdrejt mendimet e tyre, që i dëgjonte me vëmendje. Më tej dha një kontribut të cilësuar në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e punimeve të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) dhe në vijim, gjatë gjithë vitit 1973, mori pjesë rregullisht dhe, me vetëdijen e një detyre të lartë shkencore e kombëtare, në mbledhjet e komisionit për hartimin e “Drejtshkrimit të gjuhës shqipe” në pajtim me Rezolutën e Kongresit.

E. Çabej gjatë gjithë jetës ndoqi nga afër ecurinë e zhvillimit të shqipes letrare, duke vlerësuar arritjet dhe duke u shqetësuar për mangësitë dhe problemet, sidomos për ruajtjen e veçantisë kombëtare të gjuhës sonë. Vlerësonte nevojën e organizimit shtetëror të punës shkencore për gjuhën shqipe, në fillim në Institutin e Shkencave, mandej në Universitetin e Tiranës dhe më pas në Akademinë e Shkencave. Duke bashkëpunuar me prof. Aleksandër Xhuvanin, për

të cilin ruajti gjatë gjithë jetës një nderim të veçantë, vlerësoi punën dhe përpjekjet e pareshtura të kolegut dhe mikut të tij për mbrojtjen e veçantisë kombëtare të gjuhës shqipe dhe për pasurimin e saj. E. Çabej mori pjesë në komisionin e terminologjisë tekniko-shkencore të ngritur në Institutin Shkencave më 1955 dhe ndoshta i përket atij kriteri i ndjekur nga ky komision që të synohej shqipërimi i termave jondërkombëtarë, “duke quajtur ndërkombëtarë ata terma që i kanë të përbashkët jo vetëm dy ose më shumë gjuhë neolatine, por që i kanë edhe gjuhët e tjera” (këtu kihen parasysht në radhë të parë gjermanishtja e rusishtja).

Në mbledhjen e Asamblesë së Akademisë së Shkencave në shkurt 1979 Eqrem Çabej mbajti referatin “Për pastërtinë e gjuhës”. Duke u nisur nga kjo temë, që përbën një fill të pashkëputur të politikës gjuhësore për shqipen veçanërisht që nga Rilindja e këtej, ai ngre si çështje madhore institucionalizimin e kujdesit të shtetit për mbarëvajtjen e gjuhës. E. Çabej, ashtu edhe si shumë intelektualë të brezit të tij, kishin vlerësim e nderim të veçantë për shtetin si institucion që siguron përparimin e zhvillimin e një vendi në të gjitha fushat dhe që bashkon fuqitë dhe energjitë e popullit për të mirën e përgjithshme. Unë besoj se nuk ishte e rastit që ai zgjodhi ta trajtonte këtë temë pikërisht në mbledhjen e Asamblesë së Akademisë, ku merrnin pjesë rregullisht edhe përfaqësues të lartë të shtetit. Marrëdhënia e shtetit me shkencën është e dyanshme: shteti i kërkon shkencës të zgjidhë detyra që lidhen me zhvillimin e vendit dhe shkenca i kërkon shtetit përkrahje për detyra të tjera, që i argumenton si të rëndësishme. Në referatin e tij ai pikërisht argumentoi në mënyrë bindëse domosdoshmërinë e kujdesit të drejtpërdrejtë e të përhershëm të shtetit për gjuhën, duke gjetur edhe mënyrën që kërkesa e tij të dëgjohej.

Ishte befasuese për dëgjuesit përmendja e Partisë që në frazën e parë të referatit të tij: “Gjuhësia shqiptare, në këtë periudhë kohe qysh prej çlirimit të vendit e këtej, me orientimet largpamëse dhe interesimin e përhershëm të Partisë, ka arritur suksese të shënueshme, mbërritje të rëndësishme në të gjitha degët e fushës gjuhësore. Rezultatet e gjuhësisë shqiptare kanë zënë vend tashmë në gjuhësinë europiane.” Me këtë hyrje ai u dha të kuptonin të pranishmëve se nuk do të dëgjonin më tej një referat teknik gjuhësor, po diçka

shumë më të rëndësishme. Dhe si akord i dytë madhor në vijim i referatit vjen pohimi i skalitur se: “Gjuha pasqyron një kombësi a komb, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture. Prandaj ringjalljet kombëtare kudo e në çdo kohë kanë shkuar hap më hap me pasurimin dhe pastrimin e gjuhës.” Kjo do të thotë se gjendja e gjuhës shqipe është pasqyra e vërtetë e kulturës dhe e kombësisë shqiptare, është fytyra kulturore e shtetit, ajo tregon cilët jemi dhe si jemi. Prandaj kjo çështje meriton gjithë vëmendjen dhe kujdesin e botës akademike dhe të institucioneve shtetërore.

Pasi siguroi kështu vëmendjen e Asamblesë, E. Çabej vijoi shtjellimin e disa ideve të rëndësishme për arritjet në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe dhe për problemet e këtij zhvillimi. Me një mënyrë mjeshtërore ai dha në vijim një vështrim sintetik për përpjekjet e lëvruesve të gjuhës shqipe dhe arritjet e tyre që nga autorët e vjetër deri në shek. XX. Dy janë rrugët kryesore që ndoqën ata: *e para*, marrja e fjalëve të gjalla të ligjërit popullor, p.sh. *landë/lëndë* me kuptim fillestar ‘dru si material ndërtimi’, që mori më pas kuptimet ‘materie’, ‘subjekt’, ‘temë’, ose fjala *rrymë* ‘rrjedhë e vrullshme e ujit; lëvizje e ajrit’, që e ka zgjeruar sferën e përdorimit me kuptime si *rrymë elektrike*, *rrymë letrare*, *politike* etj. Rruga e dytë është formimi i fjalëve të reja sipas analogjisë me fjalë të tjera popullore ose si huazime strukturore (kalke) prej gjuhësh të huaja. Një varg shembujsh të qëmtuar prej tij në shqipen e shkruar që nga autorët e vjetër e deri në shek. XX dëshmojnë interesimin e hershëm të E. Çabejt për të hulumtuar se si gjuha shqipe u ngrit shkallë-shkallë në nivelin e një gjuhe kulture dhe shtetërore. Përfundimi i tij, që vlen të mbahet parasys përherë, është: ”Gjuha e shkrimit dhe e bisedës që përdorim ne sot i ka rrënjët në gjuhën popullore të përpunuar gjatë kohëve. Ajo është rezultat edhe i përdorimit të fjalëve të gojës së popullit, edhe i punës së madhe të brezave të mëparshëm. Do të ishte me interes për historinë e gjuhës letrare e të shkrimit të hetohej se sidomos nga fjalët e leksikut abstrakt-mendor, te cili autor secila ndër to shfaqet për herë të parë, ose të paktën në cilin shkrim (vepër, revistë a gazetë) paraqitet së pari... Aty mund të dalë që një pjesë e mirë e leksemave të këtij lloji janë më të vjetra nga ç’mund të

kujtohet, dhe që një pjesë i ka pasur qëmoti edhe gjuha popullore.” (f. 41) Dhe si vërtetim i asaj që gjuha, duke përfshirë edhe gjuhën letrare, është një krijim kolektiv, ai vë në dukje ndihmesën e madhe që ka dhënë e po jep për pasurimin dhe pastrimin e gjuhës “masa e njerëzve të thjeshtë, nëpunës, arsimtarë, ushtarakë, specialistë të degëve të ndryshme.” (f. 40)

Nga përfundimi se gjuha jonë letrare (e shkrimit dhe e bisedës) “i ka rrënjët në gjuhën popullore të përpunuar gjatë kohëve” rrjedh edhe domosdoshmëria e pastërtisë së gjuhës. Ai e përforcon këtë ide me vëzhgimin e drejtë psikolinguistik, se: “fjalët e vendit kuptohen më mirë, rroken e përvetësohen më lehtë nga nxënësit e moshave të vogla, sepse u formojnë atyre shoqërimi (asociacione) idesh; ato gjejnë analogji në pasurinë leksikore që zotërojnë ata brenda sistemit të gjuhës amtare.” (f. 45) Duke qenë në këtë konferencë ndërmjet gjermanistëve, unë do të sillja si shembull këtu emërtimet e katër veprimeve elementare të aritmetikës: *mbledhje, zbritje, shumëzim, pjesëtim*, aq të qarta për nxënësin shqiptar, përballë *Addition, Subtraktion, Multiplikation, Divizion*, të cilat nxënësit në vendet e gjuhës gjermane janë të detyruar t’i mësojnë si fjalë të huaja, me kuptim të pamotivuar. Do të shtoja këtu edhe një rrethanë tjetër: fjala shqipe ka aftësinë të lëshojë filiza, se është, si të thuash në truallin e vet, ndërsa fjala e huaj është më pak prodhimtare e ndonjëherë mbetet shterpë. Le të përfytyrojmë sikur në vend të fjalëve *ndërgjegje* (që e kemi prej Kristoforidhit) dhe *vetëdije* (prej Naimit), të kishim sot në përdorim vetëm fjalën e huaj *koshiencë*. Do të na mungonin *i ndërgjegjshëm, ndërgjegjshmëri, ndërgjegjësohen, ndërgjegjësim; i vetëdijshëm, vetëdijësohem, vetëdijësim* etj.!

Me urtësinë e moshës dhe përvojën e punës në komisionin e terminologjisë E. Çabej e shikon me sy objektiv e të matur veprimtarinë për pastërtinë e gjuhës, duke pranuar qëndrime të diferencuara, p.sh. për një pjesë të madhe të terminologjisë së shkencave natyrore e mjekësore, që përdoret përbrenda specialitetit, shqipërimi i termave do të jetë më i kufizuar. Një rëndësi më të madhe merr ndërkaq problematika e pastrimit të degëve të leksikut shoqëror, elementet e të cilit janë në përdorim të një masë më e gjerë e shtresave të shoqërisë.

Pas këtij shtjellimi vjen kërkesa themelore e tij: shteti të mar-

rë në dorë drejtpërdrejt veprimtarinë për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës. Ja fjalët e tij:

“Duke kaluar nga fjalët në punë, jemi të mendimit se janë pjekur kushtet që një komision i përhershëm (permanent) t’i përvishet kësaj pune, plotësimi të kësaj detyre të madhe. Mendojmë që në këtë komision të marrin pjesë njerëz nga institutet dhe qendrat kërkimore të Akademisë së Shkencave dhe përfaqësues specialistë të degëve të ndryshme. Të gjenden rrugët e bashkëpunimit të tyre me ndërmarrjet, fabrikat dhe institucionet shkencore e të tjera të vendit. Do të ketë pjesëmarrje e bashkëpunim aktiv sidomos edhe nga ana e arsimtarëve të rretheve, sepse shkolla do të luajë një rol të dorës së parë. Do të duhet një punë individuale dhe kolektive, një punë e re e gjithanshme, punë sistematike dhe me afat të gjatë. Me këtë punë duhet të hapet një faqe e re e historisë sonë gjuhësore, një epokë e re e pastrimit dhe pasurimit të gjuhës letrare dhe të shkrimit. Duhet të kryhet në atë mes një rishikim i gjithë punës së deritanishme. Do të rishqyrtohen nga ky këndvështrim jo vetëm terminologjitë e ndryshme dhe fjalorët terminologjikë, po edhe fjalorët e tjerë që janë punuar deri më sot. Mendojmë gjithashtu se do të jetë vendi që të dalë ndonjë botim periodik me emrin “Gjuha jonë” ose “Gjuha shqipe”, që do t’u kushtohet kryesisht problemeve e detyrave të pasurimit e të pastrimit të gjuhës.”

“Fjalët e vendit dhe termat që do të zëvendësojnë me kohë elementin e huaj, do të shtihen në përdorim që në shkollat, që me moshën e re. Shumë fjalë që do të vendoset të përdoren e të hyjnë në gjuhë, edhe neve në fillim do të na duken pakëz si çudi. Porse brezat që do të vijnë, do t’i përdorin vetvetiu; sikurse kanë hyrë në përdorim shumë fjalë vendi që janë farkuar prej paraardhësve tanë e prej brezit tonë, janë për ne sot të natyrshme dhe janë bërë pronë e qëndrueshme e gjuhës. Në këtë punë me rëndësi kombëtare do të vepronhet me guxim bashkuar me kompetencë shkencore, dhe, si u tha, me hapa të matur, me maturi në punë. Ne edhe në fusha të tjera të veprimtarisë kulturore kemi ndërmarrë punë që vetë neve në fillim mund të na jenë dukur të parealizueshme, e që i kemi kryer. Sot më shumë se kurrë na shtrohet detyra që këtë gjuhë, një nga elementet kryesore të kombit tonë, ta pasurojmë me fjalë të visarit popullor dhe ta spastrojmë nga masa e lëndës së huaj. Po t’i përvishemi punës



që në fillim ashtu si duhet, kemi bindjen se nën udhëheqjen e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha edhe kësaj detyre do t'ia dalim mbanë.”

Siç e përmenda, referati i tij niste me përmendjen e Partisë dhe mbyllet përsëri me përmendjen e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha. Sot shumëkujt mund të mos i bjerë mirë në vesh kur e dëgjon. Por duhet të kemi parasysh kohën dhe rrethanat. Në një regjim totalitar për të arritur qëllimin duhet të bësh për vete kreun e shtetit. Këtë E. Çabej e kishte kuptuar prej vitesh. Një rast që e përforcoi ishte përpjekja e prof. Sotir Papahristos, filolog klasik (të cilin e kishte ndër njerëzit më të respektuar), për të hapur në Tiranë një lice ku të mësoheshin gjuhët klasike. Ai kishte bërë ndonjë përcapje për këtë në Ministrinë e Arsimit, por pa sukses. Vinte herë pas here në zyrën tonë për të takuar miqtë e vjetër E. Çabej dhe M. Domi dhe për të kërkuar mbështetjen e tyre. Një ditë, sa hyri në zyrë, pas përsëritjes së zakonshme me ndonjë thënie nga shkrimtarët e lashtë grekë, tha: “Do të bëhet ajo!” E. Çabej, që i dhimbsej çdo minutë kohë, hoqi syzet e punës dhe e ftoi mikun e tij ta shpjegonte më të plotë lajmin e mirë.

Sotir Papahristoja (1887–1979), gjatë kohës kur kishte shërbyer si drejtor administrativ në Liceun Francez të Korçës, kishte pasur nxënës Enver Hoxhën dhe gjatë kohës kur ishte drejtor i Institutit Femnor “Nana Mbretëshë” kishte pasur nxënëse Nexhmije Xhuginin. Kështu e kishte derën të hapur në atë shtëpi. Shkoi dhe i bindi që shkenca dhe kultura në Shqipëri kanë nevojë për njerëz të rinj që të zotërojnë mirë gjuhët klasike. Kështu “me porosi nga lart” në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja (sot “Asim Vokshi”) u hap në vitin shkollor 1965 një degë e gjuhëve klasike, pa të cilën sot nuk do të kishim prodhimin shkencor dhe letrar të Pëllumb Xhufit, Shpëtim Çuçkës, Pranvera Bogdanit (Novi), Nermin Bashës, Eliana Paços etj. Kjo i detyrohet largpamjes dhe këmbënguljes së prof. Sotir Papahristos.

Komenti i E. Çabejt pas këtij lajmi ishte: “Në Shqipëri njerëzit e vegjël kanë vullnet të mirë, po nuk kanë gjë në dorë. Ata nalt i kuptojnë drejt problemet, po nuk mund të shkojnë njeriu e t'i shqetësojë për gjithfarë hallësh që mund të ketë. Gjithë punët këtu i ngatërrojnë njerëzit e mesëm. Kështu ka qenë edhe më përpara!” Këta njerëz të mesëm, që kishin në dorë të bënin diçka, E. Çabej i ndante në dy

kategori: një palë që thoshin pse të bëhet? dhe një palë vullnetmirë që thoshin pse të mos bëhet?

Kjo ndodhi m'u kujtua në vitin 1988, kur ndodhesha me koleg-un tim të ndjerë Ali Dhrimo në Institutin e Gjuhësisë të Universitetit të Bonnit. Një ditë u njoftuam se ambasadori i parë i RFGJ në Shqipëri, Friedrich Kroneck do të mbante një konferencë për përshtypjet e tij pas disa muajsh detyrë në Shqipëri. Ndër gjërat që i kishin bërë më fort përshtypje, ai përmendi se në Shqipëri edhe për gjërat më të vogla, duhet t'u drejtohesh instancave më të larta. Sipas tij, meqë Shqipëria është një vend i vogël, instancat e larta nuk kanë me se ta mbushin ditën dhe merren edhe me çështje të dorës së dytë, që mund t'i zgjidhin të tjerët. E vërteta ka të bëjë me natyrën totalitare të regjimit të atëhershëm, që i përqendronte të gjitha kompetencat në instancat më të larta, siç e dinë mirë të gjithë ata që e kanë jetuar atë kohë.

Për të arritur atë që kërkonte, E. Çabej e hapi dhe e mbylli referatin e tij në mënyrën që përmenda. Por këtu dua të shtoj se ai ka qenë krejt i sigurtë në ato që tha. E. Çabej i vlerësonte arritjet e asaj kohe në shumë fusha të ekonomisë dhe të kulturës. Përveç kësaj, Enver Hoxha në fjalën me intelektualët mbajtur në Universitetin e Tiranës në shtator 1961 kishte përmendur se Eqrem Çabej nuk e mori baltën e atdheut në thembrat e këpucëve, po u kthye në atdhe nga Italia, ku kishte qëndruar nga viti 1940 deri në gusht 1944. Më 1972, me rastin e themelimit të Akademisë së Shkencave, Enver Hoxha kishte caktuar si kryetar prof. Aleks Budën, ndërsa Eqrem Çabej u ngarkua të mbante fjalën e hapjes si më i moshuari ndër akademikët – të dy me studime universitare në Vjenë.

Zv.kryeministri i asaj kohe, Manush Myftiu, e dëgjoi me shumë vëmendje fjalën e E. Çabejt dhe mbajti shënime, të cilat i përcolli më lart dhe kështu, me propozim të Akademisë së Shkencave më 7 prill 1979 doli vendimi i Këshillit të Ministrave “Për organizimin e punës për pastrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjuhës letrare shqipe”. Ky vendim i qeverisë, pas atij të vitit 1974, vuri në lëvizje gjithë institucionet shkencore dhe aparatit e shtetit për një kujdes më të madh dhe të përgjithshëm në përdorimin e shqipes letrare, në pasurimin e saj me fjalë të reja dhe në mënjanimin e fjalëve të huaja të panevojshme. Revista “Gjuha jonë” e themeluar më 1981

(por e mbyllur më 2009), pati një rol aktiv në këtë veprimtari. Në pajtim me vendimin e mësipërm Komisioni i përhershëm gjatë veprimtarisë së tij dhjetëvjeçare caktoi një numër temash për shqyrtim dhe ngarkoi grupe pune të posaçme për të studiuar në thellësi çështjet përkatëse dhe për të përgatitur parashtrësia studimore. U morën në shqyrtim ndër të tjera: gjuha e shtypit dhe e radiotelevizionit (dy herë); gjuha e teatrit dhe e kinematografisë; gjendja e gjuhës në letërsinë artistike; ligjërimi i shkruar e i folur në Universitetin e Tiranës; gjendja e teksteve të shkollës 8-vjeçare etj. Në të gjitha diskutimet rreth materialeve të përmendura më sipër, të punuara nga grupe pune të posaçme, Komisioni përcaktonte detyra e masa për t'u zbatuar nga institucionet përkatëse.

Idetë dhe porosité e prof. E. Çabejt për ta vënë gjuhësinë tonë në lidhje të drejtpërdrejta me shtetin, për të ndjekur një politikë gjuhësore aktive shtetërore në fushën e pastërtisë së gjuhës dhe të pasurimit e zhvillimit të saj janë udhërrëfyese dhe frymëzuese për kohën tonë. Siç dihet, shteti shqiptar ka detyrim kushtetues të kujdeset për gjuhën shqipe dhe është e nevojshme të veprohet pa vonesë në këtë drejtim. Shkenca dhe shteti duhet të bashkëpunojnë. Në mënyrë të figurshme shkenca (në këtë rast gjuhësia) mund të quhet “pushteti legjislativ”, por dihet mirëfilli se pa pushtetin ekzekutiv, legjislativ gjuhësor mbetet në letër. Kush do t'i detyrojë shtëpitë botuese dhe organet e shtypit që çdo libër dhe çdo gazetë e shtypur të kalojë nga duart e një redaktori letrar? Kush do ta bëjë të detyrueshme që disertacionet e doktoratës të kenë edhe ato një redaktor letrar, nëse nuk e merr vetë autori përgjegjësinë? Kush do t'i detyrojë nëpunësit e gjendjes civile t'i shkruajnë siç duhet emrat në regjistrin përkatës e jo dikush *Eduard, Gazmend, Liliana* e dikush *Eduart, Gazment, Liljana*? Kush do të kujdeset për higjienën gjuhësore të qyteteve tona dhe t'i detyrojë bashkitë që të pastrojnë tabelat dhe mbishkrimet me fjalë të shëmtuara si *karrotrec, markatë, siguracion*? A do të quhen të gjitha lokalet e berberëve në Shqipëri *Barber shop*? Kush do t'i detyrojë firmat prodhuese që të zbatojnë rregullat e drejtshkrimit dhe jo njëra *Qafëmali* e tjetra *Qafshatama*? Kush do të japë urdhër që të hartohet regjistri normativ i emërtimeve të qendrave të banuara (qytete e fshatra) si dokument shtetëror (mungon një i tillë) dhe të ndreqen gabimet e sotme? Kush do të ndërhyjë që në tabelat

e Rrugës së Kombit të shkruhet *Morin* dhe jo *Morinë* (Morina është në rrethin e Tropojës), ose të shkruhet *Yzberish* e jo *Yzberisht* e plot të tjera si këto? Shqipëria dhe Kosova kanë secila *Këshillin e Sigurisë*, nga ana tjetër kemi *Këshillin e Sigurimit* (të OKB). Ç'hyn *sigurimi* këtu? Pse duhet të kemi dy fjalë për të njëjtën gjë kur gjuhët e tjera kanë vetën një fjalë: *Security Council*, *Conseil de sécurité*, *Совет безопасности*, *Consejo de seguridad*, *Consiglio di Sicurezza*, *Sicherheitsrat* etj. *Sigurimi* është *insurance*, jo *security*. A nuk duhet një instancë e posaçme shtetërore për të ndrequr shtetbërime të tilla? Nuk duhet të pajtohemi me mendimin se kështu ka hyrë në përdorim, siç thonë disa që ngatërrojnë *sesionin* me *sezonin* dhe shpallin *sezonin e provimeve* (!) në fakultete të ndryshme. Në cilën gjuhë thuhet *sezon provimesh*? A ka nevojë gjuha shqipe për fjalë si *karikoj*, *karikim*, *karikues*, kur në shkollë nxënësit mësojnë për *ngarkesa* dhe *shkarkesa elektrike*, për akumulatorë dhe bateri të tjera që *ngarkohen* e *shkarkohen* gjatë punës? Le të kemi parasysh përcaktimin e prof. E. Çabejt: “Gjuha pasqyron një kombësi a komb, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj.” A do ta pranojmë që të kemi një pasqyrë të tillë ku të na vijë turp të shihemi? Të gjitha këto çojnë në një përfundim: gjuha është drejtpërdrejt përgjegjësi dhe detyrë e shtetit. Shteti duhet të ketë domosdo një kuadër ligjor për këtë, ashtu siç e kërkon Kushtetuta.

Përveç detyrave tona të brendshme sot shtrohet si domosdoshmëri bashkëpunimi me Kosovën në nivel shtetëror, në radhë të parë për terminologjinë. Më se një herë janë vënë në dukje mospajtime në terminologji ndërmjet kodeve, akteve ligjore dhe praktikave ndërmjet dy vendeve. Më qartë se kushdo këtë e ka përcaktuar akad. Esat Stavileci me fjalët: “Kam krahasuar praktikat në Shqipëri e në Kosovë në fushën e terminologjisë administrative dhe kam vënë re një shkallë relativisht të lartë mosnjësimi. Ka përdorim të ndryshëm termash të njëjtë, pra, ka dhënie kuptimi të ndryshëm atyre termave, ka përdorim të gabuar të termave administrativë për shkak të shkallës së ulët të njohjes së problemeve dhe të çështjeve administrative, ka përdorim selektiv të termave, po sikurse që ka edhe përdorim joadekuat të termave. Shkalla e mosnjësimit ndonjëherë arrin kuotën e moskuptimit dhe nevojën e sqarimit term për term për të kuptuar thelbin e problemit, edhe pse përdoret një gjuhë e një fjalor.”

Shqipëria dhe Kosova janë shtete të pavarura, secili me veçoritë e veta dhe natyrisht legjislacioni dhe kodet juridike nuk mund të jenë të njëjta, por gjithsesi terminologjia e tyre duhet të jetë e njëjtë, nuk mund të lejohet që të kemi terma të ndryshëm për të njëjtën gjë, ashtu siç ndodh sot, p.sh. në kodin e qarkullimit rrugor e në kode të tjera.

Pesëdhjetë vjet pas Kongresit të Drejtshkrimit, që miratoi normën letrare të njësuar në fushën drejtshkrimore e gramatikore, sot shtrohet si detyrë e ngutshme dhe e dorës së parë **njësimi** dhe **shqipërimi** i mëtejshëm i terminologjisë tekniko-shkencore të gjuhës shqipe. Ngadalësia, spontaneiteti ose lënia pas dore në këtë fushë vështirëson dhe rrezikon zhvillimin e rregullt të shqipes standarde në të gjithë hapësirën e zbatimit të saj: Shqipëri, Kosovë, RMV e më gjerë.

Ndonëse terminologjia vështrohet si degë e gjuhësisë, puna konkrete për standardizimin e kodifikimin e saj kërkon detyrimisht përfshirjen e specialistëve të fushave të ndryshme të veprimtarisë shtetërore e tekniko-shkencore dhe miratimin zyrtar për zbatim nga autoriteti shtetëror. Unë kam bindjen se terminologjia, si veprimtari kodifikuese e standardizuese, del jashtë natyrës së punës së institucioneve kërkimore-shkencore albanologjike. Në rrethanat e sotme si zgjidhja më e përshtatshme për një punë të frytshme dhe efektive mendoj se shtrohet krijimi i një organizmi shtetëror, që mund të quhej **Komiteti Kombëtar për Terminologjinë Shqipe**, i cili do të funksiononte pranë qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës, duke u përfaqësuar në të edhe Agjencia për Zbatimin e Gjuhës Shqipe në RMV. Ky Komitet do të hartonte një plan pune të përgjithshëm, duke parashikuar ngritjen e një vargu komisionesh të përbëra nga specialistë të fushave të ndryshme dhe nga gjuhëtarë, me detyrën për: a) evidentimin e dallimeve terminologjike; b) diskutimin e terminologjive në tërësi me synim njësimit ose përafrimit sa më shumë të tyre, c) shqipërimin e termave të huaj, kur kjo është e mundshme dhe e pranueshme si për gjuhëtarët, ashtu edhe për specialistët e fushës. Unë shpreh kënaqësinë që Fakulteti i Gjuhëve të Huaja i UT (me rastin e Konferencës për terminologjinë e fushave humane, 11.05.2023) dhe Instituti Alb-Shkenca në Takimin XVIII vjetor (Prishtinë, 13–14.10.2023) e përkrahën në parim idenë e një

## Komiteti Kombëtar për Terminologjinë

Sot Eqrem Çabej nuk është më. Por ai na ka lënë dijen dhe mendimin e tij, atdhetarinë e tij, vullnetin e tij, ndjenjën e lartë të përgjegjësisë shkencore dhe qytetare ndaj gjuhës shqipe. Me këtë mision ai qëndron përpara hyrjes së Akademisë së Shkencave. Kujtimi i Eqrem Çabejt le të jetë nxitje për veprim të vendosur, për të dalë nga mefshtësia, në radhë të parë të gjithë ne që punojmë në fushën e gjuhësisë. Sot opinioni intelektual dhe shoqëror kanë një forcë të madhe ndikuese. Populli i thjeshtë i përkrah me gjithë zemër ata që dalin në mbrojtje të bukurisë e të veçantisë kombëtare të gjuhës shqipe, ata që kërkojnë një disiplinë të nevojshme gjuhësore në veprimtarinë e shtetit, ata që shkruajnë e flasin kundër shtrembërimeve e gabimeve në gjuhën e shkruar e të folur të përdorimit publik.

Le të ngremë zërin që të ringjallet revista “Gjuha jonë” si tribunë shkencore e kulturës së gjuhës shqipe, e mbrojtjes së saj nga shtrembërimet, nga shpërdorimet, nga ndikimet e dëmshme të gjuhëve të huaja, ashtu siç e kishte menduar nismëtari i saj, Eqrem Çabej. Le të dalim më shumë në shtyp e në rrjetet sociale për çështje të tilla, por në radhë të parë, le të jemi kërkuar, këmbëngulës e të përgjegjshëm që të diplomuarit në fakultetet filologjike të Universitetit të Tiranës të zotërojnë mirë bazat e normës së sotme letrare të gjuhës shqipe dhe që kultura gjuhësore në Universitetet shqiptare në përgjithësi të jetë në lartësinë që e kërkon koha e sotme.

Seit Mansaku

## **METODOLOGJI SHKENCORE DHE FRYMË KOMBËTARE NË VEPRËN E EQREM ÇABEJT**

Falënderoj organizatorët e kësaj Konference që më kanë ftuar për të marrë pjesë në të e për të mbajtur këtë kumtesë. Vlerësoj gjithashtu nismën e tyre për të trajtuar temën e letërkëmbimit, sepse mendoj se letërkëmbimi i një personaliteti të shquar si Eqrem Çabej me personalitete të shquara të gjuhësisë historike krahasuese europiane dhe albanologë të mirënjohur merr një rëndësi shkencore të posaçme dhe hedh më tej dritë mbi madhësinë e veprës dhe të personalitetit të tij. Uroj që kjo nismë të mos mbetet me kaq , por të finalizohet me botimin e plotë të letërkëmbimit në gjuhët përkatëse dhe në gjuhën shqipe.

Pasi mbaroi studimet në Vjenë dhe mbrojti doktoratën me një temë nga arbëreshët e Italisë, Çabej botoi në vitet 30 të shekullit të kaluar veprën *Për gjenezën e literaturës shqipe* dhe disa artikuj studimor në revista shkencore të autoritetshme si *Revu des études balkaniques*, *revue rumaine de linguistique*, *Zeitschrift fur balkanologji* etj, me të cilët tërhoqi vëmendjen e gjuhëtarëve dhe albanologëve të shquar europianë, të cilët shprehën vlerësimet e tyre qoftë nëpërmjet letërkëmbimit, qoftë në recensionet që botuan në revista të ndryshme. Do të përmendja këtu një vlerësim të bërë nga gjuhëtari shquar danez dhe albanolog i mirënjohur Holger Pedersen, i cili, pasi ishte njohur me botimin *Për gjenezën e literaturës shqipe*, në vitin 1938 shkruan: “Është e gëzueshme që tani për herë të parë një shqiptar i lindur trajton gjuhën dhe historinë e popullit të vet duke

zotëruar metodën e zhvilluar në Europën Perëndimore”

Falë talentit dhe pasionit të tij dhe formimit shkencor në një nga qendrat kryesore të studimeve të gjuhësisë historike krahasuese indoeuropiane dhe albanologjike që nga mesi i shekullit XIX, Eqrem Çabej solli në gjuhësinë dhe filologjinë shqiptare arritjet kryesore të shkollave gjuhësore të përparuara të këtij drejtimi gjuhësor dhe përvojat shkencore të profesorëve të shquar, sidomos të shkollës së gramatikanëve të rinj ku bënin pjesë gjuhëtarë e albanologë të shquar si Gustav Maeyer, danezi Holger Pedersen, slloveni Franz Miklosiç, Norbert Jokli i shkollës së fjalëve dhe të sendeve në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, e shumë të tjerë. E. Çabej i ruajti lidhjet me ta përmes kontakteve në veprimtari gjuhësore ndërkombëtare, shkëmbimit të botimeve të tyre dhe letërkëmbimit të vazhdueshëm. Letërkëmbimi me ta përmban të dhëna me vlerë për shkëmbimin e mendimeve, për njohjen dhe vlerësimin e punës shkencore të njeri tjetrit, prandaj nisma për ta botuar dhe për ta bërë të njohur të plotë atë. është e mirëpritur.

Me formimin, punën, pasionin e përkushtimin tij e ngriti gjuhësinë historike shqiptare në nivele të shkencës gjuhësore europiane të kohës. Në rrugën e hapur prej tij ka vijuar të ecë e të zhvillohet gjuhësia historike shqiptare deri në ditët tona, duke u përditësuar edhe me zhvillimet më të reja të gjuhësisë së shekullit XX.

Vepra madhore e Eqrem Çabejt shquhet jo vetëm për tematikën e gjerë e të rëndësishme që trajton në shumë fusha të dijes, të historisë së gjuhës dhe të kulturës, jo vetëm për arritje të shënuara në këto fusha dhe për përparimet e rëndësishme që nxori, por ajo është mësimdhënëse edhe për metodologjinë dhe metodat shkencore që ka ndjekur autori i saj për të arritur në përgjithësi themelore të qëndrueshme për gjuhën dhe kulturën tonë kombëtare, për përkushtimin dhe frymën kombëtare që e përshkon atë.

Bashkëjetesa e metodologjisë shkencore me frymën kombëtare në veprën e Eqrem Çabejt gjën shprehjen e vet në moton *Të jemi objektivë por jo indiferentë*, të cilën ai e ka përsëritur shumë herë në veprën e tij. Në shkrimin *Për disa probleme dhe detyra të gjuhësisë historike shqiptare* E. Çabej do të shkruante: “Parimi që mendojmë se duhet të ndjekë dijetari është kërkimi objektiv i së vërtetës në



përpunimin e materialit dhe në paraqitjen e fakteve shkencore. Veçse të qenët objektiv nuk do të thotë që dietari të jetë indiferent, sidomos në trajtim të problemeve që janë me rëndësi njëkohësisht shkencore dhe nacionale” (S. GJ. V, Prishtinë, 1965, f.289).

Kjo moto e përshkon të gjithë veprën e tij që ga fillimet e veprimtarisë së tij shkencore deri në fund të jetës së tij. Madje ai ia ka dalë ta mbrojë këtë parim themelor të punës së tij edhe atëherë kur veprimtaria shkencore ndikohej edhe nga faktorë ideologjikë e politikë. Edhe kur ndërhyenin ide romantike edhe me qëllim të mirë, por pa lidhje me shkencën e vërtetë. Çabej theksonte “Gjuhësia historike shqiptare ka për detyrë kryesore të studiojë rrugët e zhvillimit nëpër të cilat është përshkuar gjuha shqipe gjatë kohëve dhe t’i studiojë këto kryesisht nga pikëpamja shqiptare.”

Ky parim themelor metodologjik i veprimtarisë shkencore të Eqrem Çabejt është materializur në shumë aspekte të studimit të gjuhës shqipe dhe të historisë së saj, sidomos në trajtimin e problemeve të etnogjenezës së popullit shqiptar e të origjinës së gjuhës shqipe, në studimet etimologjike dhe në përcaktimin e vendit që zë gjuha shqipe dhe kultura shqiptare në bashkësinë gjuhësore e kulturore ballkanike dhe europiane ku korrektësia shkencore dhe ndiesia kombëtare nuk ndahen njera nga tjetra..

Së pari, Eqrem Çabej në veprën tij gjuhësore e kulturore problemet gjuhësore i ka vështruar në lidhje të ngushtë me historinë e popullit shqiptar me kulturën materiale e shpirtërore të shqiptarëve. Kjo mënyrë të vështruarit bën që përfundimet e tij të kenë mbështetje të gjerë ndërdisiplinore dhe të paraqesin një interes më të gjerë kombëtar. Kësaj i shtohet edhe fakti që Eqrem Çabej problemet e gjuhës dhe të kulturës dhe të historisë së popullit i ka vështruar e studiuar në një rrafsh të gjerë kohor dhe hapësinor duke rrokur mbarë botën shqiptare, të gjitha trojet e shqipes, brenda dhe jashtë kufijve të shqipërisë, duke përfshirë edhe diasporën. Madje, siç e thamë, ai doktoraturën në Vjenë e ka mbrojtur me një temë nga arbëreshët e Italisë në gjuhën gjermane, që ende pret të botohet në gjuhën shqipe.

Në veprën e tij madhore *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëllii I, Tiranë, 1982, f.132 ai shkruan: “Vetëm kur gjuha kundrohët në njësinë e saj të pandarë, me fijet e ndryshme që kanë

endur pëlhurën e saj me degëzimet, formimet e reja që ka përftuar, duke u liruar nga skemat e vjetra, vetëm atëherë kuptohet gjallëria dhe vitaliteti i saj në hapësirë dhe në kohë. Në pajtim me këtë parim, qëllimi kryesor i këtij punimi është që, duke u mbështetur në një material filologjikkisht të siguruar, të jepet një pamje sa më objektive e visarit leksikor të shqipes, duke paraqitur historikisht dhe përbërënda rrethit të familjeve të tyre fjalët që e përbëjnë”.

Në pajtim me këtë parim, Eqrem Çabej në veprën e tij *Studime etimologjike në fushë të shqipes* në shtatë vëllime, nuk i ka qendruar besnik përkufizimit klasik të fjalorëve etimologjikë që synojnë kryesisht gjetjen e etimonit, burimin fillestar të fjalës, por e ka zgjeruar ndjeshëm atë; bën edhe historinë e saj, përhapjen gjeografike të saj, zhvillimet formale e kuptimore të saj në hapësirë dhe në kohë, formimet e krijuara mbi bazën e saj gjatë kohëve etj. Kjo mënyrë të vështruarit tërësore gjeografike dhe historike e shqipes i ka dhënë mundësi autorit të ndjekë zhvillimet tërësore të shqipes në kohë dhe hapësirë dhe të zbulojë veçoritë e përbashkëta dhe dalluese, duke theksuar njësinë e saj midis dallimeve, ose, siç e shprehë ai, *unitetin në diversitet*. Një historian i mirënjohur austriak si Paul Kretschmer në një letër falënderimi që i drejton Çabejt në vitin 1938 ndër të tjera shkruan “Po merrem me skedat e botimit të dytë të gjeografisë sime të fjalëve të gjuhës letrare të folur, d.m.th. me një punë të ngjashme me tuajën”. (Shaban Demiraj, *Eqrem Çabej*, Tiranë, 1990, f.235).

Një parim tjetër i rëndësishëm i metodologjisë shkencore të zbatuar me konsuekuencë në veprën e Eqrem Çabejt, sidomos në studimin e problemeve të etnogjenezës dhe të studimeve etimologjike ka qenë pikënisja e kërkimit nga shqyrtimi i dukurive gjuhësore të leksikut dhe i strukturës gramatikore së pari brenda gjuhës shqipe dhe të folmeve të saj, pra e njohjes së mirë të gjendjes së brendshme të saj, duke zbatuar krahasimin e brendshëm historik midis gjendjes së sotme dhe asaj që paraqitet në tekstet e vjetra të shekujve XV-XVII dhe krahasimin gjeografik midis shqipes së përbashkët dhe dialekteve dhe të folmeve të saj, dhe vetëm pas shqyrtimit të plotë të gjendjes së brendshme, kalohet në krahasime me gjuhë të tjera për një ndriçim të mëtejshëm të burimit të fjalës dhe për ta përfshirë shqipen edhe në marrëdhëniet e saj me gjuhë të tjera ballkanike e europiane

Me këtë parim metodologjik Eqrem Çabej ka vepruar ndryshe nga shumë albanologë të huaj, që, duke mos njohur mirë gjuhën shqipe, në studimet e tyre historiko-etimologjike për shqipen, janë nisur nga gjuhë të tjera dhe nga të folme anësore për të ardhur te shqipja dhe shpesh herë, edhe pa dashur, kanë arritur në përfundime të pasakta për etimologjinë e fjalëve të shqipes dhe për vlerësimin e raportit midis leksikut të trashëguar dhe leksikut të huazuar të gjuhës shqipe dhe kanë nxjerrë përfundimin se fjalët e huazuara janë numerikisht më shumë se fjalët e vendit, duke arritur deri atje sa një albanolog i shquar si Gustav Meyer, ta cilësonte shqipen si gjuhë përzier gjysmë romane.

Po jap vetëm ndonjë shembull të përparësisë së rrugës që ndjek Çabej për të arritur në përfundime të sigurta. Disa studiues duke u nisur nga krahasimi i vetës së tretës së foljes *jam*, është me trajtën përkatëse *est* të latinishtes, e nxjerrin trajtën e shqipes nga latinishtja. Sipas metodologjisë së Çabejt, duke e shqyrtuar këtë trajtë foljore është brenda shqipes, në të folmet e gegërishtes *asht* me a hundore, një trajtë më e vjetër te Meshari i Gjon Buzukut *ansht*, del qartë se *ansht* nuk mund të vijë nga trajta latine *est*, pra nuk kemi të bëjmë me një huazim latin, por me një trajtë të trashëguar të shqipes, që ka përgjegjëse edhe në gjuhë të tjera indoeuropiane: lat. *est*, gr. e vjetër *estin*, , sanskritisht *asti* etj.

Po kështu për të përcaktuar etimologjinë e fjalës *gardh*, si fjalë shqipe e trashëguar apo si huazim nga sllavishtja *grad*, duhet shqyrtuar së pari gjendja e kësaj fjale brenda shqipes. Për sllavistët Petar Skok e Selishçev shqipja *gardh* dhe rumanishtja janë me gurrë nga sllavishtja e vjetër *gard*, ndërsa Çabej, SE IV;243 ashtu si Jokli , pasi shqyrtojnë rrjedhojat e kësaj fjale brenda truallit të shqipes si *gardhiqe*, *gardhishte*, *gardhojcë*, *gjerde*, *gardhën* etj., binden për lashtësinë e kësaj fjale në truall të shqipes dhe e vështrojnë atë me të drejtë si fjalë të trashëguar që ka përgjegjëset e saj në latinishten *hortus* “kopsht” dhe greqishten e vjetër *hortos*. Me *gardh* lidhet edhe toponimi *Zgërdhesh*, besoj edhe folja *zgërdhihem* “nxjerr jashtë gardhin e dhëmbëve”, siç ka vërejtur Kolec Topalli në Fjalorin e tij etimologjik.

Nga ana tjetër, kur shqyrtohet etimologjia e fjalës *anë*, pa dyshim fjalë e vjetër, për t'i dhënë përgjigje pyetjes pse nuk ka ndodhur

dukuria e rrotacizmit *n:r* midis dy zanoreve, historia e brendshme e fjalës nuk na ndihmon, por gjen shpjegim në krahasimet me gjuhë të tjera me indishten *antah* dhe gjermanishten *Ende*, anglisht *end*, që dëshmojnë që te trajta e vjetër e rindërtuar e fjalës *anë* tingulli i sotëm *n* nuk ka qenë midis dy zanoreve, por ka qenë në grupin *nt, nd* deri në kohën kur nuk veproi ligji fonetik i rrotacizimit në gjuhën shqipe. Pra Çabej për qëllime studimi dallonte historinë e brendshme nga historia e marrëdhënies të shqipes me gjuhë të tjera, por që të dyja plotësonin njera tjetrën dhe jepnin kuadrin e plotë të historisë së saj.

Duke zbatuar këtë metodologji studimore dhe këto metoda të analizës së fjalëve, Eqrem Çabej ka arritur t'i kthej gjuhës shqipe si pasuri vetiake të trashëguar ose të krijuar me mjetet e saj shumë fjalë që Gustav Majer-i në Fjalorin e tij etimologjik të gjuhës shqipe i kishte trajtuar si huazime nga gjuhë të tjera, duke u nisur thjesht nga krahasimet me to pa shqyrtuar më parë historinë, zhvillimet dhe përhapjen e fjalës brenda shqipes. Madje Meyer-i ka rritur numrin e huazimeve latine në gjuhën shqipe, duke marrë me burim latin fjalë të prejardhura, të formuara brenda shqipes me mjete të saj mbi bazën e një fjale të parme me etimologji latine. Ky dijetar e albanolog i shquar, jo rrallë herë ka ndërtuar edhe baza latine *ad hoc* që nuk egzistojnë as në vetë latinishten, as në gjuhët romane që burojnë prej saj. Prof. Çabej, ka dalluar sistematikisht trajtat me burim fillestar të huazuara nga rrjedhojat e formuara mbi bazën e saj brenda shqipes me mjetet e saj. Në këtë mënyrë ai, me argumente shkencore, ka rritur numrin e fjaiëve me burim nga shqipja në leksikun e shqipes, duke ndryshuar kështu raportin midis fjalëve me burim vendas dhe huazimeve nga gjuhë të tjera në të mirë të të fjalëve me burim nga shqipja. Kështu p.sh. ai miraton burimin latin të fjalës *i lirë* nga lat. *liber*, por kundërshton mendimin e Gustav Meyer-it që fjalën *dëllir*, „pastroj, qëroj” e trajton si huazim latin nga një trajtë *deliberare*, që nuk ekziston në latinishtë. Për Çabejnë *dëllir* është një formim i brëndshëm i shqipes nga *i lirë* me parasshtesën *dë-*. Po kështu për fjalën *dëm dam* edhe Meyer-i dhe Çabej e pranojnë burimin latin të kësaj fjale nga *damnum*, por Çabej nuk pranon shpjegimin e fjalës *dëmtoj* nga nga një latinishtë e rindërtuar ad hoc *damnitare* dhe e shpjegon si formim brenda shqipes nga *dëm + toj si farkë farkëtoj*,

*copë copëtoj etj.*

Tjetër kriter i metodologjisë shkencore të Eqrem Çabejt për studimin e historisë së gjuhës shqipe është ky: për një gjuhë si gjuha shqipe, e dokumentuar me shkrim vonë në shekullin XV, për të studiuar e rindërtuar zhvillimet historike të mëhershme, jemi të detyruar të nisemi nga gjendja e njohur e saj nga tekstet e vjetra dhe nga dialektet për t'u ngjitur shkallë-shkallë në gjendjet e mëhershme të saj, për të rindërtuar fazat më të panjohura të saj dhe jo në të kundërt, siç mund të vepohet për gjuhë të tjera me një dokumentim të hershëm.

Më së fundi, zbatimi i parimit *Të jemi objektivë, por jo indiferentë* në veprën e Eqrem Çabejt, vërehet edhe në trajtimin e problemeve themelore e me rëndësi kombëtare të etnogenezës së popullit shqiptar siç janë problemi i vendbanimit të hershëm dhe i formimit të popullit shqiptar dhe problemi i origjinës së gjuhës shqipe. Në këtë fushë studimesh, siç dihet, Eqrem Çabej ka një kontribut të veçantë. Ai është nga të parët gjuhëtarë shqiptarë që i trajtoi me metoda shkencore këto probleme të vështira e të rëndësishme të historisë së lashtë të popullit shqiptar dhe të historisë së gjuhës shqipe, i bëri këto objekt studimi në veprën e tij, paraqiti në mënyrë objektive e me qëndrime kritike tezën e ndryshme e mendimet e studiuesve që janë marrë me studime në këtë fushë që nga fundi i shekullit XVII deri në çerekun e fundit të shekullit XX.

Trajtimi i këtyre problemeve në studimet e tij, në organe shkencore brenda e jashtë vendit, në konferenca e kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare jo vetëm bëri të njohura rezultatet e albanologëve të huaj e të shkencave tona albanologjike në këtë fushë studimesh, por edhe i aktualizoi, i përditësoi dhe i pasuroi më tej ato me të dhëna e ide të reja, dhe nxiti kështu studiues të tjerë brenda dhe jashtë vendit për t'u marrë dhe për të dhënë ndihmesën e tyre në ndriçimin e mëtejshëm të tyre. Me autoritetin e tij i popullarizoi ato dhe si të thuash, i bëri ato pjesë të ndërgjegjies historike e kulturore të shqiptarëve.

Siç dihet, Eqrem Çabej ka mbrojtur dhe argumentuar tezën e pejzardhjes ilire të gjuhës të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar, por ka njohur dhe vlerësuar edhe tezën trake apo trako-ilire, duke shqyrtuar edhe argumentet përkatëse. Ai ka shqyrtuar 12 argumentet

historike dhe gjuhësore të kësaj teze të parashtruara nga studiuesi gjerman Gustav Veigand-i dhe i ka vlerësuar ato pa paragjykime duke pohuar se Gustav Veigand-it i bie patjetër merita që e shtroi këtë problem mbi një bazë të gjerë dhe duke e shqyrtuar me hollësi, veçse në mënyrë të njëanshme gjuhësore. E. Çabej ka pranuar se midis shqipes dhe trakishtes ka disa konkordanca gjuhësore. Ka pranuar gjithashtu se shqipja ka fjalë të përbashkëta me rumanishten të substratit trak, por nuk pajtohet me përfundimin e Veigand-it se djepi i hershëm i popullit shqiptar ka qenë në lindje të Ballkanit pranë rumunëve dhe se ata janë zhvendosur më vonë në trojet e sotme në perëndim të gadishullit të Ballkanit. Çabej është shprehur se kësaj teze i mungon baza historike, sepse burimet historike nuk përmenden në asnjë dokument historik një shpërngulje të një populli të tërë nga lindja drejt perëndimit. Ndërsa përkimet gjuhësore midis shqipes, trakishtes e rumanishtes ai i shpjegon me kontaktet e hershme të fiseve ilire verilindore me fiset trake juglindore në Ballkan. Ndërsa tezat e sllavistit rus Selishçevit dhe sllavistëve të tjerë pasues të tij, që mbrojnë tezën se shqiptarët kanë ardhur në trojet e tyre të sotme pas sllavëve, i hedh poshtë si teza pa asnjë bazë historike e gjuhësore. Po kështu edhe tezën e vendosjes së djepit të hershëm të shqiptarëve në një zonë të ngushtë midis Matit dhe Ohrit.

Për argumentimin e e tezës së prejardhjes ilire të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptr. E. Çabej është përpjekur të shmangë argumentet hipotetike dhe të mbështetet në argumente historike dhe gjuhësore të qëndrueshme ku veprojnë metodat shkencore. Në rrafshin historik argumenti kryesor që sjell autori është fakti që, sipas burimeve historike, në periudhën antike në trojet ku banojnë sot shqiptarë , kanë banuar fise ilire të Ilirëve të Jugut dhe këto burime nuk shënojnë gjëkund që shqiptarët të jenë vendosur më vonë në këto troje. Pra janë autoktonë , vazhdim i pandërprerë i ilirëve antikë. Argumentin që sjellin kundërshtarët e tezës ilire se në burimet historike për antikitetin dhe mesjetën e hershme shqiptarët nuk përmenden, Çabej e ka konsideruar si *argumentum ex silentio* “argument nga heshtja”. Historiani Aleks Buda heshtjen e burimeve historike për këto periudha e ka shpjeguar me arsyetimin se kronistët romakë e greko-bizantinë përmenden në kronikat e tyre popullësitë shtektare që kalonin në viset shqiptare dhe u sillnin shqetësime

perandorive sunduese dhe nuk përmendin popullësitë autoktone.

Nërrafshingjuhësor argumentimë i qëndrueshëm është për Çabejnë fakti që emrat e vendeve të dëshmuar që nga lashtësia në dokumentet historike, të krahasuar me trajtat e sotme të shqipes tregojnë se ato janë zhvilluar në pajtim me rregullat e fonetikës historike të shqipes, pra kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e shqiptarëve. Të tillë janë: *Scodra:Shkodër; Ulcinium:Ulqin, Drivastum:Drisht, Lissus:Lesh Lezhë, Isamnus:Ishëm,Durrachium:Durrës, Scampinus: Shkumbin, Aulona, Valona Vlorë, Scupi:Shkup, Naissus Nish, Thyamis:Çam etj.* Përveç këtyre disa nga toponimet e lashta të vendbanimeve ilire shpjegohen me fjalë të shqipes si: *Dimal, Dalmatia Delmatia, Delminium; Ulcinium etj.*

Një tjetër argument gjuhësor me peshë për vendbanimin e hershëm të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme dhe për origjinën ilire të gjuhës shqipe përbëjnë marrëdhëniet e saj me gjuhët fqinje, veçanërisht elementet latine dhe elementet nga greqishtja e vjetër. Do të thosha se elementet nga këto dy gjuhë të lashta në gjuhën shqipe përbëjnë një argument të fuqishëm për autoktoninë e shqiptarëve dhe për origjinën ilire të gjuhës shqipe. Përmasat e tyre, zhvillimi i tyre fonetik e semantik brenda shqipes dëshmon se të parët e shqiptarëve kanë qenë në kontakt të pandërprerë me grekët dhe latinët që nga antikiteti e mesjeta e hershme dhe ky kontakt mund të zhvillohej vetëm në vendbanimet e shqiptarëve e të parëve të tyre, midis botës greke dhe botës latino-romane.

Numri i fjalëve nga këto gjuhë, vjetërsia e tyre, zhvillimet formale dhe kuptimore që kanë pësuar ato dëshmojnë se kontaktet e popullit shqiptar me to kanë qenë të hershme dhe në trojet e tyre të sotme. Çabej është shprehur se trualli i sotëm i popullit shqiptar nuk është rezultat ekspansioni “zgjerimi”, por rezultat restrksioni “ngushtimi”. Madje, siç ka vërejtur prof. Shaban Demiraj në veprën *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988, disa prej këtyre fjalëve, ato më të lashtat, janë huazuar nga ilirishtja dhe kanë vijuar prej saj në gjuhën shqipe si vijim i pandërprerë i saj. Do të thosha se, nga kjo pikëpamje, këto fjalë mund të mos vështrohen më si huazime të shqipes nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja, por si fjalë të trashëguara. Eqrem Çabej ka vënë në dukje gjithashtu se elementi latin në gjuhën shqipe ka pasur më fort një karakter urban

(qytetar), sesa rural (fshatar), që përbën një argument gjuhësor kundër tezës tendencioze se shqiptarët kanë qenë një popull shtektar baritor. Kundër këtij mendimi dëshmon edhe terminologjia fetare kishtarë e shqipes, kryesisht latine e greko bizantine.

Eqrem Çabej nuk u mor me problemin e etnogjenezës së ilirëve, as me autoktoninë e tyre, jo se i konsideronte të parëndësishme, por se në rrafshin gjuhësor, nuk arrinte të gjente argumente për t'i trajtuar me metoda shkencore, ndryshe nga arkeologët, të cilët në gjetjet arkeologjike, gjejnë mbështetje për ta trajtuar këtë temë. Ai ka theksuar:” Na duket me rëndësi themelore që studimi i problemeve edhe në fushën e gjuhësisë historike të nisët nga faktet dhe vetëm pas paraqitjes së fakteve të kalohet në zgjedhjen e tezave shkencore. Është shenjë e një metode kërkimore të besueshme që dija t'i shmanget interpretimit të materialit në bazë të disa tezave aprioristike, të ndërtuara që më parë.” (Studime gjuhësore V, f. 281-288) Për të njëjtat arsye, Çabej ka njohur dhe përmendur tezën e prejardhjes pellazgjike të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar të trajtuar nga arbëreshët e Italisë dhe nga rilindasit, kryesisht për qëllime patriotike për të afirmuar lashtësinë e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar dhe për të theksuar identitetin kombëtar historik e gjuhësor, tezë të cilën e trajtoi në gjysmën e shekullit XIX, albanologu i mirënjohur Georg von Hahn në veprën e tij *Studime shqiptare*, 1854, por vetë ai nuk e bëri objekt trajtimi shkencor në veprën e tij.

Për ta përfunduar këtë kumtim, do të thosha se Eqrem Çabej për problematikën e gjerë që trajtoi në veprën e tij, për rëndësinë kombëtare historike, gjuhësore dhe kulturore që ajo paraqet dhe për metodologjinë shkencore që përdori për ndriçimin dhe vlerësimin e kësaj problematike, do të mbetet një figurë emblematike e kombit shqiptar, një model shëmbullor për t'u ndjekur nga brezat e sotëm dhe të ardhshëm, një model për personalitetin shkencor dhe njerëzor, një model se si duhen trajtuar e vlerësuar me rreptësi shkencore e me dashuri e nderim vlerat e kombit, sidomos gjuha e tij si një nga vlerat identitare më të rëndësishme të tij, një model i dijetarit erudit që shkëlqen me dijen dhe modestinë e tij.. Emri dhe vepra e tij, të lidhura ngushtë me njerëz nga vlerat më të mëdha të kombit tonë, me gjuhën shqipe dhe historinë e saj, me historinë dhe kulturën e



popullit shqiptar, i kanë siguruar përgjithmonë përjetësinë. Poeti i shquar Xhevahir Spahiu në një poezi të shkruar me rastin e ndarjes nga jeta të Eqrem Çabejt, me titull *Rrënja e fjalëve* shkruan në vargje:

Ai s'është më  
Shkoi të ngrëjë shtëpinë përgjithnjë  
Tek rrënja e fjalëve.

Floresha Dado

## METODOLOGJIA E E. ÇABEJT NË INTERPRETIMIN E LETËRSISË DHE KULTURËS SHQIPTARE

Në dy studimet kapitale të E. Çabejt, „Për gjenezën e letraturës shqipe“ 1938–39 dhe „Romantizmi në Europë Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare“ 1945, shprehet qartazi, nga njëra anë koncepti i tij mbi letërsinë „si shprehja më e mirë e shpirtit shqiptar, si shprehje estetike dhe shprehje etnike“, nga ana tjetër aplikimi i metodave historiko-kulturore në studimin e letërsisë dhe një qasje më e plotë sipas metodës komparativiste. Raporti i letërsisë me historinë e kombit, në kuptimin e gjerë si histori ideore, etno-kulturore, shpirtërore, si dhe marrëdhëniet folklorike e letrare të kulturës shqiptare me ato të vendeve ballkanike, dhe më gjerë, përbëjnë bazën filozofike, metodologjike, në sistemin e të menduarit të E. Çabejt. Ky aspekt themelor dhe i rëndësishëm i metodologjisë së interpretimit deri më sot nuk është hetuar në qasjen dhe thellësinë e duhur. Tezat e tij, shumë të rëndësishme, duhen parë brenda kuptimit të letërsisë si *një sistem specifik*, që e shfaq veten në kohë historike. Ky koncept bën që të kuptojmë, se *poetika e veprave* letrare në një kuptim është *poetikë historike dhe reciproke me mjedisin e gjerë kulturor*. Dy aksiomat e përcaktuara prej tij: ndikimi i madh i poezisë popullore tek shkrimtari, roli i poetit si prijës shpirtëror, çka bënte që „nacion dhe politikë“ të ishin „temë kryesore e krijimit letrar“, lidhen me pikëpamjen që e konsideron rrugën e zhvillimit të letërsisë si „rrugë të zhvillimit mendor të kombit“, me bindjen se „nëpërmjet autorëve kuptojmë shpirtin e kohës“, për të arritur në sugjerimin që „të nxjerrim në dritë, në pikat më kryesore, personat

e dukjet që janë themelore për vijën e zhvillimit të literaturës“. Në strukturën teorike të Çabejt ne gjejmë një kuptim më specifik të asaj që ai e quan, “metodë sinkronike dhe diakronike“. Prandaj mendoj se gjithë sistemi i Çabejt mbi kuptimin dhe zhvillimin e letërsisë shqiptare, ngrihet mbi dy boshte themelore, pa njohjen e të cilave nuk mund të shpjegohen parimet metodologjike të këtij studiuesi, i cili, krahas gjenisë gjuhësore, mbeti orientues edhe në fushën e shkencës letrare.

### I. Boshti i parë (metoda historiko–kulturore)

#### *Për gjenezën e literaturës shqipe(1938–39)*

Dihet se në zhvillimin e shkencës së letërsisë, në dy shekujt e fundit, u shfaqën një seri pikëpamjesh teorike–metodologjike, lidhur me paradigmen dominuese të studimit letrar. Eshtë folur për katër revolucione në studimin e letërsisë, teorisë letrare, kritikës, të cilat përcaktohen si:

1. Kalimi nga paradigma metodologjike idealiste te ajo pozitiviste;

2. Kalimi nga paradigma metodologjike pozitiviste tek ajo anti–pozitiviste, e brendshme, ose formale, shtrirë në shumë variante: fenomenologjike, formaliste, gjuhësore, stilistike, retorike, kritikë e re etj.;

3. Lëvizja nga paradigma formale te ajo strukturore, e cila është e radikalizuar në praktikën teoriko–metodologjike semiotike, duke e parë veprën letrare si një strukturë dinamike të hapur, lëvizje për të cilën janë të rëndësishme tre përbërës themelore – teksti në vetvete, autori dhe lexuesi i saj;

4. Kalimi nga matrica metodologjike strukturore–semiotike në atë dialogjike, hermeneutike, ndërdisiplinore dhe kontekstuale, dominante në teoritë poststrukturaliste dhe postmoderniste (neo–krahasimtare historike dhe sociologjike të Bahtinit, nëpërmjet teorisë së reapsionit, kritikës së lexuesit, kritikës psikoanalitike dhe feministe.

Pra diskutimi mbi metodën dhe metodologjinë e studimit të letërsisë, është ekstremizuar në dy qasje kryesore: “letërsia është rruga e zhvillimit mendor të kombit“ dhe “letërsia nuk ka histori.“

Në një aspekt, të dy këto metoda mbështeten në metodologji të caktuar, përpunojnë konceptet e tyre të studimit të letërsisë, por, nga ana tjetër ato e reduktojnë letërsinë në jo–letërsi: *në histori*, ose *në gjuhë*. Madje shkohet deri në kuptimin e veprave si “panteon jo kohor dhe universal” apo në tezën se vepra të mëdha të letërsisë botërore nuk japin sekuenca historike, që paraqesin historinë e njerëzimit. Filozofia e Hegelit solli konceptin e vështimit, “historicism” të historisë, por edhe të formave të artit. Në kuptimin e këtij raporti pranohej se do të ishte gabim të studioheshin veprat e artit pa iu referuar shoqërive të veçanta, në sfondin e të cilave janë krijuar. Por historicizmi në interpretimin e letërsisë ka të bëjë me përcaktimin e fenomenit të ri letrar, jo thjesht dhe vetëm në një sfond të përcaktuar historik, por edhe në procesin e konfirmimit të ndryshimeve thelbësore të tij, sipas parimit [...] të shpjegosh shkakësisht një gjë, do të thotë të shpjegosh si dhe përse ka ndodhur, domethënë të tregosh “historinë” e saj.

Vetëtitulli i punimit *Përgjenezën e literaturës shqipe* prezanton që në krye konceptin filozofik të Çabejt mbi kuptimin dhe interpretimin e letërsisë, ku duket se parimi themelor metodologjik është zbulimi i rrethanave të specifikës së letërsisë së një kombi, se, zhvillimi i saj është ndryshim i vetë sistemit letrar, se letërsia jonë lindi në një kontekst social–historik dhe kulturor, se ajo ekziston në kohë dhe hapësirë të caktuar. Kjo do të thotë se evolucioni letrar ndodh dhe në marrëdhënie me sisteme të tjera sociale, kulturore, historike, etj. *Metodologjia shkakore dhe e origjinës*, që zhvillimin e letërsisë e lidh me shkaqe historike e sociale, me ndikime të ndryshme letrare e joletrare, është një nga tri drejtimet themelore metodologjike (krahas asaj strukturore dhe asaj funksionale–receptive). Pikërisht mbi këtë bazë metodologjike në sistemin e të menduarit dhe studimit të Çabejt ndodh gërshetimi i vëzhgimeve antropologjike me ato historike apo gjuhësore, gjeografike, folklorike. Sipas tij, rruga e *zhvillimit mendor* të kombit duhet parë nga vija që ka ndjekur literatura, sepse “poezia popullore dhe shkrimtaria jonë [...] dëshmojnë *shpirtin e nacionit*”, kuptuar si dy funksione themelore që shkrihen së bashku. Sepse ne e dimë, që letërsia është mendim dhe shpirt, ndjenjë, përjetim dhe reflektim i njeriut! Ky shpirt derdhet drejtpërdrejt në poezinë popullore, prandaj ky aspekt përbën shtratin themelor të studimit të

shkencëtarit tonë gjenial. Metodologjia historiciste sjell në studimin e tij një qasje sa interesante, aq edhe origjinale, që nxit disa teza dhe orientime të rëndësishme, si: “t’i trajtojmë një herë së brendshmi këto çështje, por sidomos historinë shqiptare, duke e studiuar nga gjendja e sotme në të shkuarën, duke nxjerrë nga fakte të reja të njohura përfundime për perioda të moçme” Apo kur i jep një shtrirje më të thellë interpretimit të poezisë popullore, e cila duhet studiuar tërësisht dhe sintetikisht brenda kuadrin të folklorit të përgjithshëm ose me tezën se “këngët popullore janë në gjendje të lëshojnë dritë edhe në historinë e fiseve tona e të tjera, që do shihen më pas.

Lind pyetja: përse Çabej, i diplomuar në një nga qendrat më të zhvilluara të shkencave filologjike, në Vjenë dhe Grac, qëndron në pozitë pozitiviste, pikërisht në vitet kur mendimi teorik bashkëkohor (formalizmi rus, që spostohet më pas në Pragë etj.) si dhe ai anglo-amerikan (kritika e re) ishin bërë pothuaj mbizotërues? Nuk ka asnjë dyshim se këto teori, që kishin pushtuar me bujë mendimin teorik-letrar të kohës, njiheshin nga Çabej. Si shpjegohet atëherë qëndrimi i tij në metodologjinë e kuptimit të letërsisë si *fenomen shkakor*, i lidhur ngushtë me faktorë historikë e kulturorë? Do të mendoja se arsyet kryesore janë këto:

1. Ndikimi nga historicizmi dhe shkolla historiko-kulturore e shekullit XIX ishte i fuqishëm në sistemin e tij të të menduarit. Ndonëse teoritë formaliste ishin bërë mbizotëruese, Çabej i qëndron logjikës së rreptë të shkencëtarit. (Kish ndodhur që edhe Jakobsoni, një ndër themeluesit e formalizmit dhe gjeni në fushën e mendimit teorik-letrar, midis tre opsioneve të qasjes komplekse ndaj letërsisë, vite më pas arriti të pranojë edhe qasjen shkakore dhe gjenetike, e cila rehabiliton marrëdhëniet midis letërsisë, realitetit historik, shkrintarit e shoqërisë).

2. Arsyeja e dytë: metodat e studimit të letërsisë përpunohen sipas specifikës dhe ndryshimeve që shfaq vetë letërsia. Zhvillimet letrare shqiptare të deri atyre viteve dhe rrethanat historike të Shqipërisë kërkonin ndoshta pikërisht këto kritere të interpretimit shkencor që përpunoi studiuesi ynë. Prandaj koncepti metodologjik i Çabejt mbi shpjegimin e letërsisë i përket modelit *historicist* dhe *përcaktues*, tiparet themelore të të cilit janë metoda kronologjike, shkakësia, fakti, përshkrimi, biografia dhe psikologjia. Ky pikëvështrim, që

përqendrohet në gjenezën e fenomenit letrar, në objektivitetin dhe empirizmin, në kronologjinë letrare, në periodizimin makro e mikro të historisë së letërsisë, në marrëdhëniet shkakore midis fenomenit letrar e jo letrar, në marrëdhëniet midis letërsive të mëdha dhe të vogla, në kontekstualizimin e procesit letrar mbi bazën e kriterit themelor nacional ose rajonal, në funksionin e vlerave letrare në kohë e hapsirë, etj. është i pranishëm brenda studimit të shkurtër të Çabejt mbi gjenezën e literaturës shqipe.

Në themel të tezave të Çabejt mbetet interpretimi në plan të gjerë i krijimtarisë popullore; ai bën një dallim dhe përcaktim aq të saktë mbi specifikën e poezive, të këngëve, të gojëdhënave, të proverbave, të përrallave, madje të nënlojeve të këtyre krijimeve, koncepte të cilat mund të jenë në shtrat të çdo studimi të këtyre llojeve të krijimtarisë popullore nga specialistë të fushës. Është me shumë interes qasja e tij mbi një *aksiomatikë të dyfishtë* brenda letërsive ballkanike. *Së pari* ndikimi i poezisë popullore në letërsi, duke shkuar në ekstremin pohues se s'mund të ketë poezi të vërtetë pa këtë ndikim. Në këtë rast metoda historike–kulturore mbizotëron në pikëvështrimet e Çabejt. *Aksioma e dytë*: theksimi i ngjyrës politike të letërsisë, temat kryesore të së cilës ishin nacion dhe politikë. Sipas Çabejt, në raport me letërsitë e perëndimit ky nuk ishte ndryshim, por tipar i brendshëm kulturhistorik e tipologjik. Në këtë qasje historiko–kulturore është interesante teza se ndarja e letërsisë shqiptare sipas pikëpamjesh sistematike ose kronologjike–historike do ishte me të meta, nëse nuk do të vlerësohej edhe roli i karakterit të popullit, i personalitetit të shkrimtarit, si produkt i lidhjes etnike dhe etike me fisin. Mendoj se Çabejt është nën ndikimin e teorisë së Hipolit Tenit (shek.XIX), i cili studimin e letërsisë e lidh me tre faktorë themelorë: *racën, ambjentin dhe momentin*. Kjo duket qartazi në qasjet ndaj letërsisë në dy studimet e tij. Mbi konceptin metodologjik që qëndron në shtratin e këtyre qasjeve, Çabejt paraqiti tezën tjetër se karakterizimi i letërsisë shqipe nuk duhet bërë prej periodash historike, por prej qarqesh kulturore dhe letrare, duke përcaktuar katër qarqe, që tashmë njihen prej shkencës sonë (qarku katolik i Shqipërisë Veriore, qarku italo–shqiptar, qarku ortodoks i Shqipërisë Jugore dhe literatura kombëtare e shekullit XIX). I gjithë sistemi i tij teorik mbështete në qasjen historike ndaj letërsisë, kur

thekson se “Përpara historisë së literaturës shqiptare duhet shkruar historia e Shqipërisë.” Është mjaft interesante teza tjetër, sipas së cilës njësia shqiptare e letërsisë sonë është e projektuar në kohë, d.m.th. në fillim janë trajtat e ndryshme që më pas konvergojnë në njësinë letrare. Një ide që mund të zhvillohet më gjerësisht nga historianët e letërsisë.

## II. Boshti i dytë (metoda komparativiste)

### *Romantizmi në Europë Lindore e Juglindore dhe në Literaturën Shqiptare 1945*

Të dy studimet e Çabejt shprehin ndikimin nga shkolla komparativiste. Përpyekjet për interpretim në plan krahasimtar, sado përmes skicimeve të shpejta e të shkurtra, midis letërsisë sonë dhe të Ballkanit, midis letërsisë dhe poezisë popullore, midis letërsive ballkanike dhe atyre evropiane, afirmojnë këndvështrimin specifik metodologjik të Çabejt. Aspekti i parë që bie në sy në këtë qasje janë njohuritë e gjera mbi romantizmin evropian e ballkanik, aftësia për të zbuluar lidhjet e brendshme të letërsisë shqipe me kulturat ballkanike, raportet e këtyre të fundit me kulturat evropiane. Kjo qasje krahasimtare nuk nisët thjesht nga vëzhgime të rastit, por nga njohja e specifikave të secilës letërsi ballkanike e evropiane, që nga bota baltike, nga romantizmi polak, çek e sllovak, hungarez, rumun e bullgar, nga njohja e autorëve të spikatur të sllavëve të jugut (për të cilët vë në dukje jo vetëm motive të përbashkëta, por edhe dallimet në sistemin e tyre).

Metoda rigorozë e përqasjes krahasimtare e çliron studiuesin nga komplekset që jo rrallë janë shfaqur në shkencën letrare, duke njohur ndikimet greke apo bizantine në kulturën shqiptare. Në përqasje të tilla metoda komparativiste nuk qëndron në vetvete, por e gërshetuar me metodën historiko-kulturore, çka sjell vëzhgime dhe teza interesante në karakterizimin e dallimeve midis letërsive të Perëndimit dhe atyre të Lindjes. Konkluzioni i studiuesit E. Çabej se “literaturat, sidomos të kombeve të vogla, të Europës së Lindjes e të Juglindjes kanë më shumë një karakter receptiv, ato janë mburjtur në një farë mënyre me përkthimet që u bënë nga literaturat e Perëndimit [...] se te kombet e Lindjes na shfaqet më fort funksioni nacional dhe etik i literaturës, te kombet e Perëndimit më fort ana

artistike e saj “ është tezë që studimet e sotme mund ta zhvillojnë më gjërësisht. Qasja komparativiste midis romantizmit të Perëndimit dhe atij të Lindjes, mbi bazën e së cilës ai ka vënë në dukje një varg ndryshimesh apo tiparësh romantike që mungojnë në letërsitë e Lindjes, i nxjerr studiuesit disa pikëpyetje lidhur me çeshtjen nëse humbi romantizmi diçka nga karakteri origjinal në këtë kalim. Apo siç është pohimi befasues, se “a mund të flitet më për romantizëm në Europën Lindore?” Përsëri është *metoda historiko–kulturore* që e ndihmon studiuesin tonë t’i gjejë arsyet në trajtën mendore të këtyre kombeve, në rrethanat historike, sidomos të vendeve ballkanike, që do të përbënin një fushë shumë të gjerë studimi edhe në ditët e sotme.

Në këtë qasje *specifikuese* studiuesi zbërthen specifikën e romantizmit shqiptar. Dhe teza më interesante është ajo që “*pozita gjeografike e ndërmjeme e Shqipërisë midis Perëndimit dhe Lindjes [...] i ka dhënë drejtimin dhe literaturës.*” Kryqëzimi i botës romake–katolike me botën bizantine, herë duke ngadhjyer njëra mbi tjetrën, herë duke jetuar të dyja njëkohësisht dhe paralel, por më shumë duke u shkrirë në një njësi bashkë me lëndën anase të vendit, është ndër konkluzionet më interesante të aplikimit të metodës komparativiste, duke arritur në teza që janë shfrytëzuar nga studiues të djeshëm dhe të sotëm. Suksesi i metodës komparativiste të Çabejt u shfaq sidomos në interpretimin e romantizmit arbëresh, ku duket qartë se vëzhgimet e tij ndikuan në shkrimet e disa studiuesve që u morën më pas me romantizmin arbëresh dhe atë shqiptar në përgjithësi. Të kuptosh dhe zbatosh thellë metodën komparativiste do të thotë që vështrimi i letërsive të krahasuara të rrokë njëkohësisht strukturën e brendshme dhe të jashtme, planin e thellësive dhe të sipërfaqes. Ky është orientimi metodologjik i sistemit të Çabejt që ngërthen brenda vetes disa vëzhgime origjinale, për të shkuar në konkluzione teoriko–historike të rëndësishme. Metoda krahasimtare e drejton atë në përvijimin e specifikës së strukturës romantike të veprës së poetit arbëresh De Rada, në përfaqeset interesante të personazheve të tij me ato të veprave të autorëve perëndimorë të kulturës antike, të letërsisë orientale, në veçoritë që e vendosin poetin në patosin dhe poetikën romantike evropiane. I tillë edhe krahasimi i Darës me poezinë e botës skoceze; po ashtu është interesant karakterizimi i romantizmit



naimian, ku dallon se te poeti nuk ka ndikim të poezisë popullore, siç ndodh në romantizmin gjerman, të vendeve sllave apo dhe te autorë të tjerë shqiptarë. Shkakun e gjen në dy plane: a – në përjasjen e romantizmit turk e grek me “romantizmin e vendeve gjermanike, ku interesi për krijimtarinë popullore kish ardhur përpara lindjes së romantizmit“ dhe b – te vendet sllave, ku “poezia popullore dhe poezia romantike shkrihen me njëra tjetrën si në pikëpamje të kohës ashtu dhe të përmbajtjes.“ Metoda komparativiste zbulon dukuri thelbësore jo thjesht te Naimi, por te veçoritë e specifikës së romantizmit shqiptar, i cili duhet të hetohet jo në bllok, por në mënyrë më të specifikuar të origjinës dhe faktorëve të brendshëm të shfaqjes së tij.

Siç e thashë më parë, metoda komparativiste e aplikuar nga Çabej nuk do të kishte suksesin e thellësisë së vëzhgimit, nëse do të mbetej thjesht në një krahasim në plan të jashtëm të dukurive letrare. Ajo mplekset natyrshëm me thellësitë e njohjeve *historike e kulturore* të epokave, me krahasimin midis letërsive e kulturave të Lindjes nga ato të Perëndimit, me dallimin që sheh midis romantizmit të Europës Lindore dhe asaj Juglindore apo dhe më specifikisht, me karakterizimet e poetëve të letërsive të ndryshme, Kështu, duke njohur zhvillimin historik të dy lëvizjeve të mëdha mendore të Europës perëndimore në shek. XVI, humanizmin dhe renesansën, por edhe atë të karakterit kishtar–religjioz, si dhe romantizmin me lindjen e nacionalizmit në shek. XIX, Çabej ndërton panoramën e zhvillimeve kulturore e letrare në Europë e Ballkan, për të dalluar në këtë sfond edhe specifikat e romantizmit shqiptar. “Sadoqë poetë romantikë na paraqiten si pjella e së njëjtës frymë të kohës, megjithëkëtë ngjatë elementeve të përbashkët që i lidhin me njeri tjetrin, na dalin përpara te ata edhe tiparet nacionale“, shkruan ai. Njohja e periudhave historike të zhvillimit letrar evropian si dhe qasja krahasimtare e ndihmon për të arritur në disa tipologjizime interesante të specifikave romantike të letërsive nordike, gjermane, angleze, frënge, të letërsive të vendeve të lindjes (çeke e sllovaqe, polake, hungareze, rumune etj. Është interesant, gjithashtu koncepti komparativist i Çabejt, i cili mbi bazën e njohjeve të thella të poezisë popullore propozon që “të sqarohen në fillim, si shkallë e parë, lidhjet e veçanta midis poezisë së dy popujve, së dyti vështrimi

i përgjithshëm, i cili të përfshijë gjithë popujt e Ballkanit. Në këtë koncept metodologjik ai propozon gërshetimin e *metodës sinkronike me diakronike* të marrëdhënies letrare të vendeve ballkanike. Këtë qasje *specifikuese* dhe *dalluese* e sheh mjaft interesante sidomos edhe në krakasimin e përrallave dhe gojëdhënave, duke iu referuar “teorisë së valëve“ të Johannes Shmidit. Ai e quan shikim izolues prodhimin poetik të një populli ballkanik pa krahasimin me poezinë e popujve të tjerë.

Raportet dhe dallimet mes këtyre letërsive dëshmojnë suksesin e metodës krahasimtare të Çabejt edhe për shkak të njohurive të thella mbi këto letërsi. Kështu, mund të them, se në sajë të kryqëzimit të *metodës historiko-kulturore* dhe *metodës komparativiste*, që ngrihen mbi një koncept të qartë filozofik–metodologjik, studimi i tij i kapërcen kufijtë e trajtimit të gjenezës së letërsisë sonë dhe sidomos të romantizmit shqiptar, duke shënuar teza të rëndësishme të metodologjisë së studimit të përgjithshëm. Nuk po ndalem në analizat origjinale, madje befasuese, në aspektin melodik, metrik, gjithnjë në plan krahasimtar e tipologjizues, etj. etj. Çabej ndërton një sistem origjinal të kuptimit dhe interpretimit, hedh teza që meritojnë të shpjellohen më gjerësisht. Ndonjë tezë ëshët shfrytëzuar nga studiues të gjysmës së dytë të shek. XX e deri sot, por pa u thelluar më tej.. Një tezë shumë e rëndësishme për kohën, për të cilën edhe sot mbetet pyetja metodologjike, se a duhej konsideruar Shqipëria si një njësi apo si një mozaik, duke konstatuar të metat e deriatëhershme mbi këtë raport, ku sipas tij, kjo njësi ish cënuar nga disa studiues, të cilët përqëndroheshin vetëm në një aspekt të formave të jetës shqiptare, pa këqyrur tërësinë. Sipas studiuesit tonë, dijetarëve u mungon vështrimi i përgjithshëm. Në kohën kur u botua ky studim kjo tezë merrte rëndësi të veçantë. „*Njësia është, thekson ai. Është njësi etnike e kulturhistorike.*“ Gjithashtu, krahas vlerave të jashtëzakonshme që solli lulëzimi i romantizmit në Europë e Ballkan (aspekte që tashmë ne i dimë), njohja e thellë si dhe vështrimi objektiv i dukurive letrare ballkanike i jep Çabejt kurajën shkencore për të pohuar, se „*nacionalizmi që e ka gurrën e tij letrarisht te romantizmi, zhvilloi edhe anën e tij të prapë, shovinizmin. Siç ndodh shpeshherë me kombet e vogla, nderimi i vlerave të polemik të vet pati për pasojë që këto vlera shumë herë*

*u çmuan më lart se ç'duhej. Kjo që ana negative e këtij zhvillimi [...] helmoi në mënyrë të shumfishtë marrëdhëniet midis kombeve.* “ Mendoj se kombinimi i këtyre dy metodave, historiko–kulturore dhe krahasimtare, është qasje e përshtatshme për të arritur në konkluzione sa letrare aq edhe filozofike.

Duke kaluar, sigurisht jo gjerësisht, nëpër Europë: Lindje–Perëndim, ai la pas teza që mbeten megjithatë të patrajtuara në thellësi, sepse studimet komparativiste ende nuk janë në shkallën që e kërkon specifikimi shkencor i letërsisë dhe kulturës sonë popullore. Shkencëtari ynë ishte i vetëdijshëm për shkurtësinë e analizave të tij (siç jam edhe unë e vetëdijshme për trajtimin jo të plotë të dy studimeve të tij), por vlera e jashtëzakonshme e E. Çabejt si interpretues i letërsisë dhe krijimtarisë popullore qëndron në faktin se qasja e tij nuk ka karakter thjesht përshkrues, ai propozon thellësinë, kombinimin e dy metodave. I vlerësuar si gjeni i gjuhësisë shqiptare, E. Çabej duhet njohur edhe si një teoricien i jashtëzakonshëm i letërsisë dhe krijimtarisë popullore. Vetëm në dy studime jo shumë të gjatë ai vendosi piketa thelbësore, la teza që meritojnë të merren e rimerren për t’u zhvilluar më tej nga shkenca jonë letrare.

## **Literatura**

Çabej, E (1938-1939): Për gjenezën e literaturës shqipe. Hylli i Dritës, Shkodër.

Çabej, E. (1994): Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare. MÇM, Tiranë.

Ethem Likaj, Albana Avrami

## **ÇABEJ - ZOT I THELLËSIVE TË HISTORISË SË GJUHËS SHQIPE**

Viti 2023 shënjon 115-vjetorin e lindjes së monumentit të madhështisë së shkencës albanologjike, akademikut Eqrem Çabej. Eqrem Çabej, i njohur nga opinioni shkencor mbarëshqiptar si etimolog i paarritshëm, gjithë jetën e tij ia kushtoi thelbit të identitetit të gjuhës shqipe, etimologjisë së shqipes, mbështetur edhe në arritjet më të qëndrueshme të fonetikës historike të shqipes.

Në të vërtetë, studimet e thelluara në këto fusha të historisë së gjuhës shqipe nisën me Bopp-in, Pedersen-in, Jokl-in, Meyer-in etj., por, duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit të 20-të, shkallën më të lartë e arritën me studiesit shqiptarë, të cilët, më në fund albanologjinë e sollën në vendin e vet. Ndër ta merita më e madhe, në radhë të parë, i takon Çabejt, sepse më mirë se kushdo vështrimin kërkimor dhe studimor e hodhi edhe në krahasimin historik të brendshëm. Gjuhëtari i madh danez, H. Pedersen-i, theu mendësinë e ndikimit të strukturave gramatikore të huaja në gjuhën shqipe; austriaku N. Jokl-i, nga ana tjetër, i përcaktuar për atë kohë nga Çabej si "albanisti më i madh", rroku me kohë tërësinë e problemeve, që paraqiste studimi shkencor i gjuhës shqipe; Çabej i kapërceu të gjithë. I pajisur me filozofinë e studimeve enciklopedike, ai prej kohësh ndoqi parimin e përafritimit të të dhënave të disa fushave, që mund të japin shpjegim parim bazë për metodën bazë të çdo studimi historik.

Në studimin e etimologjisë së fjalës shqipe, Çabej është vërtet një enciklopedist. Me njohuritë e tij të thella gjuhësore, historike,

sociologjike, gjeografike dhe etnografike, që i zotëronte si një mjeshtër i madh, mundi të hyjë në labirinthin e fjalës shqipe. Mbështetur në metodën krahasuese-historike, ai i dha asaj jetë shkallë-shkallë. Duke u kapur herë nga rrënjët, herë nga degët, me dorë të sigurt, veçoi ç'është e vendit e ç'është e huaj në visarin leksikor të gjuhës shqipe. Në çdo studim të ndërmarrë, para së gjithash, përzgjedh metodën e studimit. Qysh në moshë të re përzgjedh metodën më racionale të studimeve, çka tërhoqi vëmendjen e albanologut të shquar danez, Pedersen-it, i cili në vitin 1938 do të shkruante për Çabejn 30-vjeçar: "Është shumë e gëzueshme që tani, për herë të parë, një shqiptar i lindur trajton gjuhën dhe historinë e popullit të vet, duke zotëruar mirë metodën e zhvilluar në Evropën Perëndimore."

Me frymëzim dhe përkushtim, por edhe me një objektivitet shkencor, ai i dha shqipes atë thelb të vetin, që e vendon si të veçantë në familjen e madhe gjuhësore indoevropiane. Çdo fjalë e rrokur prej tij është një studim më vete; nuk është thjesht përkthim i fjalës, por enciklopedi e saj. Tek çdo fjalë zbërthen një varg të panjohurash. Në periudhat më të errëta parabuzukiane ai u end si me fanar në dorë dhe e ndriçoi fjalën shqipe nga mosha më e hershme e saj deri në ditët tona, duke e shndërruar historinë e fjalës shqipe në histori të vërtetë të fjalës shqipe. Siç thuhet në parathënien e librit "Studime shqiptare" (Vepra të zgjedhura, libri 390, botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës), ai sikur shkriu etimologjinë fono-historike me etimologjinë leksiko-historike.

G. Meyer-i, në vitin 1891, kishte botuar "Fjalorin etimologjik të shqipes", por, për shkak të njohurive shumë të kufizuara të dialekteve të shqipes, të teksteve të vjetra dhe të folklorit shqiptar, ai dhe studiues të tjerë pas tij, mbërritën në përfundimin e gabuar, se shqipja është një gjuhë gjysmëromane. Çabej dhe studiues të tjerë shqiptarë dhe të huaj, me studimet e tyre, e përmbysën këtë hamendje, e cila ishte kthyer thujse në aksiomë.

Çabej shfaqet njëherësh edhe si fonetikan historik i përsosur. Njohësi më i mirë i dijeve të albanologëve të huaj më të mëdhej, të Meyer-it, Pedersen-it, Meyer-Lübke-s, Jokl-it etj., i kapërceu ata falë aftësisë dhe mundësisë së bashkimit të teorisë së madhe gjuhësore historike me thelbin e materialit faktik të shqipes.

Çabej e studioi vargëzimin tingëllor të shqipes në sistem me

metodën e tërheqjes nga e sotmja në të shkuarën, kudo dhe ngado. Megjithëse përfundimet e paraardhësve të tij – thuajse tërësisht të huaj për ecurinë e tingujve të shqipes ishin jo vetëm plot vlerë, por, për një pjesë të mirë, edhe të qëndrueshme. Çabej ndryshoi, saktësoi, krijoi dhe u dha jetë zhvillimeve të mëtejshme të tyre. Ai erdhi të studimet fonetike kryesisht përmes etimologjisë; por mandej bëri fonetikë në shërbim të fonetikës. Përfundimet e paraardhësve, plotësimet dhe saktësimet e mëtejshme të tij i sistemoi dhe i klasifikoi, duke dhënë me saktësi karakteret fonetike konstitutive të shqipes. Në rrafshin e fonetikës historike, Çabej vërtet nuk foli për gjithçka, por atje ku foli, tha gjithçka. Përfundimet për reflekset në barazimet dhe mosbarazimet e tingujve u bënë modele të skalitura e të qëndrueshme, saqë morën fuqinë bindëse të rregullave a të ligjeve të fonetikës historike të shqipes.

Përfundimi se zanoret fundore të vjetra të shkurtra të shqipes kanë rënë dhe zanoret e gjata zakonisht janë reduktuar në –ë, u dha shpjegim edhe mjaft përfaqësimeve fonologjike si dhe formave morfologjike të sistemit foljor, emëror dhe mbiemëror të shqipes. Për rrjedhojë, edhe vetë Çabej, por sidomos pasardhës, që u morën me probleme të morfologjisë historike të shqipes, zanoren fundore të fjalës a të fjalëformës jo vetëm e karakterizuan si të re, por njëherësh kërkuan edhe burimin e saj.

Duke dalë të ky përfundim i përgjithshëm, nuk mund t'i mënjanohej problemit aq të diskutuar dhe të diskutueshëm të nyjave të prapme dhe të përparme të shqipes. Në lidhjet gjuhësore shqiptaro-rumune - fillimisht në lëmin e leksikut - i tërhoqi vëmendjen veçanërisht rrethana që të dy gjuhët në problemin e nyjave të prapme “piqen gjer në hollësitë më të imta si në mënyrën e përdorimit, si në pozicionin sintaktik”. Kjo ngjashmëri strukturore morfologjike i krijoi bindjen se këtu nuk mund të kemi “një zhvillim spontan në secilën nga këto dy gjuhë”. Prandaj në artikullin e mirënjohur “Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe”, iu kthye problemit të nyjave dhe pas një trajtimi të gjerë, arriti në përfundimin e ri - përkundër mendimit më të përgjithshëm - se “postpozicioni i artikullit në shqipen është më i vjetër se pozicioni proklitik dhe se ky i fundit ka rrjedhur prej atij në ngërthim të fjalisë, me anë të një përsëritjeje”.

Merita e këtij gjykimi qëndron, në radhë të parë, në rrethanën

që, ndryshe nga mendimi i mëparshëm mbizotërues që mbështetej thuajse në argumentime teorike e jashtë gjuhës shqipe, tani, me metoda të kombinuara ndër-gjuhësore, argumentimet ishin më të gjera dhe veçanërisht tepër të shembëllzuara. Pavarësisht se vërtetimi i kësaj hipoteze u largua disi nga struktura burimore fillestare e përfimit të nyjave dhe se një pjesë e argumenteve vërtetonin dhe vërtetojnë njëherësh edhe mendimin e kundërt, ajo ka bërë mjaft përkrahës. Ky shpjegim dhe argumentim bëhet mjaft bindës për një periudhë më të vonshme të përfimit të nyjave, pikërisht për periudhën kur ato ishin përftuar dhe vazhdonin - siç vazhdojnë edhe sot - të ndikojnë mbi njëra-tjetrën

Nga mendimi tjetër i Çabejt, që del po në këtë artikull, se “Me qenë se [...] shumica e mbaresave zanafillëse të fleksioni ranë qëmoti, munda të shfaqej artikulli, si të thuash si një zëvendësim i fundoreve të zhdukur të rasave”, theksoj se, me këtë interpretim, ai tërthor shfaq edhe konceptimin e ri të rishfaqjes ciklike të gjendjeve gjuhësore.

Një vend të veçantë Çabejt, po këtu, i kushton edhe kronologjisë dhe vlerave të mjaft nyjave të përparme, ku, pavarësisht nga zgjidhjet që dha për burimin dhe kohën e përfimit të tyre, vetëm mendimi se “[...] artikulli prepozitiv tregohet i shumëllojtë në funksionet e tij e i lëvizshëm e elastik në paraqitje, herë-herë i lëkundshëm e i paqëndruar; (dhe që) shpeshherë kalon nga një kategori te tjetra, dhe në disa raste mungon fare”, intrigoj mjaft gjuhëtarë, të cilët i rimorën ato herë bashkë e herë veç, duke dalë pastaj me larmi mendimesh.

Por rasti më tipik i kalimit të Çabejt nga fonetika te morfologjia historike shfaqet te studimi “Fjala *vise* dhe shumëset e singularizuar në gjuhën shqipe”. Në “grindjen” e parreshtuar të dijetarëve për shpjegimin e burimit të fjalës *vis*, Çabejt, ndryshe nga gjithë gjuhëtarët e atëhershëm, nuk u nis vetëm nga etimoni, por edhe nga rrjedhojat e tij brenda shqipes. Ai me shumë shembuj, të rinj dhe të vjetër, vërtetoi se *vis* ~ *vise* nuk buron drejtpërdrejt nga një bazë indoevropiane, por është shumësi i emrit *vend*, përkatësisht *vise*, i cili është përdorur si njëjës.

Nismëtar i mprehtë i studimit të kësaj dukurie për shqipen, siç dihet, ka qenë Meyer-i, i cili jo vetëm e shpjegoi këtë dukuri, por edhe

e pasuroi me shumë shembuj. Serinë e shumësve të singularizuar e pasuruan më tej gjuhëtarë të tjerë, si: Jokl-i, Xhuvani, Weigand-i, Skok-u etj., por merita e Çabejt qëndron në rrethanën që ai kësaj dukurie i dha një vend të veçantë dhe më të madh në gjuhën shqipe, jo vetëm se e pasuroi rrethin e shumësve të singularizuar, por edhe se i klasifikoi rastet e tij, se i shpjegoi formalisht dhe kuptimisht, se, në shumicën e rasteve, e pa këtë dukuri si një proces të dyfishtë. Por, kush qëndron këtu pak më gjatë, vëren edhe një histori të tërë kthimesh dhe rikthimesh morfologjike të njëjës-shumësi i emrave: Nga barazia fillestare e njëjësit me shumësin, shqipja kaloi në formimin e një teme të veçantë për shumësin, çka e karakterizon edhe sot strukturën emërore. Historia e hershme dhe e sotme ka njohur të mjaft kategori emrash, ku njëjësi përdoret edhe si shumës; dje edhe sot vërehet edhe procesi i kundërt, ai i përdorimit të formës së shumësit si njëjës. Të dyja dukuritë, të përfuara, së pari, përmes analogjisë popullore, herë kanë barazuar njëjësin me shumësin, herë shumësin me njëjësin. Studimi i kësaj dukurie të sistemit emëror i kapërcen më tej vlerat e studimit në vetvete, sepse çeli rrugën për studimin e kësaj dukurie në tërë sistemin morfologjik të gjuhës shqipe. Çabej i vuri gishtin kësaj dukurie të një rast, duke shpjeguar edhe pse ka ngjarë. Nisur nga kjo dukuri e veçantë, sot shtrohen pyetje të tjera: Në cilin sistem morfologjik tjetër vërtetohet kjo dukuri? A vazhdon më tej? Cila është prirja? Ç’rol luan në strukturën morfologjike të shqipes etj.?

Çabej, që përtej gjuhës dhe përmes gjuhës synonte të ndriçonte çështje themelore të shqipes në hapësira më të mëdha sesa shtrirja e saj, shtroi për zgjidhje, në radhë të parë, lidhjet burimore etnike të shqiptarëve, duke u bërë kështu figura qëndrore e kësaj dijeje në botën e albanologjisë. Ai, duke njohur në thellësi e gjerësi historinë e mendimit albanologjik për këtë çështje, me prurjet dhe arsyetimet e reja, argumentoi afritë dhe lidhjet më bindëse të gjuhës shqipe me gjuhë të tjera ballkanike të periudhës së antikitetit. Pas studimeve të tij për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar, mendimi se shqipja është vazhdim i ilirishtes dhe se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve, u shndërrua në një koncept të përgjithshëm dhe të qëndrueshëm, të cilit i janë referuar dhe i referohet gjithkush që do t’i bashkohet ose t’i afrohet së vërtetës. Gjithmonë i përmbahet



parimit teorik se historia e gjuhës është historia e popullit që e flet atë. E duke iu përmbajtur këtij parimi, i kundërvihet qysh atëherë mendimit se çështja e autoktonisë duhet shtyrë në kohë shumë të mugëta, sepse, si të gjithë indoevropianët, paraardhësit e shqiptarëve janë të ardhur në Ballkan. Pra shqiptarët (a ilirët), sipas tij, kanë ardhur në Ballkan në kohë të lashta. Ndoshta ky nuk është fundi i kësaj historie prejardhjeje, por vështirë të thuhet se dija pas tij ka shkuar më tej.

Në tërësi, vepra gjuhësore e Çabejt ka vulën e pionierit dhe të mjeshtrit. Çabej, zot i thellësive të gjuhës shqipe, duke zgjedhur, ndriçuar dhe gdhendur fjalën shqipe, si rrallëkush e ktheu atë edhe në art të bukur jo vetëm nga ngjyra, por, në radhë të parë, nga thelbi i qëllimit të saj. Gjuha e Çabejt ka personalitetin e ndritur të tij. Çdo copëz e gjuhës së tij sjell një botë tjetër gjuhe, ndoshta të panjohur edhe nga njohësit më të mirë të saj. Pas saj edhe gjuhëtari apo artisti më i mirë i fjalës kërkon të flasë ndryshe.

Ja një copëz nga gjuha e Çabejt: “Në këtë nuk ndihet ëmbëlsia e fladit të verës sesa furia e murrërit të dimrit. Ajo nuk ka aromën e luleve, por ka erën e shëndoshë të dheut. Ka edhe diçka prej pikash të rënda e të idhëta; në të shprehet ana e rëndë e jetës shqiptare.”

Kushdo që njeh mirë veprën e Çabejt, habitet nga thellësia dhe gjerësia e veprës së tij; habitet sa shumë i dha ai gjuhës nga dija dhe jeta e vet.

Ky dijetar i madh për një brez studentësh, që patën fatin ta dëgjonin, u bë idhull, sepse tek ai mishëroheshin edhe plot virtyte. Teksa derdhte para studentëve dije plot dritë, që rridhnin si lumë, me sinqeritet fëminor u drejtohej studentëve për të mësuar a saktësuar një fakt gjuhësor nga treva të largëta, që ai nuk kishte mundur ta kapte. Epërsia e dijeve të tij madhohej edhe më shumë para barazisë njerëzore, që ai të ofronte në çdo rast plot respekt dhe dinjitet. Tribuni i dijeve nuk njihej aq nga dukjet a qëndrimet e mëdha hijerënda, të cilat, me meritë, do t’i shkonin për bukuri, sesa nga njerëzit, nga autoritetet pariore shkencore, që e rrethonin dhe e nderonin gati me përlulesi. Bota shqiptare do ta ruajë Çabejn në përfytyrimet e veta si monument të madhështisë shkencore. Nuk gjen fjalë që t’i shkojë për ta ngritur atë në atë shkallë që ai ngriti gjuhën shqipe. Pa asnjë dyshim, pjesën më të mirë të respektit shkencor albanologjia e ka

merituar falë madhështisë së Çabejt. Çabej i kaloi kufijtë e Atdheut të vet. Edhe pse jetoi në një botë të mbyllur, u njoh larg dhe afër. Ai, nga të rrallët, nuk vuri kufi veprash të etiketuara si të rrezikshme a të dëmshme nga ideologjia e kohës; me pastërtinë e mendjes së shkencëtarit, pati guximin të mos vërë as kufi midis njerëzve. Respekti i tij ndaj shkencës dhe shkencëtarëve mbeti nga fillimi i jetës deri në fund elitar dhe kristal. Kur një komb përfaqësohet me emra, që i kalojnë kufijtë e tij dhe njihen si simbole, ata bëhen njësh me kombin. Dhe, kur këto figura, si Çabej, i përkasin shkencës, atëherë mendja e tyre, padyshim, futet në rrallësitë, që përbëjnë thelbin më cilësor të kombit.

Gjovalin Shkurtaç

## **NGA IDEJA PIONIERISTIKE E E.ÇABEJT PËR “TË FOLËT E GRAVE” DERI TE GJINIA SI NDRYSHORE SOCIOLOGJISTIKE**

Figura si Eqrem Çabejt, përtej vlerave mirëfilli si shkencëtar e mendimtar i përmasave dhe cilësimeve meritore si gjeniale, me kohë, nëpërmjet ithtarëve e pasuesve, vijon duke e shtuar hapësirën e adhurimit, legjendarizohen dhe përbëjnë pikëmbërritjet më të lakmueshme që, në një farë mënyre, edhe idhullzohen. Një idhullzim frytdhënës dhe mbrodhësindjellës, gjithsesi i atillë që rrit, madhëson jo vetëm personin, por në radhë të parë lëmin a fushën me të cilën u mor; në rastin e mjeshtrit tonë: gjuhësinë shqiptare dhe, pa drojë se lajthisim, albanologjinë në përgjithësi.

Sot, në 125-vjetorin e ditëlindjes së Mjeshtrit tonë të madh, pavarësisht se ç’moshë kemi: të moshuar si unë që po flas dhe disa prej kolegëve të pranishëm, që patëm edhe fatin e bardhë se qemë studentë të tij në vitet ’60-’70 kur ai na jepte lëndën “*Hyrje në historinë e gjuhës shqipe.Fonetika historike e shqipes*”, po edhe brezat pasardhës, deri te më të rinjtë që janë mbledhur sot në këtë sallë, mësimdhënës qofshin a punonjës shkencorë prej të gjitha hapësirave shqiptare kompakte ballkanike, për Eqrem Çabejn kanë pasur nderimin që ndjen kombi për burrat e mëdhenj, siç ndiejnë, p.sh. fqinjët tanë sllavë për M.Kërlezhën, siç ndiejnë gjermanët për vëllezrit Grim e Wilhelm Humboldt-in. Këtë nderim që po e shprehin një yjësi studiuesish të mbledhur në Konferencën e sotme, s’epse figura dhe kontributet e Eqrem Çabejt janë të atilla që krejt bota shkencore e kulturore shqiptare do t’i kenë si postulate

e vija pune gjithmonë, sa të ketë studime albanologjike e gjuhësi shqiptare.

Në përputhje me temën e zgjedhur e të përfshirë në vargun e kumtesave të tubimit të sotëm, do të kufizohem në sotme disa vija pune dhe shqyrtime rreth **gjinisë si ndryshore sociolinguistike**, fushë së cilës, sikundër e dinë të pranishmit dhe studiuesit, me sa kam mundur, këta dhjetëvjeçarët e fundit, i kam kushtuar mund e rreshta, punë hulumtuese, kërkime konkrete në libra e fjalorë, po edhe hetim e grumbullim lënde të re në terren, porse kjo mbetet, ndërkaq, një punë “na kantjer”, një hulli që do të vijojë jo vetëm prej meje, po edhe nga studiues të rinj, që kanë ndërmarrë e do të vijojnë tema masteri e doktorature nga kjo fushë.

Qëllimi i këtyre studimeve është tashmë i qartë dhe i lidhur në atë bosht për të cilën po lejohej të kumtojmë: të ecim në hullinë dorëmbarë të nisur herët nga Eqrem Çabej, i cili qe i pari ndër gjuhëtarët shqiptarë të Pasluftës së Dytë Botërore, që përmendi “**të folët e grave**” dhe shkroi rreshtat më të parë kushtuar eufemizmave të shqipes, duke na shpënë kështu në atë fushë të pëlleshme të etnolinguistikës, po edhe më gjerë të sociolinguistikës, që ne do ta quanim si “**reparti pararojë**” i etnografisë së të folurit garisht.

Nuk kam aspak ndërmend ta lodh auditorin e nderuar me rreshtimin e përsëritur të asaj që modestërisht kemi bërë në këtë fushë, por vetëm do të theksoj disa prej “piketave” që, në hullinë e Mjeshtrit tonë të madh, na duket se kërkonin (dhe kërkojnë më tej) shqyrtime të hapëta sociolinguistike dhe që, në mënyrë të përmbledhët, po i parashtroj duke parafrazuar ideimin që kam bërë në disa tema studimore për gradën “Master” dhe “Doktor i shkencave”:

Të shqyrtohet sa më gjerë **lënda e dallimeve dhe diferencimeve gjuhësore sipas gjinisë** në shqipes, duke u pykëzuar në një kategori leksikore dhe frazeologjike të lidhur ngushtë me etnografinë e të folurit dhe me etnologjinë, sikundër janë **eufemizmat**. Shqyrtime të sotme etnolinguistike dhe ato sociolinguistike, qoftë përsa u takon marrdhënieve gjuhë-gjini (seks), qoftë edhe për **lidhjet gjuhë-mendësi** (mentalitet) mund të jenë edhe për shumë kohë të frytshme për studimin e aspekteve të ergologjisë dhe të kulturës shiptërore të popullit, sidomos i një populli që ka ruajtur më vonë se kushdo

tjetër në Evropë, dukuri të vjetra e, madje, shumë të vjetra që shfaqen edhe në gjuhën e tij. Eufemizmat, sikundër ka ideuar në kohën e vet prof.E.Çabej dhe siç jam përpjekur ta përpikëmtuar më tej në studimet e mia, mund të konsiderohen si “*reparti pararojë*” e dëshmues i gjuhës së grave. Si e tillë, kjo dukuri, **meriton të trajtohet edhe si ndryshore** në përjasje me gjuhë të mëdha, sikundër është gjermanishtja.

Dhe, tashti, për të mos hpërdoruar as kohën nevojisht të kufizuar,por as vëmendjen tuaj,po përmend,pa u ndalur në leximin e tyre,disa prej pikave që në rrjedhë të motive,me sa kam mundur I kam shqyrtuar e pajisur me prurje prej hulumtiesh konkrete në krahina të ndryshme të Veriut e të Jugut.

1. Dallimi i njerëzve sipas gjinisë (seksit) si ndryshor sociolinguistik brenda së njëjtës bashkësi shoqërore.

1.1.Dallimi sipas gjinisë është një ndryshor aq i qartë në çdo bashkësi gjuhësore e, megjithatë, atij i janë kushtuar jashtëzakonisht pak studime e hulumtime konkrete. Për këtë arsye, deri edhe në parashtrësia serioze për etnolinguistikën, shkruhet me formulime të përafërta dhe duke u mbështetur në të dhëna mjaft të mangëta. Studiuesit më në zë shprehen se një studim i thelluar në këtë ndryshor do të ishte nga më të mirëpriturit në etnolinguistikë<sup>1</sup>. Gjinia, bashkë me moshën janë faktorë natyrorë, porse ata pleksen edhe me ndarjet shoqërore e etnokulturore të ndryshme të bashkësisë shoqërore duke dhënë dorë, kështu, edhe për diferencime e grupime të të folurit. Nocioni i një “*gjuhe femërore*” apo, së paku e një sjelljeje të ndryshme të të folurit të grave, në termat e konservatorizmit apo të hapjes ndaj risive (inovacioneve) ishte një gjë familjare për botën klasike dhe mesjetare. Le të përmendim dy dëshmi nga dy përfaqësues të shquar të atyre dy epokave, përkatësisht të Ciceronit për epokën klasike dhe të Dantes për atë mesjetare.

Ciceroni në veprën “*De Oratore*”, III, 45 shkruan:

“Equidem cum audio socrum meam Laeliam – facilius enim mulieres incorruptam antiquitatem conservant, quod multorum sermonis expertes ea tenent semper quae prima didicerunt -, sed eam

---

<sup>1</sup> Shih: G.R. Cardona, Introduzione all'etnolinguistica, Societa editrice il Mulino, Milano, 1976, pp.77.

sic audio, ut Plautum mihi aut Naeuium videar audire; sono ipso vocis ita recto et simplici est, ut nihil ostentationis aut imitationis afferre videatur; ex quo sic locutum esse eius patrem iudicio, sic maiores; non aspere ut ille, quem dixi, non vaste, non rustice, non hiulce, sed presse et aequabiliter et leviter” [*Për gratë është më e lehtë ta ruajnë pastërtinë e theksit antik; duke qenë se ato nuk duhet të flasin me shumë njerëz, ruajnë zakonet e hershme...Pra, kur dëgjoj Lelian, më duket sikur dëgjoj Plautin ose Nevion. Vetë tingulli i zërit të saj është aq i përveçëm dhe natyral...sa më ngjan se aty nuk ka as gjurmë të mendjemadhësisë as të imitimit: përfundoj se i tillë duhet të ketë qenë shqiptimi i babait të saj dhe i të parëve të saj*”.]

Dante Aligieri, në “*De Vulgari Eloquentia*”<sup>2</sup>, shkruan:

“Nam vocabulorum quaedam puerilia, quedam muliebria, quedam virilia; et horum quedam silvestria, quedam urbana, et eorum que urbana vocamus, quedam pexa et lubrica, quedam yrsuta et reburra sentimus”.

[Në fakt, disa fjalë ne i dëgjojmë si femënore, disa si femërore, disa si mashkullore, dhe midis këtyre të fundit, disa si të folur fshatarak, të tjera si qytetare; dhe ndërmjet atyre që i quajmë “fjalë qytetare”, disa i dëgjojmë si më të krehura e të drejta, ndërsa të tjera si të pagdhendura e të vrazhda”.]

**1.2.** Ekzistenca e *gjuhës së grave* ka qenë vënë re qysh në kohët e lashta nga disa autorë klasikë, madje, duke u përpjekur edhe për të gjetur një farë shpjegimi: *gratë flasin gjuhë të ndryshme nga burrat, sepse ato vijnë nga grupe të tjera*. Kështu, Erodoti tregonte se skitët nuk arrinin të nxënin kurrë gjuhën e amazonave që kishin marrë për gra, ndërsa amazonat e mësonin skitishten, ndonëse jo në mënyrë të përsosur. “*Sauromantët* (dmth.pasardhësit e skitëve dhe të amazonave) përdorin gjuhën skite, porse e flasin gjithnjë me disa difekte, sepse amazonat nuk e nxënë atë asnjëherë në mënyrë të përsosur”.<sup>3</sup> Më i njohur ka qenë rasti i Karibes në

---

2 Shih: Dante Aligieri, *De Vulgari Eloquentia*. Traduzione e saggi introduttivi di Claudio Marazzini, Milano, Mondadori VII 2, 4 (cituar sipas . Vincenzo Orioles, *Sociolinguistica*, 2001-2002).

3 Citatin e japim sipas veprës së përmendur më lart të G. R. Cardona, *Introduzione all'etnolinguistica*, Societa editrice il Mulino, Milano, 1976, pp. 78.

Santa Domingo, ku burrat flisnin karibisht, kurse gratë aravakisht, fakt që është dëshmuar qysh më 1564 në librin e Du Tertre-s “*Historia general de las pequenas Antillas*” dhe qysh atëherë kjo e dhënë ka mbetur tepër e cituar në letërsinë shkencore mjaft të varfër lidhur me këtë ndryshor sociolinguistik. Në të dy rastet nuk është fjala për gjuhë të veçanta, por për të njëjtën gjuhë bazë në dy varietete të ndryshme, dhe kjo është pikërisht situata që duhej të prisnim. Siç shkruan G. R. Kardona: “Diferenca nuk duhet të jetë një aksident historik; po të donin, gratë amazone dhe avarake do të kishin mundur të asimiloheshin gjatë një periudhe të gjatë prej shumë brezash. Përkundrazi, diferenca duhej të ishte sepse ka një domethënie, dhe mjeti më ekonomik për ta mbajtur gjallë ishte që të shenjohej nëpërmjet modifikimeve të vetë varietetit që përdorin burrat. Në studimin e kësaj dukurie, gjuha e grave është konsideruar si përjashtim në krahasim me gjuhën normale, që do të ishte ajo e burrave: në terma të shkollës së Pragës, gjuha e burrave do të ishte varieteti i shenjuar (i markuar) në krahasim me atë të grave. Nuk është menduar, siç shihet qartë, se raporti dialektik që ekziston ndërmjet dy seksëve duhej të mbahej në këmbë në mënyrë aksiomatke edhe ndërmjet gjuhëve përkatëse. Për të pëmbysur termat, mjafton të fusim konceptin e *gjuhës mashkullore*. Kjo do të meritonte gjithashtu një studim të thelluar.”<sup>4</sup> Për dogonët gjuha *sixhi soo* është gjuhë sekrete e burrave (ava), pra “*formacion që bashkon burrat e bashkësisë së katundit përballë masës së grave e të fëmijëve*”. Në këtë grupim burrash, djemtë mund të pranohen e të përfshihen vetëm pasi të kenë arritur moshën e duhur dhe pasi të kenë kryer rrethprerjen (pasi të jenë bërë synet), pra, si një pjesë e ritit që shënon kalimin e tyre nga kushtet e fëmijës në atë të mashkullit plotësisht të pjekur e të përfshirë (integruar) në grupin përkatës. Me fjalë të tjera, siç thotë Kardona, “kemi të bëjmë me një kundërvënie (opozicion) të dëshiruar ndërmjet *burrave* dhe *jo burrave* (gra e fëmijë), *filleshtarë* e *jo filleshtarë*, folës të sixhi soo-së dhe jo folës të saj. E njëjta kundërvënie përshkon gjithë konceptimin e dogonëve ndaj gjuhës. Dogonët ndajnë në meshkuj e femra fjalët,

---

4 Shih: G.R. Cardona, *Introduzione all'etnolinguistica*, Societa editrice il Mulino, Milano, 1976, pp.,78.

tingujt e deri edhe dialektet”<sup>5</sup>.

Në gjuhën *koasate* (në Luisiana të SO-së) është e mundshme që nëpërmjet një tërësie rregullash të sajohen format mashkullore prej atyre femërore, por jo e anasjellta. Format femërore të koasatit janë më të vjetra (arkaike) sesa mashkulloret dhe gjejnë përgjegjëse në gjuhë të tjera të grupit muskogee; pra, janë format mashkullore që paraqiten si risi (inovacion).<sup>6</sup>Një ndihmesë të vyer për studimin e larmisë gjuhësore në lidhje me seksin ka dhënë edhe gjuhëtari danez Oto Jespersen, një nga pionierët e kërkimit në këtë lëmë qysh nga fillimi i shek.XX. Ai vuri në dukje se mënyra e të folurit femërisht ishte e mbushur me ngurrime, eufemisma, zbulime; gratë, me dashje, u shmangen shprehjeve të trasha e vulgare, ndërsa mëtojnë të depozitohen për hir të rolit të tyre shoqëror mënyra civile dhe të educates së mire: ato, pra, janë më të prirura se burrat për të qenë të rezervuara dhe elegante në qëndrimet dhe sjelljet gjuhësore<sup>7</sup>.

Për sa i takon të folurit femëror ka pasur dy qëndrime të dallueshme: ai i shkollës dialektologjike të gjysmës së parë të shek. XIX, sipas së cilës gratë janë më ruajtëse (konservative) sesa burrat dhe, në kohët më të reja, ai i sociolinguistëve, të prirur për t’i konsideruar gratë si subjekte përtëritëse (inovative), sepse ato janë më të ndjeshme ndaj formave të prestigjit, siç është dëshmuar shumë here nga sociolinguisti amerikan Uljam Lebov, sipas të cilit

*“in careful speech, women use fewew stigmatized forms than men, and are more sensitive than men to prestige patterns. They show this in sharper slope of style shifting, especially at the formal end of the spectrum”* (Labov, 1984, f.243).[“...gratë përdorin një numër më të vogël formash të stigmatizuara sesa burrat dhe janë më të ndjeshme se burrat ndaj modelit me prestigj. Ato dëshmojnë pra një përlulje më të qartë ndaj ndryshimeve të stilit, sidomos në skajin më formal të spektrit”.]

**1.3.**Letërsia shkencore që kemi në dorë përmend edhe dallime të gjuhës femërore sidomos në bazë të tre ndryshorëve: fonologjia, morfologjia dhe leksiku. Në të vërtetë çështja e një *“gjuhe të grave”* është bërë aktuale me studimet e Lebovit, nën shtypjen e të cilave

---

5 Po ai, po aty.

6 Për këtë shih edhe E. Sapir, 1929 b.

7 Shih: V. Orioles, Sociolinguistica, 2001.



duhet njohur një lidhje e seksit dhe treguesve të standartizimit të thënies. Sipas hetimeve të bëra në anglishten e Nju Jorkut, gratë duket se janë mjaft më pranë gjuhës standarde, mbajnë një qëndrim gjuhësor më konformist nga frika se mos pësojnë sanksionin shoqëror që godet theksimin (akcentin) krahinor o popullor dhe në përgjithësi varietetin jostandard. Lebovi thotë:

“...men use more nonstandard forms, less influenced by the social stigma directed against them, or, conversely, women use more standard forms, responding to the overt prestige associated with them”. (Labov, 1990, f.210). [...]

Në qëndrim i tillë varet nga fakti se gratë paraqesin një tregues shumë të ulët të vetëvlerësimit gjuhësor (*self-confidence*). Kushtet gjuhësore të gruas kanë një pasqyrim në ndryshimin gjuhësor në vështrimin që “*women lead in both the acquisition of prestige patterns and the elimination of stigmatized forms*” (Labov, 1990, f.213); e folmja e grave duket më e ndryshme për të mbledhur e për të shtënë në përdorim risitë eventuale në një drejtim të tillë. Megjithatë, shumë studiues mendojnë se tiparet e të folurit grarisht janë në pjesën më të madhe të rasteve shprehje e një të dhëna kulturore më fort sesa gjuhësore<sup>8</sup>. Këtë mund ta mbështesim edhe me të dhëna edhe nga të dhëna të shumta të etnografisë së të folurit.

**1.3.1.**Në Malësi të Mbishkodrës e më gjerë në trojet veriore kemi hetuar **të folurit e grave të reja** e sidomos të nuses së sapomartuar e në vijim derisa të bëhet grua me fëmijë. Gjatë gjithë kohës së nusërisë ajo është e detyruar të zbatojë rregullat etnografike të **të folurit me zë të ulët**, shpesh duke mos lëshuar fare zë por duke lëvizur buzët dhe duke mbajtur qëndrimin tipik të nusërisë me duart të vëna në mes në lartësinë e zemrës. Madje, në raste dasmash, kur vjen nusja në oborr, pikërisht për rrethanën që asaj, atë ditë dhe për inerci, edhe për disa muaj radhazi, nuk i takon të flasë, një nga dasmorët apo një njeri tjetër i caktuar, thërret me zë të lartë. “*O pramja e mirë po thotë nusja!*” dhe, pas kësaj, shtie me pushkë dhe fillon kënga e mirëseardhjes nga graria: “*Moj nuse kunata jonë, mirse vjen në saraj tone*” ose “*Mirë mbrama-mirë mbrama, mirë mbrama i zoti i shpisë*”. Kur fillon të ngrejë zërin dhe të thërrasë me

---

<sup>8</sup> Shih: V. Orieoles, Sociolinguistica, 2001.

zë të lartë do të thotë se nusja tashmë është bërë vendase, e ka kaluar periudhën e të qëndruarit “*palue*”.

Shumë qartë ky zakon i të folurit të nuses kur shkon në derën e dhëndrrit na është fiksuar edhe në disa prej këngëve popullore shqiptare. Në njërën prej tyre grate i këndojnë nuses vargjet e mëposhëme, si zëdhënëse të pales së dhëndrrit:

“Harroi, moj nusja ime,  
Zakonet e asaj shtëpije,  
Këta zakonezët tanë,  
Gjithë mjalt’ e sheqer janë”.

Në një këngë tjetër me titull “*Dëgjo, nuse, ç’thotë ungjilli*”, flitet pikërisht për zakonet që duhet të zbatohet nusja ndaj vjehrrës dhe vjehrrit, ajo nuk duhet të flasë kur flasin ata, përndryshe do të ketë pasoja e ndëshkime:

“Dëgjo, nuse, ç’thotë ungjilli,  
O nuse, o lule,  
*Vjehra fol’ e ti mos fol,*  
O nuse, o lule!  
*Se ti po flet, masha kërcet,*  
O nuse, o lule!  
*Vjehri fol’ e ti mos fol,*  
O nuse, o lule!  
Po me zemërë në dorë  
O nuse, o lule!”

1.4.Po kështu, në një farë mënyre, është i përcaktuar edhe qëndrimi e të folurit me zë jo të lartë të mysafirit që shkon të bujë në një shtëpi të dikujt. Mysafiri duhet të dëgjojë shumë e të flasë me zë normal, pa bërtitur dhe, po të jetë burrë me mend, nuk flet shumë, sadoqë mikpritësit dëshirojnë ta dëgjojnë dhe e pyesin, ai duhet të marrë pjesë në kuvend, por gjithnjë pa e tepruar.

Po ashtu, **të folurit me zë të lartë**, si dukuri që shkon në një izoerge që nis nga Përroi i Thatë dhe shkon duke u ngjitur drejt veriut, në mënyrë që sa më lart të ngjitesh aq më të theksuar e ndesh këtë dukuri gjuhësore e që, në fakt, është edhe etnografike. Kjo lidhet, ndoshta, edhe me klimën, me ujin etj. Burrat janë këngëtarë të mirë dhe kanë zë të lartë prej tenori. Shquan sidomos kënga

burrërore “*Maje krahut*”.

Fonologjikisht dhe, sipas mendimit tonë, më tepër fonetikut, mund të vihen re **intonacioni femëror**, realizimi disi i **këngëzuar** i disa fonemave. Kështu, në gjuhën ruse gratë e shqiptojnë /o/ si /uo/ me diftongizim; në italisht, për të karakterizuar një mënyrë shqiptimi femërore dhe snobe, përmendet shqiptimi me teprim të theksuar i labializimit të bashkëtingëlloreve, sidomos i /ts/.<sup>9</sup>

Natyrisht, dukuri të tilla janë ende në hetim dhe, për më tepër, vetë hulumtimet rreth tyre, jo vetëm ndër ne, po edhe më gjerë në studimet rreth marrëdhënieve gjuhë-shoqëri, janë ende “në kantjer”, por ka të ngjarë që edhe në raste të dallimeve shqiptimore për disa fonema të caktuara duhet të kërkohet ndonjë arsye sociale. E tillë është p.sh. gjendja e shqiptimit të **th**-së në anglishten e qytetit të Nju Jorkut që ka studiuar Lebovi. Ai thotë se shqiptimi i **th**-së rezulton të ketë një lidhje me shtesësimin social dhe me dallimin e folësve në gjini. Ky vëzhgim është konfirmuar shumë herë edhe nga Fisheri në studimin e bërë në vitin 1958, si dhe nga Fasold-i në të folmen e Detroitit. Ata theksojnë se kjo sjellje është veçanërisht e shenjuar tek gratë që i përkasin klasës së mesme-të ulët (medio-basso).

Ndoshta, po të bëhen kërkime të thelluara, ndonjë gjë interesante dhe e ngjashme me sa kanë konstatuar Lebovi, Fisheri etj. në gratë amerikane, mund ta shihnim edhe në ndonjë aspekt të shqiptimit të ndonjë foneme të shqipes, si p.sh. i fonemës **rr**. Kam krijuar përshtypjen se gratë e qyteteve të Jugut (dhe përgjithësisht si prirje e të folurit të grave të reja qytetare) nuk e shqiptojnë **rr**-në, dhe fjalët me atë fonemë i shqiptojnë duke e ndërruar me njëdridhësen **r**: *rush, ara, buri, mar, kam marë* etj.

Nga përvoja shqiptare, ndoshta, ia vlen të përmendim edhe të folurit e këngëzuar të femrave shkodrane, që aq shumë pëlqehet nga jo shkodranët e që e bëjnë mjaft simpatike e tërheqëse atë mënyrë të foluri. Sidoqoftë kjo dukuri mbetet ende gati krejt djerr dhe ia vlen që ta thellojmë me kërkime të mbështetura në anketime e hetime konkrete.

Në letërsinë që njohim është folur edhe për ndonjë dallim morfologjik të gjuhës së grave, sidomos përsa i takon dendurisë së fjalëve me prapashtesa zvogëlimi e përkëdhelie, porse, me sa duket,

<sup>9</sup> Shih: Cardona, vep. cit.

dallimi më i qartë dhe natyrisht edhe më i shpjgueshëm me arsye shoqërore e etnologjike mbetet leksiku apo fjalori e frazeologjia.

Leksikalisht varietetet femërore në përgjithësi e në çdo gjuhë paraqesin një *sasi fjalësh të ndryshme apo të modifikuara në krahasim me ato që përdoren nga burrat*; shembujt janë të shumtë dhe, shpesh, mund të shpjgohen me ndalime, tabu apo specializime të punës. Po ashtu, nga studiues të ndryshëm ka qenë vënë re denduria e **pasthirmave joburrërore** që përdoren nga gratë. Madje, ka edhe shënime se ekzistojnë deri edhe zhargone verevërte femërore. Megjithatë, edhe në këtë rast analiza vetëm sipas këtyre elementeve nuk mund të jetë e plotë dhe privilegjon vetëm disa fakte që bien në sy në mënyrë më të dukshme, por pa qenë ky një tregues i plotvlershëm. Karakterizimi apo dallimi i gjuhës sipas gjinisë duhet studiuar e kundruar në një kuadër sa më të gjerë, duke shtënë në punë edhe gramatikën e tekstit etj. Deri vonë, më të thelluarat për këtë dallim kanë qenë studimet e Lakoff-it (1972, 1973, 1975), porse, megjithatë, mbetet ende shumë për të bërë. Natyrisht *ka edhe dallime që lidhen me argumentin e bisedës* që, nga vetë dallimi kulturor, mendësior dhe shoqëror, u intereson më shumë vetëm grave, ose vetëm burrave. *Por ka edhe argumente të përbashkëta që, megjithatë, kanë ndjeshmëri të ndryshme sipas përkatësisë në gjini*. Me qëllim që të sjellim ndonjë ndihmesë në njohjen sadokudo më të mirë të këtij ndryshori, më poshtë po provojmë të parashtrojmë disa të dhëna e përfundime, qoftë edhe me karakter ende paraprak e që duhen thelluar edhe më tej, por që, ndërkaq, mund të vlejné edhe për trajtimin sa më të hapët të kësaj dukurie.

## 2. Temat “tabu” për gratë.

Janë disa fjalë e shprehje që gratë i kanë të ndaluara t’i përdorin në të folurit e tyre, ndonëse ato, natyrisht, si anëtare të bashkësive të caktuara gjuhësore ku bëjnë pjesë, i dinë. Të tilla janë, ndër të tjera:

a. Emrat e disa pjesëve të trupit të njeriut, të mashkullit e të femrës, që lidhen me organet gjenitale, me marrëdhëniet seksuale qoftë ndër njerëz qoftë edhe ndër kafshët, për të cilat, siç e kemi shprehur edhe gjatë, gratë përdorin perifraza a emërtime të

ndryshme eufemistike.<sup>10</sup> P.sh. në se gruaja do të thotë se i biri (apo një djalë kushdo qoftë) duke luajtur është varë në organet gjenitale, nuk e përmend fjalën përkatëse, por gjen ndonjë shprehje perifrastike eufemistike, si p.sh. *u vra në vehte* (Gjirokastër), *u vra në vetin* (Malësi e Madhe), *u vra në vëdi* (qytet i Shkodrës e gjetkë në veriperëndim). Të shumta dhe të larmishme janë perifrastat eufemistike për të zëvendësuar shprehjen bëj urinën: *bëj urtin* (Gjirokastër), *me lan në uj* (Kosovë), *me derll uj* (Malësi e Madhe). Deri vonë në shumë areale të shqipërisë përdoren folja *përmierr* dhe togefjalëshat *dal jashtë*, *dal për veten*, kurse në kohët e sotme ka marrë përdorim më të gjerë *shkoj në banjo*. Nuk kanë munguar gjithandej edhe shprehjet eufemistike me një dozë të dukshme humoristike, si *dal me pa motin* (Mirditë), *i jap mazit uj* (Malësi e Madhe, kryesisht në të folurit e meshkujve të rinj në moshë). Dikur, sidomos në anët e veriperëndimit, përdoren perifrasta *po shkoj atje ku shkon mbreti në kambë*. Në ligjërimin familjar, kryesisht intim, përdoren edhe shprehje të tjera, si *po shkoj të bëj një telefon*. Nëpër qytete, sipas një tregimi humoristik që ia atribuojnë një shkrimtari të njohur, është bërë e shpeshë shprehja *shkoj për të mbledhur lule*.

Në ligjërimin e fëmijëve dhe në të folurit zbutur (përkëdhelës) të grave me fëmijët e vegjël (i ashtuquajtur *baby talk*), përdoren edhe një mori fjalësh e togefjalëshash për të mënjanuar emërtimet përkatëse të organeve gjenitale dhe të foljeve që shprehin nevojat organike të përditshme të të vegjëlve. Kështu, për urinimin dëgjojmë: *bëj çicin*, *bëj çivilukun*, *baj çulën* dhe, kohët e reja, *bëj urinën*, si shprehje e ndikimit nga kultura mjekësore e higjieniko-shëndetësore në rritje; ndërsa për ujët e trashë thuhet: *bëj kakën*, *bëj nevojën*. Në spitale e ambulanca gjithashtu përdoren si eufemizma fjalët e huaja përkatëse, si: *feçe*, *urine* (*një analizë të feçes dhe të urines*); *penis*, *vagina*, *testiculat* etj.:

Shpesh gratë e reja, sidomos kur janë në prani të meshkujve, edhe fjalën *sisë* (*cicë*, *cikë*) e mënjojnë, duke shtënë në punë kalime kuptimore figurative, sidomos tropet, si p. sh. *i jap krahuor*

---

10 Shih punimin tonë “Disa shqyrtime rreth eufemizmeve sipas ideve të Eqrem Çabejt, në “Eqrem Çabej personalitet I shquar I shkencës dhe kultures shqiptare”, në 90-vjetorin e lindjes, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Studime shqiptare, 9. “ÇABEJ”, 1998, f.86-97.

(Malësi e Madhe), *i jap krahnur* ( Kosovë); *jap të pijë*, *jap gji* etj.

Një tabu ka qenë edhe shtatëzania e grave, prandaj, gjithandej, janë përdorur shprehje perifrastike, si: *kam mbetur me shtat zanë, me barrë, jam e rëndë* (geg. *jam randë*), ndërsa në zhargonin e meshkujve, sidomos kur nuk janë të pranishme femra, dëgjohen edhe **pseudoeufemizma**, si: *ka rënë miu në kos, ka rënë miu në hambar* (Korçë), *ka hangër karabusha* (Veri).

Si në Veri ashtu në Jug të bashkësisë gjuhësore shqiptare ka një deltë emërtimeve eufemistike për të mënjeluar emërtimin e bythës, si: *të ndenjurat, prapanica, e prapmja, tulet, suma, anusi* (kryesisht mjediset mjekësore).

**b.** Janë “tabu” për gartë edhe sharjet me fjalë të ndyra, siç bëjnë, jo radhë, meshkujt. Edhe kur tregojnë për zënka e grindje të meshkujve, ndërsa riprodhojnë thëniet e tyre, gratë përdorin zakonisht shprehje eufemistike të përbëra nga folja *baj/bëj*: *i tha kshtu t’ia basha nans* (Malësi e Veriut), *i tha të bëfsha nënën* (Jug). Në këtë hulli, gjithandej trevave shqiptare, folja *bëj* (*baj*) ka marrë edhe kuptimin eufemistik të kryerjes së marrëdhënieve seksuale: *e zunë duke bërë atë punë, e vrau se i bënte të ëmën, bënte me të bijën; i tha ta bafsha e ta kthefsha* etj.

Në të folurit e femrave për të mos përmendur foljen përkatëse ndeshim metafora a kalime kuptimore si: *palloj* (kushedi ku vete *pallohet* ajo; e *palloi* mirë e mirë); ndërsa në të folmen e meshkujve përdoren: *mbërthej, ngreh, rras, fus, pucas*, “rras, mbërthej fort” etj. Nga më të dendurat dhe, me kohë, e zhveshur nga kuptimi eufemistik që ka pasur në krye të herës, është *shkërdhej*, që njihet gjithandej si në Veri ashtu edhe në Jug. Në Veri, ndërkaq, *shkërdhej* ka qenë përdorur me vlerë asnjansë (neutrale) në terminologjinë e lahutës: atje, *shkërdhej* “i bie lahutës me shkathtësi” dhe *shkërdhyes-a* a *shkërdhos-a* quhej harku i lahutës, rasi apo rënësi i saj. Pra, do të kemi pasur një kalim metaforik të tipit të italishtes *scopare* “fshij” që sot është përgjithësuar duke mbetur thjeshtë si një fjalë e lidhur me seksin e që ka zëvendësuar foljen *coire*. Me vështrim humoristik përdoren edhe fjalë të markuara për marrëdhëniet seksuale ndër kafshët, si *shkarrafend* (në anët e Dibrës), *fërkoj, shkel, ndjek* (Malësi e Madhe) etj. Dikur, sidomos në ligjërimin e kujdesshëm

të meshkujve dhe femrave, ka qenë përdorur folja *puth* (e ka di:t gjithkush se e ka pu:th x), duke na dalë kështu një kuptim i foljes *puth* “kryej marrëdhënie seksuale”, pra me një kalim kuptimor të njohur edhe në gjuhë të tjera, si p. sh. në frëngjishten, ku folja *besair* “puth” ka edhe kuptimin “bëj seks”.

Vetëm në moshë të thyer dhe, gjithmonë në një kuadër të caktuar shoqëror, femrave mund t’u lejohej të përdorin ndonjë nga sharjet mashkullore, si p. sh. sharja me nënë, motër etj. Megjithatë, kjo dukuri, ndërkaq, ka qenë dhe është e ndryshme sipas krahinave, besimeve fetare etj. Me sa kemi mundur ta ndjekim, *shturja e gojës ndër gratë e moshuara është më e theksuar në zonat fshatare, sidomos në malësitë e Veriut* (pjesa katolike e Malësisë së Madhe, e Dukagjnit, e Mirditës etj.), *një pjesë e Labërisë fshatare, ku edhe gratë kanë qenë shumë “burrërore”, porse ka qenë më e pakët në shtresën e grave qytetare*. P. sh. në qytetin e Gjirokastrës, edhe gratë “hanedane” nuk kanë përdorur fjalë e togfjalëshja me fjalë e sharje të rënda.

c. Një ndikim të dukshëm në dallimin leksematik e frazeologjik të grave nga burrat e bashkësisë gjuhësore përkatëse përbën edhe **ndarja shoqërore e punës**: burrat, tradicionalisht, në çdo kohë e në çdo vend, kanë kryer punët më të rënda fizike, sidomos punët bujqësore me parmendë, mbartjen e barrëve të rënda me qerre të tërhequr nga qetë, prerjen e drunjve të mëdhenj, punët në ndërtimin e shtëpive etj., kurse gratë, si rregull, janë marrë me punët e shtëpisë, me gatim, me rritjen e fëmijëve dhe, në raste të domosdoshme, kanë marrë pjesë edhe në punët bujqësore me karakter të ngutshëm, si korrje, shirje, vjelje e rrushit dhe e pemëve të tjera.

Gjithandej, në forma të ndryshme, del edhe shprehja “*punë grash e fjalë grash*”, përkundër thënies “*punë burrash a punë për burra*” si edhe “*fjalë burrash, muhabet burrash*”. Pra, janë quajtur kryesisht fjalë grash folje të tilla, si: *qep, arnoj, gatuj, qëndis, ushqej* (koj) femijët, *shtroj* (tryezën), *laj enët, fshij shtëpinë, laj rrobat* (teshat, lëveret) etj., si dhe shprehje të ndryshme kryesisht garishte, si: *t’u bëfsha* apo *t’u bëftë nëna* (motra, tezja, halla) *kurban, ta marrsha të keqen* apo *ta marrtë nëna* (motra, tezja, halla) *të keqen; ta marrsha të ligën* apo *ta marrtë nëna* (motra, tezja, halla) *të ligën* etj.

ç. **Punë “tabu” për burrat**. Në bashkësitë shoqërore të

dikurshme, po edhe në kohën tonë, kanë qenë e janë edhe disa lloje punësh të “ndaluara” për burrat, si p.sh. tjerja e leshit, endja a thurja e çorapeve me shtiza, puna në vek a po tezgjah, qepja, arnimi i teshave etj. larja e fëmijës dhe përgjithësisht larja si proces pune konsiderohej si “*punë grash*”, gatimi i bukës dhe përgjithësisht përgatitja e gjellëve në shtëpi, me përjashtim të rasteve kur burrat ishin të caktuar si “akshi” (kuzhinier) për raste vdekjesh a dasmash për mbarë katundin, ku, sipas traditës, shërbenin *akçinj* të fisit e të rrethit shoqëror dhe nuk gatuanin gratë e shtëpisë. Së kendejmi buronte edhe fakti që *burrat pak ose aspak i njihnin emrat e foljet përkatëse për objektet a veprimet që lidhen me sa më sipër*, ndërsa ato janë aq të shumta e të shpesha në ligjërimin e grave.

**d.**Një ndarje e dukshme sipas gjinisë (seksit) ka qenë në Malësinë tonë (po besoj edhe në vise të tjera) **në pjesëmarrjen dhe mënyrën e të qarit** kur vdes ndonjë njeri i afërt. Kjo duket mjaft qartë edhe në thënien lapidare: “*Burrat thërrasin vaj, gratë kjajnë (qajnë) e vajtojnë*”. Po ashtu thuhet se “*burrat bân gjâm*”, kurse gratë “*ejkasin*” (bëjnë ejhe, ej), *ivkasin* a *vikasin* (bërtasin me zë të lartë në shenjë pikëllimi u shquajnë tonet e larta si “iu”), *kukasin* (bëjnë kuku).

Kjo, në të vertetë, është një nga pikat ku spikasin më dukshëm edhe zakonet e traditat e çdo krahine dhe përbëjnë themelin e asaj që quhet “*etnografi e të folurit*”. Burrat e vërtetë, si rregull, nuk janë shquar për fjalë të tepërta, nuk merren me “*më the e të thashë*”. Thashethemet kanë pasur si autore kryesisht gratë.

**dh.** Një nga dukuritë më spikatëse e tipike të ligjërimin femëror është edhe i ashtuquajtur “*Baby talk*” (të folurit në mënyrë fëminore për zbulimin e fëmijëve) që bëhet kryesisht nga gratë: nënat, motrat e përgjithësisht femrat, por që, në të radhë, mund të ndeshet edhe ndër burrat, veçse kurdoherë në përmasa të rrudhura e në situata tepër të kufizuara, kurse graria këtë dukuri e ka pasur dhe e ka gjithnjë në përmasa shumë të mëdha. (Për këtë do të flite më gjerë në një vend tjetër).

**e.**Ndarja shoqërore e këngëve: ka *këngë burrash* dhe *këngë grash*, prandaj, edhe nëpërmjet kësaj ndarjeje ka pasur e ka edhe një ndarje të ligjërimin artisik sipas gjinisë. Kjo, jo vetëm përsa u përket zërave e timbreve, gjithsesi e kurdoherë të dallueshëm



sipas seksit, por edhe përsa i përket mënyrës së organizmit të fjalës artistike, të shprehjes së ndjenjave etj. Kështu, ka këngë burrash si *kanga majekrahit* apo *përkrykrahit* (Malësi e Madhe, Dukagjin etj.), kënga me lahutë e me çifteli a sharki (në Veri të Shqipërisë, Mirditë, Kosovë etj.) që, deri në këta dhjetëvjeçarët e fundit, kanë qenë kryesisht “pronë” e burrave. Këngë burrash që nuk këndoheshin nga gratë ka pasur edhe në Jug, p.sh. kënga e Gjolekës në Gjirokastrë këndohej vetëm nga burrat, atë këngë nuk e këndonin gratë. Nga ana tjetër, ka pasur edhe këngë grash apo grarishte, që diku janë quajtur edhe “*bylbyli*”, të cilat kanë qenë të paracaktuara për t’u kënduar nga grupe femrash. Në përgjithësi ato që quhen “*këngë të buta*” kanë pasur më shumë përhapje në gratë e reja sesa në burrat.

Nga këngët grarishte po sjellim një nga anët e Dibrës, sipas studentes Mirela Rama:

*O mi nuse, mi karafille*  
*A t’pëlçeshin petkat jeshile*  
*Mu m’pëlçeshin o fort e fort*  
*Mi ka gje (blerë) baba me zort*  
*O mi nuse a mëjër ta bana*  
*Si s’ të lash simjet ke nana*  
*T’mbledhish ferra e kulumana.*

**f.Ndarja shoqërore e “qokave” sipas gjinisë.** Ka pasur edhe një ndarje shoqërore sipas gjinisë (seksit) në qokat apo pjesëmarrjen në ceremoni të ndryshme jashtë farefisit. Përfaqësimi në dasmat e varrimet e njerëzve që nuk bëjnë pjesë në farefisin e ngushtë është bërë kryesisht nga meshkujt. Së këndejmi edhe thënia e njohur në gojën e meshkujve: “*Pelën barsë mos ia jep askujt, gruan në dasëm mos e ço!*”. Vizitat për urim në raste të lindjes së një fëmije, qoftë edhe kur ishte djalë dëshiri (djale i vetëm dhe tepër i dëshiruar), janë bërë vetëm nga femrat, kryesisht gra të martuara. Burrat nuk lejohet të shkojnë në këso “qokash”. Kjo jo vetëm në Veri, ku emancipimi ka qenë më i vonuar e ku konservatorizmi ende vijon ta marrë “haraçin” e vet, po edhe në Jug. “Kur lindte gruaja nuk vente burri për vizitë, vente gruaja” - thotë një plakë gjirokastrite. Po ashtu, ka qenë një praktikë kryesisht grarishte festa e *përgimit*, që bëhej në malësi disa ditë pas lindjes së djalit të parë apo të vetëm. Merrnin pjesë kryesisht gratë e shtëpisë e bijat e fisit, ndrikullat dhe gra të

tjera të ftuara, por jo meshkuj.

Tipike grarishte ka qenë edhe organizimi e pjesëmarrja në varjen e pajës së vajzës një ditë para se të martohet. Në Malësi kjo quhej “*mej qit teshat në leg*” (nxjerrje e rrobave të nuses që do të martohet në një litar të varur). Aty marrin pjesë vetëm gratë dhe vajzat, asnjë burrë.

Tipike grarishte kanë qenë edhe yshtja apo “*shkrepja e thgive*” (shuarja e thëngjijve në ujë) kundër syrit të keq, *kanga e lungës*, një lloj yshtjeje kundër mëllënjve të këqinj që shfaqen tek të rinjtë në gjëndrrat e trupit, si dhe *kqyrja e filxhanit*. Përkundrazi, *kqyrja e shpatullës*, ka qenë një praktikë që bëhej kryesisht nga burrat. (Kjo del edhe në një varg të “Lahutës së Malcis” të Gj. Fishtës që thotë: “*Kqyre at shpatull SokoTona*”).

**Me interes për njohjen e leksikut të të folurit grarsht janë edhe disa prej praktikave grarishe, si p.sh. të parët e filxhanit të kafesë.** Aty ndeshim *nëpërkat*, që simbolizojnë të keqen, *zogun*, që simbolizon “haberrin” e mirë a lajmin e gëzuar, *kryqin* (a *kryqet*) që tregojnë lajme të mira, mbarësi në punë apo fejesë etj., numri *pesë* (apo numrat *pesë*) që tregojnë realizim dëshire, *shtata* që tregon lajm të gëzuar nga qeveria etj. si dhe fraza mbyllëse “*Mbifsh dhe në gur!*”, që shqiptojnë gratë në Elbasan pasi mbarojnë së piri kafenë që kanë ndërmend ta kthejnë filxhanin për ta parë mjeshhtëria.

Këto dhe të tjera, që do të dalin në dritë nga hetimet e mëtejshme prej nesh dhe brezit të ri të studiuesve me të cilët bashkëpunojmë prej kohësh, kemi kënaqësinë të themi sot: janë fryte të punës që shkon në hullinë dorëmbarë e të ideuar, së pari, nga prof. Eqrem Çabej. Mbi atë ide, studimet tona janë zhvilluar e po shtohen ashtu si bimët nga fara e zgjedhur mirë, natyrisht edhe me mundimin e kujdesin më të madh e për kohë të gjatë.

Paçim jetë e shëndet për t’i shpënë edhe më tej hetimet dhe punën në këtë lëmë. Dhe, natyrisht, duke iu bindur dialektikës, uroj që idetë dhe vijat e hulumtimeve dorëmbara të ideuara e të nisura nga Eqrem Çabej, t’i kenë për zemër e t’i shpien më tej brezi i ri i studiuesve në Shqipëri e në krejt hapësirat ku ka shqiptarë e ku flite gjuha shqipe.

Anila Omari

**LETËRKËMBIMI I HERMANN ÖLBERGUT  
ME ÇABEJN, NJË MODEL BASHKËPUNIMI  
MIQËSOR DHE KONTRIBUTI TË FRYTSHËM NË  
ALBANOLOGJI**

Hermann Ölbergu, indoeuropianist dhe albanolog i shquar, mik e dashamirës i shqiptarëve, e njohu Eqrem Çabejn në vitin 1963, me rastin e Kongresit VIII Ndërkombëtar të Studimeve Onomastike që u mbajt në Amsterdam, ku merrnin pjesë edhe profesorët nga Shqipëria Eqrem Çabej dhe Androkli Kostallari.

Që nga ajo kohë nisi një letërkëmbim i dendur dhe i frytshëm mes dy studiuesve, nga i cili për fat të keq kemi vetëm njërën palë të korrespondencës, atë të Ölbergut, që arrin në një numër prej 70 letrash në një hark kohor prej vitit 1964 deri në 1980, të cilën na e vuri në dispozicion me bujari Brikena Çabej.

Në ato vite Ölbergu ishte ende një pedagog i ri, rreth 40 vjeç, në Universitetin e Insbrukut, që kishte shfaqur interesa për gjuhën shqipe që në vitet e studimit për gjuhësi indoeuropiane, ndërsa Çabej një studiues i pjekur rreth 55 vjeç dhe në vllugun e krijimtarisë së tij shkencore.

Takimi dhe njohja me Çabejn atij duhet t'i ketë lënë mbresa të thella, gjë që shprehet që në letrat e para të tij drejtuar profesorit shqiptar, dhe me siguri ka qenë edhe një nxitje për t'u thelluar në studimet indoeuropiane për shqipen, fushë në të cilën u habilitua më pas në vitin 1972 dhe drejtoi dhe një kurs të rregullt të gjuhës shqipe

në universitetin e Innsbruket<sup>1</sup>.

Në letrat e para, të vitit 1964, ai shpreh gëzimin për njohjen me Çabejn dhe admirimin e tij për shkencëtarin e shquar shqiptar, i cili në atë kohë kishte një jetëshkrim dhe bibliografi mbresëlënëse, siç e vë në dukje vetë letërshkruesi në një nga letrat e këtij viti mbasi ishte njohur me listën “grandioze” të punimeve të Çabejt dhe ishte zhytur në studimin e saj (6.12.1964). Ky admirim e respekt shprehet në gatishmërinë e tij për të ofruar ndihmë në çfarëdo nevojë bibliografike e shkencore që mund të kishte Çabej dhe nga ana tjetër në interesin e pasionuar që shfaqte për mbledhjen dhe studimin e të gjitha punimeve të mjeshtrit, të cilat kishte vështirësi për t'i gjetur. Letrat rrëfejnë një vajtje-ardhje të vazhdueshme literature shkencore në të dy kahet, libra, separate, fotokopje, mikrofilma, dhe njëkohësisht na tregojnë vështirësitë e mëdha për sigurimin e literaturës nga studiuesit shqiptarë, por edhe të studiuesve perëndimorë për literaturën e vendeve të Evropës lindore. Përmes këmbimeve të tilla me miqtë e tij studiues të vendeve të ndryshme Çabej ka siguruar një pjesë të mirë të bibliotekës së tij vetjake.

Ölbergu, me ndihmën e Çabejt, vendos lidhje me bibliotekën e Universitetit të Tiranës ku ishin Institutet albanologjike në atë kohë dhe për vite me radhë merr rregullisht pako të tëra me libra e revista nga Shqipëria, për çka i shpreh herë pas here falenderimet e tij Çabejt për drejtorin e bibliotekës Mihal Hanxharin, më pas edhe për Kolë Lukën. Në komunikimin me bibliotekën e Shkodrës pati një ngecje në dërgimin e librave, e cila u zgjidh sapo Çabej mori në telefon drejtuesit përgjegjës në Shkodër. Vit mbas viti, Ölbergu me këto dërgesa krijon një seksion të mirë me libra, revista e periodikë shqip në bibliotekën e Universitetit të Innsbruket. (15.12.1966).

Përmes literaturës që merr nga Çabej, Ölbergu tërhiqet gjithnjë e më shumë nga çështjet e gjuhës shqipe në rrethin e gjuhëve i.-e. dhe të historisë së lashtë të saj. Ai mëson jashtëzakonisht shumë nga kumtesat dhe artikujt e Çabejt, të cilat i vlerëson të argumentuara në mënyrë aq të qëndrueshme saqë nuk mund të mos i pranosh përfundimet e tyre. Për të ndjekur fillin e studimeve të Çabejt ai

---

1 E. Lafe, Hermann Ölberg – albanolog i shquar dhe mik i shqiptarëve, Gjurmime Albanologjike - Seria e shkencave filologjike, nr. 52, 2022, f. 153-158. <https://gazetadita.al/hermann-olberg-albanolog-i-shquar-dhe-mik-i-perzemert-i-popullit-shqiptar/>

kërkon vazhdimisht artikuj të tjerë, për të cilat nuk kishte dijeni më parë, duke theksuar faktin e pashmangshëm që çdo kërkim në fushën e albanologjisë duhet të nisë prej tij (p.sh. letër e dt. 4.5.1964). Përshtypja e Ölbergut nga leximi i punimeve të Çabejt është e njëjtë me atë që përjetojmë sa herë lexojmë punimet e tij: ato duhen lexuar me vëmendje rresht për rresht dhe madje duhet t'i rikthehesh, aq të ngjeshura dhe gjithëpërfshirëse janë. Në një letër të vitit 1968 ai shkruan se po merret intensivisht me etimologjitë e Çabejt dhe vëren se puna e tij është vepra më e madhe shkencore që indoeuropianistika ka sjellë që prej dekadash. Njëkohësisht shpreh keqardhjen që këto punë të botuara ende nuk kanë gjetur shteg në studimet e të tjerëve dhe mendon se nëse kjo do të ndodhë, do të ketë një përmbyse të madhe në fjalorët etimologjikë. (15.12.1968) (Ju jeni "absolute Spitze", siç thuhet tani në gjuhën e fëmijëve të mi)

Dëshira për t'u thelluar në çështjet e shqipes e shtyn Ölbergun të interesohet për shqipen e vjetër. Kërkon të dijë nëse janë ndërmarrë punime themelore për veprën e Bogdanit, si glosarë, komentarë, studime gjuhësore dhe nëse në veprimtarinë mësimdhënëse të Çabejt ka një lëndë me temë shqipja e vjetër. (6.12.1964). Veprën e Bogdanit thotë se e ka kserokopjuar me cilësi të mirë nga kopja origjinale mjaft e vjetruar që gjendet në bibliotekën e Vjenës dhe ka dëshirë të thellohet në të. Interesimin rreth shqipes së vjetër ai e shpreh herë pas here në letrat e tij duke pyetur nëse janë bërë edhe për autorët e tjerë punime si ai i Kolë Ashtës për Buzukun dhe, siç ka dëgjuar, edhe për Kuvendin e Arbënit. Shpreh gëzim të sinqertë për lajmin e daljes së shpejti të botimit kritik të Buzukut nga Çabej (26.3.1967), të cilin e vlerëson të çmuar mbasi e ka marrë (14.12.1969), ndërsa pak më vonë njofton se të gjitha monumentet e vjetra shqipe tashmë janë kserokopjuar (16.11.1967).

Letrat pasqyrojnë edhe diskutime e pyetje shkencore që lidhen me leximet e veprave të Çabejt por edhe me vetë punën e tij kërkimore-shkencore në fushë të gjuhësisë indoeuropiane me fokus shqipen, për të cilën konsultohet vazhdimisht me kolegun e shquar dhe pret me padurim kritikun prej tij për punimet që i dërgon (psh. 27.6.1971, 21.12.1971). Dashuria dhe admirimi për personalitetin dhe veprën e Çabejt nuk e pengojnë atë gjithsesi të vështrrojë edhe me sy kritik argumentet e tij shkencore. Në formë të një pyetjeje

me takt ai duket se e sheh me dyshim argumentin e një evolucioni të mëvonshëm satem të shqipes nga karakteri kentum i dikurshëm i ilirishtes, si një mjet gjuhësor për të vërtetuar prejardhjen e shqipes nga ilirishtja, dhe shtron pastaj pyetjen: a është në fund të fundit e domosdoshme që shqipja të jetë patjetër një pasardhëse e drejtpërdrejtë e ilirishtes, edhe pse zotëron vendbanime të lashta në hapësirën ilire? (4.5.1964). Për çështjen e autoktonisë që mbron Çabej, ai i sjell në vëmendje argumentet toponomastike të Ivan Popovićit për kronologjinë e ardhjes së shqiptarëve në trojet e tyre në raport me sllavët<sup>2</sup>, të cilat i duken me rëndësi. (10.1.1964). Ölbergu duket se është i ndikuar nga opinionet e përhapura mes gjuhëtarëve që nga vitet 20-30 për prejardhjen e shqiptarëve nga vise më lindore të Ballkanit në trojet e tyre aktuale, sidomos mbas tezave të famshme të Weigandit që vinin në pikëpyetje origjinën ilire të shqipes dhe e lidhnin atë me trakishten. Për sa i përket reagimit shkencor të Çabejt ndaj analizave gjuhësore të Popovićit dhe konkluzionit të tij për ardhjen e shqiptarëve në Shqipërinë e Veriut me gjasë pas dyndjeve sllave në ato vise, mund t'i referohemi artikullit të tij "Ilirishtja dhe shqipja", ku argumenteve nga toponomastika që Popovići sjell për tezën e tij u përgjigjet me kundërargumentin se një pjesë e mirë e këtyre toponimeve në gjuhën shqipe janë apelativa, fjalë të leksikut të përgjithshëm, gjë që dëshmon se sllavët i kanë marrë ato prej shqiptarëve<sup>3</sup>. Ölbergu pranon forcën e argumenteve të Çabejt në studime si "Probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe" apo "Karakteristikat e huazimeve latine të shqipes" etj., megjithatë mendon se problemi iliro-shqiptar duhet të mbetet i hapur derisa të mos gjenden disa pika të ngulëta kronologjike për zhvillimet kentum ose satem të shqipes. (6.12.1964). Gjatë studimit të etimologjive të Çabejt ai nxjerr edhe shënime, vërejtje etj., të cilat nuk ngurren t'ia përcjellë autorit pasi mendon se janë në të mirë të punës së tij studimore.

Në vjeshtë të vitit 1970 ai më në fund bën një vizitë trejavore

2 I. Popović, "Slaven und Albaner in Albanien und Montenegro: Zum Problem der slavisch-albanischen Sprachchronologie", *Zeitschrift für Slavische Philologie*, Vol. 26, No. 2 (1958), f. 301-324.

3 E. Çabej, "Ilirishtja dhe shqipja", në: *Ilirët dhe gjeneza e shqiptarëve*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë 1969, f. 41-52, ribotuar në: *Studime Gjuhësore IV*, Rilindja, Prishtinë, 1977, f. 202.

studimi në Shqipëri, mjaft të rëndësishme për punën e tij kërkimore, ku takon personalisht Çabejn dhe familjen e tij si dhe kolegë të instituteve albanologjike në Tiranë e në Shkodër. (11.11.1970).

Fillimin e një momenti kulmor në bashkëpunimin mes Ölbergut dhe Çabejt shënon letra e datës 27.6.1971, me të cilën gjuhëtari austriak i ka përgatitur një surprizë mikut dhe kolegut nga Shqipëria, ndoshta edhe si një dëshirë për t'i sjellë sadopak gëzim mbas një hidhërimi të rëndë familjar që i kishte ndodhur pak kohë më parë. Njëkohësisht kjo ishte dhe një shprehje mirënjohjeje ndaj mikpritjes së veçantë që përjetoi nga kolegët në Shqipëri si dhe e lidhjes shpirtërore e profesionale që kishte krijuar tashmë me Shqipërinë përmes kontakteve të ngushta me Çabejn. Atij i ka shkuar ndër mend se Norbert Jokli, mësuesi dhe miku i madh i Çabejt, në vitin 1972 kishte tridhjetëvjetorin e vdekjes dhe me atë rast mund t'i organizohej një tubim albanologjik ndërkombëtar në Insbruk. Idenë e tij e ka biseduar me kryetarin e Shoqatës indogjermane prof. Mayrhofer dhe projekti është miratuar në Shoqatë. Letrës i ka bashkangjitur një skicë paraprake të tubimit, por disa çështje që ka menduar ai i parashtron në letër dhe gjithashtu shtron një varg pyetjesh që lidhen me mënyrën e organizimit dhe me tematikat e kumtesave, për të cilat kërkon mendimin e kolegut. Nga përmbajtja e letrave që lidhen me organizimin e kolokiumit bie në sy serioziteti dhe përkushtimi për të realizuar në parametra e nivel sa më të lartë shkencor një tubim albanologjik, që do të ishte i pari në botën e jashtme dhe do të mbetej më i rëndësishmi edhe për shumë dekada me radhë. Idetë dhe pyetjet që paraqiten në letra na japin edhe një model se si duhen organizuar konferencat shkencore, për një strukturim sa më efektiv të aktivitetit.

Synimi i organizatorit është të mbledhë një tubim sa më përfshirës, ku të pajtohen dy fusha interesi të ndryshme: nga njëra anë të diskutohen probleme të ndryshme gjuhësore të albanologjisë dhe nga ana tjetër të marrin pjesë edhe indoeuropianistët, të cilët nuk kanë shumë njohuri për albanologjinë, me referate të përgjithshme, pa u thelluar në çështje të veçanta. Këtë grupim fushash ai e ka pasqyruar edhe në skicën e programit, duke parashikuar një tematikë kushtuar indoeuropianistikës në dy ditë të veçanta dhe një tjetër kushtuar çështjeve specifike të albanologjisë dhe ballkanistikës

në ditët e tjera. Për pjesën e indoeuropeanistikës Ölbergu kërkon mendimin e Çabejt mbi mënyrën e ndërtimit të saj dhe i lutet nëse mund të hartojë një listë temash. Kërkon të zgjidhë një mëdyshje nëse duhet të mbahen kumtesa të veçanta nga secili studiues apo të mbledhin paraprakisht qëndrimet e tyre për pika të veçanta dhe të diskutojnë e të referojnë gjerësisht për to. Mbasi merr me kënaqësi pranimin e Çabejt për pjesëmarrje, ai shpreson se mjeshtri do të mbajë më shumë se një referim dhe sugjeron një referat solemn për personalitetin dhe arritjet e Joklit (21.12.1971). Letërkëmbimi intensiv që vijon gjatë gjithë vitit 1972 na njeh me një bashkëpunim të ngushtë e të frytshëm për përgatitjet e tubimit. Edhe pse nuk i kemi letrat e Çabejt, mësojmë se ai i është përgjigjur rregullisht kërkesave dhe pyetjeve të mikut austriak (psh. 13.3.1972). Nga ana e tij ky shfaq merakun për mbulim sa më të mirë të tematikave sidomos të pjesës indoeuropiane, pasi mungojnë temat nga morfologjia, si lakimi, përemrat, lindja e nyjeve të përparme e të prapme etj. prandaj i lutet Çabejt të ndërhyjë herë pas here me diskutime që të plotësojë këto zbrazëti, meqë ai këto i ka të gjitha në kokë, si edhe për çdo gjë tjetër që e sheh të nevojshme. Disa çështje të tjera do t'i mbulojë ai vete, si numërorët apo fonetikën. (12.5.1972). Për Çabejn ka edhe lutjen tjetër që të mbajë një referim për arritjet etimologjike në fushë të shqipes, ashtu siç do të bëjnë edhe studiues të tjerë për albanologjinë në vendet e tyre (21.8.1972).

Në një moment të caktuar del diçka e papritur që ngjall shqetësim te organizatori: njoftimi për mbajtjen e kuvendit të parë të studimeve ilire në Tiranë në muajin shtator, pak para datave të përcaktuara për tubimin e Insbrukut, aq sa ai mendon se duhet ta shtyjnë tubimin një javë më pas dhe kërkon përgjigje të shpejtë që të mund të riorganizohen. Nuk bëhet fjalë më tej për këtë gjë, por është e ditur se të dy tubimet u mbajtën në datat e parashikuara, kuvendi i Tiranës në 15-20 shtator, ai i Insbrukut më 28 shtator - 3 tetor. Çabej mori pjesë me referime në të dy aktivitetet, madje edhe në kongresin e onomastikës në Sofje në qershor-korrik të atij viti tepër të pasur me aktivitete shkencore albanologjike, nëse kemi parasysh edhe kongresin e drejtshkrimit në nëntor.

Organizatori e njofton mikun nga Tirana hap pas hapi për të rejtat lidhur me aktivitetin, për studiuesit e vendeve të ndryshme që kanë



dhënë pëlqimin për pjesëmarrje ose dërgim kontributesh, të gjithë emra të shquar albanologësh e indoeuropianistësh, si Desnickaja, Hamp, Gabinsky, Bevington, Klingenschmitt, Fiedler, Buchholz etj., rreth 40 pjesëmarrës. Mbetet preokupim i vazhdueshëm që shprehet gjithnjë e më me ankth sa më shumë përparon koha, konfirmimi i pjesëmarrjes dhe temat e referimit të gjuhëtarëve nga Shqipëria, të cilët duhet të mbulojnë më të shumtën e tematikave të pjesës albanologjike e ballkanologjike. Brenda muajit maj paraqiten edhe emrat e 6 studiuesve nga Prishtina, Ajeti, Kaleshi, Hadri, Mulaku, Pllana, Mirdita, por ende asgjë nga Tirana, pa të cilët nuk mund të dërgohet lajmërimi i dytë qarkor i tubimit. Ai i shkruan për këtë edhe drejtorit Kostallari, duke i shprehur gatishmërinë për të pranuar tema e për t'i botuar ato në akte edhe nga studiues që nuk mund të marrin pjesë, por nuk ka si ta dijë dhe askush nuk mund t'ia thotë se miratimi për pjesëmarrje duhet të vijë nga Komiteti Qendror duke kaluar ndoshta edhe nëpër filtra të tjerë të strukturave shtetërore. Më në fund (21.8.1972) ai njofton se i ka ardhur një telegram nga drejtori i Institutit për pjesëmarrje të një delegacioni shqiptar dhe pret me kureshtje letrën e detajuar.

Letra pasuese është ajo e 3 dhjetorit 1972 ku mikpritësi falenderon mikun e veçantë dhe gjithë anëtarët e delegacionit nga Shqipëria që me praninë e tyre ndikuan në mbarëvajtjen e tubimit në Insbruk dhe shpreh gëzimin e madh që mundi t'i përshëndesë e t'i takojë.

Dhe me të vërtetë kolokuiumi i Insbrukut ishte një sukses dhe një ngjarje e shënuar në historinë e albanologjisë. Siç del nga Aktet e kolokuiumit të botuara në vitin 1977 në Insbruk nën kujdesin e Ölbergut, nga Shqipëria morën pjesë fizikisht E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, J. Gjinari e J. Kole, ndërsa A. Kostallari, B. Beci, E. Lafe, Xh. Lloshi, J. Thomai dërguan kumtesat që u përfshinë në botimin e Akteve.

Çabej mbajti referatin kryesor për Veprën albanologjike të Norbert Joklit, një hulumtim gjithëpërfshirës për jetën dhe veprimtarinë shkencore të këtij albanologu të ndritur, një studim prej rreth 30 faqesh që edhe sot nuk është përkthyer në shqip. Në seksionin për çështjet specifike të gramatikës së shqipes ai mbajti kumtesën Studime të reja etimologjike në fushë të shqipes. Kumtesat dhe

artikujt e studiuesve të tjerë nga Shqipëria e Kosova kontribuan në mbulimin e shumanshëm të problemeve të përgjithshme të studimeve gjuhësore në Shqipëri e Kosovë (M. Domi, Sh. Pllana) ashtu edhe të atyre specifike albanologjike, si çështje të fonologjisë (B. Beci, R. Ismajli), gramatikore e leksikogramatikore (Sh. Demiraj, S. Floqi, E. Lafe, J. Kole), dialektologjike (J. Gjinari, L. Mulaku), të proceseve fjalëformuese të shqipes (J. Thomai), të formimit të gjuhës letrare (Kostallari), të dorëshkrimeve të përkthimeve biblike (Xh. Lloshi), si dhe probleme të tjera të rëndësishme të vendbanimeve të lashta ballkanike të shqiptarëve (Z. Mirdita, I. Ajeti), të shtrirjes hapësinore të shqiptarëve në shekujt e kaluar e periodizimit të historisë së tyre (H. Kaleshi, A. Hadri) etj.. Në hapësirën e diskutimeve u aktivizuan gjallërisht Çabej, M. Domi dhe Sh. Demiraj.

Kështu, kjo korrespondencë e bukur mes dy njerëzve të ndritur, e mbushur me ide e diskutime shkencore dhe po aq me ndjenja njerëzore, me respekt, dashuri e vlerësim të ndërsjellë, që zgjati deri në vitin kur Çabej u nda nga jeta, sollti frytet e saj të prekshme në një konferencë që do të mbahej mend gjatë dhe në një vëllim me studime albanologjike i cili shënoi një gur kilometrik në historinë e albanologjisë së shekullit XX.

Hermann Ölberg  
Innsbruck

Innsbruck, am 10.1.1964

Herrn  
Univ.-Prof.Dr. Egreş Çabej  
Rruga B. Curri 260  
shk.7, ap.15  
T i r a n a

Sehr verehrter Herr Professor!

Anlässlich des Jahreswechsels möchte ich Ihnen, sehr verehrter Herr Professor, meine aufrichtigen Glückwünsche für dieses nun vor uns liegende Jahr entbieten und hoffen, dass es Ihnen viel Schönes und Erfreuliches bringen möge! Schon lange möchte ich Ihnen schreiben und Ihnen danken für die schöne Begegnung in Amsterdam während des Kongresses. Hoffentlich hatten Sie eine gute Weiterreise und Heimfahrt. Gerade während der Tage Ihres Aufenthaltes in Wien war Doz. Solta in Innsbruck, was ihn, als ich von Ihnen ihm erzählte, furchtbar ärgerte. Verständlich, hatte er Sie doch noch nicht gekannt! Hatten Sie schönen Aufenthalt und Erfolg in Ihrer Nachforschung nach Jokls Nachlass? Er läge in der Nationalbibliothek, wie Solta mir sagte. Es würde mich dies alles sehr interessieren.

Ich denke oft auch daran, ob Sie schöne Bilder gemacht haben? Bekommen Sie Patronen nachgeliefert? Es wäre mir eine grosse Freude, wenn ich Ihnen ansonsten helfen könnte.

Ich habe mich nun ein bisschen in den wissenschaftlichen Zeitschriften besonders nach Ihren Arbeiten umgesehen und mit Freude gesehen, dass ja bereits allerhand vorliegt. Freilich, neuere Arbeiten, die in östlichen Zeitschriften (Rumänien etc.) erschienen sind, stehen mir leider hier nicht zur Verfügung und ich wäre Ihnen um einige Sonderdrucke sehr verbunden. Auch um den Beitrag de quelques problèmes fond. de l'histoire ancienne de l'Albanais, den ich von Prof. Knobloch zur Einsicht kurz erhielt. Ich weiss, dass Sie die Autochthonität der Albaner vertreten und gerade darum war mir dies Arbeit so sehr wertvoll, aber all das, was Popović in der Zeitschrift für slav. Philologie 26,1957,301 ff. dagegen vorgebracht hat, scheint mir doch auch sehr beachtlich. Sie werden ja sicherlich auf diese Argumente andernorts eingegangen sein. Über das mir von Ihnen mitgeteilte Wort trual finde ich in IF 36. 137 den Hinweis auf terriola, bzw. besser - nach Joki - terra + -ola, also eine lateinische Bildung? Bitte geben Sie mir doch darüber einige Details, schon wegen meiner Arbeit.

Mit Ihrer Universitätsbibliothek habe ich Fühlung aufgenommen und auch eine sehr freundliche positive Antwort erhalten. Mein erstes Paket hinunter scheint aber verloren gegangen zu sein, das von der Bibliothek angekündigte Paket ist hier noch nicht eingetroffen, aber nach solchen Anfangsschwierigkeiten wird sich hoffentlich eine gute Zusammenarbeit ergeben. Ich sandte mein erstes Paket nicht rekommandiert, vielleicht ein Fehler. Heute geht ein weiterer Brief ab. Haben Sie meinen bescheidenen Sonderdruck erhalten?

Bitte würden Sie auch Ihrem Kollegen, der in Amsterdam mit war, recht herzliche Grüsse von mir bestellen.

Für heute verbleibe ich

Ihr sehr ergebener

*Hermann Ölberg*

Mario de Matteis

## **ALBANISCHE KULTUR UND SPRACHE IM EUROPÄISCHEN KONTEXT NACH EQREM ÇABEJ**

Nachdem der junge Eqrem Çabej für Recherchen zu seiner Abschlussarbeit nach Piana degli Albanesi (*Hora e Arbëreshëve*) in der Provinz Palermo gegangen war, kam er mit der faszinierenden Welt der Arberëshë-Gemeinschaft in Kontakt, sammelte direkte Zeugnisse über deren Sprache und Kultur und promovierte 1932 an der Universität Wien.

Mit dem Band *Tra gli Albanesi d'Italia. Studi e ricerche sugli Arbëreshë* herausgegeben von Matteo Mandalà<sup>1</sup>, bietet Çabej eine nahezu vollständige Sammlung der zahlreichen Beiträge, die er im Laufe der Jahre zur Geschichte, Sprache, Literatur und Kultur der Arbëreshë verfasst hat, die seit jeher ein Eckpfeiler seiner Forschung geblieben ist.

Der Aufsatz *Shqiptarët midis Perëndimit dhe lindjes* über die Kultur und Entstehung der albanischen Literatur von Eqrem Çabej<sup>2</sup> gilt noch heute als grundlegender Text für diejenigen, die die albanische Geschichte und Mentalität verstehen und erklären wollen nach dem Grundsatz, dass, „das literarische Produkt eines Volkes nicht verstanden werden kann, ohne die Geschichte dieses Volkes zu kennen“. In kurzen, aber dichten Kapiteln befasst sich Çabej hier mit den verschiedenen Elementen, die die Bildung des Charakters eines Volkes und seiner Kultur beeinflussen, beschreibt die geografischen Merkmale des Landes, erörtert den Ursprung des Namens des Volkes und die Zentrifugalkräfte im Charakter der

Albaner und die ausländischen Einflüsse, also alles, was Albanien zu einem Knotenpunkt zwischen West und Ost macht. Çabej analysiert dabei die Fis (Stämme) des Nordens und Südens, die traditionalistischen Berggebiete und die nationale Einheit, um zu interessanten und wertvollen Schlussfolgerungen auch in Bezug auf Folklore und Literatur zu gelangen.

Eqrem Çabej ist einer der maßgeblichsten Gelehrten des albanischen Kontexts und der erste, der das Zentrum der Albanistik vom Ausland nach Albanien verlegt hat.

Ausgehend von Studien zur albanischen Literatur und Kultur im Allgemeinen konzentrierte er sich auf die Geschichte der Sprache, den Ursprung und die Autochthonie des albanischen Volkes und stützte sich dabei fast ausschließlich auf sprachliche Fakten und vor allem auf die Etymologie.

Çabej fand das Gebiet der albanischen Etymologie nicht unberührt. Ab der Mitte des XIX. Jahrhunderts bis zu seiner Zeit waren auch andere Forscher, wenn auch sie die Etymologie nicht als den einzigen Gegenstand ihrer Arbeit hatten, vor allem aus Deutsch sprechenden (Franz von Miklosich, Gustav Mejer, Holger Pedersen, Norbert Jokl, Johann Georg von Hahn u.a.) aber auch aus Albanisch sprechenden (Marco La Piana, Petro Furiqi, Kostandin Kristoforidhi, Alexander Xhuvani u. a.) Regionen Europas.

Im Gegensatz zu diesen Forschern macht Çabej die Etymologie des Albanischen zum Hauptgegenstand seiner Arbeit und bringt somit die Forschung über die Etymologie des Albanischen sowie seine (Sprach-) Geschichte in sein Heimatland.

Die Ergebnisse seiner Forschungsarbeit veröffentlichte er von 1960 bis 1980 in den Sprachzeitschriften des Tiraner Instituts für albanische Sprache. Seine wissenschaftlichen Forschungen auf diesem Gebiet wurden von der Tiraner Akademie der Wissenschaften in dem 7-bändigen Werk *Etymologische Studien auf dem Gebiet des Albanischen* herausgegeben.

Zu der Bewertung der von ausländischen Forschern geleisteten Arbeit auf dem Gebiet der Etymologien wies Çabej auf folgende Mängel hin:

- 1) Begrenzte Kenntnisse des Lexikons des Albanischen und der albanischen Welt;

- 2) Wertschätzung der gebenden Rolle von Fremdsprachen, insbesondere des Lateins und der empfangenden Rolle des Albanischen;
- 3) Mängel der verwendeten Methoden und der von ihnen befolgten Prinzipien.

In der von ausländischen Wissenschaftlern geführten etymologischen Forschung haben wir im Allgemeinen nur den Vergleich albanischer Wörter mit Fremdwörter, da

- a) der Vergleich von Wörtern innerhalb des Albanischen fehlt und
- b) die Daten zu den entsprechenden Dialekten und/oder der dazu gehörigen Onomastik fehlen, weil die Dialektologie eine sprachwissenschaftliche Disziplin ist, die in Albanien erst seit den 50er Jahren des letzten Jahrhunderts erforscht wurde und dadurch die Daten der albanischen Onomastik nicht erfasst werden konnten.

Die etymologische Forschung von Çabej<sup>3</sup>stützt sich auf streng wissenschaftliche Prinzipien und auf eine von Hugo Schuchard skizzierte und von ihm verfeinerten Methode der Wörter und Objekte, die das Leben des Wortes mit dem von ihm benannten Objekt verbindet und dabei seiner Ausdehnung in Raum und Zeit folgt.

Darüber hinaus basieren die von Çabej erzielten Ergebnissen auf einem viel reichhaltigeren lexikalischen Material, das sich: a) auf den Daten der Dialektstudien und der albanischen Onomastik; b) auf den historischen und c) auf den geografischen Daten der materiellen und spirituellen Kultur des albanischen Volkes stützt.

Dadurch gelang es ihm, die Etymologie vieler zuvor ungeklärter oder falsch erklärter Wörter, sowie vieler Wörter, die als Lehnwörter erklärt wurden, ins Albanische zurückzubringen und so den autochthonen Fundus zu vergrößern.

Dazu reicht es aus, das etymologische Wörterbuch von Gustav Majer mit den Teilschlußfolgerungen von Çabej zu vergleichen.

Majer findet von den in seinem Wörterbuch 5140 eingetragenen Wörtern:

- 3980 Entlehnungen,
- 400-410 indoeuropäischen Ursprungs und

---

<sup>3</sup> Çabej, *Studime etimologjike ne fushë të Shqipërisë*, I, 29-132.

- 730 nicht entzifferbar(e Wörter).

Majer gibt also nur 8% des Wortschatzes als autochthon an.

Çabej hat bei dem Versuch, eine Statistik über das Verhältnis von albanischen Wörtern zu Fremdwörtern zu erstellen, bewiesen, dass das lokale Lexikon in dem Teil vorherrscht, in dem er sich auf die Natur und eine pastorale und landwirtschaftliche Wirtschaft und Kultur bezieht, während das entlehnte Lexikon in den Bereichen a) materielle Kultur, b) moralische Kultur und c) abstraktes Vokabular beobachtet wird.

Aus der Untersuchung von 1424 Wörtern aus diesen drei Feldern kommt Çabej zu dem Schluß, dass 667 autochthonen Wörtern nur 757 Entlehnungen gegenüberstehen.

Somit sind etwa 48% der Wurzelwörter in diesen Bereichen autochthon.

Diese Statistik, die Çabej selbst als unvollständig und nicht schlüssig bezeichnet, zeigt in jedem Fall das das Gewicht des autochthonen Elements im allgemeinen Wortschatz des Albanischen relevant ist.

### **Schlußbemerkung**

Was die Schriften von Clemente Merlo und Carlo Tagliavini für die Geschichte und die Kultur der italienischen Sprache im indoeuropäischen Kontext sind, sind es meiner Meinung nach auch die Schriften von Eqrem Çabej für die Sprache und die Kultur der Albaner: Sie sind heute mehr denn je ein Bezugspunkt für jeden Wissenschaftler, der sich für die Einordnung der albanischen Sprache und Kultur im balkanischen und indogermanischen Kontext interessiert.

### **Literatur**

Çabej, Eqrem (1982), Studime etimologjike ne fushe te shqipe, I. Akademia e shkencave e RPS të Shqipërisë - Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë . Tiranë.

Çabej, Eqrem (2020), Gli Albanesi tra Occidente e Oriente. Sulla nascita della letteratura albanese. Besa Muci Edizioni, Nardò (Le).

Çabej, Eqrem (2021), Tra gli Albanesi d'Italia. Studi e ricerche sugli Arb resh a cura di Matteo Mandalà, Besa Muci Edizioni, Nardò (Le).

Dhori Q. Qirjazi

**LETRA TË GJUHËTARËVE GREKË D.  
GEORGACAS DHE T. JOCHALAS  
PËR PROFESORIN E. ÇABEJ**

*“Sie sind die grösste Autorität in der Albanologie.”*

Në arkivin e të paharruarit Eqrem Çabej ruhen një numër letrash të gjuhëtarit grek Demetrius Georgacas (1908–1990), mes të cilave përvijohet qartë respekti dhe admirimi i tij për bashkëmohatarin dhe bashkudhëtarin në të përpjetat e shkencës, kolegun e nderuar shqiptar dhe ballkanas.

Georgacas–i studioi filologji dhe gjuhësi në Universitetet e Athinës dhe të Berlinit dhe më pas u përfshi në grupin hartues të Fjalorit Historik të Greqishtes, të Akademisë së Athinës. Në vitin 1947 nis karriera e tij shkencore në SHBA, fillimisht në Universitetin e Çikagos dhe më pas në University of North Dakota, ku themelon dhe drejton për rreth 20 vjet Modern Greek-English Dictionary Center.

Veprimtaria e gjerë shkencore e tij (histori e gjuhës greke, dialektet e greqishtes, etimologji, onomastikë, leksikografi, etj.) nuk mund të kuptohet pa përmasën ballkanike të saj dhe prandaj i drejtohet një mentori të çmuar, dinjitozit, seriozit dhe skrupulozit Çabej. Për fat të keq, nuk kemi arritur të gjejmë ende (nëse janë ruajtur diku) letrat e Çabejt për Georgacas–in, por edhe me aq sa disponojmë arrijmë të përfytyrojmë dhe të admirojmë sot mënyrën si komunikonin ato mendje të ndritura e kujtimpashuara.

Letra e parë e Georgacas–it për Çabej–in mban datën 28.6.1943



dhe shkruhet në Berlin. Nuk njihen (*Ihren bin ich unbekannt*), ose më saktë i pari e njeh të dytin nga shkrimet e tij (*ich kenne Sie aber durch Ihre Schriften, wie z.B. durch Ihren Aufsatz "Volkstum und Volksname der Albaner"*), dhe dëshira për t'u njohur lind nga interesimi i studiuesit grek për shqipen: *Leider habe ich nicht richtig die Gelegenheit gehabt, die so wichtige (für das Indogermanische und für das Griechische) albanische Sprache zu lernen.*

Për fat të keq ndërmjetëson një periudhë heshtjeje (sipas të dhënave të Arkivit) prej plot 20 vjetësh, por nga përmbajtja e letrës së 12.9.1963 duket se pas gjasash kanë qenë edhe më parë në kontakt. (*Einen schönen Gruss möchte ich Ihnen aus meiner Universitätsstadt, in die ich zurückgekommen bin, zuschicken.*) Shpreh gëzimin që *"Sie und Herrn A. Kostallari im Internationalen Kongress zu Amsterdam kennengelernt zu haben."* dhe i përcjell të falat e mikut të përbashkët dr. D. Moutsos, me shënimin *"aber ich habe seinen Lehrer, Herrn Dr. Hamp, noch nicht gesehen."*

Nga kjo letër mësojmë gjithashtu se letërkëmbimi i tyre mund të quhet edhe libër-këmbim, në kuptimin që thujse në çdo kontakt të dy studiuesve gjejmë rregullisht tituj librash apo artikuj që ata i kërkojnë apo i dërgojnë njëri-tjetrit. Në rastin tonë, duket se Çabej ka treguar interes për librin *A Gazetteer of Albania*, London, 1946, të cilin Georgacas-i i premtun ta gjejë dhe i bën të ditur njëkohësisht se

*Ich habe Ihnen heute zugesandt:*

1. *die photographische Reproduktion des Artikels von Mann "The Indo-European Vowels in Albanian", Language 26 (1950), 379–388, und*

2. *meine Studie Περί της καταγωγής των Σαρακατσαναίων και του ονόματος αυτών (Athen, 1949).*

Kemi lënë pa thënë se letra mban siglën University of North Dakota, Greek English Dictionary Project, Prof. D.J. Georgacas, Director, dhe i drejtohet Herr Prof. Dr. Eqrem Çabej, rr. B. Curri 260, shk. 7, ap. 15, Tirana, Albanien.

Prej këtu, si edhe prej krejt letërkëmbimit të tyre, zgjidhet "enigma" si ka mundur Çabej, në kushtet e izolimit të skajshëm të Shqipërisë, të siguronte atë plotëri bibliografike që edhe sot ia kemi zili. Falë kontakteve me miq e kolegë, ai ka arritur të ndjekë hap pas

hapi arritjet dhe botimet e fushës së vet, gjë të cilën e hasim në çdo rresht të opusit çabejian.

Në letrën e 17.3.1964, pas fjalëve *“Ihr Brief vom 7. März hat mich sehr erfreut.”*, shkruesi shpreh gëzimin *“Es ist ausgezeichnet, dass wir alle Ihre albanische Etymologien in einem Buch haben werden”* dhe vijon me njoftimin se tashmë ka qarkulluar numri i parë i revistës *Zeitschrift für Balkanologie*, ku botohet edhe një shkrim i studiuesit V. Polák me titull *“Balkanische Zusammenhänge und etymologische Forschungen des Albanischen”*. Pason kërkesa *“Nun möchte ich Sie, lieber Herr kollege, bitten, den albanischen Teil eines Beitrages von mir durchzulesen und zu kritisieren”*, me sqarimin e vetëkuptueshëm deontologjik *“Selbsverständlich werde ich Ihre Hilfe erwähnen.”*, sepse *“Ich glaube an den grossen Wert der Spezialisten und an den Wert der Arbeiten, die etwas Gründliches zum Licht bringen, aber ich selbst weiss zu wenig übers Albanische und benötige die Hilfe des albanischen Spezialisten.”*

Në këtë letër, Georgacas-i shpreh për herë të parë kërkesën për bashkëpunim në një vepër, ku ndihmesa e Çabejt do të jetë esenciale dhe që do të kthehet në objekt informacioni të ndërsjellë në letrat që pasojnë:

*Noch eine Bitte: Professor W.A. McDonald und ich werden eine Kollektion der Ortsnamen der südwestlichen Peloponnes [i.e. Messeniens] publizieren. Nun haben wir ein Kapitel: “Albanische Ortsnamen der Provinz Triphylia”. Wären Sie so freundlich, das Manuscript durchsehen und uns Ihre wertvollen Bemerkungen geben zu wollen? Wenn ja, werde ich Ihnen eine Kopie desjenigen Teiles zusenden.*

Georgacas-i shënon në përfundim të letrës *“Vielen Dank für Ihre freundliche Absicht, mir die Fortsetzung des Buletins und auch noch “Studia Albanica” zusenden zu wollen.”*

Kalojnë disa muaj dhe në letrën e 17.9.1964 kolegu grek i drejtohet Çabejt me fjalët e mëposhtme:

*Als ich noch in Chicago war, erhielt ich Ihren langen und inhaltreichen Brief vom 20. August mit Ihren wertvollen Bemerkungen zu den albanischen Ortsnamenstichworten, die Sie so freundlicher Weise zu kritisieren einwilligten. Die meisten Ihrer Vorschläge sind als einleuchtend ohne weiteres übernommen; dies*

*konnte ja nicht anders sein, denn Sie sind ein grosser Albanologe und m.E. der grösste. Ich erlaubte mir, Ihren Namen nach solchen Deutungen in Parenthesen, wenn auch nicht immer, angeben.*

Pas këtij vlerësimi superior (në atë periudhë a pak më pas Çabejt i vinin Fletërrufe në Shqipëri!!!), vjen një detaj që e bën mjaft njerëzor dhe madje prekës komunikimin e dy kolegëve:

*Meine Tochter Anna [8½ Jahre alt] fragte mich vor drei Tagen, ob ich Ihnen geschrieben habe; ich wusste nicht wie sie sich daran interessiert hatte. Dann merkte ich, dass sie die albanischen Briefmarken hoch schätzte, und sie möchte darum unsere Korrespondenz weiter gehen sehen!*

Mes letrave të Georgacas—it për Çabejin gjendet edhe njëra sosh, tekst i shkurtër falenderimi, e gjuhëtarit amerikan W.M. McDonald, e datës 6.10.1964, ku thuhet ndër të tjera se “*My colleague Demetrius Georgacas and I are very indebted to you for your generous assistance in preparing for publication the Albanian toponyms from Southwest Greece.*” Letra mbyllet me fjalët “*With kindest regards and warm thanks and fraternal greetings, I am very sincerely yours.*”

Sot është mbase e vështirë të kuptohet çfarë belarash mund t'i çelëshin Çabejt nga këto “fraternal greetings” ardhur prej Amerike, gjë të cilën nuk mund ta merrte me mend as vetë McDonald—i, kur ia dërgonte para plot 60 vjetësh!

Në letrën e 7.2.1966, pasi ka marrë prej Çabejt letrën e datës 29.11.1965, Georgacas—i i shkruan se “*Ihre Angaben und Ratschläge sind immer sehr willkommen, den Sie sind die grösste Autorität in der Albanologie. Ihre Bemerkung dass altgegisch shqype ‘Adler’ nicht gleich shqip ‘albanisch’ ist wichtig und ich dürfte dieselbe erwähnen.*”

Nuk mund të japim me hollësi përmbajtjen e të gjitha letrave, por prej tyre kuptohet vlerësimi i ndërsjellë dhe dëshira e sinqertë për të ndihmuar njëri-tjetrin për ndriçimin e të fshehtave apo pikave të errëta të kërkimit shkencor. Desiderata për dërgim librash e artikujsh, falënderime prej *homines academici* e burrash zamani, shkëmbim mendimesh dhe reflektim i tyre në prodhimin shkencor, përmendje dhe respekt ndaj kontributeve të kolegut.

Kjo duket qartë në fjalët që Demetrius J. Georgacas, University

of North Dakota, dhe William A. McDonald, University of Minnesota, autorë të librit *Place Names of Southwest Peloponnesus, Register and Indexes*, distributed by the University of Minnesota Press – Minneapolis (1967) i rezervojnë në hyrje të punimit kolegut dhe mikut shqiptar:

*Professor Eqrem Çabej, University of Tirana, Albania, was kind enough to review the final version of the Albanian material before it went to press and to offer his valuable help; his contribution is mentioned in many cases by name [in parentheses] [f. 19]*

Ο καθηγητής κ. Eqrem Çabej του Πανεπιστημίου των Τιράνων της Αλβανίας είχε την καλωσύνη να θεωρήσει την τελική διατύπωση του αλβανικού υλικού, πριν το στείλουμε στο τυπογραφείο, και να δώσει την αξιόλογη βοήθειά του· η συμβολή του μνημονεύεται σε πολλές περιπτώσεις στο κείμενο [σε παρένθεση]. (f. 38)

Profesori z. Eqrem Çabej i Universitetit të Tiranës, Shqipëri, pati mirësinë të rishikonte versionin përfundimtar të lëndës shqip, para se ta dërgonim në shtypshkronjë dhe të na ofronte ndihmën e çmuar të tij; ndihmesa e tij përmendet në shumë raste brenda tekstit [në kllapa]. (f. 38)


Një etikë shkencore për t'u marrë shembull nga më të rinjtë dhe e cila mungon jo rrallë në ditët tona!

Po a u panë ndonjëherë nga afër dy shkencëtarët bashkëmoshatarë e ballkano-fqinjëtarë? Letra e datës 21.10.1969 na lë shteg të themi një PO të plotë, pa qenë nevoja të përdorim atë shprehjen “magjike” pas shumë gjasash të Çabejt:

*Lieber Kollege Dr. Çabej,*

*Es war eine feine Gelegenheit, Sie in Wien am 10. onomastischen Kongress wieder zu sehen, wie auch Herrn Kostallari.*

*Vor einigen Tagen habe ich hier Ihre kritische Ausgabe:*



*“Meshari” i Gjon Buzukut [1555], 2 Bände, erhalten. Ich bin Ihnen dankbar für die wundervolle Gabe und möchte Sie zu diesem magnum opus herzlich gratulieren. Sie haben viel Zeit und Mühe darauf aufgewendet, aber das Endresultat ist vortrefflich und bewunderungswürdig.*

*Ich bitte Sie, meinen Namen und Adresse an Ihre Universität geben zu wollen, damit ich linguistischen Publikationen erhalte. Dann möchte ich für dieselben Geld zusenden oder amerikanische Bücher mit Ihren Büchern austauschen.*

Letra e fundit, gjithnjë sipas Arkivit, që i dërgon Georgacas–i Çabejt mban datën 9.4.1970.

Më poshtë po japim fotot e disave prej letrave të përmendura ose jo në këtë shkrim, duke shprehur edhe një herë dëshirën për të përfshirë në të, kur të gjenden, edhe letrat e vetë Çabejt për Georgacas–in.

Ia vlen të vërehet më në fund edhe mënyra si i drejtohet Georgacas–i Çabejt me kalimin e kohës:

1943: *Sehr geehrter Herr Dr. Çabej!*

1963: *Sehr geehrter Herr Professor Çabej!*

Mars 1964: *Sehr geehrter Herr Kollege und lieber Freund!*

Shtator 1964: *Lieber Freund und Kollege!*

Prill 1970: *Lieber Freund Eqrem!*

Dr. phil. Dem. J. Georgakas  
Berlin-Charlottenburg, Niebuhrstr. 66  
b. Wichmann, Tel. 32 25 93

Berlin, den 28. Juni 1943

Sehr geehrter Herr Dr. Gaber

Ihren bin ich unbekannt, ich kenne Sie  
aber durch Ihre Schriften, wie z. B. durch Ihren  
Aufsatz „Volkstum und Volksname der Albaner“  
in der Leipziger Vierteljahrschrift für Südostropa-  
pa. Ihnen bekannt ist mein Landsmann Fr. M.  
Andriotic, Mitarbeiter von mir an der Akademie,  
und Fr. Locker (z. Z. in Berlin) hat mir von Ihnen  
erzählt. Leider habe ich nicht richtig die Ge-  
legenheit gehabt, die so wichtige (für das Indoger-  
manische und für das Griechische) albanische  
Sprache zu lernen; da ich nun einen Artikel  
in Übersetzung zu benutzen brauche, wage ich,  
an Sie die Bitte zu richten, mir jemand (in  
Berlin oder anderswo) angeben zu wollen, der  
diese Übersetzung, selbstverständlich gegen Ho-  
norar, machen will. Ist eine Übersetzung wegen  
des Umfangs (12 Seiten) unmöglich, hätte ich  
gerne eine Zusammenfassung des Inhalts, be-  
sonders des Abschnittes, welcher Formen und  
Ableitung des Namens Arbnuer behandelt.  
Könnte jemand in Rom ausfindig gemacht  
werden, der mir die Übersetzung herstellen

1. 947/5308

THE UNIVERSITY OF NORTH DAKOTA

GRAND FORKS

UNIVERSITY OF NORTH DAKOTA  
 GREEK-ENGLISH DICTIONARY PROJECT  
 PROF. D. J. GEORGADAS, DIRECTOR  
 UNIVERSITY STATION  
 GRAND FORKS, N. DAK.

Herrn Prof. Dr. Egrem Çabej  
 nr. B. Curri 260  
 shk. 7, ap. 15  
 TIRANA, Albanien

am 12. September 1963

Sehr geehrter Herr Professor Çabej,

Einen schönen Gruss möchte ich Ihnen aus meiner Universitätsstadt, in die ich zurück gekommen bin, zuschicken. Es hat mich sehr gefreut, Sie und Herrn A. Kostallari im internationalen Kongress zu Amsterdam kennengelernt zu haben. Ich habe Ihnen Gruss an unseren Kollegen, Herrn Dr. D. Moutsos, übersandt, aber ich habe seinen Lehrer, Herrn Dr. Hamp, noch nicht gesehen.

Leider ist der Gazetteer von Albanien, von der amerikanischen Regierung publiziert, vergriffen und ich erinnere mich jetzt dass ich denselben in der Bibliothek der University of Chicago angesehen hatte; wenn der den Gazetteer benötigen, würde ich einen Film des ganzen Buches machen lassen, aber es wird kostbar sein. Doch habe ich den Gazetteer von Albanien, von der britischen Regierung publiziert, für Sie aus England schon bestellt und, bald wie das Buch auch erreicht, werde ich es Ihnen zuschicken. Der Titel ist wie folgt:

A Gazetteer of Albania, London, S.W.7, 1946  
 (Permanent Committee on Geographical Names for British Official Use,  
 Prepared by the P.C.G.N. at the House of the Royal Geographic  
 Society, Kensington Gore, London, S.W.7)

- Ich habe Ihnen heute zugesandt:
- 1) die photographische Reproduktion des Artikels von Mann "The Indo-European Vowels in Albanian", Language 26(1950), 379-388, und
  - 2) meine Studie Τίπλι τῆς κατὰ γῆς τῶν Σπαρταρσάβαϊων καὶ τοῦ ὀνόματος αὐτῶν (Athen, 1949).
- Späterhin werde ich Ihnen gerne auch Sonderdrucke von Arbeiten

# THE UNIVERSITY OF NORTH DAKOTA

GRAND FORKS

UNIVERSITY OF NORTH DAKOTA  
GREEK-ENGLISH DICTIONARY PROJECT  
PROF. D. A. McDONALD, DIRECTOR  
UNIVERSITY STATION  
GRAND FORKS, N. DAK. 58202

am 17. März 1964

Professor Eqrem Çabej  
rr. B. Curri 260  
shk. 7, ap. 15  
Tirana, Albania

Sehr geehrter Herr Kollege und lieber Freund!

Ihr Brief vom 7. März hat mich sehr gefreut. Es ist ausgezeichnet, dass wir alle Ihre albanische Etymologien in einem Buch haben werden; ich hoffe, dass das ganze als ein separates Buch erscheinen wird. Sie wissen vielleicht, dass der erste Band der Zeitschrift für Balkanologie ist (für 1962) erschienen (in 1963). Darin (Seiten 75-90) hat Václav Polák (Praha) den Beitrag "Balkanische Zusammenhänge und etymologische Forschungen des Albanischen" (Aus dem Vorwort zu dem Etymologischen Wörterbuch des Albanischen) veröffentlicht; Sie wissen es wahrscheinlich. Ja, ich hatte vor zwei Monaten die Sprache bekommen und Jokl's alten Artikel darin eingesehen; ich habe denselben betreffs des Suffixes -zë gebraucht.

Mun möchte ich Sie, lieber Herr Kollege, bitten, den albanischen Teil eines Beitrages von mir durchlesen und kritisieren zu wollen, welcher (Beitrag) in der oben erwähnten Zeitschrift für Balkanologie zur Veröffentlichung eingeladen worden und im 2. Band zu erscheinen ist. Der Beitrag ist schon in den Händen der Herausgeber, doch möchte ich die notwendigen Änderungen im Manuskript anbringen. Sie brauchen mir die Kopie des Manuskripts nicht zurückzusenden, sondern nur Ihre Bemerkungen, die ich gebrauchen werde. Selbstverständlich werde ich ~~Ihre Hilfe erwähnen. Ich glaube an den grossen Wert~~ der Spezialisten und an den Wert der Arbeiten, die etwas Gründliches zum Licht bringen, aber ich selbst weiss zu wenig über Albanische und benötige die Hilfe des albanischen Spezialisten. (Ich habe Ihren Namen in demselben Beitrag gelegentlich schon erwähnt.)

Noch eine Bitte: Professor W. A. McDonald und ich werden ~~unser~~ eine Kollektion der Ortsnamen der südwestlichen Peloponnes (i.e. Messeniens) publizieren. Nun haben wir ein Kapitel: "Albanische Ortsnamen der Provinz Triphylia". Wären Sie so freundlich, das Manuskript durchsehen und uns Ihre wertvollen Bemerkungen geben zu wollen? Wenn ja, werde ich Ihnen eine Kopie desjenigen Teiles zusenden.

Herr Dr. Moutsos hat Ihren Brief erhalten und mir Ihre freundlichen Grüsse übermittelt. An Herrn Vayakakos schreibe ich gerne heute und übermittle ihm Ihren Dank.

Leider haben wir kein mehr Geld um die Sammlung des nötigen Materials fortzusetzen und abzuschliessen, bevor ich die Redaktion des ngri. Wör-

BUY NORTH DAKOTA PRODUCTS



THE UNIVERSITY OF NORTH DAKOTA

GRAND FORKS

UNIVERSITY OF NORTH DAKOTA  
GREEK-ENGLISH DICTIONARY PROJECT  
PROF. D. J. GEORGACAS, DIRECTOR  
UNIVERSITY STATION  
GRAND FORKS, N. DAK. 58202

September 17, 1964

Professor Eqrem Çabej  
rr. B. Curri 160  
shk. 7, ap. 15  
Tirana, Albania

Lieber Freund und Kollege!

Als ich noch in Chicago war, erhielt ich Ihren langen und inhaltreichen Brief vom 20. August mit Ihren wertvollen Bemerkungen zu den albanischen Ortsnamenstichworten, die Sie so freundlicherweise zu kritisieren einwilligten. Die meisten Ihrer Vorschläge sind als einleuchtend ohne weiteres übernommen; dies konnte ja nicht anders sein, denn Sie sind ein grosser Albanologe und m.E. der grösste. Ich erlaubte mir, Ihren Namen nach solchen Deutungen in Parenthesen, wenn auch nicht immer, anzugeben.

Wenn auch Herr Professor William A. McDonald der Universität von Minnesota nicht viel mit dem albanischen Teil unserer Ortsnamensammlung zu tun gehabt hat, schätzt er Ihre Zusammenarbeit darin *sehr hoch*.

Nun wird jetzt das Manuskript an den Drucker abgehen. Lasst uns hoffen, dass diese ON-Sammlung Kollegen von Nutzen sein wird.

Nun, Lieber Herr Kollege, werde ich glücklich sein, wenn auch ich etwas für Sie tun, z.B. Bücher aus den Vereinigten Staaten zusenden, dürfte. Es wird mich sehr freuen, solche Kleinigkeiten für Sie jetzt und in der Zukunft erledigen zu dürfen.

Meine Tochter Anna (8½ Jahre alt) fragte mich vor drei Tagen, ob ich Ihnen geschrieben habe; ich wusste nicht wie sie sich daran interessiert hatte. Dann merkte ich, dass sie die albanischen Briefmarken hoch schätzte, und sie möchte darum unsere Korrespondenz weiter gehen sehen!

Mit allerbesten Grüssen an Sie und Ihre Familie von uns allen

Ihr dankbarer Freund

*Demetrios*

October 6, 1964

Professor Eqrem Çabej  
rr. B Curri 260  
Shk. 7, ap 15  
Tirana, Albania

Dear Professor Çabej:

My colleague Demetrius Georgacas and I are very much indebted to you for your generous assistance in preparing for publication the Albanian toponyms from Southwest Greece. We hope that the monograph will be a useful and dependable source of information for interested scholars and a credit to its authors and their numerous collaborators.

With kindest regards and warm thanks and fraternal greetings,  
I am

Very sincerely yours,



William A. McDonald

WAM:pct

cc: Demetrius Georgacas

am 7. Februar 1966

Mein lieber Freund, Professor Çabej,

Ein glückliches Neujahr!

Es hat mich sehr gefreut, Ihr Schreiben vom 29. Nov. 1965 zu erhalten, und ich bin Ihnen für Ihre Verweise und Noten zu meinem polygraphierten Artikel über die albanischen Ortsnamen in Messenien sehr zu Dank verpflichtet. Ihre Angaben und Ratschläge sind immer sehr willkommen, denn Sie sind die grösste Autorität in der Albanologie. Ihre Bemerkung dass altgëgisch shqype 'Adler' nicht gleich shqip 'albanisch' ist ist wichtig und ich dürfte dieselbe erwähnen.

Ich hatte Ihre wertvolle Studie in Leipz. Viertelj. f. Südosteuropa 4, 1/2 (1940), schon benutzt, und ich habe jetzt (nach Ihrem Briefe) Ihren Artikel in Lingua Posnaniensis 8 (1960) angesehen. Falls Sie mir die Seiten aus dem Artikel von M. Frashëri in Diturija 2 (1926) nicht geschickt haben, so ist es schön; denn ich habe eine Photokopie des ganzen Artikels erhalten.

Unglücklicherweise, einstweilig verreist kann ich die rumänische Zeitschrift Revue de Linguistique 7 nicht finden, in der Ihre Studie "Zur Charakteristik usw." gedruckt ist, und habe Ihre Sonderdrucke nicht bei mir. Deshalb danke ich Ihnen sehr für die kurze Angabe der Herkunft des Namens Shqëfëri aus dem lateinischen Stephanus.

Besten Dank noch für die Sonderdrucke neuer Studien von Ihnen, die mir so freundlich im Dezember zugesandt haben, wie ich aus Ihrem Briefe sehe. Ihre Separata sind alle geschätzt und ich werde dieselben in Bänden zusammen binden lassen.

Herr Dr. Moutsos und ich arbeiten nicht für das Balkaninstitut in Chicago; wir sind nicht dazu eingeladen. Sie haben Grüsse vom Herrn Vajakakos, aber ich habe Herrn Thomop nicht gesehen.

Nun, lieber Freund, habe ich zwei Desiderata, wofür Sie mir vielleicht helfen könnten, indem Sie mir Photokopien und Übersetzungen einiger Seiten zusenden wollen. Meine Verpflichtung zu Ihnen wird sehr gross sein, wenn ein Freund von Ihnen die diesbezüglichen Seiten ins Deutsche oder in eine andere europäische Sprache übersetzen könnte. Ich bitte Sie, mir die Geldsumme für all diese Ausgaben zu nennen, so dass ich Ihnen entweder einen Scheck in Dollars oder in einer anderen Währung oder irgendwelche amerikanischen oder europäischen Bücher zusenden dürfte.

Hier sind die Desiderata:

- 1) das Buch: Sufflay, Srbi i Arbanasi, albanische Übersetzung; oder Photokopie einiger Seiten (siehe 2 unten);
- 2) Übersetzung daraus der Seiten 36 und 37 sowie der Seiten, wo der Autor die Namen Arbanasi, Arnaut, Shqipëtar behandelt oder darüber etwas sagt; dabei könnten vielleicht die Seiten der serbischen Ausgabe verglichen werden;
- 3) den Band Hylli i Dritës 7 (1931) oder eine Photokopie des Artikels von M. Sirdani, Die Namen Shqypar und Arbnuer [albanisch], Hylli i Dritës 7 (1931), Seiten 198-204 und 635-639;
- 4) Übersetzung derselben Seiten (198-204 und 635-639).

Ein neuer Brief von Ihnen wird mich freuen. Mit schönen Grüssen  
Ihr sehr ergebener

*S. J. Georgacas*

# The University of North Dakota

GRAND FORKS 58201

MODERN GREEK – ENGLISH DICTIONARY

DIRECTOR & EDITOR: Dr. Demetrios J. Georgacas  
Office: Montgomery Hall 217 (tel. 777-2767)

21 Oktober 1969

Professor Eqrem Çabej  
rr. Bajram Curri 260  
shk. 7, ap. 15  
Tirana, Albania

Lieber Herr Kollege Dr. Çabej,


Es war eine feine ~~W~~ Gelegenheit, Sie in Wien am 10. onomastischen Kongress wieder zu sehen, wie auch Herrn Kostallari.

Vor einigen Tagen habe ich hier Ihre kritische Ausgabe: "Mashari" i Gjon Buzukut (1555), 2 Bände, hier erhalten. Ich bin Ihnen dankbar für die wundervolle Gabe und möchte Sie zu diesem magnum opus herzlich gratulieren. Sie haben viel Zeit und Mühe darauf aufgewendet, aber das Endresultat ist vortrefflich und bewundernswürdig.

Ich bitte Sie, meinen Namen und Adresse an Ihre Universität geben zu wollen, damit ich die linguistischen Publikationen erhalte. Dann möchte ich für dieselben Geld zusenden oder amerikanische Bücher mit Ihren Büchern austauschen.

Mit allen guten Glückwünschen verbleibe ich

Ihr

  
Demetrios J. Georgacas

Ndërsa Georgacas–i i shkruan Çabejt si vërsniku vërsnikut dhe kolegu kolegut, studiuesi tjetër grek, albanologu Titos Jochalas, lindur më 1942, i drejtohet Çabejt si nxënësi mësuësit. Kemi në duar vetëm një letër të vitit 1968, shkruar gegnisht, ku “gega” Jochalas, i ndodhur me studime në Palermo, thotë ndër të tjera “Ësht mirë qi kjo botë shkencore e Shqipnis t’u bâhet e njoftun edhe Grekvet, gjâ qi unë do të përpiqem ta zbatoj”, dhe shton se “Ju kuptoni mâ mirë se tjetërkush se ç’rândësi kanë studimet shqipe në Greqi.”

Po japim më poshtë tekstin integral të letrës, të cilën, sikurse edhe letrat e Georgacas–it, na e bëri të ditur zonja Brikena Çabej. Me lejen e saj dhe miratimin e vetë autorit, letra e Jochalas–it shërbeu si majâ e strumbullar i Festschrift–it që Akademia e Shkencave e Shqipërisë

botoi në 80-vjetorin e lindjes së albanologut të arvanitëve, njeriut që më shumë se kushdo tjetër hulumtoi dhe ndiçoi botën arvanite dhe "bukuroshen e fjetur", arvanitishten.

Palermo I9-2-1968

I shkëlqyemi Profesor,

I nënshkruemi jam një filolog i Universitetit të Athinës, i cili tash tre vjetë specializohem në gjuhë e letërsi shqipe, pranë Universitetit të Palermës, ku do të parashtrij në qershorin e këtij vjete një doktoratë me këngë greke-shqiptare të pabotueme, me komentime, përkthim italisht e glosar. Punimi do të ketë edhe një nënhyje historike mbi ardhjen e Shqiptarvet në Greqi simbas dokumentash venedikas, aragonas e simbas arkivit të Korfuzit. Këta dokumenta, besoj, do të botohen, kështu që do të jenë një ndihmesë e mirë për albanologët në përgjithësi.

Tash disa ditë Krejtoriaja e Bibliotekës së Universitetit të Tiranës ka pasë mirsin të më dërgojë disa libra shqip dhe disa numra të Revistës "Studime Filologjike" (1966 e dy numrat e parë të vjetit 1967). Përveç kënaqsis që ndieva tue pa botime shqipe, mu jta me vrejte me gezimin më të madh, se në Shqipëri është një botë ~~shqiptare~~ shqiptare, që jeton e krijon. Është mirë që një botë shkencore e Shqipërisë t'u bëhet e njohur edhe Grekvet, gjë që unë do të përpiqem t'a zbatoj.

Universiteti i Athinës ka themeluar një katedër edhe për gjuhën dhe letërsinë shqipe; kështu edhe Universiteti i Janinës. Por nuk janë ende në funksion për mungesë të albanologvet grekë.

Tue vrejte, se Ju, i shkëlqyemi Profesor, interesohuni për studimet shqiptare në Greqi, besoj se do të më ndihmoni në këtë ndërmarrje. Tue qene se Ju përfaqsoni shkencën gjuhësore të Shqipërisë, kishem me Ju lutë të më dërgoni disa prej veprave të Jueja; do të Ju jem shumë mirënjohës. Mjerisht më kanë dërgue vetëm numrat I-4 të vjetit 1966 dhe I-2 të vjetit 1967. Kështu që nuk kam mundësin të shoh krejt punimin e Juej mbi etymologjinë e shqipes që Ju keni botue më përpara.

Fosa të kthej në Greqi, kam dishir të parashtrij tri vepra, edhe në përkthim I) Një gramatikë shqipe, 2) Një histori të letërsisë shqiptare, 3) Një antologji të poezisë shqipe popullore e t'auctorvet. Këso dore Grekët dotë shofin se ka një botë shqiptare që rreh me fuqi.

✓

---

Ju a kërkoj këto botime, pse ndoshta Ju kuptoni më mirë se tjetër kush se ç'ëndësi kanë studimet shqipe në Greqi.

Do të Ju jem shumë mirënjohës dhe jam në dispozicion të Juej për botimet greke apo të shtypuna në Greqi.

Në pritje të njëj përgjijeje, Ju lutem, pranoni urimet e mija më të mira.

*Prof Titos Jochalas*

(Titos Jochalas)

Casa Professa-Palermo, ITALIA

Çabej u nda nga jeta në vitin 1980, pikërisht atëherë kur Jochalas–i botonte Fjalorin e Mark Boçarit, i cili do të pasohej nga një numër i madh monografish kushtuar gjuhës së arbërve të Greqisë. Duke i shfletuar ato të lind vetiu mendimi sa shumë të dhëna, nxjerrë nga viset dhe visaret e arvanitishtes, do t'i kishin shërbyer Çabejt për ta pasuruar edhe më tej opusin etimologjik të tij. Po marr këtu vetëm një shembull dhe pikërisht fjalën *val*, për të cilën Çabej shënon:

*val* m. “luginë” (?). Ruhet vetëm në shprehjen *mal e val: i pasun mal e val*, që jep Gazulli për Malsi të Madhe [...] Te *val* kemi të bëjmë me një nga ato elemente latine të shqipës, të cilat nuk ruhen në leksikon e kësaj gjuhe, por kanë mbetur vetëm si relikte në toponomastikën e vendit. (E. Çabej, *Studime Etimologjike VII*, Tiranë 2006, f. 221–23)

Ndërkaq, në monografinë e Jochalas–it për arvanitët dhe arvanitishten e Moresë (Peloponezit) jepet i regjistruar teksti i një kënge dasmorësh, që thotë mes tjerash:

*Shkuom male, shkuom vale,*

*Muorrm çënjë donjëm nave.*

*Shkuom male, shkuom prre[nj],*

*Muorrm çënjë donjëm ne.*

(T. Γιοχάλας, Η αρβανιτιά στο Μοριά, v.A, Athinë 2011, f. 221)

Këtu, nisur nga konteksti, por edhe nga shprehja *mal e val*, që përmend Çabej, mund të themi pa ngurrim se apelativi *val* ka kuptimin ‘luginë’. Në këtë mënyrë, me të dhënat e arvanitishtes del që fjala *val* është ruajtur si e tillë në të folmet periferike a diasporike të shqipës. Ky përfundim gjen mbështetje edhe në faktin se apelativi *val* dëshmohet në të folmet arbëreshe të Italisë:

*Taksën malt, taksën valt,*

*Taksën fushat me lule.*

(M. Mandalà, *Nikollë Filja dhe veprat e tij poetike*, Tiranë 2022, f. 474).

### **Përmbyllje**

Sa herë mblidhemi për të nderuar e përkujtuar Çabejin dhe veprën e Tij, aq më shumë ia ndiejmë mungesën, por edhe ndërgjegjësohemi për detyrimin që na përcjell ai emër: ta njohim më mirë e ta mbrojmë opusin çabejian. Kësisoj ai është dhe (duhet të) bëhet më i pranishëm mes nesh e brenda nesh.

Nuk duket të jetë aspak e rastit që ky *die grösste Autorität in der Albanologie* përbën ndoshta edhe *das grösste Objekt* të sulmit (dhe zulumës) të gjithfarë gjithologëve të shfaqur së fundi në gjithësinë e shqipes. Hordhitë e të paparëve dritë i janë vërsulur, sepse, sa herë dëgjojnë emrin e Tij, u erren sytë e u merren mendtë, ngaqë Çabej është pasqyra ku shohin lakuriqësinë e vet, mishërim i asaj që ata i shmangen si djalli temjanit, sinonim i shkencës e i logjikës, shkëmb i paepur ndaj tollovisë e paditurisë.

Nehring, Gerd-Dieter

## **E. ÇABEJ DHE M. LAMBERTZ: DISA FJALË RRETH PASQYRIMIT TË TYRE RECIPROK**

Kontributet shkencore të filologut të ndritur shqiptar Eqrem Çabej (06./07.1908–13.08.1980) gjetën ndër të tjera një pasqyrim në veprat e Maksimilian Lambercit (Maximilian *Lambertz*, 27.07.1882–26.08.1963), të nismëtarit të albanologjisë në Gjermani pas Luftës së Dytë Botërore.<sup>1</sup> Dhe anasjelltas, edhe profesori E. Çabej u kushtoi vëmendje arritjeve në fushën e albanologjisë të dijetarit të njohur me prejardhje austriake.

Shtjellimet e mëposhtme trajtojnë pyetjen se çfarë lloj pasqyrimesh të ndërsjella kanë këta shkencëtarë dhe si mund të përcaktohet rëndësia e tyre në albanologji dhe më gjerë?

Bazat kryesore të vëzhgimeve në vijim paraqesin në radhë të parë studimet gjuhësore të E. Çabejt në 6 vëllime më 1975 si dhe veprat e Lambercit nga vitet 1949, 1954–1959. Në “Studime gjuhësore” (Çabej 1975b/5: ‘Gjuhë – folklor – letërsi – diskutime’, Prishtinë 1975) jepen 4 punime të E. Çabejt, që i përkasin në mënyrë të veçantë M. Lambercit (khs. më poshtë). Burimet e tjera, lidhur me letërkëmbimin, nuk ishin të arritshme.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Khs.: Nehring, Lewin 2008.

<sup>2</sup> Zonja Beate Rebner (Universitätsarchiv Leipzig, Prager Str. 6, 04103 Leipzig) më shkroi më 05.09.2023 ndër të tjera: ‘Fatkeqësisht nuk mund t’ju jap ndonjë informacion pozitiv. Edhe pse ekziston një trashëgim nga Maximilian Lambertz-i në arkivat e Universitetit, ai përmban vetëm dokumente pune dhe dorëshkrime dhe nuk përmban asnjë korrespondencë.’ (‘Leider kann ich Ihnen keine positive Auskunft geben. Zwar gibt es im Universitätsarchiv einen Nachlass von Maximilian Lambertz, dieser enthält jedoch ausschließlich Arbeitsunterlagen und Manuskripte, es ist keinerlei Briefwechsel darin enthalten.’). Për dallim nga kjo, zonja Brikena Çabej gjatë konferencës bëri të ditur se ka korrespondenca mes babait të saj dhe profesorit Lamberc. Të njëjtat gjenden në arkivin privat të të atit dhe nuk ishin të arritshme për mua.



Kumtesa ime ndahet në tri pjesë. Këto janë:

1. Pasqyrimet reciproke të dijetarëve në fjalë,
2. Krahasimi i pasqyrimeve përkatëse,
3. Qasje për hulumtime të ardhshme.

1. Pasqyrimi reciprok i dijetarëve

Cilat janë pasqyrimet e ndërsjella të këtyre shkencëtarëve? Khs.:

## 1.1 Prof. Çabej për M. Lambercin

### 1.1.1 Vlerësime të përgjithshme

Profesori Çabej përcaktoi në mënyrë të përgjithshme rëndësinë e madhe të veprimtarisë së M. Lambercit, si. p.sh.:

– “Në vargun e dijetarëve që u janë kushtuar studimeve shqiptare Maximilian Lambertz zë një vend më vete, për tematikën e veçantë e të pasur të interesave të tij shkencore e të punimeve që ka kryer” “Maximilian Lambertz është një dijetar me natyrë artisti i pajisur me një dell letrar të fortë.” (Çabej 1975b/5, 176) “Sidomos i ka kushtuar një vëmendje të veçantë dhe të pandërprerë literaturës popullore e artistike, gjuhësisë dhe etnografisë e folklorit në kuptimin më të gjerë të kësaj fjale.” (Çabej 1975b/5, 180)

– [...]”Bashkë me shkencën përparimtare gjermane, 75-vjetorin e M. Lambertzit e kremton edhe shkenca shqiptare.” (Çabej 1975b/5, 173) “Kërkimet e tij tregojnë një përzierje të lumtur të gjuhëtarit, të folkloristit e të letrarit.” (Çabej 1975b/5, 173)

Në gjuhësinë shqiptare gjurmimet e M. Lambercit përfshijnë, thekson E. Çabeji, më fort sintaksën, leksikologjinë e sidomos dialektologjinë, duke ardhur nga bota klasike. Me këto vlerësime lidhen edhe të dhënat bibliografike mbi profesorin e Lajpcigut.

1.1.2 Pasqyrimet e E. Çabejt për veprat gjuhësore të M. Lambercit lidhen në detaje me:

### 1.1.2.1 Kërkimet gramatikore e leksikologjike

Këto janë:

a) “*Perioda hipotetike në gjuhën shqipe*”, monografia paraqet “një punë pioneri” (Çabej 1975b/5, 173), ato “hetohen me një ndjenjë psikologjike e stilistike të hollë” (Çabej 1975b/5, 178). Ai jep një pasqyrë të plotë mbi fjalitë kushtore në gjuhën shqipe. (Çabej 1975b/5, 182) “Momenti psikologjik dhe nuancat stilistike

vihen në dukje me kompetencë të madhe” (Çabej 1975b/5, 182); Lambertzi bën krahasime me gjuhët romane perëndimore, sidomos me rumanishten (Çabej 1975b/5, 182).

b) Lambertzi trajton edhe *aoristin*, përmendi E. Çabej, veçanërisht me *-va*, duke bërë krahasime me gjuhë të tjera dhe duke sjellë vëzhgime lidhur me përhapjen e tij. (Çabej 1975b/5, 182)

c) Prof. Çabej i kushtohet krahas me të edhe *onomastikës* te Lambertzi 1916 “Sistemit të *emrave dyfishe*”, 1913, 1914 “Përhapjes së *supernomen-it* në Perandorinë romake”. (Çabej 1975b/5, 182)

d) “Lambertzi gjer në fund të jetës u mor me *emrat shqip të burrave dhe të grave*, me trajtat e tyre të shkurtuara dhe me *formantet* që përbëjnë këto trajta, si *-k, -kë*” (të tipit *Prend Prenk* etj.), “me *emrat vetiake shqiptare*” (Çabej 1975b/5, 183) që vërtetojnë birërinë ilire të shqipes (Dasas Sasimius), ai trajton *emrat e ditëve të javës dhe të muajve* të shqipes. (Çabej 1975b/5, 183)

#### 1.1.1.2 Kërkimet dialektologjike të M. Lambercit

Kërkimet dialektologjike të tij përfshijnë sipas Çabejt jo vetëm Shqipërinë, po edhe kolonitë shqiptare. Ato zënë kryet në lëmin e gjuhësisë, shënon profesori Çabej (Çabej 1975b/5, 177). Ai nënvizon sidomos:

a) hetimet e Lambercit në *terren*,

b) kërkimet e vitit 1916 (tiparet kryesore të *gegërishtes*<sup>3</sup>, “Në kohët e fundit përshkroi [...] dhe të folët e qytetit të

Gjirokastrës” (Çabej 1975b/5, 177).

Më 1959 bën “një diferencim edhe më tej” të “gegërishtes, duke e ndarë këtë në gegërishte veriore, verilindore, të mesme dhe jugore.” (Çabej 1975b/5, 182)

c) studimet mbi të *folmet arbëreshe* 1915, 1916, 1922, 1923, 1925 (sh. V, 173)

M. Lamerc jep një hyrje historike të shkurtër, trajton tingujt bashkë me një vështrim të përgjithshëm të veçorive fonetike, format e sistemit nominal dhe verbal dhe, më shkurt, ndërtimin sintaktik, jep një glosar të pasur dhe tiparet e ndikimit të mjedisit roman dhe të

---

<sup>3</sup> Lambertz, M. (1916): Bericht über meine linguistischen Studien in Albanien von Mitte Mai bis Ende August 1916. Në: Anzeiger der kaiserlichen Akademie der Wissenschaften. Phil. – hist. Kl. Sh. edhe: Çabej 1975b/5, 181v. më gjatë.

çështjes, “nga ç’anë të Shqipërisë janë shkukur” mbajtësit e dialektit, duke u mbështur në emrat e familjeve dhe në tiparet e dialektit të tyre. (Çabej 1975b/5, 181)

d) Prof. Çabej përmend edhe *vështrimin e përgjithshëm të dialekteve të shqipes* 1943, Alb. Lesebuch I (Çabej 1975b/5, 174), 1957 (Çabej 1975b/5, 182).

### 1.1.3 Pasqyrime mbi librat me qëllim praktik të M. Lambercit

Librat me qëllim praktik të mësimit të shqipes (disa në bashkëpunim me të tjerë dijetarë) E. Çabej i përmend me vlerësim të lartë të përgjithshëm. Ata u përkasin botimeve të viteve 1913, 1948, 1954 (=> fjalori shqip-gjermanisht), 1955 (ndër të tjera me copë të zgjedhura të letërsisë popullore e artistike). Lidhur me “Librin leximit të shqipes” 1948 prof. Çabej shkruan p. sh.: [...] “thellimi i çështjeve dhe artikujt e veçantë [...] bëjnë që kjo vepër [...] t’i kalojë caqet e një libri të leximit e të bëhet një vademecum për gjithë ata që duan t’i hyjnë mësimit të gjuhës e të literaturës sonë.”<sup>4</sup>

### 1.1.4 Pasqyrimet e E. Çabejt për politikën gjuhësore të M. Lambercit

Pasqyrimet përkatëse lidhen me pjesëmarjen e Lambercit në “Komisinë letrare të Shkodrës” (Çabej 1975b/5, 174 vv.).

- Komisia [...]”u ngarkua me punën e rregullimit të ortografisë së shqipes e me zbatimin e saj.” Lamberci “ndihmoi mjaft që rregullat ortografike që u vendosën atje të abstraktoheshin nga shqiptimi real e njehohësisht të mbështeteshin në një normim të varianteve që ekzistojnë nëpër dialekte, duke pajtuar parimin fonetik me parimin e gjuhësisë historike.” (Çabej 1975b/5, 178)

- “Lambertzi [...] ka mbajtur qëndrim ndaj çështjes së gjuhës së përbashkët e të shkrimit [...] ai nuk u përzie praktikisht në këtë çështje, sikur pat bërë Krumbacheri në çështjen e gjuhës në Greqi. Ai është shprehur çiltas kundër një gjuhe të përzier geqe/ toske, kundër një gjuhe që nuk flitet gjëkund, kundër hapjes së gremisë së thellë midis njerëzve të zyrës, të shkollës e të kulturës dhe njerëzve të popullit, kundra lindjes së një diglosie artificiale.” (Çabej 1975b/5,

4 Khs.: Çabej 1975b/5,174; E. Çabej e shënon vitin 1949, kur ka dalë nga shtypi ky libër. Për dallim nga kjo e jep vitin 1948 në të dhënat bibliografike përkatëse. Sh. edhe: Çabej 1975b/5,175, 182 v.

### 1.1.5 Thëniet e E. Çabejt për botimet rreth folklorit shqiptar të M. Lamercit

Temat janë:

#### 1.1.5.1 Poezia Khs.:

- Botimi i M. Lamercit nga viti 1917<sup>5</sup> “është i pari botim përmbledhës” (Çabej 1975b/5, 174): ai “ka vënë në pah karakterin e veçantë të poezisë popullore shqiptare brenda poezisë së popujve të Ballkanit, duke gjetur tiparet dallonjëse përbrenda elementeve të përbashkëta.” (Çabej 1975b/5, 178)

- [...] ”në mënyrë të veçantë shqyrtohet imët melodia e ritmi, rima e ndërtimi i vargut.” (Çabej 1975b/5, 184)

- “Një nga meritat e tij” [të Lamercit] qëndron në interpretimin e poezisë nga jeta.” (Çabej 1975b/5, 189)

#### 1.1.5.2 Përrallat

Khs. p.sh.këto vërejte të prof.. Çabejt për: Lamercin e viteve 1917, 1922<sup>6</sup>. Sipas profesorit Çabej Lamerci jep një pasqyrë të përmbajtjes, të formës, duke përfshirë edhe gjuhën; kjo është me vlerë të qëndrueshme “për studimin e përrallave të mbarë popujve të Ballkanit” (Çabej 1975b/5, 174); këtu ai [d.m.th. Lamerci] ka rrahur edhe zhvillimin e letërsisë shqiptare (sh. edhe: V, 180,184; botimet e Lamercit gjatë vitve 1925–1952).

#### 1.1.5.3 Epika popullore te M. Lamerci

##### 1.1.5.3.1 Pasqyrimet e E. Çabejt për shtjellimet e veçanta

Ato u përkasin punimeve të Lamercit si vijo:

– Lidhur me vitet 1954–55 dhe këtu me *Ciklin e Mujit dhe të Halilit* I, II: “Asgjë që të jetë qenësore nuk ka mbetur pa u rrahur në të” (Çabej 1975b/5, 175) [...] ”Kjo monografi, bashkë me librin përmbi përrallat [...] mund të thuhet se përbën kulmin e veprës shkencore të këtij dijetari.”

5 Lambert, M. (1917): Die Volkspoesie der Albaner. Eine einführende Studie. Sarajevo.

6 Lambert, M. (1917), sh. më sipër. Lidhur me vitin 1922: Lambert, M. (1922): Albanische Märchen und andere Texte zur albanischen Volkskunde. Wien.

- Lidhur me të **Çabej përmendi** edhe: “Epikën popullore të shqiptarëve” (1954–55, ribotuar më 1958). Ajo e lidh sipas E. Çabejt Lambertzin me Homerin.

-“Një dashuri të veçantë ka ushqyer Lambertzi gjatë gjithë jetës së tij për Këngët e Kreshnikëve, për rapsoditë e Veriut” [...] (**Çabej 1975b/5**, 184). “Si një meritë e veçantë e autorit do shikuar fakti që ai vë në dukje edhe ndjenjat njerëzore më të holla që dalin në këto këngë”. (**Çabej 1975b/5**, 185)

#### 1.1.5.3.2 Përgjithësime dhe lidhje kulturore-letrare

a) *Mitologjisë* “shqiptare ky dijetar i ka kushtuar interesimin shkencor gjer në ditët e sprasme të jetës së tij. Për këtë dëshmon dhe një punim që kreu në shtratin e lëngimit të fundit”. (**Çabej 1975b/5**, 185, 186)

b) Lambertzi ka vënë “në dukje çdo herë *ndikimet* e shoqishoqme *sllave–shqiptare*” dhe kjo “me njohjen e thellë të jetës së popullit shqiptar”.

- “për marrëdhëniet shqiptare–sllave në kompozicionin e këtyre rapsodive [...] ai me të drejtë arrin në përfundimin që këto rapsodi janë përfutur në truall të simbiozës serbe– shqiptare”. (**Çabej 1975b/5**, 189)<sup>7</sup>

c) [...] “autori mbërrin në një sintezë të veçantë të lëndës dhe në një interpretim të ri e origjinal të kësaj epike.” (**Çabej 1975b/5**, 185) “Për sa u përket kreshnikëve, do thënë se këta na dalin si kalorës mesjetarë të Ballkanit”. “Atllarët edhe armët i përshkruan në mënyrë të hollësishme.” [...] “Me interes të veçantë paraqitet hetimi i qendrave gjeografike ku ndodhin ngjarjet”. (**Çabej 1975b/5**, 186)

d) “Në këto rapsodi, përveç motiveve specifike shqiptare, ka edhe të tjera që janë përgjithësisht ballkanike” (**Çabej 1975b/5**, 187). [...] ”hijeshia fizike e gruas përshkruhet më fort sipas skemës së ditur të lirikës popullore ballkanike, skemë kryesisht e gurrës orientale, veçse krahas me atë nuk mungojnë dhe krahasime të vendit.” (**Çabej 1975b/5**, 188 e tj.)

e) E. Çabej e karakterizon përveç lidhjeve ballkanike gjithashtu

---

<sup>7</sup> “Në punën e çështjes së përgjithshme të gjenezës së kësaj epike [...] në parim ekziston mundësia që ata t’i kenë marrë prej shtresës që sllavët gjetën në këto troje [...] kësaj poezie nuk mund të mohohet a priori, një thelb më i vjetër e prasllav” (**Çabej 1975/5**, 189).

formën, stilin dhe gjuhën e rapsodive të zgjedhura nga Lamberti.<sup>8</sup>

f) Epika popullore “përfshihet”, theksoi E. Çabej, ”në lidhjet europiane”. (Çabej 1975b/5, 189)

1.1.6 Pasqyrimi i E. Çabejt për shtjellimet e M. Lambercit rreth letërsisë shqiptare

Nga profesori Çabej theksohen:

- Trajtesa e zhvillimit historik të literaturës artistike nga Lamberci më 1943<sup>9</sup>; Gjenezja e zhvillimi i literaturës shqiptare<sup>9</sup>, botuar më 1948 (Çabej 1975b/5, 175);

- copë të zgjedhura të letërsisë artistike dhe popullore shpesh me komentare në Lesebuch 1955, dhe në “Albanien erzählt” 1956;

- prodhimi letrar i arbëreshëve të Italisë: Jul Variboba (Giulio Variboba) 1956 (Çabej 1975b/5, 175).

- Me të gjitha meritat në trajtimin e letërsisë shqiptare E. Çabej kërkon edhe studime më të gjera për ta vlerësuar kontributin e Lambercit.

Khs.: [...]”literatura shqiptare ka filluar me disa qarqe krahinore-konfesionale (qarku katolik, qarku ortodoks i Jugut e qarku italo-shqiptar, të cilat pastaj [...] u derdhën në rrymën e përbashkët të literaturës nacionale.” [...]. “Ky është një mendim, i cili [...] po të [...] thellohet me një frymë objektive, mund të bëhet pjellor [...] Disa fusha kërkimesh i ndjej më të afra, disa më të larta, prandaj po ua le të tjerëve që të vlerësojnë si duhet kontributin që ka dhënë ky dijetar në studimet e literaturës shqiptare.” (Çabej 1975b/5, 176)

- Lidhur me monografinë e Lambercit nga viti 1949 profesori Çabej shpreh ndër të tjera këtë mendim:

“Gjergj Fishta dhe epi heroik shqiptar “Lahuta e Malcis”<sup>10</sup> këtu

---

8 [...] ”habitoret dhe thirrmat e shpeshta, konstrukti emfatik dhe konstrukti i intensitetit, pyetja si mjet stilistik, dhanorja e intimitetit (dativus intimitatis) te përemri vetor, tha-ja epike, (‘inquit’) si-ja shtesore” [...] etj. “Ndër veçoritë gjuhësore trajtohen edhe gjurmët dialektore [...] pranë koinesë gege të Veriut [...] pastaj deminutivat, paskajorja ndaluese (infinitivi prohibitiv) me kuptimin urdhëror (imperativ), urdhërorja në vend të habitores, koha e shkuar (preteriti) në vend të së ardhmes (futurit), sinonimet [...] mallkimet, bekimet edhe betë” [...]. “Me interes të veçantë janë shtjellimet që bën autori [M. Lamberci] mbi masën e vargut, metrin e rapsodive [...] Vargjet në shumicën janë ndërtuar me dhjetërokshin serb [...] me të drejtë thekson që aty gjejmë një larmi vargjesh” (sh. Çabej 1975b/5,188).

9 Lambert, M. (1943): Das Werden der albanischen Literatur. Në: Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa 7, 160–174 (ribotim i ndryshuar te Albanisches Lesebuch. Bd 1. Leipzig 1948, 373–387; sh. edhe më sipër 1922 (Çabej 1975/5, 180).

10 Lambert, M. (1949): Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos Lahuta e Malcis, Laute des Hochlandes. Leipzig.

Lamberci jep përmbajtjen e këngëve si dhe një karakteristikë të poetit. Përkthimi gjermanisht i Lahutës ‘Die Laute des Berglandes’ 1958 [...] “është i vetmi i plotë gjer më sot dhe është më i miri nga përkthimet e këtij epi.” (Çabej 1975b/5, 180)

- E. Çabej përmend edhe përkthimin e Lambertzit të dramës ‘Toka jonë’ të *Kolë Jakovës*. Ai shton se Lamberci ka lënë në dorëshkrim edhe një punim me titullin “Drama në teatrin shqiptar të sotmin”. (Çabej 1975b/5, 181)

### 1.1.7 Përmbledhja e shkurtër e pasqyrimeve të E. Çabejt për M. Lambercin

- Profesori Çabej dallohet në punimet e tij mbi M. Lambercin si një njohës jashtëzakonisht i shkëlqyer i veprimtarisë së dijetarit gjermanishtfolës. Ka dijeni gjithëpërfshirëse bibliografike.

- Ai jep përmbledhtas, me përjashtim të folklorit dhe të dialektologjisë, te publikimet më të rëndësishme të Lambertcit në shumë e raste një pasqyrë të përmbajtjes, jo rrallë u bën referim vetëm publikimeve të Lambertcit.

- Nuk bën një analizë kritike të publikimeve të Lambertcit, përkundrazi, ai jep vlerësime të larta, thekson edhe në një rast lidhur me letërsinë, se nevojiten hulumtime më të gjera.

- E. Çabej nuk bën shtjellime të veçanta lidhur me përkthimet e Lambertcit në gjermanishte, megjithëse ka pasur dijeni shumë të mira edhe mbi gjuhën gjermane.

### 1.2 Profesori Lamperc për E. Çabejn

Te Lamberci gjejmë shumë pak shtjellime për veprimtarinë e Çabejt. Këto janë:

1. Përpjekjet e intelektualëve shqiptarë për një *gjuhë zyrtare të përbashkët* 1952, diskutimi në shtator të vitit – seanca e Institutit në Tiranë (Lambertz, M. (1959), 29vv.):

a) [...] “një referues kryesor ishte Eqrem Çabej.”

b) Çabej “bën thirrje për një studim të plotë të dialekteve të shqipes, një fjalor etimologjik, punime të reja mbi elementet turke, greke, sllave dhe rumune në gjuhën shqipe dhe vendos parimin për gjuhën e shkrimit: të dy dialektet duhet të përafrohen sa më afër që të jetë e mundur, në të shkruarit të jashtëm, në drejtshkrim; aty

ku toskërishtja ka dy forma sot, duhet të zgjidhet kjo që është e përshtatshme edhe për gegishten; me pak fjalë, ideali i tij është edhe ai i *një gjuhe të përzier të temperuar mirë.*” (f. 31)<sup>11</sup>

2. *Ndikimi i shqipes në gjuhët e profesioneve dhe kallpazanëve të greqishtes së re*

Këtë e ka trajtuar Eqrem Çabej gjithashtu. “Ende nuk e kemi punimin e tij.” (1959, 41)<sup>12</sup>

## 2. Krahasimi i pasqyrimeve reciproke të dijetarëve

Për ta bërë më të hollësishëm krahasimin e pasqyrimeve reciproke të dijetarëve, nevojitet që të merren në konsideratë veprat e tyre në tërësi, d.m.th. veprat e Çabejt deri në fund të jetës së Lambercit, dhe anasjelltas veprat e Lambercit në një të tërë, sepse mbi këtë bazë arrijmë në një përfundim, edhe nëse fillimisht është vetëm teorik, se çfarë pasqyrimesh të ndërsjella do të kishin qenë të mundshme mes të dy shkencëtarëve.

### 2.1 Rreth veprave të dijetarëve

Baza e vëzhgimit mbi veprimtarinë shkencore të E. Çabejt është përmbledhja: “Bibliografi e veprave të prof. Eqrem Çabejt” (Çabej 1975b/5, 349–353). Këtu kemi 154 punime **të ndryshme deri vitin 1962, të publikuara** sidomos në revista (rreth 40%). Përafërsisht 10% paraqesin shtjellimet e E. Çabejt në libra. Bie në sy numri i madh i recensioneve të tij (25%).<sup>13</sup>

Te veprat e E. Çabejt mbizotërojnë, siç mund të supozohet, nga një anë punimet gjuhësore (gjithsej 35%), të cilat merren me historinë e shqipes dhe me etimologji (rreth 21%), me çështje të shqipes moderne (mbi 12%), me dialektologji (këtu sidomos të shqiptarëve të Italisë). Megjithatë, nuk janë lënë mënjanë krahas me

11 Er “fordert gründliches Studium der albanischen Mundarten, ein etymologisches Wörterbuch, neue Arbeiten über die türkischen, griechischen, slawischen, rumänischen Elemente im Albanischen und stellt für die Schriftsprache den Grundsatz auf: Möglichste Annäherung der beiden Dialekte im äußeren Schriftbild, in der Orthographie; wo das Toskische heute zwei Formen hat, ist die zu wählen, die auch dem Gegischen eignet, kurz auch sein Ideal ist das einer wohltemperierten Mischsprache.” Çabej e konsideron të rëndësishëm krijimin e një standardi uniform, sipas mendimit tim, pasi mori pjesë në diskutimin e vitit 1952 për çështjet e zhvillimit të standardit shqiptar, por u shmang rrugëve konkrete të standardizimit nëpërmjet analizave të veçanta.

12, “Den Einfluß des Albanischen auf “... „die neugriechischen Berufs- und Gaunersprachen hat Eqrem Çabej behandelt. Seine Arbeit liegt uns noch nicht vor.”

13 Mes veprave të profesorit Çabej gjinden përveç kësaj shumëfishme (6,5%), letra (rreth 5%) dhe dorëshkrime (9%).



të as folklori, as letërsia, as historia, as përkthime etj. Bibliografia e punimeve provon një pasuri të madhe publikimesh.

Interesimi kryesor i djetarit Lamberc lidhet veçanërisht me:

a) letërsi dhe folklor (50%; me rëndësi janë: përralla, epika dhe poezia popullore);

b) gjuhësi (34%; këtu hyjnë punime të rëndësishme si: periudha hipotetike, shqipja standarde, dialektologjia shqiptare, edhe një fjalor); si dhe:

c): shqipja si gjuhë e huaj, në radhë të parë lidhur me të dhënat letrare, gjuhësore, mbi Shqipërinë (libra mësimi sh. më poshtë).<sup>14</sup>

## 2.2 Krahasimi i pasqyrimeve reciproke të dijetarëve

Në bazë të shtjellimeve të deritanishme mund të nxirren këto përfundime kryesore:

1. M. Lamercit nuk arrin numrin e punimeve të veçanta (sipas vëzhgimeve tona 44) sesa E. Çabej (154), megjithatë ka kryer vepra të rëndësishme veçanërisht në lidhje me gjuhën shqipe, me letërsinë dhe folklorin e shqiptarëve dhe me trojet shqiptare dhe me mësimdhënien (duke përfshirë jo rrallë lidhjet me popuj fqinjë; sh. edhe më sipër).

2. Interesimi i M. Lamercit nuk ishte i përqëndruar aq fort në çështje etimologjike dhe te të folmet arbëreshe, por ai shqyrtoi, pa u përzier, pak më shumë se Çabej çështje të standardit të shqipes.<sup>15</sup>

3. Te E. Çabej mbetën jo pak vepra në dorëshkrim.

4. Të dy nuk përpiluan punime mbi situatën sociolinguistike të asaj kohe në Kosovë, as në Maqedoni.

5. Krahasimi i pasqyrimeve të dijetarëve, lidhur me dallimet mes tyre, na çon te dy konkluzione të rëndësishme. Ato kanë të bëjnë:

a) me çekuilibrin e perceptimit reciprok të dijetarëve dhe  
b) me qëndrimin e tyre ndaj zhvillimit të shqipes standarde të njësuar, në lidhje me bazën që duhej të zgjidhej.

6. *E. Çabej nuk cek, ç'mund të supozohet, të gjitha publikimet e Lamercit, disa nganjëherë vetëm shkurtimisht, por ai*

<sup>14</sup> Khs.: [http://www.albanianphotography.net/lambertz/lambertz\\_publications.pdf](http://www.albanianphotography.net/lambertz/lambertz_publications.pdf)

<sup>15</sup> Gjë që mund të ketë qenë e shkaktuar, sa i përket profesorit Çabej, nga rrethanat e atëhershme politike, nga pyetjet e pazgjidhura në procesin e krijimit të standardit.

*karakterizon përmbajtjen e veprimtarisë së M. Lambercit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të plotë.*

7. *Gjë që nuk vlen për M. Lambercin në pasqyrimet e tij mbi Çabejn. Përkundrazi, pasqyrimet e tij janë nga numri shumë të pakta, siç ishte dashur të ilustruhej më lart.*

2.3 Qëndrimet e zgjedhura të të tjerëve rreth pasqyrimeve reciproke të E. Çabejt

Lidhur me tematikën e konferencës dhe për shkak të numrit të vogël të pasqyrimeve të prof. Labercit mbi veprën e E. Çabejt përqendrohemi më tutje vetëm te pasqyrimet e E. Çabejt për M. Lambercin. Vërehen këtu edhe disa ngjashmëri edhe disa dallime. Khs.:

2.3.1 Ngjashmëri me pasqyrimet e E. Çabejt për M. Lambercin

Saktësinë e pasqyrimet të prof. Çabejt e vërtetojnë në disa raste ndër të tjera vlerësimet e mëvonshme për punën e M. Lambercit, si për shembull:

– Lamberci luajti një rol vendimtar në çështjen e gjuhës së shkruar dhe të drejtshkrimit shqip gjatë qëndrimit të tij në Shqipëri gjatë Luftës së Parë Botërore. Ai kundërshtoi haptazi krijimin e një diglosie artificiale në formën e një gjuhe të përzier geqe dhe toske dhe, jo më pak me rëndësi, falë tij u arrit që në përcaktimin e rregullave drejtshkrimore parimi fonetik dhe parimi i gjuhësisë historike të merreshin parasysh si të barabartë. (Gostentschnigg 2018,796)<sup>16</sup>

– Dhe edhe një herë është gjuhëtari i rëndësishëm shqiptar Eqrem Cabej ky, i cili zgjedh fjalët e goditura në një vlerësim përmbledhës të punës së Lambercit në fushën e albanologjisë: Ai është një nga ata të fundit në radhën e dijetarëve nga Austria e vjetër [...] të cilët kanë promovuar ndjeshëm studimet albanologjike. Ai është nga të paktët prej tyre që, kur shqyrtojnë çështjet shkencore, nisen nga një vështrim i tërësishëm i gjërave, të cilët lidhin në këtë kuptim në veçanti të dhënat e etnografisë, gjuhës dhe të letërsisë.

---

16 [...] Es "spielte Lamberts während seines Albanienaufenthaltes in Ersten Weltkrieg eine entscheidende Rolle in der Frage der albanischen Schriftsprache und Orthographie. Er trat offen gegen die Schaffung einer künstlichen Diglossie in Form einer gegischen und toskischen Mischsprache auf, und nicht zuletzt ihm ist es zu verdanken, dass bei der Festlegung der orthographischen Regeln das phonetische und sprachgeschichtliche Prinzip gleichermaßen Bedeutung fanden."

Jo në fund për shkak të kësaj metode kërkimore dhe të rezultateve të arritura nëpërmjet saj, ai arriti rezultate të qëndrueshme dhe u bë udhërrëfyes për kërkimet e mëvonshme. (Gostentschnigg 2018, 804)<sup>17</sup>

– Gerda Uhlisch e shpreh vlerësimin e saj për veprën e M. Lambercit në këtë mënyrë: Kishte dhe ka vetëm pak indogermanistë që i kanë kushtuar vëmendje të veçantë shqipes. Këtu përfshihen, mbi të gjitha, Gustav Meyeri dhe Norbert Jokli, i cili u vra nga fashistët gjermanë në Luftën e Dytë Botërore. Indogermanisti i Lajpcigut Maximilian Lamberc duhet përmendur në të njëjtën frymë si këta të mëdhenj, sepse ai ishte albanologu kryesor i Gjermanisë për gjysmë shekulli. (sipas Gostentschnigg 2018, 802)<sup>18</sup>

### 2.3.2 Dallime nga pasqyrimet e profesorit Çabej

Në disa raste të gjuhësisë dallohen vlerësimet shkencore nga pasqyrimet e E. Çabejt. Këto janë:

A) Lidhur me *periudhën hipotetike* dhe *kritikimin* e saj nga Jokli, që nuk ka përmendur Çabej:

– Konkluzioni i fundit i analizave përkatëse të Lambercit është se formimi i periudhës hipotetike shqiptare tregon natyrën e dyfishtë të shqipes si gjuhë gjysmë romane. (Gostentschnigg)<sup>19</sup>

– [...] Kritikat e veprave të tij, si ato të Joklit për periudhën

---

17 “Und wieder einmal ist es der bedeutende albanische Sprachwissenschaftler Egreme Cabéj der in einer zusammenfassenden Beurteilung von Lambertz Wirken auf dem Felde der Albanologie die treffenden Worte wählt: Er ist einer der letzten aus jener Reihe von Gelehrten aus dem alten Österreich, die [...] die albanischen Studien wesentlich gefördert haben. Er gehört zu den ganz wenigen unter ihnen, die in der Untersuchung der wissenschaftlichen Fragen von einer ganzheitlichen Betrachtung der Dinge ausgehen, die in dem Sinne namentlich die Angaben der Ethnographie, der Sprache und der Literatur miteinander verbinden. Nicht zuletzt durch diese Forschungsmethode und die durch sie erzielten Ergebnisse hat er Dauerndes geleistet, ist er wegweisend für die spätere Forschung geworden.”

Es fällt auf, dass in den gen. Zitaten hinsichtlich des Wirkens von Lambertz unterschiedliche Länder genannt werden. In diesem Zusammenhang gilt es allerdings zu berücksichtigen, dass der Sozialist Lambertz nach 1945 in der ehemaligen DDR seine Heimat und Wirkungsstätte suchte und fand. Aus diesem Grunde wird er im deutschsprachigen Raum hinsichtlich seiner Staatlichkeit in Bezug auf die Zeit vor 1945 Österreich zugeordnet, hernach bis zu seinem Tode der DDR/Deutschland.

18 “Es gab und gibt nur wenige Indogermanisten, die sich des Albanischen besonders angenommen haben. Zu ihnen gehören vor allem Gustav Meyer und der im 2. Weltkrieg von den deutschen Faschisten ermordete Norbert Jokl. Der Leipziger Indogermanist Maximilian Lambertz muss in einem Atemzug mit diesen Großen genannt werden. Denn er war ein halbes Jahrhundert der führende Albanologe Deutschlands.”

19 „Deren Schlussergebnis dahingehend lautet, dass die Bildung der albanischen Hypothetischen Periode Die Doppelnatur des albanischen als einer halb romanischen Sprache zeige.” (Gostentschnigg 2018, 789).

hipotetike, janë më fort të rralla. [...] Pretendimin e Lambertit, “shqipja është një gjuhë gjysmë romane e Ballkanit”, Jokli e mban si një rekurs për një pikëpamje, së cilës i është bërë luftë me sukses nga kërkimet më të reja, sepse përcaktimi i ngjashmërive sintaksore me romanishten nuk është i barasvlershëm me vërtetimin e origjinës së këtyre fakteve nga romanishtja. Dhe përveç kësaj konkordancat romane–shqiptare gjithashtu mund të evidentohen në gjuhët sllave jashtëballkanike si në rusishten dhe çekishten dhe në gjuhën gjermane. (Gostentschnigg)<sup>20</sup>

B) Lidhur me *Komisinë Letrare*, khs.:

– Megjithatë, në fund [...] Komisioni Letrar vendosi për elbaskanishten ‘me disa përmirësime’ si bazë të gjuhës standarde shqipe. (Nehring 1999; Komisija 1917).

– E folmja e Elbasanit është po aq e kuptueshme për shqiptarin verior si dhe për toskën. A. [August] Ritter von Kral [Komisioneri Civil Perandorak e Mbretëror Austro-Hungarez dhe Konsulli i Përgjithshëm] parashikoi se Tirana do të bëhej kryeqyteti i Shqipërisë së ardhshme, gjë që e bëri atë të paracaktuar nga vendndodhja e saj qendrore, dhe se për këtë arsye gegërishtja jugore, dialektet e Tiranës dhe të Elbasanit, ka shumë gjasa të japin bazën për gjuhën e ardhshme zyrtare dhe qeveritare. (Lambertz 1949, 9).<sup>21</sup>

– Nga veprimtaria e komisionit u hodhën themelet e mëtejshme për një gjuhë standarde uniforme shqipe; megjithatë, vazhduan të funksionojnë më tutje 2 sisteme fonologjike dhe 2 norma fonetike,

---

20 Kritiken an seinen Werken, “wie sie Jokl zum Beispiel an der hypothetischen Periode übt, sind eher selten. [...] Lamberts Behauptung, das Albanische sei eine halbromanische Balkansprache, bezeichnet Jokl als Rückgriff auf eine von der neueren Forschung erfolgreich bekämpfte Auffassung, denn die Feststellung syntaktischer Übereinstimmungen mit dem Romanischen sei nicht gleichbedeutend mit dem Nachweis der Herkunft dieser Tatsache aus dem Romanischen. Und außerdem ließen sich diese albanisch romanischen Konkordanzen auch im Ausserbalkanischen slawischen wie Russisch und Tschechisch und im Deutschen nachweisen.” (Gostentschnigg 2018, 794)

21 “Trotzdem entschied sich [...] die Literarische Kommission für das Elbabanische (Mittelalbanische) [...] mit einigen Verbesserungen” als Grundlage der albanischen Standardsprache (Komisija 1917; Nehring 1999, 450). “Der Dialekt von Elbasan ist dem Nordalbaner ebenso wie dem Tosken leicht verständlich. [...] A. Ritter von Kral [k. u. k. österreichisch-ungarischer Zivillandeskommisär und Generalkonsul] sah voraus, dass Tirana die Hauptstadt des zukünftigen Albaniens werden sollte, wodurch es durch seine zentrale Lage prädestiniert war, und dass daher das Südgegische, die Mundarten von Tirana und Elbasan, am ehesten berufen seien, die Grundlage für die künftige Amts- und Regierungssprache abzugeben.” (Lambertz 1949, 9)

të cilat nuk u njësuan plotësisht. (Beci 1985, 97).<sup>22</sup>

– Fatkeqësisht, gjendja e rëndë luftarake solli me vete që jo vetëm thënia e vjetër “inter arma silent Musae” të zbatohet në masë të madhe me të drejtë edhe për Shqipërinë, por edhe që komisioni letrar nuk ka mundur deri më tani të bëhet vatra qendrore intelektuale kombëtare, e cila përmes bashkëpunimit harmonik të të gjithë krerëve më të aftë të popullit të shqiptarëve [...] do të tregonte rugën më të mirë pa ankesa drejt një gjuhe të shkruar të unifikuar që përfshin gjithë popullin. [...] Ky vend me kulturë të re pothuajse nuk ka ende filologë me shkollim specifik metodik: pra kështu pjesa më e madhe e kohës priset kot duke u ngatërruar me të ashtuquajturat çështje drejtshkrimore. [...] Nga ana tjetër, një publik që është i aftë për praninë, që jep sfondin e nevojshëm, ekziston vetëm sa hap e mbyll sytë dhe madje ky është kryesisht i mbushur me paragjykime nga më të ndryshmet. (Nachtigall 1917, f. IVf.).<sup>23</sup>

#### 2.4. Pyetje të hapura

Krahasimi i pasqyrimeve dhe i vlerësimeve reciproke të dijetarëve si dhe shtjellimi i mendimeve të zgjedhura për ta në fushën e albanologjisë kërkojnë hulumtime të tjera për ta ndriçuar më thellë raportin e ndërsjellë të shkencëtarëve në fjalë dhe për t’u dhënë një përgjigje pyetjeve të hapura, të cilat rrjedhin nga shtjellimet e deritanishme. Këto pyetje janë për shembull:

1. Pse ekziston një pabarazi mes pasqyrimeve reciproke të dijetarëve, Çabej iu referua relativisht shumë Lambercit, anasjelltas Lamberci vetëm pak Çabejt?

2. Pse mungojnë analiza kritike reciproke të tyre?

---

<sup>22</sup> “Durch die Tätigkeit der Kommission wurden weitere Grundlagen einer einheitlichen albanischen Standardsprache gelegt; es funktionierten jedoch weiterhin 2 phonologische Systeme und 2 phonetische Normen, die nicht völlig vereinigt waren.” (Beci 1985, 97, edhe sipas Gostentschnigg 2018).

<sup>23</sup> “Leider hat es der schwere Kriegszustand mit sich gebracht, dass nicht nur das alte Sprichwort ‘inter arma silent Musae’ auch für Albanien in großem Maße zurecht besteht, sondern dass auch die literarische Kommission bisher nicht zu jenem nationalen geistigen Brennpunkte werden konnte, welcher durch harmonische Zusammenarbeit aller fähigsten Köpfe des Volkes der Shqipëtare[...] den klaglosesten Weg zur einheitlichen, das ganze Volk umfassenden Schriftsprache weisen würde. [...] Philologen mit methodischer Fachschulung hat das kulturjunge Land beinahe noch gar nicht: so wird denn auch die meiste Zeit mit Tüfteleien über so genannte orthographische Fragen verzettelt. [...] Andererseits ist ein aufnahmefähiges, den nötigen Hintergrund abgebendes Publikum nur zu einem geringen Bruchteil vorhanden und selbst dieses zum größten Teil von den verschiedenartigsten Vorurteilen durchsetzt” (Nachtigall 1917, IVv.).

3. Si dhe në ç' masë ndryshojnë dijetarët në çështjet që lidhen ndër të tjera me shqipen standarde?

4. Ç'rëndësi dhe rol kanë pasqyrimet reciproke të tyre në historinë e shqipes, në albanologji?

Një përgjigje për këto pyetje nuk gjejmë, kuptohet, as te M. Lamerci as te E. Çabej. Prandaj desha të hedh shkurtimisht pak dritë në qasjet që do të duheshin të na bënë të mendojmë më gjerë mbi reflektimet e ndërsjella të përmendura për t'u gjetur përgjigje pyetjeve të hapura.

### 3. Qasje për hulumtime të ardhshme

Qasjet për hulumtimet e ardhshme kufizohen në shtjellimet në vijim në dy zgjidhje të mundshme të pyetjeve të hapura, me to nuk pretendohet të arrihet plotësia e problematikës. Qasjet janë:

1) marrja parasysh e rezultateve shkencore nga shkencat e komunikimit, nga pragmatika dhe

2) teoria e standardizimit të gjuhës.

#### 3.1 Qasjet nga shkencat e komunikimit, nga pragmatika – sugjerime

Nëse kuptojmë pasqyrimet e treguara si një mënyrë të veçantë të shprehurit, d.m.th. si akte komunikimi, na çojnë analizat përkatëse dhe me to përgjigjet për pyetje të hapura në fushën e shkencave të komunikimit, dhe këtu në radhë të parë:

a) në fushën e kushteve të përgjithshme socio-kulturore të komunikimit dhe

b) lidhur me të në lëminë e gjuhësisë pragmatike.<sup>24</sup>

Ta marrim si ilustrim faktin se E. Çabej shprehet në mënyrë pozitive për Lamercin, në këtë rast mund të interpretohen pasqyrimet e tij si implikatura, d.m.th. në këtë mënyrë:

1. se Çabej supozon, se lexuesit e tij njohin veprat e Lamercit, gjithashtu kritikën përkatëse;

2. se Çabej nuk ka asnjë shkak adekuat për diçka negative, për një mendim të kundërt në lidhje me Lamercin.

Këto interpretime bazohen në parimin e kooperimit në

---

<sup>24</sup> Mbi nocionet sh.: Bußmann 1990, 393, 605v.

komunikim dhe në maksimën e tij të cilësisë.<sup>25</sup> Ato mund të paraqesin një përgjigje të pyetjes, pse prof. Çabej nuk vuri në dukje ndonjë shoshitje kritike të punës së M. Lambercit.

Në të njëjtën kohë mund të interpretohet supozimi se lexuesit i njohin veprat e Lambercit si një presupozim, si një presupozim ekzistencial, d.m.th. si një parakusht i përmbajtjes së vetëkuptueshme të mesazhit që është implikuar në komunikim.<sup>26</sup> Në këtë kuptim supozimi i E. Çabejt nën 1. gjithashtu paraqet gjithashtu një përgjigje pyetjes së shtruar më lart.

Le të shtojmë këtu se edhe mbajtja parasysh e kushteve të përgjithshme të komunikimit, me to edhe të pasqyrimeve reciproke, na çon te interpretimi se E. Çabej udhëhiqej nga qëllimi i publikimeve të veta, d.m.th. nga synimi se dëshiron ta nderojë Lambercin, prandaj pasqyrimet e tij kishin një karakter pozitiv.<sup>27</sup>

Te Lamberci mund të marrim me mend ndër të tjera supozimin se kishte dashur të tërheqë vëmendjen mbi gjendjen përkatëse aktuale ndër shqiptarët në Shqipëri, lidhur me pasqyrimet e tij.

Mirëpo, pavarësisht nga interpretimi i pasqyrimeve reciproke si implikaturë dhe/ose presupozim vlen, se edhe pasqyrimet në përgjithësi dhe ato të treguarat më lart në veçanti përmbajnë kuptime shtese, të cilat nuk shprehen në mënyrë verbale dhe të cilat duhet t'i zbulojmë nëpërmjet hulumtimeve të tjera. **Përgjigja** për pyetje të caktuara mund të jetë e shumëllojshme, ajo mbetet **në varësi nga të gjeturat** dhe në raste të caktuara mund të jetë të paktën e paplotë.

### 3.2 Qasjet nga standardizimi gjuhësor – sugjerime

Si bazë për përcaktimin e rëndësisë së pasqyrimeve të treguara për standardizimin e gjuhës shqipe mund të shërbejë ky model sociolinguistik, i cili tregohet këtu me sa nevojitet për shtjellimet tona:<sup>28</sup>

#### **Rekonstrukcioni i historisë së gjuhës/të varieteteve standarde moderne mbi bazën e politikës gjuhësore**

■.....*Shoqëria gjuhësore (që formohet) dhe gjuhë.....*■

Subjektet (shteti, grupe, individë)

kushtet



## **POLITKA GJUHËSORE** — varësia e saj nga:

### — 1) **determinantët nga shoqëria gjuhësore dhe gjuhët**

- | 1.1. Faktorët politikë-shoqërorë, d.m.th.:
- | – faktorët demografikë, socialë
- si – aspekte gjeolinguistike, sociolinguistike
- (sistem i) – faktorët psikolinguistikë etj.

**veprimeve drejtuar në mënyrë të:**

| a) (ri)themelimit/pengimit ose

1.2. Faktorët e veprimtarisë të shoqërisë/të individëve

| b) ruajtjes ose – rrethanat politike

| c) ndryshimit – faktorët ekonomikë, kulturorë etj.



### 2) **të gjuhës/të varieteteve standarde dhe të të menduarit kolektiv përkatës.**

(si objektet, fushat e ndikimit të politikës gjuhësore)

Në bazë të modelit mund të nxirren këto përfundime për pasqyrimet reciproke të dijetarëve në fjalë:

a) Nga një anë përshkruhen ndërmjet pasqyrimeve të përmendura shqipja dhe dialektet e saj. Ky përshkrim është njëfarë parakushti për të zhvilluar standardizimin e mundshëm të shqipes, më saktë për të zgjedhur bazën dialektore të saj.

b) Nga ana tjetër pamë se u paraqitën përpjekjet, veprimet e personave të veçuar, jo ose shumë pak të grupeve të njerëzish, jo të shtetit. Këta individë ishin përkujdesur të gjejnë zgjidhje për një zhvillim të mundshëm të shqipes standarde.

Pra, pasqyrimet e tyre reciproke radhiten, nga njëra anë, në determinantet e politikës gjuhësore të bashkësia gjuhësore shqiptare e asaj kohe drejt themelimit të shqipes standarde. Nga ana tjetër, paraqesin vetëm akte individuale të politikës gjuhësore.

### **Në vend të përfundimit:**

Jam i vetëdijshëm se vëzhgimet e mia janë të paplota. Ato kishin si qëllim, në radhë të parë, të tregohet se edhe pasqyrimet reciproke të E. Çabejt dhe të M. Lamercit kontribuojnë për hulumtimet e mëtejshme të shqipes dhe të kulturës së mbajtësve të saj dhe të



gjuhës gjermane. Këto vëzhgime paraqesin vetëm njëfarë fillimi për gjurmimet e ardhshme, duke përfshirë edhe letërkëmbimin e dijetarëve si dhe materiale të tjera për/përkatësisht mes profesorëve tanë të famshëm dhe shumë të merituar.

### **Bibliografi:**

Beci, B. (1985) : Sistemi fonologjik i gjuhës së sotme letrare dhe norma fonetike. Në: Studime filologjike 39 (22) 1, 93–110.

Bußmann, H. (1990): Lexikon der Sprachwissenschaft. Zweite, völlig neu bearbeitete Aufl. Unter Mithilfe und mit Beiträgen von Fachkolleginnen und -kollegen. Stuttgart.

Çabej, E. (1975a): Dr. Eqrem Çabej: Studime Gjuhësore. Vëll. 1–6. Prishtinë.

Çabej, E. (1975b): Dr. Eqrem Çabej: Studime Gjuhësore. Vëll. 5. Gjuhë–Folklor–Letërsi–Diskutime. Prishtinë, 5–360.

Çabej, E. (1957): *Maximilian Lambertz në shtatëdhjetepesëvjetorin e ditëlindjes* (M. L. Dans son 75<sup>ème</sup> anniversaire), Buletin për shkencat shoqërore II, 127–130. Marrë nga: Çabej, E. (1975b), 173–175.

Çabej, E. (1960): Maximilian Lambertz, Epika popullore e shqiptarëve (Die Volksepik der Albaner, botuar së pari gjermanisht), Compte rendu, Lingua Posnanniensis VIII, 288–292. Marrë nga: Çabej, E. (1975b), 186–189.

Çabej, E. (1962): Maximilian Lambertz. Në: Nëndori IX 9, 174–177. Marrë nga: Çabej, E. (1975b), 176–179.

Çabej, E. (1964): Maximilian Lambertz (1882–1963), Orbis XIII 1 326–336 = Studime filologjike I (1964) 211–216. Marrë nga: Çabej, E. (1975b), 180–185.

Gostentschnigg, K. (1999): Die Verflechtung von Wissenschaft und Politik am Beispiel der österreichisch–ungarischen Albanologie. Në: Südost–Forschungen 58, 221–245.

Gostentschnigg, K. (2018): Wissenschaft im Spannungsfeld von Politik und Militär. Die österreichisch–ungarische Albanologie 1867–1918. Wiesbaden.

Komisija letrare shqipe (1917): Parime e rregulla mbi orthografin e gjuhës shqipe të shkrueme. Shkodër.

Lambertz, M. (1949): Gjergj Fishta und das albanische Heldenepos Lahuta e Malcis 'Laute des Hochlandes'. Leipzig.

Lambertz, M. (1954): Lehrgang des Albanischen. Teil 1. Albanisch-deutsches Wörterbuch. Berlin.

Lambertz, M. (1955): Lehrgang des Albanischen. Teil 2. Albanische Chrestomathie. Berlin.

Lambertz, M. (1959): Lehrgang des Albanischen. Teil 3. Grammatik der albanischen Sprache. Halle.

Lewin, E./Nehring, G.-D. (2008): Kontributi albanologjik i filologëve dhe historianëve gjermanolindorë. Në: Hylli i Dritës 258 (3), 99-137.

Meibauer, J.: Pragmatik (2008). Eine Einführung. Zweite, verbesserte Aufl. Tübingen.

Nachtigall, R. (1917): Die Frage einer einheitlichen albanischen Schriftsprache. Graz.

Nehring, G.-D. (1999): Studien zur Neubegründung von Standardsprachen nach 1850 am Beispiel: Bosnien-Herzegowina und Albanien. Bd. 1. Berlin.

Nehring, G.-D. (2004): Zu Fragen der standardsprachlichen Einordnung des Schrifttums bulgarischer Aufklärer um 1800. Në: Lehmann, Volkmar: Normen, Namen und Tendenzen. Festschrift für Karl Gutschmidt zum 65. Geburtstag. Slavolinguistica 3. München, 515-524.

Steinmetz, K. (Hg.) (1965): Bedeutende Gelehrte in Leipzig. Bd 1. Leipzig.

Bardhyl Demiraj

## NORBERT JOKL-I NË LETËRKËMBIM ME EQREM ÇABEJN

Kontakti im i parë me emrin dhe personalitetin e Norbert Jokl-it daton në vitet e rinisë së parë, fillimisht me lexime të do shkrimeve përkujtimore që botoheshin atëbotë herë pas here e rast pas rasti në shtypin periodik shqiptar. Shkas bëheshin – siç edhe pritet këso rasash – vite jubilarë të lindjes dhe të mortit të Jokl-it (1877 – 1942) e shkas për to gjente gjithherë Eqrem Çabej si ish-nxënës i tij gjatë kohës së studimit në Vjenë (1929-1933). Që leksionet, seminarët, sikurse vetë prurjet e Jokl-it si studiues dhe njohës i patëmetë i shqipes dhe i kulturës shqiptare paskëshin ndikuar aq fuqishëm në formimin e tij shkencor-universitar, për këtë rrethanë shkruesi i këtyre radhëve erdhi e u ndërgjegjësuua më vonë dhe në vazhdimësi përgjatë viteve të studimit dhe të karrierës profesionale në fushat e albanologjisë historike dhe të filologjisë shqipe. Dhe është fakt që emri i Jokl-it rezultoi të jetë jo vetëm më i cituari në opusin e Çabejt; mes sish përkujtojnë plotësisht edhe fushat e kërkimit albanologjik: gramatikë historike-krahasuese (fonologji, fjalëformim e sintaksë), etimologji dhe etnolinguistikë, filologji e përgjithësisht kulturë e letrave shqip. Të dy ndajnë së bashku aparatën e nevojshëm shkencor dhe metodat në hulumtim e si mësuesi po ashtu edhe nxënësi i përkushtohen njëllëj dinamikës së zhvillimit të shqipes qoftë si gjuhë e gjallë europiane me një mozaik të pasur dialektor, ashtu edhe historisë së saj ballkanike (Balkansprachbund) sikurse asaj indoeuropiane (familja gjuhësore indoeuropiane), duke e vështuar atë njëherësh edhe si derivat i një realiteti gjuhësor të Ballkanit antik.

Parë nga perspektiva e historisë së zhvillimit të albanologjisë si

shkencë komplekse rajonale në hapësirën shqipfolëse, shpresojmë të mos gabojmë, në rast se përsiasim tash bashkëlidhjen *mësues ↔ adept*, të sendërtuar natyrshëm në marrëdhënien Jokl ↔ Çabej, si urën lidhëse që përcolli natyrshëm ndryshimin e paradigmës shkencore në studimet albanologjike në Shqipëri aty rreth gjysmës së dytë të viteve 30' të shekullit të kaluar, periudhë kjo që përkon po aq natyrshëm me kthimin në atdhe të Çabejt si edhe të shumë studentëve të tjerë shqiptarë në universitetet austriake të kohës.

Asgjëmangut, tematizimi i kësaj bashkëlidhjeje në kohën tonë – bash 80 vjet pas zhdukjes mizore të Jokl-it (maj 1942) e më shumë se 40 vjet pas largimit të Çabejt prej nesh (13 gusht 1980) – parakupton një shqyrtim më të thelluar të përmasave të saj në aspektin shoqëror-human, çka mundëson njëherësh të njohim më mirë ‘njeriun’, më saktë pamje deri sot të panjohura ose pak të njohura të natyrës dhe të karakterit të Jokl-it, deri edhe mënyrën se si i përjetoi Ai në trup e në shpirt vitet e përçudnimit antisemit. E këto tipare, sidomos ndër njerëz fjalëpakë, por mendje- e punëshumë, përshfaqen zakonisht rrallë dhe vetëm në komunikim mes miqsh që i besojnë gjithçka njëri-tjetrit, çka vjen me thënë, që në rastin tonë bashkëlidhja *mësues ↔ adept*, e sendërtuar në marrëdhënien Jokl ↔ Çabej të kishte arritur ndërkohë një pikë kulmore si miqësi e vërtetë dhe e pazgjidhshme mes sish.

Në rastin e Norbert Jokl-it, këto tipare të karakterit të tij e sidomos atë përjetim vuajtjesh shpirtërore ndaj dhunës naziste ne arrijmë t'i përfytyrojmë sado mjegullueshëm kur lexojmë korrespondencën e tij të njohur me ish-mësues dhe kolegë të ndryshëm të kohës, si p.sh. Paul Kretschmer, Carlo Tagliavini etj., të cilët i shteruan të gjitha mundësitë me shpëtuar ‘njeriun’, sikurse sosh me ish-nxënës, intelektualë e politikanë shqiptarë të të gjitha rrymave, që i vunë vetes si detyrë sa morale edhe patriotike të shpëtonin përpos ‘njeriut’ edhe ‘albanologun’ e madh. Këto përfytyrime, qoftë edhe si pjesë e së vërtetës, kushtëzohen deri diku me faktin se në shumësinë e rasteve lexojmë dhe njohim vetëm kumtin ose letërkëmbimin e njëanshëm të kolegëve gjithëfarësh dhe të miqve shqiptarë, ndërkohë që vetë Jokl-i hesht, domethënë që edhe në ato pak letra të shkruara prej tij ai kufizohet të shkruajë vetëm për mundësitë me u shpërngulur gjetkë e për të çuar gjetiu një jetë sado të thjeshtë, por

të paqme, të cilën s'arrinte ta perceptonte ndryshe larg bibliotekës dhe tavolinës së punës.

“Udhë e jetës së N. Jokl-it është e thjeshtë, siç ishte njeri i thjeshtë edhe ai vetë”, kumton nxënësi i dikurshëm Eqrem Çabej në fjalën e vet përkujtimore në “Colloquiumin Albanologjik në përkujtimin e Prof.-univ. dr. Norbert Jokl” (Innsbruck, më 28.9.-3.10.1972; f. 3). Andaj nuk bëjmë çudi që në hapësirën plot 21 faqe të asaj kumtese ngjërojmë gjithë-gjithë 13 rreshta që portretizojnë kursyeshëm për të parën e ndoshta të fundit herë karakterin e Norbert Jokl-it:

“E kam të pamundur të përshkruaj karakterin njerëzor të këtij dijetari. Me aq sa kam pasur nderin ta përjetoj nga afër si nxënës i tij prej një njohjeje – e madje mund të them miqësie – shumëvjeçare, Norbert Jokl-i ishte njeri i parimeve.[...], në marrëdhënie të përditshme me kolegë dhe nxënës gjithmonë dashamir, i gjindshëm dhe tejet korrekt. Në mënyrën e vet të jetesës ai përçohet prej atij parimi, të cilin e kishte bërë pjesë inventari [jetik] qysh në vitet e rinisë prej leximit të Kant-it dhe Bacon-it: *de nobis ipsis silemus*. [për veten tonë ne hesitim.] Në leksione përkujdeste me dëshirë zbatimin e metodës dialektike në pyetje-përgjigje... Në kritikën shkencore ai ndiqte kryesisht parimin: *Suaviter in modo, fortiter in re* [I butë në mënyrë, i fortë në thelb]”. (f. 19)

Sa i përket kësaj njohjeje deri miqësi shumëvjeçare, për të cilën Çabej ndihet i nderuar, këtë konstatim nuk e hasim më gjëkund në shkrimet e tij. Pas gjase edhe Çabej i mbetet besnik parimit: ‘*de nobis ipsis silemus*.’ E këtë rrethanë e rëndonte dikur edhe mosnjohja e një letërkëmbimi të mundshëm me Çabejn në trashëgiminë epistolare të Jokl-it që ruhet sot e gjithë ditën në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë (ÖNB).<sup>1</sup> Një rrethanë fatlume përjetojmë gjithsesi në arkivin e familjes Çabej (Tiranë), ku ky letërkëmbim është i pranishëm, edhe pse i njëanshëm, meqë në të ruhen vetëm letra të Jokl-it drejtuar Çabejt. Janë shi këto letra që i dhanë formë e shtat edhe realizimit të këtij shkrimi.<sup>2</sup>

---

1 Së paku nuk na kumton gjë njohësi më i plotë i saj, Lazar Dodić, që emrin e Çabejt e regjistron vetëm në ndonjë material në dorëshkrim, ku Jokl-i e falënderon shprehimisht për ndihmën e dhënë.

2 Falënderoj me këtë rast përzemërsisht vajzën e prof. Çabejt e kolegen e çmuar Brikena Çabej për ndihmën e pakursuer, duke më vënë në dispozicion materialin arkivor që i dha formë e kuptim këtij shkrimi.

Për arsye vendi do të përqendrohemi në vazhdim në do pasazhe që përcjellin dhunti të natyrës dhe karakterit njerëzor të Jokl-it, sikurse edhe gjendjen e tij shpirtërore nën trysinë e dhunimit të çdo të drejte humane, deri edhe episode të përjetimit të një miqësie shumëvjeçare, të skalitur në bashkëlidhjen *mësues ↔ nxënës/adept*.

Disponojmë ndërkohë gjithë-gjithë 6 letra të Jokl-it drejtuar Çabejt në një hapësirë kohore prej thujse 5 vitesh (30 mars 1937 – 27 shkurt 1942), që përkon pak a shumë me fazën e fundit të jetës së Jokl-it, bash kur iu nënshtrua përfundimisht përçudnimit nazist. Përjashtim bëjnë nga kjo fazë dy letra që datojnë vitin 1937, pra në një periudhë kur Austria nuk ishte bërë ende pjesë e Gjermanisë naziste. Ndër këto letra, 5 rezultojnë të dërguara prej Jokl-it me rrugë postare, përpos letrës së fundit, dhënë dorazi prej Carlo Tagliavini-t që ndodhej atë kohë në Vjenë. Siç pritej atëbotë, letrat hapeshin dhe kontrolloheshin prej organeve përkatëse: *Oberkommando der Wehrmacht*. Madje nuk kemi përse bëjmë çudi që Jokl-i si adresues ishte i detyruar sipas rastit të bënte të dallueshme origjinën e tij hebreje, duke i shtuar emrit llogarën 'Israel'.

Bashkëlidhja e letrave në përmbajtje me njëra-tjetrën na lejon të mëtojmë se së paku pesë të parat të kenë qenë edhe i gjithë numri i atyre të hartuara prej Jokl-it. Ndërmjet letrës së pestë dhe asaj të gjashtë mund të ketë ndonjë boshllëk që duhet hulumtuar më hollësisht. Numri i letrave, kartolinave dhe i kartave postare të dërguara nga Çabej duhet të ketë qenë shumë më i madh (pa rrokur këtu edhe dërgesat e materialeve të botuara prej njërit apo tjetrit autor), madje këto të fundit rezultojnë të jenë dërguar mote para vitit 1937, ndoshta menjëherë pas viteve 1933/34, kur Çabej doktoroi në Vjenë dhe u kthye për të punuar dhe jetuar në Shqipëri.

**Letra nr. 1: 30.03.1937**

[Përgjigje letrës dhe telegramit të Çabejt më dt. 21 dhe 24 mars 1937]

Këtë situatë mësojmë së paku në letrën e parë të Jokl-it, ku ai merr shkas prej një letre të mëparshme të Çabejt dhe një telegrami urimi me rastin e 60-vjetorit të lindjes së tij:

„Shumë i nderuar zoti Dr.!<sup>3</sup> | I dashur mik! | Prej kohësh, mund të them, prej vitesh kam dashur t’ju shkruaj me hollësi dhe faj është

---

3 Rasti i parë dhe i fundit që Jokl-i përdor këtë frazë në korrespondencën me Çabejn.

pikërisht ngarkesa ime e jashtëzakonshme [në punë], ajo çka nuk e përmbushi këtë detyrim. Pra jo se nuk kam menduar shpesh e më shpesh për ju; përkundrazi nuk kalonte e kalon thujtë asnjë ditë që unë nuk çoj mendjen te ju, dëgjuesi im më i dashur dhe mik i vyer. Ja që tash më vjen telegrami juaj i dt. 24 mars dhe letra juaj e ndjerë dhe dashamirë e dt. 21 mars. Do të ishte thujtë mëkat, po të doja të shtyja më tej letrën e hollësishme të planifikuar prej kohësh. Shpresoj të mos ma merrni për keq këtë heshtje të tejzgatur; shpresoj shumë për këtë, sepse besoj pikërisht që ju më njihni shumë mirë.“ (f. 1)

Në këtë letër Jokl-i skicon thukët me dorën e vet tipare të natyrës e të karakterit të tij njerëzor:

„Që ju në letrën tuaj përcillni tone ndjenjash, kjo më ka prekur shumë. Ju e dini që unë gjithnjë, në mos thujtë gjithmonë përçohem prej parimit, të cilin e kam përvetësuar si pjesë inventari [jetik] në rini, shi në një kohë kur në një farë mase merresha edhe me lexime filozofike prej Kant-it dhe Bacon-it: *De nobis ipsis silemus*. Veçse këso rasash, siç është 60-vjetori, njeriu detyrohet të mos i qëndrojë besnik një devize të tillë...“ (f. 1-2)

Në këtë letër Jokl shprehet ndër të tjera për angazhimin e dyfishtë që ndikon në njëfarë mase edhe në kërkimet e veta shkencore:

„...Ngarkesa e dyfishtë: si bibliotekar... dhe puna shkencore është [kockë] e fortë. Puna shkencore duhet t'u përmbahet detyrimisht caqeve të fiksuara si të tilla, meqë kapacitetet e punës nuk mund të rriten sipas rastit. Tani unë jam 60 vjeç; e ndërsa më parë nuk kishte kuptim, të gjykoja në këtë pikë për fatin tim, kjo gjë do të ishte tash shumë më pak e dobishme, meqë unë aty nga fundi i vitit 1938 e përmbush kohën e angazhimit tim si bibliotekar.“ (f. 2)

Ja që këto punë nuk erdhën e u kavërdisën më pas, bash ashtu siç parashikonte Jokl-i atëbotë, pas daljes së tij në pension. Përndryshe ai informon në këtë letër mikun e tij të dashur kryesisht me çështje të natyrës specifike shkencore, duke përcjellë natyrshëm edhe prirjet e tij ndaj detyrimeve në punën e mirëfilltë shkencore, si vijon:

“Ndërkohë jam i zënë kryesisht me punën mbi *Historinë e hulumtimit të Trakishtes, Frigishtes dhe Ilirishtes*, të cilat i kam marrë përsipër mbi [projektin] *Bazat e Gjuhësisë Indoeuropiane* në

vend të prof. Kretschmer (me dëshirën e tij urgjente). Meqë unë kisha për të trajtuar të njëjtën temë, edhe pse nga një tjetër perspektivë, për Eberts R[eal]-L[exikon], ndjehem ndonjëherë si bjerraditës. Për shkak të kësaj pune mbi historinë e kërkimit [shkencor] jam i privuar të përmbyll punë të tjera që i kam *gati* për shtyp, por që kanë thjesht nevojë të rihidhen në [letër] të pastër e të plotësohen me të dhënat e fundit.“ (letra nr. 1, f. 2-3)

Domethënës në këtë letër është edhe shënimi postscriptum mbi fotografinë e një viti më parë (1936) me rastin e pranimit të tij si anëtar i Akademisë Mbretërore të Shkencave në Kopenhagë, ndërkohë që në vetë fotografinë lexojmë në fund përkushtimin:

“Zotnís së Tij prof. dr. Eqrem Çabej për shëj miqësie edhe kujtimi. Dr. Norbert Jokl.»

**Letra nr. 2: më 29. dhjetor 1937**

[= Përgjigje letrës së Çabejt më dt. 23 dhjetor 1937]

Në këtë 3-faqe-letër Jokli i përcjell Çabejt përjetimet e paharrueshme që pati gjatë vizitës së tij të parë dhe të fundit në Shqipëri (Tiranë, fundi i nëntorit 1937) me rastin e festimeve të 25-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë e më pas të kthimit të tij drejt Vjenës (30.11.-3.12.1937), pasi kishte kishte vizituar ndërkohë edhe Tagliavini-n në shtëpinë e tij (Bologna), ku i kishte lënë mbresa të forta biblioteka e tij tejet e pasur. Në këtë letër përjetojmë edhe ndonjë çast humori – paçka se nuk ishte gjithmonë e vetëkuptueshme në natyrën e Jokl-it (!!!) –, sa i përket lodhjes që pati gjatë kësaj vizite dhe se ç’punë e priste në bibliotekë:

“Po të shkonin punët sipas dëshirave të mia, atëherë do t’ju kisha shkruar me kohë. Veçse pas kthimit në atdhe më priste një baticë e tillë pune, saqë m’u desh, edhe pse me keqardhje, të spostoja të gjithë korrespondencën... Në orën 4 pasdite vijova udhëtimin [nga Bologna] për në Vjenë, ku mbërrita të nesërmen më dt. 3 [dhjetor] në orën 8 të mëngjesit. Unë shkova në shtëpi, u ndërrova dhe u nisa menjëherë drejt e në bibliotekë. Pasdite mbajta leksionin tim dhe isha pastaj sigurisht i vdekur prej lodhjes.

Pasi në Vjenë, sidomos në Bibliotekë m’u desh të përballem me një mal punë, thashë se: *dardha ka bishtin mbrapa...*“

Jokl-i e mbyll letrën e tij të dytë me urimet e përzemërta për vitin 1938. Të njëjtat urime i kishte shkruar, pas gjase, më parë edhe



Çabej në letrën e tij më dt. 23.12.1937.

### Viti 1938

Që ky vit i gllabërimit të Austrisë në Rajhun e 3-të (mars 1938) Jokl-it sikurse – në rast se të dhënat përkojnë me realitetin – thujse gjysmës së personelit të Universitetit të Vjenës nuk u sollli fat fanmirë, me këtë rrethanë është mirënjohur prej kohësh bota shkencore albanologjike. Sa i përket korrespondencës në fjalë, vërejmë se ky vit dëshmon një boshllëk në letërkëmbim, pa qenë se arrijmë të identifikojmë ndonjë arsye të caktuar.

Gjithsesi, në rast se i përmbahemi angazhimit social të Çabejt në këtë kohë, vijmë natyrshëm në përfundimin, që ai mundi dhe diti të pikasë jo vetëm fatin e pafat që e priste Jokl-in në ato rrethana të rënduara që përjetonte atëbotë e gjithë Austria, por edhe të përsiaste atë detyrim qoftë edhe moral të botës shqiptare për t'i shpëtuar Jokl-it jetën, përkatësisht për t'i krijuar atij mundësitë me vijuar pa shqetësime të rastit kërkimet e tij në albanologji.

Prashtu, lejohemi të ndjekim Eqrem Çabejn *in personam* në shkrimin „Prof. Norbert Jokli“ në revistën e kryeqytetit „Përpyekja Shqiptare“, pikërisht në fletoren e saj të muajit prill (nr. 16, viti 1938), që vjen me thënë dy-tri javë pas asaj ngjarjeje, kur Çabej lëshon thirrjen e parë të alarmit, si vijon:

„...Pasojat e rrymës antisemitike – parim nga më kryesorët të Nationalsocializmit – që hyri, me realizimin e Anschluss-it [Bashkimit] edhe në Austri, u duknë qysh në mëngjezin e 12 marsit të kaluar, dit' e aneksimit të Austrisë Shtetit Gjerman. Një „halt“ [Ndal!] ju dha që n'atë çast aktivitetit ebrë. ...Si përfundim i të gjithave vjen vetiut spastrimi i jetës së ebrejeve në tokat austriake. Një është për ta udha e shpëtimit: shpërngulja...“

Prof. Jokli, si çdo tjetër ebrë i Austrisë, pas kaqë kohësh shërbimi të vlefshëm në degën e tij, ikën nga Austria. Eshtë tani një irrident që as ai vetë nuk di të vendosë për ku po e merr drejtimin...

Gjëjmë rast për të shfaqur edhe né një lutje t'onën që është pa dyshim ajo e gjithë intelektualëve të vëndit. Në një kohë kur jemi duke bërë hapat e dhura – siç e kemi relatuar edhe herë tjetër – për ngrehjen e një Instituti Albanologjik në Tiranë, na duket e arësyeshme e shumë me vënd se thirrja e prof. Joklit për t'a vendosur në krye të këtij instituti do të ishte një vepër nga ato që s'mbeten pa

lënë gjurmë në fushën e përpjekjes kombëtare... Për neve një vepër e tillë nuk do të ish vetëm një hap drejt realizimit për çka duam të bëjmë, por do të quhesh – me plot të drejtë – edhe një shënjë e shquar respekti e shqipëtarëve të lirë kundrejt atit të Albanologjisë, atij që i ka konsakruar pjesën më të madhe të jetës së vetë kësajë diturije....“

Kjo thirrje e parë e Çabejt u shoqërua më pas – deri ditën e arrestimit të Jokl-it më 3/4 mars 1942 – me përpjekje të vazhdueshme prej të gjitha rretheve intelektuale shqiptare qoftë në Shqipëri, qoftë në diasporë, sidomos në SHBA. Përrjetojmë këtë kohë dhe vitet në vazhdim (deri në fund të shkurtit 1942) një lloj gare në jetën sociale-itelektuale shqiptare, se si dhe kush mund t'i shpëtonte jetën Jokl-it, duke i përmbushur atij të gjitha kushtet me vijuar punën e tij shkencore. Kemi të bëjmë pa ekzagjeruar aspak me një unikat *në historinë e kulturës shqiptare, se si ish-nxënës të tij, studentë shqiptarë në Austri e gjetkë, intelektualë, klerikë, qeveritarë dhe ente ministeriale të rrymave ndër më të ndryshmet, politike-ideologjike dhe kulturore-fetare, deri edhe fashistë të deklaruar u bënë njësh me synimin për të shpëtuar njëherësh “njeriun” dhe “studiuësin albanolog” prej përndjekjes naziste: gjithshka rezultoi e pamundur!*<sup>4</sup>

Meqë këto përpjekje janë dokumentuar ndërkohë shterueshëm në historinë e kulturës shqiptare, le të vijojmë me letërkëmbimin tonë për vitet në vazhdim.

Se si e priti Jokl-i pushimin e tij nga puna pak para daljes në pension e çfarë traume përjetoj bibliotekari ynë, kur iu mohua e drejta për të shfrytëzuar shi bibliotekën e universitetit<sup>5</sup>, këto rrethana i mësojmë sado kalimthi në letrën e tretë që datohet më 19 janar 1939.

### **Letra nr. 3: 19 janar 1939**

[= Përgjigje ndaj letrës së Çabejt të dt. 8 janar 1939]

Krahas urimeve për Vitin e Ri 1939 dhe shkëmbimit të kurdo gjendshëm të mendimeve dhe botimeve shkencore vërejmë në këtë letër një keqësim të dukshëm të gjendjes shpirtërore të Jokl-it. Kështu, ai shkruan ndër të tjera:

“Sa i përket asaj çështjeje që ju përmendni në letrën tuaj, ju mund ta mendoni, se kjo gjë më preokupon seriozisht prej kohësh. Në punë shkencore këta dy muajt e fundit nuk kam mundur të punoj

shumë, për shumë arsye. Deri në kohën e përmendur gjithçka ishte ndryshe...”

Jokl-i përgjigjet në këtë letër edhe lidhur me mundësitë e punësimit në Shqipëri, të cilat i vinin pas gjase nga shumë drejtime:

“Lidhur me çështjen në fjalë unë për fat të keq nuk jam shumë i qartë. Prej planit zanafillës (Institut) duket që të jenë përfutur ndërkohë kushtet e nevojshme. [Veçse] së paku në fund të dhjetorit [1938] erdhi një propozim krejt tjetër (anëtar i Komisionit Tek[nik]). Në përgjigjen time – gjithsesi pa dorëzani – ndaj propozimit të parë, unë ju kisha përmendur edhe juve. Përgjigja e dhjetorit heshte për këtë, si edhe për të gjithë propozimin e parë, i cili ishte bërë spontanisht prej posteve kompetente. Kështu që përkohësisht gjithçka mbetet e paqendrueshme.” (f. 1)

#### **Letra nr. 4: 17 prill 1940**

[Përgjigje ndaj letrës së Çabejt më dt. 10 janar 1940]

Krahas ngushëllimit të thellë dhe fjalëve të ngrohta mbi vdekjen e të atit të Çabejt, përballemi në këtë letër me momente emocionuese lidhur me vuajtjet shpirtërore që përjeton ndërkohë Jokl-i, duke vlerësuar njëherësh edhe marrëdhënien miqësore me nxënësin tij:

“Së fundi edhe do lajme mbi gjendjen time. Që unë rrekem sa mundem të vijoj punët e mia, për këtë nuk kam nevojë të të shkruaj; një jetë pa punë kërkimore do të ishte për mua e padurueshme. Veçse ju mund ta mendoni, që kushtet aktuale me vijuar punët e mia nuk janë të përshtatshme. Andaj ju falenderoj me gjithë zemër ju, mik i dashur, dhe gjithë ata zotërinj, bash Shkëlqesinë Dr. [Ernest] Koliqin, dhe prof. A[leksandër] Xhuvanin, të cilët përpiqen njëlloj si ju të më krijojnë kushte pune të përshtatshme dhe shpërnguljen në vend[in tuaj]. Me gjithë pasigurinë ndrydhëse dhe gjymtuese të të gjitha kushteve të mia të punës unë nuk dua asesi të humbas durimin. Për mua ishte një kënaqësi e madhe të mësoja [prej jush], që vitet tuaja të studimit në Vjenë kanë lënë mbresa përzemërsie dhe miqësie ndaj meje. Kujtimet e mia i përcjellin shpesh e me kënaqësi ato vite bashkëpunimi me ju lidhur me bisedat e shumta e nxitëse për çështje të gjuhësisë dhe të historisë shqiptare, të cilat bënin të fluturonin orët. Letra juaj nxit të shfaqen po aq gjalla këto kujtime.” (f. 2-3)

## Letra 5: 22 shkurt 1941

[Përgjigje ndaj letrës së Çabejt më dt. 8 dhjetor 1940]

Letra e radhës adresohet në banesën e Çabejt në Romë, ku ndodhej ndërkohë si bashkëpunëtor shkencor në projektin *Atlasi dialektologjik i shqipës*, me detyrën për të zhvilluar kërkimet në terren tek arbëreshët në Italinë e Jugut dhe në Sicili.

Kjo letër lë të kuptohet qartë, që gjendja e rënduar shpirtërore e Jokl-it ka arritur një pikë kulmore:

“Në rast se përgjigjem tash, kjo ka të bëjë me faktin që unë gjithë kohës e sidomos javët e fundit përjetoj trysninë e problemeve ndër më të vështirat, të cilat nuk i kam njohur më parë. Një gjendje e tillë paralizon çdo lloj fuqie vendimmarrëse.”(letra 5: f. 1)

Gjithsesi në këtë letër nuk mungojnë kumte fatlume lidhur me suksesin e parashikueshëm të nxënësit dhe mikut të tij në karrierën e vet si historian albanolog, çka e gëzon tej mase Jokl-in në rolin e mësuesit të dikurshëm:

“Veçse kjo nuk do të thotë aspak, që mua lajmet tuaja nuk më bëjnë përshtypje dhe u qëndroj me mospërfillje. Gjithçka që ju më kumtoni lidhur me angazhimet dhe planet e reja, zgjoi tek unë, me gjithë hallet e mia të rënda vetiake, gëzimin më të ndjerë. Dorëzania me hulumtime albanologjike për atlasin gjuhësor është detyra shkencore më tërheqëse, më e rëndësishme dhe më frutdhënëse për zhvillimin tuaj, një detyrim, i cili as mund t’i përcillej më bukur një albanologu të ri në përgjithësi. Që kjo detyrë ju besua pikërisht juve, mikut tim të dashur, një adepti të shkollës vjeneze, në formimin e të cilit, kam edhe unë pjesën time, kjo është pikërisht ajo çka e lehtëson sadopak atë hidhësi të tejmase, që përjeton ndërkohë fati im.”(letra 5, f. 1)

Veçse me këtë fat të pafat Jokl-i nuk pajtohet assesi, andaj vazhdon:

“Sa fatlum do të isha unë, sikur të mund të vlerësoja rezultatit e hulumtimeve tuaja leksikore, dialektore dhe etnografike edhe për fjalorin etimologjik. Veçse a do të ma lejojë ky fat përpunimin dhe përfundimin e kësaj vepre, për të cilën unë, siç e dini mirë, kam mbledhur prej dekadash aq shumë material dhe kam realizuar punë paraprake (në fund të fundit thuajse të gjitha punët e mia janë parpërgatitje për këtë libër)? Nuk e di, veçse dua të përpiqem edhe

njëherë t'u bëj ballë pa u thyer të gjitha vështirësive..." (letra 5, f. 1)

Asgjëmangut fraza „t'u bëj ballë“ për Jokl-in do të thotë: Puna kërkimore vazhdon në çdo rrethanë!, si vijon:

“Sado e vështirë që është [bërë] jeta ime, unë kam punuar megjithatë përgjatë gjithë dimrit, vetëm kohët e fundit nuk kam mundur të vijoj aspak këtë punë. Bëhet fjalë për një kontribut mbi shpjegimin e emrave të pjesëve të trupit dhe për dukuri gjuhësore gjegjëse, një trajtim ky, për të cilin kam përpunuar deri tani një sasi prej 40 faqesh në makinë shkrimi; mungon ende aty te një e treta, kështu që - parakupto që do ta kem atë fat ta përmbyll këtë punë - do të rezultojë prej saj një monografi më e gjërë me rreth 60 faqe. Unë besoj se kam mundur të ofroj një aradhë rezultuatesh dhe shpjegimesh të reja, të cilat në fakt edhe për fjalëformimin janë të rëndësishme për t'u njohur.“ (letra 5, f. 1-2)

Jokli shprehet gjithashtu në këtë letër se nuk e ka humbur shpresën, që shqiptarët sikurse edhe kolegët e tij italianë (Tagliavini, etj.) po shfrytëzojnë të gjitha mundësitë me i siguruar atij një vend të sigurtë në Shqipëri ose në Itali. Andaj ai lutet ndoshta për të fundit herë për mbështetje të mëtejshme edhe prej nxënësit të tij:

“Prashtu po kaloj në problemet e mia. Prof. Tagliavigni. Më shkroi më dt. 18 shtator 1940, që si ai ashtu edhe shkëlqesia dr. Koliqi po përpiqen dhe do të përpiqen më tej në entet [zyrtare] përkatëse në Romë dhe Tiranë, në mënyrë që mua të më lejohet qëndrimi në Shqipëri; ai shkroi më tej se Konti C[iano] është shprehur parimisht dakort. A nuk mund ta nxisni ju lutem këtë çështje. Në rast se Shqipëria vjen tash në shqyrtim, unë do të isha i kënaqur me një qëndrim të përkohshëm në Itali. Edhe Àt Fishta, i cili për keqardhjen time e ka bekuar jetën [= kohën], ishte i angazhuar për një leje qëndrimi të kësaj natyre për mua<sup>6</sup>. A mund të hyni ju p.sh. në koordinim me Prof. Bartoli-n dhe Prof. Tagliavini? Ose eventualisht të ndërhyni, nëmos të nxisni ndërhyrjen pranë Sekretarisë së Shtetit për Shqipërinë? Unë nuk do të guxoj të drejtohesha juve me këtë lutje, në rast se Prof. Tagliavini në letrën e përmendur më lart nuk do të vinte në pah, që sipas informacioneve të tij autoriteti përkatës do të ndërmerre për mua të gjitha lehtësimet e mundshme. Veçse ndihma *urgjente* bëhet kur të zë halli; bëhet fjalë për bazat e gjithë

<sup>6</sup> Vdekur më dt. 30.12.1940.

ekzistencës sime, edhe për ato të miat shpirtërore; dhe besoj të kem qëmtuar prej nëntonit [= ndërmjet rreshtave] të letrës suaj të dt. 8 dhjetor, se edhe ju dini ta ndjeni këtë.“ (letra 5, f. 1)

Respekt e mbresë të veçantë mirënjohjeje meriton në këtë letër paragrafi përmbyllës, kur Jokl-i përshkruan edhe një përjetim fatlum prej nxënësit të vet:

„Ju falënderoj me gjithë zemër për dërgesën e librit të Kutelit. Në të njëjtën kohë me ekzemplar in tuaj u erdhi edhe një ekzemplar i dërguar prej Gerold-it, përkatësisht Lumo Skëndos. Një ekzemplar unë ia kalova mikes sonë, znj. Prof. dr. Wahrmann, për çka besoj, se edhe ju, siç mendoj, do të jeni dakort. Znj. Prof. dr. Wahrmann ju bën të fala të përzemërta; ne kemi lexuar shpesh së bashku tekste shqip, sa kohë që për mua ishte ende e mundur, duke pasur kështu një lloj ditë diskutimesh albanologjike.“ (letra 5, f. 2)

#### **Letra 6: 27 shkurt 1942**

Letra e gjashtë dhe e fundit e Jokl-it daton më 27 shkurt 1942. Atë do t'ia dorëzojë Çabejt dorazi Carlo Tagliavini, i cili ndodhej ndërkohë për vizitë në Vjenë. Kjo letër të lë fillimisht përshtypjen, se kemi të bëjmë ndoshta me një ndërprerje të letërkëmbimit përgjatë vitit 1941 e fillimit të vitit 1942. Me siguri mund të shtojmë këtu se kemi në rastin konkret një letër shoqëruese për dy separate punimesh të Jokl-it, të cilat do t'i dorëzonte gjithashtu Tagliavini:

“Mik i dashur!

Unë po shfrytëzoj praninë e prof. Tagliavini-t në Vjenë, për t'ju mundësuar dy separate („E folmja e Borgo Erizzo-s në Dalmaci“ dhe raportin e letërsisë albanologjike në Indogerm[anisches]. Jahrb[uch], bl. XXIV). Punën e pritur fillimisht jua dërgova ndërkohë në gusht 1940, d.m.th. pas botimit e nëpërmjet z. Konsull Rrota.

Për fat të keq ky ekzemplar nuk ju ka rënë në dorë, ndërsa për ekzemplarët e tjerë – unë dërgova atëbotë 20 copë – të adresuarit pjesërisht më kanë miratuar mbërritjen e dërgesës. Me shkas të [pranisë së] prof. Tagliavini-t po ju dërgoj ekzemplar in e dytë.

Shumë, shumë falemnderit për të gjitha letrat tuaja dhe për kutinë shumë praktike që sollti me vete prof. Tagliavini. Letrën time të fundit ndoshta do ta keni marrë. Gjithçka tjetër do t'ju tregojë prof. Tagliavini.

Me përshëndetje të përzemërta

I huaji tejet i devotshëm

Norbert Jokl

*Me urgjencë.*“

Mbi gjendjen e Jokl-it ato çaste e nëse Çabej do të mund të ndërmernte diçka për të, kjo lë vetëm të kuptohet në fjalinë e fundit para përshëndetjes ndarëse: „Gjithçka tjetër do t’ju tregojë prof. Tagliavini.“ e ndoshta edhe fraza më e fundit e nënvizuar: „*Me urgjencë*“.

### **Përfundim**

4/5 ditë më pas, më 3/4. März 1942, Norbert Jokl-i u arrestua në banesën e tij në Vjenë (VII Neustiftgasse 67-69) duke u dërguar fillimisht në kampin e grumbullimit në Wien-Leopoldstadt, Castellezgasse 35, për t’u transportuar më vonë në kampin e shfarosjes në Maly Trostinez pranë Minsk-ut. Ai nuk arriti ta shohë më banesën e vet me dhomën e punës dhe fondin e pasur albanologjik që kishte mbledhur prej thujse katër dhjetëvjeçarësh.

Pas 30 vjetësh, miku i tij i dashur dhe nxënësi besnik Eqrem Çabej përshkruan me afërsi zhdukjen e tij mizore:

“Unë nuk i njoh në detaj rrethanat e Golgatha-s së tij; ato ndoshta do të mbeten edhe në të ardhmen të panjohura dhe është po ashtu e vështirë të përsiatësh, atë çka ai mund të ketë vuajtur nën trysninë e rëndë shpirtërore para fundit të vet. Këtu sendërtohen rishtas fjalët e Martial-it: *Ille dolet vere qui sine teste dolet*. [Vuan vertet ai që vuan pa dëshmitarë]” (Çabej [Innsbruck, am 28.9.1972] 1974, S. 4 f.)

Valbona TOSKA

## **ROLI I EQREM ÇABEJIT NË ZHVILLIMIN E GJUHËSISË SHQIPTARE NË MAQEDONINË E VERIUT**

Gjuhësia shqiptare nuk mund të imagjinohet pa emrin Eqrem Çabej. Eqrem Çabej është sinonim i shkencave albanologjike dhe një nga përfaqësuesit më të denjë të tyre. Shkencëtarët eminentë të kalibrit të tij, si Aleks Buda, Mahir Domi, Dhimitër Shuteriqi, Aleksandë Xhuvani, Shaban Demiraj, Selman Riza, Idriz Ajeti e të tjerë, me veprat e tyre bënë që epiqendra e studimeve albanologjike të vendoset atje ku duhet – në botën shqiptare. Dhe kjo pa dyshim është një meritë e një rëndësie jo vetëm shkencore, por edhe kombëtare. Të flitet për meritat shkencore të akademikut Eqrem Çabej, para së gjithash është një përgjegjësi, pasi kjo nënkupton të shqyrtohen teza dhe argumente që kanë të bëjnë me çështjet më të rëndësishme të identitetit tonë: autoktoninë, origjinën dhe vazhdimësinë.

Veprimtaria shumëdimensionale e akademik Eqrem Çabejit, karakteristikë e së cilës janë njohuritë e thella teorike dhe saktësia shkencore, është dëshmia më e mirë e kompetencës së tij në fushat e ndryshme të albanologjisë. Akademiku Shaban Demiraj në monografinë *Eqrem Çabej* (1990) pasqyron përmasat e veprës së tij duke i shtjelluar, siç thotë Ismail Kadare në parathënien e këtij libri, të gjitha fushat ku punoi, u lodh dhe triumfoi Eqrem Çabej: studimet diakronike, studimet për prejardhjen e gjuhës shqipe, hedhja poshtë e pseudoargumenteve..., studimet në fushë të fonetikës dhe gramatikës historike, të dialektologjisë, sidomos të së folmes së arbëreshëve..., studimet për marrëdhëniet e shqipes me gjuhë të tjera,



huazimet e ndërsjella, tezat për restriksionin dhe jo ekspansionin e elementit shqiptar në Gadishull, studimi monumental për Gjon Buzukun, hulumtimet për Pjetër Budin, për pastërtinë e gjuhës, për drejtshkrimin, studimet në fushë të etimologjisë, referatetet e kumtesat në kongreset e simpoziumet ndërkombëtare, studimet në fushë të folklorit, në fushë të gjenezës së letërsisë shqipe, të disa miteve të veçanta e të disa personaliteteve të shquara të saj e të botës, si Noli, Poradeci, Jokli, Kreçmeri etj. (Demiraj : 6).

Ky opus i veprës së Çabejt, ashtu si në gjuhësinë shqiptare në përgjithësi, ka pasur ndikim të madh edhe në formimin e mendimit shkencor të gjuhëtarëve shqiptarë të Maqedonisë së Veriut. Përveç kësaj prof. Eqrem Çabej ka dhënë edhe një kontribut të drejtpërdrejtë në orientimin e veprimtarisë shkencore të gjuhëtarëve shqiptarë të këtij vendi.

### **Konteksti i pranisë**

Kur flasim për gjuhësinë shqiptare të Maqedonisë së Veriut, duhet të kemi parasysh kontekstin e zhvillimit të saj, domethënë cilat ishin kushtet arsimore, sociale e politike të shqiptarëve në ish Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore. Siç dihet, pas Luftës u njohën po ato kufij të Shqipërisë, që kishin mbetur nga Marrëveshja e Versajës, ashtu që shqiptarët, *që më parë kishin jetuar në Mbretërinë e Jugosllavisë*, vijuan të jetojnë *në Jugosllavinë federale*, me ç'rast Kosova kishte status të krahinës autonome, ndërsa shqiptarët e tjerë mbetën *në Republikën Popullore të Maqedonisë*, në Serbi (Lugina e Preshevës) dhe një pjesë në Mal të Zi. *Në Mbretërinë e Jugosllavisë* nuk kishte arsim në gjuhën shqipe. Në Maqedoni shkollat fillore e të mesme shqipe u hapën në vitin 1941, kurse arsimit i lartë fillon akoma më vonë. Me vendim të Qeverisë së Republikës Popullore të Maqedonisë në vitin 1947 themelohet Shkolla e Lartë Pedagogjike, *në të cilën në vitin 1952 fillojnë studimet e grupit të gjuhës shqipe*. Ndërkaq, në vitin 1951 në kuadër të Katedrës së atëhershme të Gjuhëve Sllave të Jugut dhe të Gjuhëve Ballkanike me Seminar të Gjuhës Maqedonase u hap Lektorati i Gjuhës Shqipe (studime në dy semestra), i cili pas tetë vjetësh, në vitin shkollor 1959/60 u zgjerua në Seminar të Gjuhës Shqipe me studime katër semestrale, kurse në vitin shkollor 1967/68 studimet u zgjeruan në gjashtë semestra.

Nga viti shkollor 1971/72 studimet u shtrinë në tetë semestra dhe seminari mori statusin e Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe. Ndonëse katedra e gjuhës shqipe në Beograd kishte funksionuar që nga viti 1925, ishin të paktë ata shqiptarë që kishin studiuar në Beograd. Në kushte të këtilla, shqiptarët në Maqedoninë e Veriut shumë vonë do ta kapin hapin e arsimit masiv, e aq më vonë do të futen në rrjedhat shkencore albanologjike.

Duke qenë një hapësirë e përbashkët kulturore, shqiptarët e Maqedonisë kanë qenë të lidhur pandashëm me shqiptarët e Kosovës, veçanërisht intelektualët. Prandaj, për shqiptarët e Maqedonisë një ngjarje shumë të rëndësishme arsimore e shkencore paraqet hapja e Universitetit të Prishtinës më 1970, universitet që u bë strumbullar i botës intelektuale për të gjithë shqiptarët në federatën jugosllave. Në atë kohë komunikimi mes kësaj bote që ndodhej nga ana tjetër e kufirit dhe botës intelektuale brenda kufijve të shtetit shqiptar ishte shumë i kufizuar, për të mos thënë se nuk ekzistonte fare. Pas prishjes së marrëdhënieve ndërshtetërore mes Shqipërisë e Jugosllavisë më 1948, komunikimi mes shqiptarëve të të dyja shteteve ishte shndërruar në një dëshirë që shumë herë as që mund të shprehej. Por, zbutja e raporteve që ndodhi në fillim të viteve 70 të shekullit të kaluar, mundësoi që një plejadë profesorësh, shkencëtarësh e krijuesish të fushave të ndryshme nga Shqipëria të vijnë në Prishtinë e në disa raste edhe në Shkup. Ardhja e personaliteteve me autoritet siç janë Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Jani Thomai, Jorgo Bulo, Xhevat Lloshi, Nasho Jorgaqi, Sterjo Spasse e të tjerë, që më shumë se një shkëmbim i stafit akademik për biseda, ligjërata, cikle leksionesh apo shkëmbim përvojash pedagogjike.

Ardhja e profesorëve të shquar në një mënyrë simbolizonte ardhjen e frymës njësuere të kombit. Pikërisht në këtë periudhë u morën vendimet për gjuhën standarde shqipe. Dhe, derisa në Kosovë edhe para ardhjes së prof. Çabejit, gjuha standarde kishte marrë udhën e vet në trajtën „një komb – një gjuhë” dhe derisa shqiptarët e Maqedonisë e kishin ndjekur po këtë vijë, vetë ardhja e Çabejit shënonte një ngjarje të rëndësishme shkencore për albanologjinë. *Ligjëratat e tij ndiqeshin jo vetëm nga studentët e degës së gjuhës shqipe, por edhe nga profesorë, madje ato regjistroheshin në audio dhe disa sosh janë shndërruar edhe në botime.*

## **Dy dimensionet e orientimit të gjuhësisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut**

*Në një nga këto ardhje në trojet e ish Jugosllavisë, prof. Çabej më 18 maj të vitit 1971 në Shkup ka vizituar Katedrën e Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe, pranë Universitetit „Kirili dhe Metodi” dhe në ambientet e atëhershme të fakultetit, në gjuhën frënge ka mbajtur një ligjëratë lidhur me kontaktet gjuhësore. Akademik Bllazhe Koneski, themeluesi i gjuhësisë maqedonase, në atë kohë edhe kryetar i Akademisë së Shkencave, para auditorit të pranishëm ka prezantuar profilin shkencor të prof. Çabejit duke shprehur konsideratat dhe vlerësimet më të larta për eruditin e shkolluar për gjuhësi indoeuropiane në Vjenë. Vetë prezenca e prof. Çabejit në Shkup ishte mbështetje për punën arsimore që bënte Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe dhe për veprimtarinë e studiuesve të gjuhës. Të qenët aty e figurës më të rëndësishme të gjuhësisë shqiptare, që kontribuoi drejtpërsëdrejti në kodifikimin e drejtshkrimit dhe në konsolidimin e gjuhës standarde duke marrë pjesë aktive në të gjitha komisionet për hartimin e udhëzimeve drejtshkrimore (në 1948, 1951, 1954, 1956, 1967 e 1973), jepte edhe inkurajim për përkrahje të gjuhës së përbashkët standarde. Ndonëse Maqedonia ishte republikë më vete dhe politikat gjuhësore i hartonte vetë, gjuhëtarët e saj shqiptarë, njësoj si gjuhëtarët nga Kosova, nuk kishin asnjë hezitim në përzgjedhjen e varietetit gjuhësor. Madje, gazeta „Flaka e vëllazërimit” kishte filluar ta përdorte gjuhën që sot quhet standarde, edhe para mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit në vitin 1972.*

Prof. Berton Sulejmani (ligjërues në Universitetin e Tetovës) ka bërë një hulumtim në bibliografinë e revistës “Jehona” që dilte nga edicionet e „Flakës së vëllazërimit” dhe ka gjetur se aty janë botuar gjithsej pesë artikuj të prof. Eqrem Çabej: „Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe” (1972, viti XI, nr. VII); „Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes” (1972, viti X, nr. IX); “Elementet latine të gjuhës shqipe” (1974, viti XII, nr. IV); „Ilirishtja dhe shqipja” (1980, viti XVIII, nr. VII), ndërsa shkrimi i katërt, që është botuar pas vitit 1990 - „Romantizmi në Europën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare” (1995, viti XXXIII, nr. IV), në fakt paraqet pjesën e tretë të një studimi

të shkruar më 1945 e *që ka* parë dritën për here të parë në veprën: Eqrem Çabej: „Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes” që u botua në vitin 1994 në Tiranë. Përmbajtjen dhe rëndësinë e këtyre artikujve prof. Sulejmani e analizon në kumtesën e tij me titull „Kumtesat shkencore të Prof. Eqrem Çabejit, të botuara në revistën “Jehona” të Shkupit”, të prezantuar në këtë Konferencë.

Artikulli mbi çështjet e traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes që u botua në këtë revistë *në kohën e mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit, kishte rëndësi të madhe për* kuptimin e drejtë të çështjes së standardizimit të gjuhës shqipe mes shqiptarëve të Maqedonisë, kurse artikulli mbi rolin dhënës të shqipes shërbeu si kornizë për studimin e interferencës gjuhësore të shqipes me gjuhët sllave, në radhë të parë me maqedonishten.

Prania e prof. Çabejt në revistën „Jehona” me këta artikuj, por edhe në revistat shkencore të Kosovës (në vitin 1980-të në Prishtinë u botua edhe kompleti i veprave të tij), ishte një lloj shtylle, në të cilën do të mbështetej e zhvillohej më tej gjuhësia shqiptare në Maqedoni.

Derisa dimensionin e parë i rolit të prof. Eqrem Çabejit në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare në Maqedoninë e Veriut kryesisht ka të bëjë me gjuhën standarde dhe rolin dhënës të shqipes, dimensionin e dytë i këtij roli i referohet këshillës ose inkurajimit të tij që gjuhësia shqiptare në Maqedoni të orientohej në vjeljen dhe studimin e të folmeve shqipe në këto treva. Dhe kjo do të bëhej për dy arsye themelore: së pari ashtu vizatohej harta gjuhësore e shqiptarëve të këtij areali dhe, së dyti, kështu do të bëhej një punë që nuk mund të përmbushej nga gjuhëtarët e tjerë, qofshin ata të Kosovës apo të Shqipërisë.

Siç e dimë tashmë, në vitet 70 të shekullit të kaluar nuk ishte bërë gati asgjë në studimin e të folmeve shqipe në Maqedoni dhe ato ishin gati krejt të panjohura për publikun shkencor albanologjik jashtë Maqedonisë. Përveç faktit se pothuaj shumica absolute ishin të folme geqe, të gegërishtes qendrore, mungonte çfarëdo studimi mbi to, si edhe leksiku dialektor, që paraqet një pasuri të madhe për secilën gjuhë. Madje, duke pasur parasysh këtë fakt, në një bisedë rreth mbledhjes së materialit gjuhësor që është zhvilluar me prof. Remzi Nesimin, gjuhëtar nga Maqedonia e Veriut, prof. Çabeji është

shprehur: «Ashti të merret me gjithë mish, do të thotë fjalët e të folmeve të mblidhen bashkë me shprehjet frazeologjike.» (Nesimi: 121).

Duke besuar shumë se gjuhëtarët shqiptarë të Maqedonisë nuk lëkundeshin nga gjuha standarde dhe se nuk kishte rrezik për divergjenca gjuhësore, kërkesa e tij që këta gjuhëtarë dhe ata që do të vinin më vonë të orientoheshin në studimin e të folmeve shqipe të Maqedonisë, do të jetë një *lajtmotiv* i gjuhësisë shqiptare deri në ndërrimin e shekujve. Si rezultat i këtij përkushtimi, me përjashtime të vogla, sot gjuhëtarët shqiptarë në Maqedoni e kanë përmbushur këtë detyrim, duke realizuar studime monografike mbi të folmet shqipe në këtë areal gjuhësor. Këto studime, ndërkohë, janë botuar dhe kanë qarkulluar në opinionin albanologjik, ndërsa së fundi Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup i ka përmbledhur në një seri të veçantë me titull „Dialektologjia shqiptare – Të folmet shqipe të Maqedonisë së Veriut”, ku, me një redaktim të prof. Qemal Muratit, janë përfshirë studimet që janë realizuar deri më tani për të gjitha të folmet shqipe në Maqedoni, që nga Struga e deri në Kumanovë. Në këto studime, përveç shqyrtimit fonologjik dhe gramatikor të të folmeve përkatëse, është prezantuar edhe materiali dialektor përmes teksteve dialektore. Në shumicën prej tyre kemi edhe fjalorth të së folmeve përkatëse, diku kemi edhe material onomastik, kështu që, marrë në përgjithësi, ky detyrim është përmbushur, mund të themi me sukses. Në këtë mënyrë është mbuluar me studime gjuhësore gjithë harta gjuhësore shqiptare në Maqedoninë e Veriut dhe kështu, kemi edhe një kontribut të vlefshëm dhe të rëndësishëm për mbarë gjuhësinë shqiptare, sepse këto studime kanë plotësuar arealin lindor shqiptar.

Dhe, gjithë kjo punë, përveç meritë e secilit studiues dhe mentor (udhëheqës shkencor) përkatës të studimeve të tilla monografike (shumica e të cilave janë disertacione shkencore), është meritë edhe e ideatorit e nismëtarit të orientimit të gjuhësisë shqiptare në këtë drejtim, pra meritë e prof. Eqrem Çabejit. Mbase për shkak të këtij orientimi, studimet dialektore shqiptare në Maqedoninë e Veriut prijnë jo vetëm në kuadër të gjuhësisë shqiptare në këtë vend, por edhe më gjerë. Madje, ato u prijnë edhe studimeve të historisë së shqiptarëve në këtë shtet, por edhe studimeve të tjera të kulturës,

artit, folklorit etj.

**Literatura e shfrytëzuar:**

Çabej, **Eqrem**: *Studime gjuhësore I-VIII*, Rilindja, Prishtinë, 1986.

Çabej, Eqrem: *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes*, rev. Jehona, viti X, nr. IX, f. 3-16, Shkup, 1972.

**Demiraj, Shaban**: *Eqrem Çabej – Një jetë kushtuar shkencës*, 8 NËNTORI, Tiranë, 1990.

**Remzi Nesimi**, *Çështje gjuhësore*, SHKUPI, Shkup, 1997.

Shezai Rrokaj

## **METODA KËRKIMORE NË STUDIMET GJUHËSORE TË EQREM ÇABEJT**

Eqrem Çabej, njëri prej emrave më të shquar të gjuhësisë shqiptare të shekullit të XX, është pa dyshim një monument kulture me një vend të veçantë në panteonin e saj, të cilit i përulemi sot me respekt e nderim. Shumëkush do t'ia kishte zili veprën e larmishme në fushë të etimologjisë, të fonetikës e të gramatikës historike, të dialektologjisë historike, të studimit të Autorëve të Vjetër, të shqipes së sotme standarde e të raportit të saj me dialektet e deri tek studimi i letërsisë e folklorit.

Duke e vështruar gjuhën si një nga shfaqjet më të rëndësishme të jetës së popullit, ai e studioi atë në funksion të ndriçimit dhe të zgjidhjes së problemeve themelore të historisë dhe të kulturës kombëtare. Këtë studim ai e mbështeti në elementet e tjera etnokulturorë, në zhvillimin e tyre historik si dhe në kontaktet gjuhësore dhe kulturore me popujt e tjerë.

**Çabej kërkonte rrënjët e fjalëve për të provuar “themelet” e kombit; ai do të studiointe marrëdhëniet e shqipes me gjuhë të tjera për të shpjeguar ndryshesat që vijnë nga gjuhët dhe kulturat në kontakt.**

**Çabej** - pohon S. Mansaku – është njëri nga gjuhëtarët e parë shqiptarë që përvetësoi, zbatoi në mënyrë krijuese në pajtim me veçoritë dhe rrethanat e shqipes dhe integroi në mënyrë të natyrshme në gjuhësinë historike shqiptare parimet teorike, metodat dhe kërkesat e shkencës gjuhësore të kohës.<sup>1</sup> Një ndër to është edhe

---

<sup>1</sup> Mansaku, Seit (2003): Vepra e Eqrem Çabejit – sintezë e shkencës gjuhësore evropiane dhe traditës shqiptare. Në: Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare. Gjirokastër, 2003, f. 21.

metodologjia që përdor krahasimin sistematik të formave gjuhësore si parim studimi dhe njëkohësisht si mjet për rindërtimin historik të marrëdhënieve midis gjuhëve, siç ai shprehet qartë në Deutsche Grammatik-ën e J. Grimm-it (1918–1922).

Lidhur me metodën e zbatuar nga Çabej në studimet diakronike, Demiraj shprehet se si në studimet etimologjike ashtu edhe në ato për fonetikën, gramatikën dhe dialektologjinë historike, ai është mbështetur në parimin që, duke u nisur nga faza e dokumentuar e shqipes dhe duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e mundshme, të ngjitemi shkallë-shkallë në fazat më të hershme të saj.<sup>2</sup> Nga ana tjetër, përkundër mjaft studiuesve të huaj (përjashto ndonjë rast si Jokli), të cilët niseshin në studimet etimologjike, historike, dialektore a filologjike të leksikut nga gjuhët e tjera për të mbërritur tek shqipja, Çabej u nis prej njohjes dhe përshkrimit të thellë të shqipes për të dalë e për t’u krahasuar me gjuhët e tjera.

**Çabej ishte mjaft rigoroz në punën studimore. Ai shprehet se “kurrkush nuk ka të drejtë të shkruaj mbi gjuhë pa u pat marr vite me radhë me studimin e vërtetë të saj [...] Se filologjia nuk është zbavitje, është larg nga diletantizmi. Është dituri, dhe që të kapes me dituri, duhet të dish”.**<sup>3</sup>

Nga shkolla e Gramatikanëve të rinj Çabeji mori arritjet në fonetikën e krahasuar, sidomos metodën e rreptë shkencore që ata zbatuan lidhur me veprimin e ligjeve fonetike të gjuhës, për ta zbatuar në fonetikën historike dhe në studimet etimologjike në fushë të shqipes.

Nga shkolla e Fjalëve dhe Sendeve (Schuchardt) ai mori parimin e njohur të studimit të historisë së fjalëve bashkë me historinë e sendeve. Historia e gjuhës shqipe do të studiohej e lidhur ngushtë me historinë e kulturës së institucioneve dhe etnicitetin e popullit. Ky parim gjeti zbatim sidomos tek vepra e tij madhore “Studime etimologjike në fushë të shqipes”. Kjo është edhe vepra madhore e Çabejt: plot 7 vëllime me mbi 4000 fjalë. Në këtë vepër studimi fonetik, gramatikor e semantik i fjalëve të gjuhës shihet i lidhur me elementet e kulturës materiale e shpirtërore të bartësve të saj. Objekt

---

2 Demiraj, Shaban (1990): Eqrem Çabej. Nëntori. Tiranë, f. 33.

3 Cit. sipas Demiraj, Shaban (1990): Eqrem Çabej: një jetë kushtuar shkencës. Tiranë, f. 220.



i analizës janë fjalët, të cilat studiohen për nga përhapja e tyre në të shkuarën dhe në të tashmen, vendi i formimit të tyre, zhvillimi i tyre i brendshëm, aftësitë fjalëformuese, zgjerimi a ngushtimi i kuptimit, ndryshimi formal, zhdukja, zëvendësimi me fjalë të tjera etj. Një vend të posaçëm në metodën e tij të studimit zë edhe qëndrimi i tij lidhur me grupimin e fjalëve në fond të trashëguar dhe fond të huazuar, duke iu dhënë përgjigje disa gjuhëtarëve (sidomos Majerit), që e shihnin shqipen si një gjuhë gati të romanizuar.<sup>4</sup> Ai shtron tezën se si për fjalët me burim vendës ashtu dhe për ato të huazuara duhet të mbahet parasysh përhapja e tyre dhe denduria e përdorimit dhe se prania e elementit vendës dhe atij të huaj tregojnë “në një anë shkallën e ndikimit të huaj mbi shqipen, më anë tjetër shkallën e rezistencës së kësaj gjuhe”.<sup>5</sup> **Nëpërmjet një analizë statistikore ai tregon se fondi me burim vendës është më i pasur se ai i huazuar.**<sup>6</sup>

**Një nga kërkesat bazë të metodës së tij në studimin e etimologjisë së fjalës ishte respektimi rigoroz i ligjësive fonetike, morfologjike, fjalëformuese e semantike, që historikisht kanë vepruar mbi gjuhën shqipe e në gjuhët në kontakt. Zbulimi i këtyre ligjësive mundësoi rindërtimin e mjaft trajtave të hershme. Nga ana tjetër, krahasimi i brendshëm u pa i lidhur ngushtë me faktorët jashtëgjuhësorë të përmendur më lart. Zbatimi i parimeve shkencore të fonetikës dhe gramatikës historike do të hidhte dritë për një varg çështjesh që ai studioi, si: evolucioni i sistemit zanor e bashkëtingëllor të shqipes, posaçërisht në lidhje me theksin, gjatësinë, dukurinë e metafonisë, hundorësinë, diftongjet, zanoren ë të patheksuar, bashkëtingëlloret grykore, grupet e vjetra të bashkëtingëlloreve *nt, ng, nd*, dhe mbi disa dukuri të tjera morfonologjike, si: ai i nyjeve, i shumësit të singularizuar, gjinisë asnjane etj.**

Veçanërisht, çështja e prejardhjes së fjalëve dhe afria e tyre gjuhësore në faza të ndryshme të evolucionit kanë lidhje të drejtpërdrejta me çështjen kombëtare dhe autoktoneitetin e saj. Sipas

---

4 Majer, Gustav (2007): Elemente latine në shqipe. Përkth. I, f. 805.

5 Çabej, Eqrem (1982): Studime etimologjike në fushë të shqipes. Vëll. I. A.SH. Tiranë, f. 113.

6 Po aty, f. 114.

kësaj qasjeje shqipja e sotme ruan me konservativizëm ashtin e lashtë të substratit: gjuha dhe etnosi i këtij populli janë në vazhdimësi të atdheut të të parëve të shqiptarëve dhe të territorit të tyre. Evolucioni organik i gjuhës është bërë në lidhje të ngushtë me evolucionin e kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar, duke e parë këtë mekanizëm në shtrirjen e tij kohore e hapësinore.

Një vend të posaçëm në studimet etimologjike zë onomastika. Te jeta e toponimeve, në shfaqjen e trajtave të tyre, fotografohet jeta e moçme e etnisë dhe autoktoneiteti i saj. Ndryshe nga fjalësi tjetër i gjuhës, i cili ndryshon në faza të caktuara të zhvillimit, emrat e toponimeve nga vetë natyra e tyre janë më të ngurtësuar; kështu më jetëgjata dhe përbëjnë dëshminë më të besueshme që shqiptarët janë të ngulitur qysh në krye të herës e vazhdojnë të jenë në këtë truall nga mot e deri sot. Onomastika dëshmon edhe për pjesën tjetër të leksikut të përgjithshëm i cili, në fakt, është më i hapur ndaj ndryshimit. Çabej pohon se “materiali onomastik përbën në një farë vështrimi një pjesë të pashkruar dhe me këtë edhe një pasurim të leksikut, një rëndësi dyfishe për një gjuhë me traditë relativisht të vonë shkrimi, siç është shqipja”.<sup>7</sup> Me anën e shembujve të shumtë<sup>8</sup> ai argumenton se emrat e mjaft viseve kanë ruajtur trajtën e vjetër ilire. Për vetë natyrën e kësaj dukurie, studimi i tyre është bërë me një metodologji studimore komplekse, e cila gërsheton metodat gjuhësore, historike, gjeografike, etnografike etj.

Etimologjia çabejane është në fakt historia e gjuhës shqipe, e cila përkthehet në histori të popullit dhe historia e popullit orienton drejt përcaktimit të gjenezës, të substratit dhe të autoktoneitetit.

Ai iu përmbajt tezës së prejardhjes ilire të gjuhës shqipe dhe të autoktonisë së shqiptarëve, duke u mbështetur në argumente brendagjuhësore dhe jashtëgjuhësore. Çështja e prejardhjes ilire të gjuhës shqipe nuk është çështje thjeshtgjuhësore. Vërtetimi i saj lidhet ngushtë me një kompleks problemesh historike, arkeologjike dhe etnografike, pasi gjuhët nuk janë entitete që jetojnë të izoluar, “se historia e gjuhëve në thelb është pasqyrë e historisë së popujve e

---

7 Çabej, Eqrem (1982): Studime etimologjike në fushë të shqipes. Vëll. I. A. SH. Tiranë, f. 98.

8 Po citojmë disa syresh, si: Dodona, Flamona, Drisht, Drina, Sharr, Tomorr, Artë, Durrës, Dukagjin, Karavasta, Dajç, Frakull, Çermenikë etj.

kulturave”<sup>9</sup>. Çështje themelore si: prejardhja e kësaj gjuhe ballkanike, vendi ku është folur qysh në krye të herës, pozicioni i saj në raport me gjuhët i-e dhe marrëdhëniet e saj me gjuhët ballkanike do të përbënin ndër drejtimet kryesore të orientimit të metodës kërkimore çabejane.

Ndryshe nga disa studiues të drejtimeve të ndryshme, që origjinën e shqipes e lidhnin me burimin trak apo me dokomizishten ballkanike<sup>10</sup>, krahas edhe shumë gjuhëtarëve të huaj<sup>11</sup>, Çabeji i përmbahet tezës së prejardhjes ilire të shqipes. Për një varg çështjesh të shtruar nga ithtarët e tezës joilire si: evolucioni i toponimeve të vjetra vendase, mungesa e termave të lundrimit në gjuhë, mospërmendja e shqiptarëve para shekullit të XI të erës sonë, lidhjet e hershme mes shqipes e rumanishtes, mungesa e pretenduar e huazimeve nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja, Çabeji në punimet e tij provoi me argumente të tjera shkencore, krahas atyre që ishin hedhur, se gjuha shqipe e ka origjinën nga ilirishtja. Kjo tezë deri sot ka gjetur edhe shtrirjen më të gjerë ndër studiues vendës dhe të huaj.

E rëndësishme është të theksohet se, përpos një hulumtimi tipik për një shkencë të veçantë, i cili u përmbahet disa parimeve, si: objekti, metoda dhe ligjet *ad hoc*, studimet çabejane u mbështetën në një tërësi të ndërthurur argumentesh, që buronin e mbështeteshin në mënyrë të ndërsjellë nga fusha të shkencave të ndryshme, si: gjuhësia, gjeografia, historia, kultura, onomastika, etnologjia, njëjtë si një filozofi kundrimi të një mozaiku shumëngjyrësh brenda një entiteti homogjen. Metoda e tij ishte tërësisht historike e krahasuese, sepse ajo i përmbahet sa zhvillimit të brendshëm të shqipes pra, fazave të evolucionit të saj, gjithaq edhe krahasimit me gjuhët në kontakt gjeografik e historik, lidhjes gjuhësore ballkanike a marrëdhënieve brenda familjes së gjuhëve me prejardhje nga i njëjti trung indoevropian.

Parimet metodologjike të neolinguistikës janë një tjetër burim i rëndësishëm në veprën e Çabejit. Që prej botimit të *Atlas Gjuhësor i Gjermanisë Veriore* më 1881 nga Georg Wenker<sup>12</sup>, filloi një qasje e

9 Çabej, Eqrem (1975): Studime gjuhësore. Vëll. V. Prishtinë, f.10.

10 Cit. H. Hirt, G. Weigand, V. Georgiev etj.

11 Cit. J. Thumann, G. Hahn, G. Majer, H. Pedersen, N. Jokl etj.

12 Ky është një botim me 6 harta që kishte për qëllim të përcaktonte kufirin ndërmjet bashkëtingëlloreve të spirantizuara të dialekteve të gjermanishtes së sipërme dhe të

re në këndvështrimin metodologjik të gjuhësisë areale e, në veçanti, të dialektologjisë, e cila do të merrte formë më të plotë në veprën e Jules Gilliéron *Atlas Linguistique de la France* (1902–1912). Parimi që u vu re ishte se shpërndarja në territor e tipareve fonetike nuk duket përherë e rregullt dhe homogjene; shpeshherë fjalët ndikohen edhe nga faktorë të tjerë si etimologjia popullore e homofonia. Areali i përhapjes së fjalëve, përcaktimi i kufijve dialektorë dhe i të folmeve brenda vetë gjuhës nga njëra anë, dhe i vetë gjuhës në raport me gjuhët e tjera brenda arealit indoevropian, nga ana tjetër, janë disa nga zbatimet metodologjike të kërkimeve çabejane. Këtë gjë e vëmë re sidomos në përgatitjen e *Atlasit Gjuhësor*, një ide kjo e hedhur qysh më 1929 nga Bartoli, e cila u mor më vonë nga Talia-vini. Çabeji ishte anëtar i Komisionit *ad hoc për hartimin e atlasit dialektologjik të shqipës (1942), i cili hartoi një pyetësor me 2578 pyetje*<sup>13</sup> (në të dyja gjuhët), që rroknin një tematikë të gjerë të veprimtarisë njerëzore. Kjo punë përgatitore nuk mundi të kurorëzohet për shkak të Luftës së Dytë Botërore dhe të pasojave që ajo solli në vendin tonë e më gjerë.<sup>14</sup>

Metoda e tij është e rëndësishme edhe në fushën filologjike. Studimi i Autorëve të Vjetër lidhet jo vetëm me njohjen e tyre, por edhe për të rindërtuar fazat sinkronike të një evolucioni në rrafshin fonetik, gramatikor e leksikor që ka pësuar gjuha shqipe përgjatë zhvillimit të saj. Të folmet arkaike do të përbënin edhe brumin që ai do të shfrytëzonte për të ndërtuar etimologjinë e fjalëve të gjuhës shqipe, duke përcaktuar prejardhjen e saj si dhe për të studiuar ligjësitë fonetike, gramatikore, fjalëformuese e semantike. Me rëndësi nga pikëpamja e metodës së përdorur është transliterimi dhe transkribimi i *Mesharit*, si dhe një studim i plotë në *Hyrje*, një punë e vyer prej më shumë se dy dekada. Çabeji arrin në përfundimin se *Meshari* nuk duket se është vepra e parë e shkruar në shqip, pasi

---

bashkëtingëlloreve mbylltore të gjermanishtes së poshtme.

13 Pyetësi i Çabejt përmbledh një tematikë mjaft të gjerë. Aty përfshihen pyetje nga trupi i njeriut, lindja, fëmija, moshë, lojërat, martesë, vdekje, veprimtaria familjare, veshjet, të ushqyerit, muzika, cilësi morale dhe jeta fetare, terreni, bujqësia, drurët, frutat, kafshët, ditët javët, muajt festat, ngjyrat, numrat etj.

14 Për informacion të mëtejshëm shih: Puna e Egerem Çabejt për hartimin e Atlasit të Gjuhës shqipe. J. Gjinari–Gj. Shkurtaç. Dialektologjia, f. 81.

ai na paraqitet me një ortografi tashmë të ngulitur.<sup>15</sup> Sipas autorit kjo vepër dëshmon se ka pasur qysh në Mesjetën e vonë një traditë letrare liturgjike me një ortografi pak a shumë të kristalizuar. Mbështetur dhe në studimin e gjuhës së Pjetër Budit, autori arrin në përfundimin se gjuha e Shkrimtarëve të Vjetër dëshmon për ekzistencën e një koineje. Ai është i mendimit se pavarësisht nga preardhja dialektore, këta shkrimtarë u ngritën në një gjuhë shkrimi mbidialektore.<sup>16</sup> **Këtë gjë e dëshmon edhe fakti i përkthimit të kësaj vepre për gati dhjetë muaj. Kjo vepër hodhi edhe themelin e traditës së shkruar, nga do të fillonte edhe historia e gjuhës së shkruar, duke u kthyer në monumentin më të madh kulturor të shqiptarëve.**

Çabeji u mbështet edhe në parimet teorike të gjuhësisë së përgjithshme, në koncepte të tilla si sistemi, struktura, karakteri funksional i gjuhës, raportet standard/dialekt, raportet gjuhë/mjedis shoqëror, gjuhë/etni, parimet leksikologjike e leksikografike për hartimin e fjalorit të 54-ës, parimet fonetike e grafike të Kongresit të Drejtshkrimit të 1972-it. Qëndrimi i tij për standardin e shqipes ka pasur si kusht mbledhjen më së pari të materialit të gjuhës së gjallë e sidomos njohjen e studimin e tij në tërësinë e rrafshve gjuhësore dhe të arealit të shpërndarjes së tij. Më pas mund të flitej për përzgjedhjen e një koineje të standardit, një normë të standardit etj.

Megjithatë, ai ishte i palëkundur për domosdoshmërinë e një standardi në kushtet e funksionimit dhe të epërsisë politike të shtetit të njësuar. Ndër parimet metodologjike të formimit të gjuhës standarde ai do të përmendte thjeshtimin e strukturës fonetike e gramatikore si dhe pasurimin e leksikut, konvergjencën në rregullat e drejtshkrimit si dhe mbështetjen në gjuhën e gjallë të popullit, nga do të dalin edhe rregullat e përdorimit.<sup>17</sup>

Megjithatë, për çështjen e gjuhës së përbashkët letrare, Çabeji fillimisht ka qenë mbështetës i tezës së Komisionit Letrare të Shkodrës, e cila e shihte bazën e standardit në pikëtakimin midis gegërishtes dhe toskërishtes, pra Shqipëria e Mesme. Më vonë ai do t'i bashkohej mendimit që doli nga Kongresi i Drejtshkrimit. Parimi që shpreh Çabeji është se ky standard “paraqet një realitet dhe njëkohësisht rezultatin e një farë abstrakcioni të formuar gjatë kohës, në

mënyrë që nuk përputhet krejt me një dialekt territorial të caktuar, as edhe me dialektin që përbën bazën e tij. [...]”<sup>18</sup>

Nga ana tjetër, Çabej thekson domosdoshmërinë e mbështetjes në traditën e mirë për një gjuhë të pastër, të thjeshtë dhe të bukur, larg ndikimit të fjalëve të huaja. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është tregues i nivelit të kësaj kulture – thotë ai.<sup>19</sup>

## Bibliografi kryesore

- Çabej, Eqrem (1968): “Meshari” i Gjon Buzukut. Vëll. I. Tiranë.
- Çabej, Eqrem (1986): Hyrje në studimin krahasimtar të gjuhëve indoevropiane. Në: Studime gjuhësore. Vëll. VII. Prishtinë.
- Çabej, Eqrem (1966): Pjetër Budi dhe gjuha e tij. Në: Studime Filologjike. Nr. 4. Tiranë. 138-150.
- Çabej, Eqrem (1982): Studime etimologjike në fushë të shqipes. Vëll. I. A.SH. Tiranë.
- Çabej, Eqrem (1976): Studime gjuhësore. Rilindja. Prishtinë.
- Çabej, Eqrem (1975): Studime gjuhësore. Vëll. V. Prishtinë.
- Çabej, Eqrem (2009): Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe. Çabej. Tiranë.
- Whithney, William D. (1867): The life and growth of language. New York.
- Demiraj, Shaban (1990): Eqerem Çabej: një jetë kushtuar shkencës. Tiranë.
- Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastër. (2003): Eqrem Çabej dhe kultura shqiptare.
- Frashëri, Sami (1879): Gjuha shqipe. Në ‘Alfabetare e gjuhësë shqip’. Konstandinopojë.
- Grup autorësh (2003): Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot. Tiranë.
- Majer, Gustav (2007): Elemente latine në shqipe. Përkth. I. Tiranë.
- Meillet, Antoine (1921): Linguistique historique et linguistique générale. Paris. Champion.
- Petrota, Gaetano (1932): Në: Parathënien e studimit të P.Skiroit. Il più antico testo di lingua albanese. Në: Indo - Greco - Italica.
- Raka, Fadil (2005): Historia e shqipes letrare. Prishtinë.
- Rrokaj, Shezai (2007): Çështje të gjuhës shqipe. Albatros. Tiranë.
- Rrokaj, Shezai (2007): Hyrje në Gjuhësinë e Përgjithshme. Ilar.

---

18 Po aty, f. 101.

19 Gjuha jonë (1981). Nr.1. Tiranë, f. 36.

Tiranë.

Rrokaj, Shezai (2007): Strukturalizmi klasik në gjuhësi. Ilar. Tiranë.

Sapir, Edward (1968): Linguistique. Folio Essais. Gallimard. éd. Minuit.

Seminari ndërkombëtar i Prishtinës (1988): ‘Për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare’. Prishtinë.

Shkurtaj, Gjovalin (2003): Puna e Eqrem Çabejt për hartimin e Atlasit të Gjuhës shqipe.

J. Gjinari – Gj. Shkurtaj. Dialektologjia.

Sosyr, Ferdinand de (2002): Kurs i gjuhësisë së përgjithshme. Dituria. Tiranë.

Thomai, Jani (1989): Prejardhja semantike në gjuhën shqipe. Tiranë.

Berton Sulejmani

## **KUMTESAT SHKENCORE TË PROF. EQREM ÇABEJT TË BOTUARA NË REVISTËN “JEHONA” TË SHKUPIT**

Profesor Eqrem Çabej u formua dhe u specializua në gjuhësinë komparative indoevropiane si dhe në shkencat albanologjike dhe kështu u bë shkencëtar me aftësi të rralla krijuese dhe historian i shkëlqyer jo vetëm i historisë së gjuhës, por edhe i historisë së kulturës kombëtare shqiptare. Veprimtaria më e frytshme arsimore e shkencore e Profesor Çabejt është ajo e pas viteve 1945 (e njohur si periudha e Pasçlirimit), në një anë për përgatitjen e kuadrove universitare (prof. E. Çabej është edhe njëri nga themeluesit e arsimit të lartë të Shqipërisë), e në anën tjetër për t'i çuar përpara shkencat albanologjike. Në këtë drejtim ai hartoi dhe redaktoi shumë tekste mësimore për shkollat shqipe. Kur bëhet fjalë për veprimtarinë e tij të gjerë arsimore, duhet të theksohet se prof. E. Çabej dha kontribut të madh e të çmueshëm me cikle ligjëratash dhe ligjërata të veçanta shkencore për studentët e shkallës së dytë e sidomos për ata të shkallës së tretë dhe për pedagogët e katedrave albanologjike të Universitetit të Prishtinës e të Shkupit si dhe në atë të Vjenës. Por, ajo që e bën të pavdekshëm dhe që i siguron përgjithmonë një vend nderi në botën shkencore është veprimtaria e tij e gjithanshme kërkimore me nivel të lartë shkencor.

Krahas punës së tij për një kohë mjaft të gjatë në Institutin e Shkencave e më vonë në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, anëtar i së cilës ishte që nga themelimi i saj e madje edhe anëtar i Kryesisë së Akademisë, prof. E. Çabej botoi edhe disa kumtesa



shkencore në revistën “Jehona” të Shkupit. Në këtë revistë të parë dhe të vetme në gjuhën shqipe pas Luftës II Botërore ndër shqiptarët e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (sot R. e Maqedonisë së Veriut) dhe që filloi të botohet në Shkup në vitin 1962 me dhjetë numra në vit, profesor Eqrem Çabej botoi këto studime shkencore:

1. **“Problemi i formimit të gjuhës shqipe”**, “Jehona”, viti XI, nr.7, f. 48-76, Shkup,

1972. Në këtë kumtesë shkencore, të cilën Prof. Çabej e kishte mbajtur në Kuvendin I të Studimeve Ilire, trajton një nga problemet kryesore, sikundër dihet, çështjen e burimit të shqipes, përkatësisht çështjen e lidhjes dhe afrisë me gjuhët jogreke të kohës së vjetër, dhe atë të vendit ku gjuha shqipe u formua si një madhësi e caktuar e më vete. Edhe pse ky kompleks çëshjesh nuk përbën vetëm një problem gjuhësor, por njëkohësisht edhe një problem etnografik e arkeologjik, gjuhësisht, prof. Çabej, këtë problem e përmbledh në këtë pyetje: A ka gjurmë të lashta të shqipes në Gadishullin Ballkanik, dhe në qoftë se po, ku ka? Në këtë mes nuk trajtohen dëshmitë e shkruara të kësaj gjuhe, të cilat janë të një kohe shumë më të vonë. Në këto rrethana duhet t’i drejtohem një materiali më të mëtejshëm, i cili jo vetëm na jep një formë gjuhësore më të hershme, por na jep të dhëna edhe për shtresimin gjeografik dhe për vendin e përhapjes së bartësve të gjuhës në kohët e para. Këtu është fjala për marrëdhëniet e vjetra të huazimit me gjuhët fqinje, por mbi të gjitha emrat e lashtë vetjakë, sidomos emrat e vendeve. As në Panoni, as në Dalmaci ose në Bosnjë, as në Transilvani<sup>1</sup> nuk gjenden kund gjurmë të lashta të shqipes. Profesor Çabej ndalet brenda trevës Naissus-Nish, Scupi-Shkup e Astibos-Shtip, ku dëshmohet që Dardania bashkë me viset kufitare të Maqedonisë e të Peonisë bëjnë pjesë në territorin e formimit të shqipes. Po të kalojmë në trevën gjuhësore, që shtrihet brenda kufijve të shtetit të sotëm shqiptar, e nëse qëndron mendimi se “shqiptarët nuk kanë trashëguar asnjë element kulture (si p.sh.: emra personash ose vendesh) të kohës antike”, pamja paraqitet si vijon. Duke nisur me Veriun, pikëpamja e N. Joklit, për

---

<sup>1</sup> Transilvania është një rajon historik dhe kulturor në Evropën Qendrore dhe Lindore, që përfshin Rumaninë qendrore. Në lindje dhe jug, kufiri i saj natyror janë Malet Karpate dhe në perëndim Malet Apuseni.

qytetin e Shkodrës: “Shkodra, qysh prej kohës pararomake gjer më sot, pa ndërprerje, ka folur vetëm shqip”, nuk pajtohet me rezultatet e fonetikës historike të shqipes. Çështja e vendit të formimit të shqipes që shtrohet prej nesh për fazën antike të shqipes, e për atë periudhë gjuhësore barazimi *Scodra*: shq. *Shkodër* pajton më së miri me rregullat fonetike të gjuhës shqipe; për ballin e fjalës khs. gr. e vj. (trak.) *skalme*: shq. *shkallme* “shpatë”, *skariphos*: *shkarpë* “karthje”, lat. *scamnum*: *shkamb* “shkëmb; stol”, për grupin konsonantik në trup të fjalës lat. *barathrum* prej gr. së vj. *barathron*; shq. *balladër* “ujvarë”, lat. *chersydrus* prej gr. së vj. *khersydros*; shq. *kulshedër*.

Profesor E. Çabej niset nga toponimet me burim jolatin dhe duke shkuar prej Veriut në Jug e në lidhje me refleksat e *Naissus*, *Scupit* e *Scodras*, në Veri të *Oulkinion*; *Ulqi*, *Ulqin* dhe të trevës së gjuhës shqipe, shfaq edhe emrin e Raguzës, *Ragusium*, emërtimi i vjetër shqip i së cilës, *Rush*, tregon ndërmjetësinë e gjuhës shqipe. Më në jug, emri i qytetit që në greqisht jepet si *Lissos*, e latinisht *Lissus*, e që shqip është *Lesh*, paraqitet me një formë, e cila pajtohet kryekrejt më shpesh prej lat. *spissus* “i shpeshtë”. Çabej merr edhe toponimin *Qafa e Prushit*, që gjendet në veri, mund të jetë vijim i emrit të Pirustëve (*Pirustae*, *Perustae*, pas një mendimi të A. Saraçit), me një zhvillim të grupit *st* në *sh* si te fjala *teshë* prej lat. *testa* “gu- skë, gurr ç, rr shtë, kokë”. Po këtu përfshin edhe *Candavia*: ipeshkvia mesjetare *Chunavia*, me ndërrimin *nd*: *n* që është rregull i shqipes. Më në lindje, emri i malit që tek autorët grekë jepet si *Skardos*, *Skardon*, te romakët si *Scardus mons*, u ka zhvilluar sipas ligjeve fonetike të shqipes në të sotmin *Shar*, një emër ky nga i cili prej shqipes kaloi edhe në të tjerat gjuhë ballkanike duke përfshirë aty edhe turqishten. Në këtë studim, Çabej, shkruan edhe për zgjerimin e vjetër të shqipes me sufiksin –n, *Skampin-*, latinisht dëshmuar si *Scampinus*, një rrjedhojë e *Scampis* të kohës antike (Elbasani i sotëm), në gojën e shqiptarit dhe rregullisht *Shkumbi*, *Shkumbini*, me errësimin e ë-së paratheksore në *u* në dialektin përkatës të Shqipërisë së Mesme, dhe me asimilimin e grupit *mb* në *m* në gegërishte. Më poshtë në jug, emri i qytetit bregdetar të Vlorës, greqisht te *Ptolomeu Aulon*, që po të kishte pasur një ndërmjetësi të sllavishtes pas fjalëve të vetë Weigandit (Vajgandit) duhej të kishte përfunduar në *Valin*, por ka dhënë *Vlonë*, *Vlorë* rezultat i ligjeve

fonetike të shqipes, me aferezë të rregullt të *a*-së e me rotacizmin e mëpastajme të toskërishtes. Fare në Jug, forma Çam – e Çamërisë na jep shembullin e emërtimit të një krahine nga lumi që e përshkon: aty, sikundër vuri re prej kohësh M. Leake (Leaku), është ruajtur nga emri i lumit *Thyamis* të kohës së vjetër, i cili ndërkaq në greqishten e re nuk njihet, por është zëvendësuar me emrin *Kalamas*.

Në çështjen e vendit të formimit të gjuhës shqipe, Profesor E. Çabej shkruan se duhen pasur parasysh më në fund edhe marrëdhëniet e huazimit të gjuhës shqipe me idiomat fqinje, si huazimet që shqipja ka marrë prej sosh, si dhe elementet e shqipes në ato gjuhë. Marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e gjalla të Ballkanit, me sllavishten jugore, greqishten (të mesmen dhe të renë) e rumanishten, tregon se këto marrëdhënie nuk japin gjë pozitive as në pikëpamje të gjeografisë gjuhësore as në atë të historisë gjuhësore. Në këtë gjë faktet e gjuhës pajtojtohen me ato të historisë, duke shprehur dhe marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e përmendura, kryesisht prej një kohe pasantike, mesjetare – edhe kjo përsëri një provë që çështja e atdheut të kryehershëm të shqipes ka lidhje me rrethanat e kohës antike. Rezultati i kërkimit shkencor është ky: shqipja është formuar në përgjithësi në trevën e sotme gjuhësore me përfshirje edhe të bregdetit, që kjo trevë nuk ka pësuar ndonjë ndryshim qenësor gjatë kohëve. Dardania dhe Shqipëria Veriore bashkë me krahinën e Matit duhet të shikohen si pjesë e trevës gjuhësore të kryehershme, jo si kjo vetë, mendimi i përkundërt është i shikuar tepër ngushtë.

## 2. “Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipes

“Jehona”, viti X, nr.9, f. 3-16, Shkup, 1972. Këtë punim të tij profesor Eqrem Çabej, e fillon me “Parimet e rregullat” e Komisionit Letraro që ajo caktoi për drejtshkrimin e shqipes aty nga fillimi i vitit 1917 dhe *që vendosi*, ndër të tjera, që zanorja *ë* e patheksuar, grupet e zanoreve **ie**, **ue**, **ye** dhe grupet e bashkëtingëlloreve **mb**, **nd** e **ngj** do të shkruhen të plota ashtu si i ruan këto toskërishtja e pjesërisht edhe disa nëndialekte të gegërishtes, ajo mund të shtonte e të thoshte, pra Komisioni Letraro, *që ashtu të plota kanë ekzistuar* ato dhe janë shkruar pak shekuj më parë në krejt truallin e gegërishte dhe se janë të gjithmbarshme të gjuhës. Dihet se shkrimtarët e vjetër

të Veriut, të shekullit XVI e XVII gjer aty nga mesi i shekullit XVIII, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Gjon Nikollë Kazazi e të tjerë, ndër ta edhe ndonjë anonim, ruajtës të një tradite gojore e shkrimore të gjuhës, i kanë përdorur të plotë këta tinguj, këto grupe zanoresh e bashkëtingëlloresh, dhe se nga ana tjetër këto ndihen dhe sot e kësaj dite në disa treva anësore e si të tilla më konservative të fushës dialektore të gegërishtes. Në këtë punim, profesor Çabej, krahas disa pikave që kanë lidhje me anën formale fonetike e thjesht gramatikore të drejtshkrimit, vë re se edhe kur të kenë gjetur zgjidhje shumica e çështjeve të kësaj fushe, puna e drejtshkrimit nuk ka mbaruar. Nuk ka mbaruar, por jemi ende në mes të rrugës, po ta vështrojmë drejtshkrimin me një pamje më të hapët, më tërësore; fjalën e ka te zgjerimi i tematikës së tij, duke përfshirë në lëmin e vështrimit, sikundër dihet, edhe disa probleme të sintaksës, të frazeologjisë e të leksikut. Shkrimi i shqipes moderne, në krahasim me atë të periudhave të mëpashme të saj, karakterizohet nga dy tipare kryesore: *puna për një normim përherë e më të madh të formave fonetike e gramatikore të fjalëve dhe për një pasurim progresiv të leksikut me elemente pozitive të vendit*; nga ana tjetër puna për depërtimin e ngulitjen e disa ndërtimeve të huaja dhe të një shumice, sa vete më të madhe, fjalësh të importuara së jashtmi.

Në lidhje me këtë, në drejtshkrimin sintaktik (siç e quan E. Çabej), në rend të parë duhet synuar në një ndërtim fjalish sipas frymës së shqipes, në harmoni me parimet që zotërojnë në sintaksën e kësaj gjuhe, e jo në imitim sintaksor të gjuhëve të tjera. Duhet nisur së brendshmi, e jo së jashtmi. *Më rëndësi se çështja nëse një fjalë do të shkruhet me e apo me ë, me i apo me j, me j apo me nj* fundore, ka parimi që fjalia të jetë ndërtuar sipas modelit vetiak të shqipes (sipas natyrës së gjuhës shqipe, B.S.), jo të njërës a të tjetrës gjuhë të huaj. Ndërtime të tilla si **rregullat fonetike dhe ato morfologjike, letërsia artistike dhe ajo popullore** e të tjera si këto janë të huaja për gjuhën shqipe. Në përdorim të një shtrese të caktuar intelektualësh, por jo në ligjërimin popullor, ato janë italianizma sintaksore, përkthime të ndërtimit sintaksor të *italishtes*. *Të tilla ndërtime ndeshen edhe në rumanishten moderne të shkrimit edhe aty pas gjedhesh (modelesh) të gjuhëve romane perëndimore, veçse atje janë më të kuptueshme, ngaqë hyjnë në sistemin e një*

*gjuhe gjithashtu romane. Imitim është ndër të tjera edhe përdorimi i lidhëzës **pse** në fjali shkakore (më fort pas it. **perche**), aty ku në shqipen e mirëfilltë përdoret **se** ose **sepse**. Në punë të drejtshkrimit nuk janë pa rëndësi dhe shenjat e pikësimit, të cilat peshojnë edhe në përcaktimin e drejtë të kuptimit të fjalëve e të lidhjeve të tyre. Edhe aty gjuha shqipe ka rregullat e veta, të cilat nuk duhen *lënë mënjanë*. *Vendosja e presjes para lidhëzës në fjali të tipit **mendoj, se; kuptohet, se; është e qartë, që**, ka depërtuar këto vitet e fundit nga rusishtja, e cila nga ana e saj e ka marrë këtë përdorim prej gjermanishtes. Kështu shprehja (i **hedh**) **pluhur syve**, e cila nuk është veçse shqipërim i një shprehjeje të gjuhëve të huaja, në frazeologjinë shqiptare i përgjigjet **hi syve**. Si kjo ka plot shprehje frazeologjike e të thëna popullore, të cilat duhej të përdroreshin nga shkruarit e gjuhës.**

Prof. Çabej në fund të punimit shkruan se me rëndësi të dorës së parë është puna e përdorimit të visarit të fjalëve. Aty shtrun detyrën dyfishe, të pasurimit dhe të pastrimit. Pasurim me leksema të gjuhës popullore, nga burime të saj; pastrim nga elementet e huaja që po vërshojnë në gjuhë prej të gjitha anëve. Neologjizmat që janë formuar gjatë historisë së gjuhës me përkthim nga gjuhët e tjera, si: **e diel, e hënë, peshkaqen, mollatar-të, vajgur-i** ose **përdjek** “persekutoj” te Pjetër Budi, **hapësirë, vetëdije, ndërgegje** e të tjera të shekullit XIX, **botoj e shkrimtar** pak më vonë, **botëkuptim, hekurudhë, largpamës, mbinjerëzor, ndërlidhje, pararojë, përballoj, përvetësoj, i pranishëm, prapavijë, rilindje** e të tjera në ditët tona. Këto *përbëjnë një pasuri pozitive të gjuhës; aty gjedhja e formimit është e huaj, lënda është e vendit*. Në këtë mënyrë mund të vazhdohet e të shkohet përpara, duke pastruar e duke pasuruar; duke zëvendësuar ndër të tjera **fenomen** me **dukuri, efekt** me **duk, persekutim** me **përndjekje, krijoj** me **lentoj, tekstile** me **veglore**, fjalë shumica të gjalla edhe sot nëpër dialekte. Gjuhëtarëve u bie barra e gjatë dhe jo e lehtë që me një punë të vijueshme të mbledhin visarin leksikor të gjuhës popullore. Të tjerëve, në radhë të parë shkrimtarëve, përkthyesve arsimtarëve e teknikëve të ndryshëm, u bie barra ta shtien në qarkullim në botimet e tyre. Mbledhja e këtij materiali është një punë që s’pret, që nuk duron afate. Për detyrat, *që duhet të përballojë në të ardhmen drejtshkrimi i shqipes*, i shikuar në

aspektet e tij të shumëllojshme, prof. Çabej jep një këshillë: hartuesit e tij do të duhet të udhëhiqen nga një ndjenjë e lartë përgjegjësie. Në formulimin e çdo rregulli do të jetë e pranishme vetëdija për një drejtshkrim të caktuar jo për disa mijëra veta, po për katër milion njerëz që e kanë shqipen gjuhë amtare. Pra, qysh në atë kohë, Çabej, jep porosinë mbarëkombëtare për drejtshkrimin e përbashkët të gjuhës shqipe, gjë që ndodhi më 1972 në Tiranë.

3. Profesor Eqrem Çabej prej fillimit të krijimtarisë së tij ka përkrahur tezën se

shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe se gjuha shqipe vjen prej ilirishtes<sup>2</sup>. Në kongrese të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare me argumente shkencore hodhi poshtë pohimet e dijetarëve të huaj që e kanë kundërshtuar prejardhjen të shqiptarëve. Këtë më së miri e shohim edhe në punimin e tij të radhës të botuar në revistën “Jehona” (Shkup) me titull: “**Ilirishtja dhe shqipja**” (1980, viti XVIII, nr. VII). Kjo teori, e mbrojtur nga një varg historianësh e gjuhëtarësh, sidomos nga Gustav Meyer- i aty nga fillimi i shekullit XX u zëvendësua te një pjesë e mirë e dijetarëve me tezën e dalë kryesisht nga fusha e gjuhësisë, sipas së cilës shqiptarët janë stërnipër trakasish të ardhur prej visesh më lindore në brigjet e Adriatikut dhe shqipja është bija e trakishtes, ose edhe një dialekt trak i ilirizuar<sup>3</sup>. Ka pasur edhe një sintezë të të dy teorive, e përfaqësuar me Norbert Jokl-in, sipas së cilës shqipja është ngushtësisht e afërt dhe me ilirishten dhe me trakishten. Këtë teori e kanë ndjekur mjaft dijetarë.

*Çështja se çfarë marrëdhëniesh ka midis shqipes dhe ilirishtes, a ka një afri (parente) midis këtyre dy gjuhëve, dhe, në qoftë se ka, a kemi aty një raport filiacioni (birërie) apo jo. Për të krahasur dy madhësi, shkruan Çabej, ato duhet t’i njohim. Në rastin tonë konkret ne dimë vetëm njërën nga këto, shqipen. Ilirishten e njohim pak, e aspak; sidomos jemi krejt në errësirë në punë të strukturës së saj gramatikore dhe mezi po arrijmë ta rindërtojmë gjer diku atë gjuhë me anë të thërrimeve që mund të thuhet se na kanë mbetur prej*

---

2 Mr. Remzi Nesimi, *Prof. Eqrem Çabej – erudit dhe personalitet i shquar shkencor*, Jehona, 7/1980, viti XVIII, f. 608, Shkup, 1980.

3 Dr. Eqrem Çabej, *Ilirishtja dhe shqipja*, “Jehona”, 1980, viti XVIII, nr. VII, f. 611, Shkup.

saj. Përveç kësaj, distanca kohore që nga ekzistenca e nga zhdukja e dialekteve ilire gjer te dokumentimi i parë i shqipes si gjuhë më vete është bukur e madhe. Problemi i raportit të shqipes ndaj ilirishtes është një problem historik e gjuhësor. Prandaj edhe rrugët e mjetet për t'iu afruar zgjidhjes shkencore të tij nuk mund të jenë vetëm gjuhësore, ato duhen rrokur në tërësinë komplekse të tyre. Në këtë rast, prof. Çabej thotë se aty ekzistojnë disa kritere, të cilat duhen zbatuar në këtë fushë kërkimi. Së pari është kriteri gjeografik-territorial, rrethana që populli shqiptar banon në një trevë që bënte pjesë në vendbanimet e popullsisë të ilirëve jugorë. Sy dyti, është fakti historik *që në asnjë nga burimet historike të mëvona nuk flitet për ndonjë ardhje të shqiptarëve nga vise të tjera në atdheun e tyre të sotëm: heshtje që do të ishte e vetme dhe paradoksale, po ta kemi parasysh afërsinë e pandërmjetme të Shqipërisë me botën romake, e romane e greke-bizantine. Për ne është një dëshmi e një metode shkencore e padrejtë, pra një regres në shkencë, e quan prof. E. Çabej, kur shumica e dijetarëve të sotëm (kupto për vitet 1970) problemit të burimit të popullit shqiptar e të gjuhës së tij i afrohen vetëm me mjete linguistike (gjuhësore) dhe lënë pas dore kriteret gjeografike-historike të shtruara prej Johan Tunman-it qysh në shekullin XVIII. Këtyre vjen e u shtohet së treti rrethana, *që në disa stacione prehistorike të Shqipërisë vihet re një vazhdimësi kulture, e cila me mjaft gjasë dëshmon për një vazhdimësi popullsie, dhe në çdo rast përforcon të dhënat territoriale historike.**

Nga fusha e toponomastikës historike, duke u nisur (në rrugën metodikisht të drejtë) prej rrethanave të brendshme të shqipes, Çabej konstaton se emrat e atyre qyteteve, lumenjve, maleve etj., të trevës nga Raguza gjer në Çamëri, nga Shtipi, Nishi, Sharri e Shkupi e gjer në brigjet e Adriatikut e të Detit Jon, të cilat njihen që nga koha antike, me trajtën që kanë sot në gjuhën shqipe, dëshmojnë për një vazhdimësi, për një kontinuitet në këtë truall. Këto emra në pjesën më të madhe paraqesin një zhvillim gjuhësor nga trajta e lashtë në të renë në pajtim me ligjet fonetike të shqipes, dhe në një mënyrë që trajta e tyre e sotme nuk mund të shpjegohet veçse me mjetet e saj, duke mos gjetur shpjegim me anë të ndonjë gjuhe tjetër të Gadishullit Ballkanik: Ragusium: Rush, Scodra: Shkodër, Astibus: Shtip, Naissus: Nish, Scardusmons: Shar, Scupi: Shkup, Drivastum:

Drisht, Pirastue: Qafa e Prushit, Lissus: Lesh (si lat. spissus: shpesh), Candavia: Kundavlja, Durrachium: Durrës, Isamnus: Ishëm, Scampinus: Shkumbi, Aulon: Vlonë, Vlorë, Thyam: Çam –. Kjo është një nga provat më shtrënguese për autoktoninë e popullit shqiptar.

Duke kaluar tek emrat e personave, Çabej thotë se me gjithë ndryshimet e mëdha që ka pësuar antroponomia, si kudo, edhe në Europën Juglindore e në Shqipëri, sidomos me përhapjen e krishterimit, e këtu pastaj edhe me depërtimin e islamizmit, edhe në këtë fushë nuk mungojnë analogjitë. *Çabej* përmend disa emra personash ilirë, si: Bardus, Bardyllis, Bato, Dasas, Das (s) ius, Dida, Licaus Licca, Marica. Këto ose janë të gjalla edhe sot në Shqipëri, ose gjejnë përgjegjëset e tyre në gjuhën shqipe, ose shpjegohen me mjetet e saj. Këtu Çabej përfshin edhe emrin Bardibalus, emër burri i gjetur me kohë në Serbinë Perëndimore, të cilit nga fusha e shqipes i përgjigjet kompozita me dy sinonime ballbardhë, që ndryshon nga ai vetëm në topikën e dy elementeve përbërëse të tij. Këtu hyn edhe emri i një gruaje Lydra gjetur në shekullin XX në Durrës. Ky emër, i cili mund të lexohet edhe Ludra, për më se “e pastër, e dëlirë”, i përket etimologjikisht e morfologjikisht grupit gr. lutron “banjë”, lat. autus “i larë”, “i pastër”, gal. lautro “banjë botore”, afrohet edhe me shqipen i dëlirë, gjë që tregon se edhe *i lirë* nuk rrjedh me rrugë të drejtpërdrejtë prej lat. liber, por duket të jetë përzier me një fjalë vendi të shqipes, të afërt me emrin Lydra.

Në këtë punim, Çabej, nuk e le mënjanë ekzistencën e një terminologjie detare mjaft të pasur të shqipes, si në lidhje me florën e faunën e detit, si dhe ç’i përket lundrimit e peshkatarisë. Edhe kjo dëshmon se shqipja është formuar lashtësisht në brigjet detare të krahut perëndimor të Ballkanit. Karakteri autokton i popullit shqiptar që nga koha antike i vërtetuar me mjete gjuhësore, pastaj banimi i tij dhe formimi i gjuhës së tij në një territor ku kanë banuar kryesisht fise ose popullsi ilire, është një nga provat e filiacionit ilir (birërisë ilire) të tij.

4. Elementi latin i gjuhës shqipe, i shikuar në tërësinë e tij, përbën, sikundër dihet, një nga kapitujt më me rëndësi të kësaj gjuhe (pra, gjuhës shqipe). Për ta rrokur atë në aspektet e tij të ndryshme,



në përmasat që ka marrë në shqipen, në çështjet që lidhen me rrugët e depërtimit të tij në këtë gjuhë, duhet kundruar si në pikëpamje gjeografike e historike, në hapësirë e në kohë, si edhe nga një anë e përgjithshme sociale, etnologjike e kulturore. Këto kënde vështrimi ndërkaq nuk janë të ndara në mënyrë të prerë, po janë të lidhura ngushtë me njëra - tjetrën, shkruan Profesor Eqrem Çabej në punimin e tij me titull “**Elementet latine të gjuhës shqipe**” (1974, viti XII, nr. IV). Prandaj edhe kundrimin shkencor të kësaj teme e kryen në një mënyrë tërësore dhe njëkohësisht të diferencuar, që të rrokë tiparet qenësore të problematikës së saj. Kuptohet ndërkaq që këto tipare këtu i vështron veçse në vijat më kryesore.

Në planin hapësinor, problemit se në ç’trevë të Gadishullit Ballkanik u ushtrua ndikesa latine mbi gjuhën shqipe në kohën antike, Çabej, e lidh me një tjetër, me atë të vendit ku u formua ose ku ishte formuar shqipja në atë periudhë historike si një gjuhë më vete, me ato tipare që e dallojnë atë në grupin e gjuhëve indoeuropiane. pa hyrë shumë në hollësi, por duke u mbështetur në studimet e kohës. Çabej thotë se vendi i formimit të kësaj gjuhe, në vija të përgjithshme është po treva gjuhësore e sotme, në brigjet e Adriatikut e të Detit Jon e në hinterlandin e tyre. E shikuar nga pikëpamja e ndikimit gjuhësor që vinte nga Italia, këtë trevë e paraqet njëkohësisht qendrore e periferike: qendrore, sepse është më afër Gadishullit Apenin, shumë më afër, p.sh. se Gadishulli Iberik, Galia ose brigjet lindore të Ballkanit; disi periferike, sepse e ndarë sidomos nga Italia e nga ndikimet e saj me anë të detit, si edhe vetë për natyrën e saj kryesisht malore, me përjashtim të viseve bregdetare.

Nga këndi i një vështrimi kulturor të përgjithshëm vihet re se ndikimi latin shtrihet në shumicën e sferave të fushës leksikore të shqipes, jo vetëm në ato të botës konkrete e të kulturës materiale, po sidomos edhe në ato të jetës mendore e sociale, dhe aty – siç e vuri re i pari Norbert Jokli – edhe në lëmin e ligjeve popullore. Sikundër dihet, Norbert Jokli<sup>4</sup>, mbi dëshminë e disa elementeve leksikore e të disa toponimeve që në trajtën e tyre përkojnë me dalmatishten, që pra konkretisht me **o**-në e tyre në vend të një **u**-je (si në **furkë** etj.) dalin jashtë fushës së rregullave fonetike të shqipes, është i prirur të gjejë praninë e një elementi etnik që fliste latinisht në disa anë jugore

---

4 Balkan – Arkiv IV 195 vv., sidomos 212 vv.

të Shqipërisë veriperendimore në kohën antike. Çabej shkruan se ky mendim gjen vijimin e tij historik në tezën e shprehur që më parë nga ana e një lagjeje dijetarësh, historianë e gjuhëtarë, se mbi dëshminë e disa dokumenteve historike, nëpër qytetet më në veri të asaj ane ka qenë folur gjer në mesjetën e plotë një gjuhë romane më vete nga ana e pasardhësve të provincialëve romakë; kjo tezë ka gjetur shprehjen e saj linguistike në pranimin e një gjuhe romane më vete në këto anë dhe në emërtimin “albano-romanishtja” (albano-romanico) të kësaj gjuhe nga ana e Matteo Bartoliti<sup>5</sup>.

Nga pikëpamja historike ndikimin e latinishtes në gjuhën shqipe, Çabej, e shtrin në një periudhë kohore prej afërsisht tetë shekujsh. Këtë ndikim e nis me fillimet e shekullit të tretë para erës sonë, atëherë kur Roma, me pushtimin e Italisë së mesme e të një pjese të mirë të Italisë jugore, shfaqet në brigjet lindore të Detit Adriatik. Ky ndikim vijon në shqipen popullore pa ndërprerje edhe pas mbarimit të Perandorisë Romake, gjer aty nga shekulli i gjashtë i erës sonë, kur shfaqen dëshmitë e para të italishtes si zhvillim organik i gjuhës latine. Kuptohet vetvetiu që gjatë një periudhe kaq të gjatë, gati njëmijëvjeçare, shqipja, sidomos si një gjuhë e pashkruar që ka pësuar mjaft ndryshime, duke kaluar prej fazës antike të saj në fazën mesjetare. Të një rëndësie themelore e paraqet faktin që elementi i shqipes me burim latin, në pjesën më të madhe hyn në leksikun e përgjithshëm roman, duke përkuar shpeshherë me gjuhët romane qendrore. Kështu p.sh. fjalë të një karakteri më të përgjithshëm e të një shtrirje të hapët, si – ndër të tjera – **aër, aestimare, amicus, benedicere, bucca, caelum, castigare, causa, donare, fabella, fabrica, gallus, gente, hora, inimicus, insula, invitare, latinus, laude, lege, magister, medicus, meridies, natura, nodus, oleum, oliva, opera, orare, pace, placere, potestate, praeda, quarta, radix, rege, robur, saeculum, sagitta, sanitate, scala, spiritus, tegula, testimoniare, unctura, versus**, rrojnë në shqipen popullore. Përkundrejt kësaj mase leksikore, për disa fjalë latine, Prof. Çabej shkruan se në fushën e gjuhëve romane nuk mbijetojnë e që ruhen vetëm në shqipen dhe që si të tilla e ndihmojnë ravizimin e karakterit të përgjithshëm të elementit latin të kësaj gjuhe.

Në fushën fonetike, prej Jernej Kopitarit u vu re së pari, qysh më

<sup>5</sup> Italia e Croazia 121 vv.

1829, që në latinisht **ke, ki** okluzivi gutural ka ruajtur në gjuhën shqipe karakterin e tij në formë të një palatali (**cepa: qepë: cicer: qiçër**), në pajtim me dalmatishten e sardishten, ku është ruajtur artikulimi velar (**ke, ki**), e në kundërshtim me italishten e rumanishten, ku shfaqet zhvillimi i mëtejshëm në afrikate, it. **cipola**, rum. **ceapa**. *Përtej vjetërisë së këtij elementi* prof. E. Çabej, sheh edhe disa tipa të sistemit morfologjik: Neutrum latin, i cili në periudhën e latinishtes vulgare më së shumti ishte rrafshuar e shkrirë me mashkulloren e pjesërisht me femëroren, dhe që në gjuhët romane nuk rron më askund si gjini më vete, në literaturën e vjetër shqiptare del i ruajtur mirëfilli krahas me asnjësat e fondit të trashëguar: khs. emrat **damnum: damtë, iudicium: gjyqtë, pignus: penktë, signum: shenjë** etj., në dallim të shquar nga mashkulloret e femëroret e rrjedhës latine, **arcus: harku, cubitus: kuti, camisia: këmisha**. Në lëmin e visarit të fjalëve, shqipe e **diel** është një përkthim, një kalk më i hershëm, i kohës pagane të latinishtes: **dies solis**, ashtu siç janë edhe emrat e kësaj dite të javës në gjuhët gjermanike (anglisht: **Sunday**, gjermanisht: **Sonntag** etj.), ndërsa emrat e saj në gjuhët romane (*frëngjisht: dimanche*, italisht: **domenica**, rumanisht: **dumineca** etj.), rrjedhin prej (dies) **dominica**, emërtim kishtar më i vonë i kësaj dite, i cili shfaqet në shekullin e katërt të erës sonë, formuar pas gjedhes së greqishtes: **kiriake**. Në fjalëformim, fjala shqip: **qepë**, bashkë me rumanishten: **ceapa**, pasqyron formën e thjeshtë **cepa** të latinishtes, *përkundrejt* dalmtishtes: **kapula**, italisht: **cipolla** etj., reflekse të formës më të vonë **\*cepulla**. Me veprimin e vazhdueshëm të latinishtes nuk mungojnë në shqip edhe huazimet prej latinishtes së vonë dhe latinishtes mesjetare, si: **flori, grosh, taftar**. Çabej këtu shkruan edhe për gjurmë të një ndikese me anë fjalësh librore, savante, me kalke kryesisht të sferës abstrakte të leksikut, si **kreatyrë, natyrë, tempull** e të tjera.

Për fjalën **përrallë**, prof. Çabej shkruan se nuk vjen nga greqishtja: **e parabole**, po nga latinishtja: **parabola** *që ka dalë prej saj*. Ndërsa për fjalët, si: **kallm** e **qerm** “anë, buzë, qenar” për të cilat, punën e burimit, a prej greqishtes së vjetër (**kalamos, terma** “cak, fund mbarim”, **termon** “cak, kufi ndërmjet arash”) a prej latinishtes (**calamus, terminus, termen** “gur kufiri, kufi, fund, skaj”) nuk shprehet në mënyrë të prerë. Ka pastaj fjalë me

rrugë depërtimi të ndryshme, me rrugë dyfishe, si: **parriz** prej lat.: **paradisus, i parajsë** prej gr. **paradheisos**. Ka disa fjalë nga tema greke: **balladër “ujvarë”, kulshedër, përrallë** etj. që kaluan në latinishte e prej andej në gjuhën shqipe. Të tilla janë dhe: **flamur, nun, pallat, radhë, rrogë, visar të cilat kanë hyrë në gjuhën shqipe**, si huazime indirekte, nëpërmjet greqishtes, në periudhën bizantine edhe më vonë.

Një rëndësi të veçantë në këtë punim prof. Çabej i kushton edhe një numri jo të vogël leksemash, të cilat më parë ishin trajtuar si *të burimit të huaj, bëhet fjalë për një material të trashëguar të gjuhës shqipe*. Me këtë punë janë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme përpjestimet sasiore midis elementit leksikor të vendit dhe elementit të burimit të huaj. Duke u kufizuar në disa shembuj, Çabej përmend këtu se s'janë latine, por të gurrës vetjake të gjuhës fjalë të një përdorimi të gjerë, si: **afroj, arë, bjeshkë, blej, bluaj, burg, çë, çoj, dëboj, dështoj, dua, eci, flakë, fle, fushë, fyell, fyt, grurë, gjurmë, gjysh harroj, hyj, jashtë, jetë, kallëz, këqyr, krye, kthej, laj e shpëllaj, i lehtë, lot, luaj, lule, mbërthej, zbërthej, mbuloj, zbuloj, nder, ngatërroj, nis, nuk, nuse, petk, për, pikë, pyes, qark, që, qumësht, rroj, rruaj, sipër, shaj, shkoj, shkruaj, shpejt, shtrungë, terr, tmer, truall, thekër, thelb, ther, thërrime, unazë, unë, ve, vegël, vig, zdryp, zgjoj** e shumë të tjera.

**“Romantizmi në Europën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare”** (1995, viti XXXIII, nr. IV, ky studim është shkruar më 1945 dhe pa dritën e botimit për herë të parë në veprën: Eqrem Çabej *“Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”* që u botua më 1994 në Tiranë. Kolegjiumi i redaksisë së revistës *“Jehona”* kanë shkëputur dhe kanë botuar pjesën e tretë të këtij studimi).

Rëndësia e këtyre studimeve të profesor E. Çabejt, këtij eruditi dhe personaliteti të shquar të shkencave albanologjike në përgjithësi dhe të gjuhësisë shqiptare në veçanti, të botuara në revistën *“Jehona”* (Shkup), është kolosale për shkak të kohës dhe vendit ku u botuan, por veç të tjerash, kanë qenë pika referimi për zhvillimin e studimeve të gjuhës shqipe nga gjuhëtarët e Trevave Lindore Shqiptare (sot Maqedonia e Veriut).

## Literatura e shfrytëzuar:

**Nesimi, Mr. Remzi:** *Prof. Eqrem Çabej – erudit dhe personalitet i shquar shkencor*, Jehona, 7/1980, viti XVIII, f. 606-610, Shkup, 1980.

Çabej, Eqrem, *Mbi disa çështje të traditës së shkrimit dhe të drejtshkrimit të shqipe*, rev. Jehona, viti X, nr. IX, f. 3-16, Shkup, 1972.

Çabej, Eqrem, *Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe*, rev. Jehona, viti XI, nr. VII, f. 48-76, Shkup, 1972.

Çabej, Eqrem, *Elementet latine të gjuhës shqipe*, rev. Jehona, viti XII, nr. IV, f. 3-20, Shkup, 1974.

Çabej, Eqrem, *Romantizmi në Europën Lindore e Juglindore dhe në literaturën shqiptare*, rev. Jehona, viti XXXIII, nr. IV, Shkup, 1995.

Ben Andoni

## **SHKRIMI I PROFESOR ÇABEJT, SI NARRACION LETRAR**

### **Hyrje**

Është afër mendsh, që sapo të përmendet emri i profesor Eqerem Çabej, mendja të të shkojë instinktivisht tek gjuhësia. Dhe, nuk mund të ndodhë ndryshe, duke pasur parasysh peshën e jashtëzakonshme që përmban vepra dhe kontributi i tij në gjuhësi. Kjo e fundit e bën xheloze letërsinë kombëtare dhe jo vetëm, sepse i ka vjelë personalitetit të Çabejt më së shumti mendimin, përkushtimin dhe veprën e tij të pasur intelektuale. Në fakt, veç soneteve të tij, ai iu kushtua, sidomos në periudhën e para Luftës së Dytë Botërore, një angazhimi shumë interesant në detyrat që po i hapeshin gjuhësisë shqiptare, ndërkohë që shikoi një ngasje serioze me aspekte të ndryshme teorike, lidhur me vendin e letërsisë kombëtare, kritikës dhe sidomos folklorit. Sak në këtë lëmë po bëjmë një rravim në veprën e tij.

Po a është e mundur, që studiuesi i gjuhësisë, i cili merret thellësisht me teorinë dhe letërsinë, të përshfaqet edhe vetë si krijues? Në rastin e profesor Çabejt, duke marrë parasysh, kulturën, njohjen e artit, argumentimin e shumë temave me një formë të zgjedhur, si rrëfim përmes shkrimit, i jep gati çdo punimi të tij karakterin e një tregimi. Dhe, hapi i parë në përcaktimin e lidhjes narrative është të merret në konsideratë domeni i duhur i saj. Mund të konsiderohet e pakundërshtueshme të thuhet, se fusha e diskursit narrativ përbëhet të paktën nga ngjarje dhe gjendje. Do të përpiqemi ta trajtojmë këtë përmes kuptimit të narracionit. Një

lidhje narrative përfaqëson një sërë ngjarjesh dhe/ose gjendjesh. Përmendja e një serie këtu nënkupton që narrativat përmbajnë citimin e dy, por ndoshta të më shumë ngjarjeve dhe/ose gjendjet e një narrative? (Van Peer, W. & Chatman, S. (2001). Në një nga studimet e Çabejt, e citojmë shembullin e parë: “Perëndija e ernavet, qi fryjnë prej detit, quhet Talas dhe ky ëmën është marrë prej greqishtes asa paragreqishtes falassa. Mauthija, qi asht një *zâne e veshun me ar dhe qi nderohet n’Elbasan, asht ndoshta Amalfeja e Grekvet të vjetër, qi nderohet në Dodonë. Kulshedra, gjarpën me shtatë krena, në Tiranë, më kujton Hydren e Grekvet. Gjithashtu edhe legjenda e Perseut dhe e Andhromedës jeton sot në Shqipni”* (Çabej, 35). Jo vetëm, në këtë shkrim, por përgjatë shumë punëve të tij gjejmë shpjegime dhe interpretime të simbolikave, që jetojnë në vend, por edhe ritualeve arkaike, që i hasim ende në vende të ndryshme në Shqipëri, masje në një formë rrëfimi tejet elegante. “Në Gjinokastër vajtimi i hutinit mbi pullazin e shtëpisë paralajmon lindjen e një djali, përkundrazi ajo i kukuvajkës lindjen e një vajze” (Ibid). Për Hagar Salamon dhe Harvey E. Goldberg (2012), simboli, miti dhe rituali konsiderohen si tre mjete shprehjeje të ndërlidhura me njëri-tjetrin, qoftë në nivelin estetik, ashtu edhe në dimensionet e tjera rregullatore dhe komunikuese në atë që mund të përkufizohet qartë si një “gjuhë e kulturës”. Është bash kjo kohë disi inkurajuese para lufte, kur mesazhi që përcjell nga formimi i tij, tashmë i transformohet në një kërkesë dhe nxitje për të kontribuar më thellësisht në letërsi. “Përveç aspekteve teorike, që ndërlidhen në historinë e letërsisë shqipe, me gjenezën e saj, me romantizmin si një formacion stilistiko-letrar të zhvilluar në kuadër të saj, Çabej më 1936 i rreket punës për ta hartuar një histori të letërsisë shqipe . Fjala është për librin ‘Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe’” (Matoshi, 2008).

Pak vite më vonë, në një kohë të tjetër, që dikton metodika të reja, bën që fill pas mbarimit të Luftës së Dytë më 1946, profesor Çabej të mbajë ligjëratat lidhur me linguistikën dhe albanologjinë në Shkollën e Lartë të Tiranës. Duke shtuar kontributin e tij të pamohueshëm, në periudhën para lufte, duket se nuk mund ta braktisë interesin dhe pikëvështrimin e tij interesant për folklorin “... jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për folklorin e letërsinë artistike,

me një anim të lehtë nga kjo fushë e dytë. E kjo duket qartë edhe nga titujt e botimeve të tij të kësaj periudhe, kur krahas studimeve thjesht gjuhësore ka botuar edhe studime nga fusha e folklorit dhe e letërsisë, ose edhe studime me karakter të përzier gjuhësor e letrar. Nga studimet thjesht gjuhësore të asaj periudhe mund të përmendim nga fusha e folklorit dhe e letërsisë mund të përmendim ndër të tjera: *Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare*, *Zakone dhe doke të shqiptarëve*, *Konstandini i vogëlith dhe kthimi i Odiseut*, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, *Kulti dhe vijimi i hyjneshës Diana në Ballkan*” (Demiraj, 1990).

Në kohën, që i dedikohet kësaj veprimtarie, publiku ka nevojë dhe etje për formësimin e një ndërgjegjeje, që i shkon kohës, ashtu sikurse ky lloj i ri optimizmi i pasluftës, që ushqehet nga propaganda, kërkon një identitet. Dhe, këtu punët e profesorit mund të shërbejnë sërish e më së miri për këtë qëllim, paçka se një pjesë datojnë pak vite më parë. Teorikisht, rezultati i procesit narrativ, vetë llojet e narrativave, ndikojnë në zhvillimin e vetëdijes individuale dhe kontribuojnë në formësimin e identitetit të njerëzve. Prandaj, të tilla si tregimet e këtij lloji bëhen pjesë e kujtesës kolektive të popullit (Halbwachs 1992; Wertsch 2008), sepse krijojnë imagjinatën e ndarë nga anëtarët e të njëjtit grup përmes një procesi intensiv akulturimi, që ravijëzohet i ardhur qysh në hershmërinë e jetës. Rrëfimet janë pjesë e asaj që Wundt (1916, 4) i quan ndikime që e rrethojnë qenien qysh në hershmëri dhe janë të pandashme nga procesi, i cili lind spontanisht brenda vetëdijes së qenies. Tek Çabej shikohen shpesh ndikime dhe respekti për folklorin kombëtar, por edhe ndjesi të ndërfitura thellë nga vitet e hershme të formimit.

Nga teksti “Elemente të gjuhësisë e të literaturës shqipe” të botuar më 1936, në orët e mësimi ai jepte edhe njohuri për gjuhën dhe sidomos folklorin shqiptar me të cilin e konsideron si një minierë studimi. Te “*Kënga e Lenorës në poezinë popullore shqiptare*”, na rrëfen jo vetëm shqyrtimin, por edhe hulumtimin e thellë, duke bashkëpunuar edhe me nxënësit, që u kërkon si anketime variante të kësaj kënge nga treva të ndryshme dhe vetë me një narracion të këndshëm pothuaj letrar na sjell diku variantin e Lambertz-it: “E ëma nuk e mallëkon të birin as e lë djerrë varrin e tij, sikurse në variantet greke dhe bullgare, por përkundrazi, në



ditën e të vdekurvet ajo në varrin e gjithë bijve ndez nga një qiri dhe derdh nga një vajtim, te varri i Kostandinit ndez dy qirinj e derdh dy vajtime...” (Çabej, 34). Duket se këto janë të futura thellë tek ai. Ka pjesë të një kulture popullore, të cilat ne i mësojmë pa i ditur, referuar nga studiuesi (Díaz Viana 2005a) dhe që ndikojnë edhe në psikologji. Më e rëndësishmja është, ashtu siç referon Daniel D. Hutto (2008), se psikologjia popullore fitohet përmes këtyre tregimeve specifike. Fjala është për një mbresë të përgjithshme, që kushtimisht të përcjell në botën e përrallës dhe asaj që i shkon formave letrare të rrëfimit. Është e sigurt se krahasimi analitik i kësaj forme dhe përrallës pothuajse s’ka ku të mbështetet: format letrare mund ta imitojnë përrallën e gjatë dhe kjo të mbetet novelë, mu sikurse që për nga çdo element i saj i veçantë, përralla mund të merret si një lloj apo si një formë origjinale, ose një novelë e përshtatur sipas mundësive. Kundërthënia në mes të hapësirës, që e formëson përralla dhe asaj që i jep trajtë çdo lloj forme letrare, mund të vërehet më parë në mbështetje të përshtypjes që krijon, sesa në bazë të ndonjë konkluzioni (Solar, 1983).

Në fakt, tema jonë mëton të tregojë një sendërtim përpjekjesh në periudhën para luftës, që edhe në vepra kryesisht studimore dhe përkrahuese, profesori të përcjellë në stilin e tij elementë të narrativës së tregimit dhe deri diku të novelës, e lidhur kjo jo vetëm për shkak të gjatësisë së shkrimit. Por, në parathënien e “Mesharit”, kjo ndjesi ravijëzohet qysh në paragrafin e parë, ku duket për një moment se është duke nisur një punë mirëfilli korale, siç do të ishte romani. “Ky më i pari monument i literaturës shqiptare që dihet gjer më sot, pat rënë në më se tre shekuj e gjysmë të harresës e qe përshkuar nëpër peripeti të shumëllojshme, gjersa u zbulua përfundimisht e u bë prona e botës shkencore”, citojmë profesor Çabejn në hyrjen e “Mesharit”.

Studimet e shumta kanë treguar, se njohja dhe kultura krijojnë një hapësirë të ndërthurur, ku mund të gjejmë nocionin hibrid të narrativitetit. Ndërkohë kemi një produkt mirëfilli studimor, ku mund të gjejmë shumë ndjesi rrëfimi, e kjo aftësi e profesorit përshfaq koncepte dhe me anë të krahasimit i jep qytetari studimeve shqiptare. Një koncept përkufizohet si aftësia njerëzore për ta interpretuar botën në mënyrën narrative (Hardy 1968; Bruner 1991),

megjithëse ka edhe një dimension material. Në përpjekjen për të kontribuar në dallimin klasik midis strukturës narrative dhe procesit kompozicional, Peter Goldie (2012) pohon, se ekziston një ndryshim i fortë midis narrativës si produkt dhe narrativës si proces. Në një kuptim të përgjithshëm, i pari përfshin çdo gjë që ka një strukturë narrative, historinë që tregohet, ndërsa ka edhe një veprimtari specifike njerëzore, kolektive apo individuale, që prodhon këto materiale kulturore. Dhe, në rastin tonë dhe studimore. Nëse nuk do e kishin këtë përmasë narracioni, punët e profesor Çabejt mezi do lexoheshin, ashtu si përthithen sot e kësaj dite. William C. Dowling (2011, 4) pohon se konceptimi i kulturës si një sistem simbolik, i përcaktuar nga Paul Ricoeur në “Time and Narrative”, është thelbësor pasi “ai siguron një kontekst të nevojshëm për interpretimin e veprimit njerëzor”. Në fakt, për filozofin francez, narrativiteti është mediumi më i sigurt, që i lejon njerëzit të kuptojnë njëri-tjetrin në jetën e përditshme. Dhe, duke u bazuar dhe në konceptimin dhe duke ndjekur mendimin e Aristotelit se *nga* çdo histori e thënë mirë mëson diçka dhe zbulon aspekte universale të gjendjes njerëzore, pohohet se nga zhanret letrare zhvillojnë te lexuesit një lloj kuptimi më të thellë dhe përmbajtësor. Kjo është një mënyrë për të kuptuar realitetin, i cili është afër urtësisë praktike të gjykimit moral, diçka që përcaktohet si inteligjencë narrative (Ricoeur, 1991). Në studimet për letërsinë dhe punët e folklorit, lexuesi e ndjen këtë përmasë, që duke ndërthurur kulturën, historinë e bën të kuptojë një realitet, të shkojë deri te një perceptim gjykimi moral. Dhe, ashtu si u tha më sipër, qoftë në qëndrimin, përkushtimin dhe thellësinë e punëve të tij, shprehur me një narracion interesant, prof. Çabej parashtron dhe një dimension mirëfilli edukues dhe moral të cilësisë së artit tonë.

Ndërkohë misioni i profesor Çabejt duket se do të sjellë dhe një përpjekje për kujtesën e jashtme, që mund të vijë shumë mirë dhe nga këto trajtesa që bëhen në pjesët e ndryshme të studimeve në letërsi dhe sidomos në folklor. Në kohët e sotme, Merlin Donald-i parashtron një hipotezë rreth tranzicioneve të njëpasnjëshme njohëse në evolucionin njerëzor, në të cilën ai identifikon një fazë të tretë zhvillimore, ku u shfaqën ruajtjet dhe rikthimet e kujtesës së jashtme (Donald 1993a). Në këtë rrjedhë, Damasio (2010) nënvizon përparimin e sistemeve të ruajtjes së kujtesës së jashtme, jo vetëm

të atyre të instaluara organikisht në trurin e njeriut, por edhe të atyre që inteligjenca njerëzore i ka projektuar dhe prodhuar. Këto sisteme të kujtesës artificiale përbëjnë çelësin për rritjen e evolucionit të mendjeve njerëzore, pasi ato lejojnë të mësuarit më të shpejtë përmes transmetimit të sasive më të mëdha të njohurive të grumbulluara. Kështu, shpjegon Ricoeur (1990), filli i një rrëfimi mbledh dhe integron në një njësi të plotë disa ngjarje dhe të shpërndara, duke skematizuar domethënien e kuptueshme që i bashkëngjitet të gjithë historisë. Konstatohet, falë studimeve të shumta, se kjo aftësi njerëzore është ajo që Mark Turner-i (1996, 5) e quan imagjinatën narrative, e përcaktuar si “të kuptuarit e një kompleksi objektesh, ngjarjesh dhe aktorësh të organizuar nga njohuritë tona për historinë”. Ky është instrumenti themelor i mendimit.

Donald-i argumenton se kujtesa semantike është ajo që bën dallimin për të prodhuar përfaqësime dhe për të shpikur sisteme simbolesh. Varet nga ekzistenca e strukturave abstrakte, të dallueshme përfaqësuese, të cilat vetëm njeriu mund t'i krijojë. Katherine Nelson (1998) pajtohet me të në atë se njësia bazë e përvojës është ngjarja dhe, për rrjedhojë, edhe kujtesa dhe ndërtimit brenda sistemit të kujtesës (Nelson 2007).

Dhe, Çabej e bën këtë përmes përcjelljes së shumë autorëve arbëreshë, laboratorit tonë gjuhësor, kujtesës sonë. Lëmia e tij do e përballë me ta, jo thjesht në aspektet gjuhësore por edhe përshkruese në letërsi me një narracion, që të jep idenë e skicave tregimtare. Shikon gjëra shumë interesante për **Jul Varibobën**, i cili përbën korpusin klasik të shkrimtarëve shqiptarë të Italisë, duke e kurorëzuar si poeti më i vjetër i letërsisë shqipe. Ashtu si mund të merret lehtë me përshkrimin që i bën **Jeronim de Radës**, duke e konceptuar si më të parin ndër poetë shqiptarë të Italisë, **Zef Seremben** si improvizator gjenial dhe “një nga fytyrat më markante të literaturës shqipe” (Çabej, 1986). Në Sicili i blaton skeptrin e poetit të vërtetë **Skirroit**, ashtu si për “*Kënkën e sprasme të Balës*” e thotë qartë se nuk është mistifikim letrar, por i takon personalitetit të **Gavrill Darës** dhe, madje “*është një nga veprat më të bukura të literaturës shqipe*”(Ibid). Në periudhën që i takon letërsisë së shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, ku shtrihet dhe fokusi i tij, Çabej nuk mund t'i shmanget autorëve më të shquar. Këtu rrëfen

dhe përshkruan: “**Naimin** si “apostull të idesë nacionale e romantik të vonuar”; **Fishtën** si “shkrimtarin e parë të kohës kur u shkrua historia”; **Asdrenin** e konsideron “poet artist në kupëtimin e plotë të fjalës” (Ibid) dhe si autor që “formon kalimin nga brezi i kaluar në poezinë moderne shqiptare” (Ibid), **Konicën** e vlerëson për stilin e mprehtë dhe merret me mend “Albaninë”, kurse **Nolin** për përthithimet e tij e në mënyrë të veçantë për “Rubairat” e Khajamit. Por, pjesën e kulturës, njohurive, teknikave, që ai zotëronte, e shikon indirekt dhe tek vlerësimi i Kadaresë për profesor Çabejn: “Jeta dhe vepra e Çabejt është një ngjitje në ngrehinën e madhe të universit të gjuhëve, që është një lartësi e vështirë e shkencës dhe një bastion i vërtetë i qytetërimit shqiptar. Kam patur fatin ta njoh e ta takoj shumë herë Eqrem Çabejn. Më shumë se i njëjti qytet ku kishim lindur, na bashkonte mbarë gjuha shqipe, ajo që flitej nga jugu në veri, e përtej kufijve e përtej detit e përtej oqeanit Atlantik. Njohja me të më erdhi nëpërmjet një drejtimi të lumtur : poezisë. Ai u mor tërë jetën me një nga përmasat më të gjera, më madhështore e më misterioze të jetës sonë: gjuhën....”.

### **Përfundim**

Kontributi që prof. Çabej ua ka blatur studimeve në fushën e letërsisë, si në planin e kritikës letrare edhe në narracionin e tij, por edhe në studimin e romantizmit shqiptar për ta vënë në një raport krahasues me romantizmin e popujve të Evropës, apo puna e bërë në periodizimin e historisë së letërsisë shqipe dhe në hartimin e një historie po për këtë letërsi, tregojnë se elementi i narracionit e ka ndihur të gjithë këtë veprimtari. Mrekullia e punës së tij është se punët e tij lexohen sot e kësaj dite, falë tipareve të zgjedhura të narracionit përdorur normalisht në studime. Paçka se letërsia nuk ia mori kohën e plotë të studimeve dhe përpjekjeve teorike për narracionin, prof. Çabej në një sërë punësh ka lënë tragë për studiuesit, që në të ardhmen të punojnë më shumë për cilësinë dhe thellësinë e narracionit të tij. Dhe, në frymën moderne që trajtohet sot narracioni, puna e tij, edhe pse gati e përgatitur një shekull më parë, ruan cilësi dhe thellësi dhe ende një grishje që duhet ndjekur dhe të përbëjë temë studimi.

## Referencat

- Bruner, J., S. 1991. The Narrative Construction of Reality. *Critical Inquiry*, 18 (1): 1–21. <http://www.jstor.org/stable/1343711>
- Çabej, E. (1934). Normalisti, nr.6., Elbasan, f.19-22
- Çabej, E. (1935). Zakone dhe doke të shqiptarëvet. *Illyria*, 1935-1936, nr.34-50, Tiranë.
- Çabej, E. (1986) Vepra e përmbledhur. f. 29, 40, 41
- Damasio, A. 2010. *Self Comes to Mind: Constructing the Conscious Brain*. New York, NY: Pantheon Books.<http://search.ebscohost.com/login.ct=true&scope=site&db=nlebk&db=nlabk&AN=761455>.
- Demiraj, Sh. (1990). “Eqrem Çabej, një jetë kushtuar shkencës”. 8 nëntori. (Shkëputur nga [origjinali](#) më 10 tetor 2023).
- Diaz Viana., L. 2005a. Los caminos de la memoria: oralidad y textualidad en la construcción social del tiempo. *Acta Poética* 26 (1): 181–217. <https://dialnet.unirioja.es/servlet/articulo?codigo=2702733>
- Donald, M. (1993a). *Origins of the Modern Mind: Three Stages in the Evolution of Culture and Cognition*. Cambridge, Mass.; London, England: Harvard University Press.
- Dowling, W., C. (2011). *Ricoeur on Time and Narrative: An Introduction to Temps et Récit*. Notre Dame, IN: University of Notre Dame Press.
- Goldie, Peter. (2012). *The Mess Inside: Narrative, Emotion, and the Mind*. Oxford, UK: Oxford University Press.
- Halbwachs, M. (1992). *On Collective Memory* 1992. Edited by Lewis A. Coser. Chicago and London: The University of Chicago Press. [https://m/2323632\\_258215069?hash=088d0a68dc307ebe8b&dl=085736d4624aa83fc3](https://m/2323632_258215069?hash=088d0a68dc307ebe8b&dl=085736d4624aa83fc3)
- Hardy, Barbara. (1968). Towards a Poetics of Fiction: 3) An Approach through Narrative. *NOVEL: A Forum on Fiction* 2 (1): 5–14. doi:10.2307/1344792.
- Hutto, Daniel D. (2008). *Folk Psychological Narratives: The Sociocultural Basis of Understanding Reasons*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Matoshi, H., (2008). Eqrem Çabej dhe historia e letërsisë shqipe. (Shkëputur nga <https://www.zemrashqiptare.net/neës/4894/hysen-matoshi-eqrem-cabej-dhe-historia-e-letersise-shqipe.html>)
- Nelson, Katherine. (1998). *Language in Cognitive Development: The Emergence of the Mediated Mind*. Cambridge, UK; New York: Cambridge University Press.
- Nelson, Katherine. (2007). *Young Minds in Social Worlds:*

Experience, Meaning, and Memory. Cambridge, MA and London, England: Harvard University Press.

Ricoeur, Paul. (1991). Life in Quest of Narrative. In On Paul Ricoeur: Narrative and Interpretation, *edited* by David Wood, 20–33. London: Routledge.

Salamon, H. & Goldberg, H., E. (2012) Myth-Ritual-Symbol. Nė: A companion to Folklor.

Solar, M. (1983). Roman kao knjiŹevna vrsta. Treći program. Radio Beograd, nr 57.

Turner, M. (1996). The Literary Mind. Nė: The Origins of Thought and Language. Kindle edition. New York; Oxford: Oxford University Press, USA.

Van Peer, W. & Chatman, S. (2001). New perspectives of narrative perspective. F.23,

Wertsch, J. V. (2008). The Narrative Organization of Collective Memory. Enė: thos 36 (1): 120–35. <http://www.jstor.org/stable/20486564>.

Wundt, W. (1916). *Elements of Folk Psychology: Outlines of a Psychological History of the Development of Mankind*. Translated by Edward Leroy Schaub. London; New York: George Allen And Unwin Ltd.; The Macmillan Co. <http://archive.org/details/elementsoffolkps014744mbp>

Edmond Malaj

## **JETA DHE VEPRIMTARIA E E. ÇABEJT NËN DIKTATURËN KOMUNISTE**

Rreth burimeve dhe literaturës

Ky punim është bazuar mbi dokumente dhe artikuj shkencorë. Një fond i rëndësishëm për punimin është edhe dosja formulare e Sigurimit të atëhershëm të Shtetit, e cila gjendet tek AIDSSH (Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit), të cilën patëm mundësi ta shfrytëzonim pjesërisht. Një burim të dhënash janë edhe kujtimet e së bijës së Çabejt, Brikena Çabej.<sup>1</sup> Dosja formulare e lartpërmendur mbante numrin 2383, përbëhej nga 205 fletë dhe u mbajt deri pesë muaj pas vdekjes së Eqrem Çabejt më 13 gusht 1980.<sup>2</sup> Një artikull i rëndësishëm së veçantë është edhe ai i studiueses Ledia Dushku me titull “Armik i popullit që shkencërisht punon për ne”<sup>3</sup>, të cilit i jemi referuar më poshtë. Po ashtu me rëndësi është edhe “*Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist*”<sup>4</sup>, në dymbëdhjetë vëllime, i cili merr në shqyrtim të imtësishëm pa përjashtim çdo qytetar që iu nënshtrua përndjekjes direkte, pavarësisht nga funksionet apo përkatësia social-politike që ka pasur para dhe gjatë regjimit komunist. Pra titujt e mësipërm janë literatura bazë që u përdor në hartimin e këtij artikulli. Titujt e tjerë që nuk i përmendëm këtu më sipër, gjenden të cituar nëpër fusnota, si dhe në bibliografinë në fund të punimit.

1 Brikena Çabej, “Takimet e tim Eti me Enver Hoxhën”. URL: <https://gazeta-shqip.com/2017/03/08/brikena-çabej-takimet-e-tim-eti-me-enver-hoxhen/> (Aksesi: 1. 2. 2024)

2 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor që shkencërisht punon për ne”, në: *Studime Historike* 3-4/2020, f. 221.

3 Po aty, f. 221.

4 *Fjalori enciklopedik i viktimave të terrorit komunist. në dymbëdhjetë vëllime. I-XII. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. 2012-2023.*

Të dhëna biografike të papërshtatshme

Sistemi komunist në Shqipëri i vinte shumë rëndësi biografisë së personave dhe origjinës së tyre familjare. Gjatë diktaturës komuniste në Shqipëri ekzistonin dy koncepte në lidhje me identitetin e personave dhe bindjeve të tyre politike. Këto ishin “*biografi e keqe*” dhe “*biografi të mirë*”, të përcaktuara sipas kriteresh në fakt të pashkruara, por që në kohën e komunizmit gjenin një përdorim të gjerë. Njerëzit me *biografi të mirë* ishin ata persona që jetonin dhe vepronin me besnikëri sipas diktatit që udhëzonte partia në pushtet dhe udhëheqja e saj. Ata kishin komunistë në familje ose ishin vetë të tillë, apo kishin dëshmorë në farefisën e tyre. Ndërsa njerëzit me *biografi të keqe* ndaheshin në disa kategori, por neve na intereson të përmendim këtu dy të tilla që nuk shiheshin me sy të mirë nga pushteti i asaj kohe: në njërin kategori bënin pjesë ata që dikur kishin qenë të pasur, si p.sh. tregtarë, qytetarë apo edhe fshatarë të pasur (*kulak*<sup>5\*</sup>), ndërsa në kategorinë tjetër, në atë më të rrezikshmen, sipas këndvështrimit të pushtetit, bënin pjesë ata që mendonin politikisht ndryshe, që e shprehnin pakënaqësinë ndaj sistemit, ishin disidentë e madje kishte prej tyre që edhe kishin vepruar kundër shtetit të diktaturës. Shpeshherë mjaftonte që të kishe të paktën një pjesëtar të tillë në familje apo në farefis dhe damkoseshe përgjithmonë si njeri me “*biografi të keqe*” nga opinioni. Organet e shtetit të trajtonin si nështetas të kategorisë së dytë apo edhe më keq, duke të privuar nga shumë të drejta<sup>6\*</sup> që i kishin nështetasit e tjerë me biografi “normale”, dhe në shumë raste edhe duke të përgjuar.

---

5\* Sipas Fjalorit Enciklopedik Shqiptar të periudhës së diktaturës KULAKËT ishin “*Elementë kapitalistë të fshatit (fshatarë të pasur), që kishin edhe qëndrim të keq politik. Zotëronin një bazë të shëndoshë ekonomike; nëpërmjet shfrytëzimit të punës së fshatarëve të varfër nxirrin fitime disa herë më të mëdha se fshatari punonjës; mbanin lidhje e bashkëpunimin me bejlerët, bajraktarët, klerikët reaksionarë, kriminelët, diversantët dhe armiqtë e tjerë të pushtetit popullor. Cilësimi i kulakëve nga byrotë e komiteteve të Partisë të rretheve mbi bazën e propozimeve të organizatave-bazë të Partisë filloi në vitin 1949 dhe vazhdoi edhe në vitet 50. Kundër kulakëve u ndoq politika e kufizimit ekonomik, që synonte dobësimin shkallë-shkallë të bazës së tyre ekonomike nëpërmjet tatimit në natyrë dhe në të holla, si dhe politika e veçimit politik, që synonte likuidimin e ndikimit të tyre ndaj fshatarëve nëpërmjet demaskimit publik të veprimtarisë shfrytëzuese dhe armiqësore të kulakëve dhe mënjanimin të tyre nga jeta politike e shoqërore e vendit. Duke vazhduar me vijimësi këtë politikë, me ndërtimin e plotë të bazës ekonomike të socializmit, u bë likuidimi i kulakëve si klasë, pa qenë nevoja të merreshin ndaj tyre masa administrative shpronësimi”.* (autorët e shkrimit: Apostol Kotani [Ap. Ko.];Turhan Shilegu [T. Sh.]). Fjalor Enciklopedik Shqiptar. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH të Shqipërisë 1987, f. 571

6 \* Këtu mund të përmendim heqjen e së të drejtës për të vazhduar një shkollë të lartë, për të gjetur një vend pune të denjë në bazë të profesionit apo arsimit që kishe, e shumë e shumë të drejta të tjera që nuk mund t'i rreshtojmë këtu..



Tani në lidhje me Eqrem Çabejn po japim më poshtë disa elemente biografike që e bënin atë të dyshimtë, apo të papërshtatshëm, apo shpesh herë edhe me “biografi të keqe” karshi shtetit komunist të asaj kohe. Këto të dhëna biografike<sup>7</sup> i kemi përzgjedhur si më poshtë: Eqremi ishte i biri i një juristi të formuar dhe me aktivitet në Turqi deri në lindjen e tij. Lindi në Eskishehir (Eskişehir Turqi) më 6 gusht 1908, si i biri i një gjyqtari dhe pinjoll i një familjeje të rëndësishme dhe të kamur të Gjirokastrës së paraçlirimit dhe kjo i shënohet edhe në dosjen formulare të Sigurimit të Shtetit<sup>8</sup>. Pas shkollës fillore dhe qytetëse fiton një bursë nga shteti shqiptar dhe në vitin 1920 vazhdon më tej shkollën e mesme në Austri, fillimisht në Sankt Pölten në vitin 1922, pastaj në Grac (Graz) dhe maturën e përfundon në Klagenfurt më datë 8 korrik 1926.<sup>9</sup> Studimet e Larta i ndjek në Universitetin e Gracit (*Karl-Franzens-Universität Graz*) (1927-1929) dhe në atë të Vjenës (1929-1933)<sup>10</sup>, ku përfundon për Gjuhësi të Përgjithshme, Indoevropianistikë dhe Albanologji. Ndër shumë pedagogë kishte dhe profesor Norbert Jokl<sup>11</sup>, tek i cili në vitin 1933 shkroi edhe disertacionin me titull “*Italoalbanische Studien*”<sup>12</sup> dhe mori edhe titullin “Doktor”. Për studimet arbëreshe E. Çabej pati shkëputur studimet universitare në semestrin e verës në vitin 1932, me qëllim që të shkonte në *Piana dei Greci* të Palermo, ku mblodhi materialin për disertacionin e tij.<sup>13</sup> Pas Miratimit të disertacionit më 29 qershor 1933, Çabej e e mbrojti më, 7 tetor

---

7 Në lidhje me të dhënat biografike të hartuara nga Mahir Domi në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të vitit 2008 duhet thekskohet këtu që ato janë të ngjashme por pak më të zgjeruara se ato Fjalorit Enciklopedik të periudhës së Diktaturës dhe kanë shumë mungesa. Në to nuk jepen të dhëna mbi vrojtimin dhe Çabejt nga ana e Sigurimit të shtetit. Shih: Fjalor Enciklopedik Shqiptar. Botim i Ri. Tiranë: Akademia e Shkencave 2008, f. 368; Fjalor Enciklopedik Shqiptar. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH të Shqipërisë 1987, f. 147

8 Dosja formulare: Raport propozim f. 6.

9 Herman, M. Ölberg, “Eqrem Çabej dhe Austria”, në: *Studime Shqiptare 9: Eqrem Çabej personalitet i shquar i shkencës dhe i kulturës shqiptare*. (Në 90-vjetorin e lindjes). Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Sektori Shkencor i Albanologjisë. Tiranë: Çabej MÇM 1998, f. 160.

10 Po aty, f. 161.

11 Jokli pati një ndikim të madh në studimet e Çabejt dhe një ndër këto ndikime është edhe teza trake, të cilën Çabej nuk e mënjanon kurrë por e radhit shqipen „si e bija e trakishtes dhe e ilirishtes“, por që sipas tij „fondin themelor të popullit shqiptar pas gjase e përbejnë ilirët“. Begzad Balu, “Profesor Eqrem Çabej dhe Norbert Jokli – Ndërlidhje Personale dhe Shkencore”, në: *Studime Shqiptare 12: Albanologu i Shquar austriak Norbert Jokli (1877-1942)*. Shkodër: Camai-Pipa 2003, f. 73.

12 Eqrem Çabej, *Italoalbanische Studien: Wiener Dissertation aus dem Jahr 1933*. Mit Beigaben von Oskar E. Pfeiffer und Joachim Matzinger Herausgegeben von Heiner Eichner und Joachim Matzinger. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag 2017 (= Albanische Forschungen nr. 34)

13 H. Ölberg, “Eqrem Çabej dhe Austria”, f. 161.

1933 para një komisioni të përberë prej Paul Kretschmer-it, Norbert Jokl-it dhe Karl Patsch-it.<sup>14</sup> Më pas kthehet në Shqipëri ngaqë kishte lidhur kontratë me shtetin shqiptar që pas studimeve të kthehej dhe të punonte për shtatë vjet.

Pra, E. Çabej bënte pjesë ndër studentët e financuar me fondet e mbretërisë shqiptare dhe diçka e tillë domosdo do ta bënte atë të dyshimtë për regjimin e mëvonshëm. Studimet e tij qoftë ato të mesme, qoftë ato të larta në dy vende Itali dhe Austri, të cilat nga regjimi komunist konsideroheshin si shtete kapitaliste me një histori të caktuar, duhet të kenë ndikuar jo pak në stigmatizimin e Eqrem Çabejt, dhe këtë do ta shohim edhe më poshtë. Personat që kishin studiuar nëpër vendet perëndimore quheshin shpeshherë “kuadro të vjetër”, në krahasim me “kuadrot e rinj” që më vonë përfunduan studimet nëpër vendet socialiste, sidomos në Bashkimin Sovjetik, e më pas edhe në Universitetin e sapokrijuar të Tiranës. Kjo kategori e dytë “kuadrot e rinj” ishin më të preferuar për shtetin. Megjithatë, sunduesit komunistë, pak kohë më vonë, nuk ngurruan t’i dërgonin fëmijët e tyre apo të afërm të tjerë me studime e me specializime nëpër shkollat e vendeve perëndimore, si në Itali, Francë, Gjermani, etj.

Pastaj fakti tjetër, që studimet universitare E. Çabej i kreu tek profesorë të mëdhenj jo vetëm të gjuhësisë indoevropianistike, por edhe të Albanologjike, si: Kretschmer, Patsch, Oberhammer, Jokl etj., do të ketë ndezur jo pak edhe smirën dhe xhelozinë e ndonjë kolegu të tij (nuk po e themi në shumës) në vendin ku ai punonte, duke mos përjashtuar këtu edhe ndonjë spiunim apo raportim, gjë që në Shqipërinë komuniste ka ndodhur shpesh me figura të ndryshme.

Një pikë tjetër ishte edhe anëtarësimi i tij si anëtar i rregullt dhe pjesëtar i këshillit drejtues në Institutin e Studimeve Shqiptare në vitin 1940<sup>15</sup>, më vonë 1942, drejtues i Institutin Mbretnuer i Studimeve Shqiptare dhe në prill 1944, anëtar i Institutit Shqiptar

---

<sup>14</sup> Po aty.

<sup>15</sup> Institutit përbëhej nga 48 anëtarë të përjetshëm, të cilët formonin edhe Këshillin e Përgjithshëm me sekretar të përgjithshëm At Zef Valentinin. Anëtarët e Institutit ishin Ernest Koliqi, Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, At Anton Harapi, Karl Gurakuqi, Lasgush Poradeci, Namik Resuli, At Zef Valentini, Dom Lazër Shantoja, Filip Fishta, At Justin Rrota, Ilo Qafëzezi, Anton Paluca, Xhevat Korça, Kolë Kamsi, Ekrem Vlora, Sotir Kolea, Vangjel Koça, Dhimitër Berati etj. Shih: *AQSH, F. 200: Instituti i Studimeve Shqiptare, V. 1940, D. 1*. Kryetar i Institutit u zgjodh Ernest Koliqi. *AQSH, f. 200: Instituti i Studimeve Shqiptare, V. 1941, D. 4*.

për Studime në Arte.

Bashkëpunimi me institucionet e kohës, si me Institutin Mbretnuer të Studimeve Shqiptare dhe Institutin Shqiptar për Studime dhe Arte nuk duhej të jetë parë me sy të mirë. Ai më pas kërkon të dorëhiqet nga komisionet e punës, sepse në to bën pjesë edhe Atë Fulvio Cordignano<sup>16\*</sup>, për të cilin Çabej e thotë se “ai njihet botërisht si armik i rreptë të racës shqiptare”<sup>17</sup>, por dorëheqja refuzohet ngaqë emërimi i tij si anëtar ishte i përjetshëm sipas statutit. Këto institucione drejtoreshin nga personalitete të shquara të albanologjisë si, Ernest Koliqi, Atë Giuseppe Valentini SJ, etj., të cilët më vonë nga sistemi do të konsideroheshin si armiq, do u ndalohej publikimi dhe leximi i veprave të tyre dhe emrat do të ishin të diskretuar deri me rënien e diktaturës.

Çabej refuzon postet si ministër i arsimit në Tiranë që ia ofrojnë autoritetet italiane në vitin 1942 dhe ato gjermane në vitin 1943. Këto refuzime dhe këto qëndrime, qoftë karshi autoriteteve fashiste italiane dhe atyre naziste gjermane, sigurisht që më vonë duhet t'i kenë dalë në ndihmë për karrierën e mëtejshme shkencore gjatë periudhës komuniste. Po ashtu edhe qëndrimi i tij kundër politikës fashiste duhet ta ketë ndihmuar patjetër në vazhdimin e karrierës. Duhet të kujtojmë këtu që në një raport të Federatës së Fashios, dërguar Drejtorisë vendore të Partisë Fashiste në Tiranë, në korrik të vitit 1940, ai konsiderohet si i vetmi person përgjegjës për veprimet e këqija të shkaktuara nga studentët e Liceut në demonstratat e datës 28 nëntor 1939 dhe se nuk tregonte asnjë shenjë afrimi me politikën fashiste.<sup>18</sup> Përveç kësaj, në janar të vitit 1942 ai u dërgua në Itali ku qëndroi deri në prill të vitit 1944 duke u mbikëqyrur dhe këtë

---

<sup>16\*</sup> Çështja apo skandali në lidhje me Atë Fulvio Cordignanon konsistonte në faktin që. Ai (Fulvio Cordignano) kishte vënë në diskutim homogenitetin e kombit shqiptar por edhe të shtetit të ri kombëtar, i cila në atë periudhë po përcaktonte kufijtë e tij në polemikë me “fqinjët” e tij serbë dhe grekë, dhe se Cordignano kishte dyshuar në faktin që shqiptarët e tanishëm ishin pasardhës të drejtpërdrejtë të ilirëve të lashtë. Kjo gjë, nga këndvështrimi i nacionalistëve shqiptarë, do të vinte në pikëpyetje “të drejtën natyrore” të popullit shqiptar që të kishin nën zotërimin e tyre territoret në të cilat ishin shumicë. Shiko për më tepër tek: Donato Martucci, “La «purezza della razza» e lo scandalo Cordignano”, në: *Palaver* 5 n.s. (2016), n. 2, f. 232 (DOI 10.1285/i22804250v5i2p231)

<sup>17</sup> AQSh. Fondi 200: Institutit i Studimeve Shqiptare, v. 1942. D. 1, fl. 16. Letër e Eqrem Çabejt dërguar Institutit mbretëror të Studimeve Shqiptare, 27 shtator 1942.

<sup>18</sup> AQSh. Fondi: Partia Fashiste, V. 1940, D. 138, fl. 15-20. Raport i Federatës së Fashios të Tiranës dërguar Drejtorisë Qendrore të Partisë Fashiste, Tiranë, 29 korrik 1940. Shih edhe: Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 201.

periudhë Çabej e cilëson si gjysmë internim.<sup>19</sup>

Një fakt tjetër që duhet të përmendet këtu si faktor i papërshtatshëm biografik për organet e diktaturës komuniste ishte edhe aktiviteti i Salaudin Çabejt, vëllait të tij në organet shtetërore të atëhershme, gjatë periudhës kur Shqipëria ishte e pushtuar nga nazistët gjermanë. Salaudin Çabej (1899-1944) kishte qenë jurist i formuar në Stamboll dhe kishte shërbyer si nënprefekt i prefekturës së Tiranës, së Elbasanit dhe së fundi i Tropojës, ku edhe u vra nga atentatorë komunistë në janar të vitit 1944.<sup>20</sup> Vrasja e të vëllait u bë shkak edhe për kthimin e Eqremi në atdhe. Pas kthimit nga Italia ai filloi që të punonte provizorisht në Ministrinë e Arsimit dhe në Komisionin e Teksteve Shkollore dhe vazhdoi të angazhohej në Institutin e Studimeve Shqiptare dhe të Artit.<sup>21</sup>

Pra, si konkluzion: një njeri që vinte nga një familje e pasur e kohës, i shkolluar në perëndim, bashkëpunëtor me shumë personalitete të rëndësishme të shkencës, por të cilat më vonë do të konsideroheshin armiq, me një vëlla me pozicione të rëndësishme në administratën mbretërore, por të vrarë nga dora komuniste, konsiderohej si individ i papranueshëm, ose të paktën shumë i dyshimtë për Sigurimin e Shtetit të asaj kohe. Këto ishin pra pjesët e identitetit vetjak dhe profesional të E. Çabejt në fillim të periudhës komuniste.

Për shkak të këtij identiteti të tij, Sigurimi i Shtetit do ta klasifikonte Çabejn më vonë si një person me prejardhje nga “shtresat e pasura”, me një jetë të zhvilluar në “rrethe borgjeze” e me një rreth shoqëror që përbëhej nga “elementë kundërshtarë të pushtetit”<sup>22</sup> Bile, përta i përket shkollimit të tij jashtë, informacioni i parë që Sigurimi i Shtetit i vuri rëndësi, ishte se Eqrem Çabej në kohën e fashizmit ishte dërguar nga Ministria e Ekonomisë për të

---

19 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 201.

20 Selaudin Çabej u varros me nderime të mëdha më 27 janar të vitit 1944 në varrezat e Xhamisë së Hadumit, në Gjakovë, dhe më 7 tetor 2011 (pas 67 vjetësh) u zhvarros në praninë e familjarëve, zyrtarëve komunal dhe përfaqësuesve të Këshillit të Bashkësisë Islame në Gjakovë, , për ta dërguar në varrezat familjare në Tiranë. Shih: Esat Rexha, “Zhvarrosjet në Gjakovë Selaudin Çabej, vëllai i Eqrem Çabejt”, Marr nga faqja zyrtare e Bashkësisë Islame - Gjakovë URL: <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=2936> (Akses: 25.10. 2023)

21 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 203.

22 Këta element ishin: Selahudin Toto, Gjergj Ashta, Vedat Kokona, Sabiha Kasimati, etj. të cilët do i përmendim edhe më poshtë Shih: Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 209.

ndjekur studimet në Itali.<sup>23</sup>

Aktiviteti i Çabejt nën diktaturë dhe përgjimet e ndaj tij

Le të vimë tani te çështja kryesore e prezantimit tonë, që ka të bëjë me përgjimin e E. Çabejt. Më 28 janar 1947, nga qeveria e Enver Hoxhës, krijohet Instituti i Studimeve i cili më vonë u quajt Instituti i Shkencave,<sup>24</sup> anëtar i të cilit u bë edhe Eqrem Çabej.<sup>25</sup> Ky institucion mbante qëndrim mohues dhe të politizuar ndaj Instituti Mbretnuer të Studimeve që kishte qenë më përpara dhe u bënë përpjekje të vazhdueshme për stigmatizimin e atij institucioni duke e konsideruar atë si një organizëm të krijuar nga pushtuesit fashistë italianë në shërbim të politikës së tyre të italianizimit të shoqërisë shqiptare.<sup>26</sup>

Ata që kishin studiuar në perëndim më herët dhe që ishin aktiv quheshin “kuadro të vjetër” dhe konsideroheshin si persona që ishin nën influencën e shkollave të Perëndimit dhe si rrjedhojë edhe nën zotërimin e “ideologjive borgjeze që vinin nga këto shkolla”.<sup>27</sup> Si rrjedhojë duhej që të krijohesh një elitë e re që duhej të formohej në vendet e demokracive popullore, sidomos në Bashkimin Sovjetik.<sup>28</sup> “Punonjësit e mendjes” duhej të ndërprinin çdo lloj lidhjeje me botën e vjetër dhe me “shkencën borgjeze”. Metoda e punës duhet të ishte e bazuar në filozofinë marksiste-leniniste dhe duhej të njihesh “botëkuptimi i ri” i materializmit filozofik e dialektik dhe liria e mendimit dhe e gjykimit për studiuesin shmangej hapur dhe kufizohej vetëm në “njohjen e aspiratave, nevojave dhe problemeve të popullit dhe të kontribuojë në gjuhën e tyre, sepse nuk ka liri më të madhe se kjo”.<sup>29</sup> Stigmatizimi i çdo arritjeje shkencore para

---

23 Po aty, f. 207.

24 AQSH. Fondi: Këshilli i Ministrave (490), v. 1947, fl. 1. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 16, dt. 28 janar 1947.

25 “Antarët e Asamblesë së Përgjithshme të Institutit të Studimeve: 1. Manol Konomi, 2. Sefulla Malëshova, 3. Spiro Koleka, 4. Gaqo Tashko, 5. Andrea Nathanaili, 6. Koço Theodosi, 7. Aleksandër Xhuvani, 8. Naum Stralla, 9. Mark Ndoja, 10. Shefqet Musaraj, 11. Shumitër Shuteriqi, 12. Sotir Anđjeli, 13. Aleks Buda, 14. Andrea Xega, 15. Gjovalin Gjadri, 16 Kostaq Cipo, 17. Sotir Kuneshka, 18. Fejzi Hoxha, 19 Federik Shiroka, 20. Gjergj Canco, 21. Petraq Pepo, 22. Petro Fundo, 23. Eqrem Çabej.”; në: *Buletin i Institutit të Studimeve*, Viti I-rë, qershor 1947/ Nr 1, f. 6.

26 Z. Dervishi, *Fillime vizionare në kohë të traumatizuar*, f. 547-549. Shih edhe: Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 205.

27 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 206

28 Shih edhe: Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 206.

29 Manol Ikonomi, “Fjala inaugurale e Dr. Manol Konomit, kryetar i Institutit të studimeve, mbajtur n’Asamblenë e Përgjithshme t’institutit, më 28-IV-1974”, në: *Buletin i Institutit të Studimeve*, Viti I-rë, qershor 1947/ Nr 1, f. 11.

ardhjes së diktaturës, kontrolli i punës intelektuale, përpjekjet e para për të krijuar kushtet për krijimin e “Njeriut të ri”, këto ishin rrethanat në të cilat iu desh të fillonte punë E. Çabej në shtetin e ri që krijuan komunistët.

Në dosjen formulare të përpiluar nga Sigurimi i Shtetit ka shumë të dhëna në lidhje me vëzhgimin e këtij personaliteti. Ai në këtë dosje përshkruhet si pinjoll i shtresave të pasura, që rrjedh nga një familje që ka “qenë kundra pushtetit”<sup>30</sup> dhe me një jetë në rrethet borgjeze që mbante shoqëri me elementë kundërshtarë të pushtetit popullor<sup>31</sup>, dhe si elementë të tillë klasifikohen Vedat Kokona, profesori i fizikës Selahudin Toto, Gjergj Ashta<sup>32\*</sup>, Enver Sazani dhe mjeku radiolog, Irfan Pustina<sup>33\*</sup> (këta dy të fundit i kishte miq të ngushtë).<sup>34</sup> Ndër emrat e tjerë të rrethit të tij shoqëror përmenden edhe Abas Xhamo, Mark Ndoja, Andon Kroqi, Pandi Geco, Skënder Animali dhe në dokument përmendet edhe Sabiha Kasimati, e cila “për veprimtarinë e saj kundër Pushtetit tonë Popullorë është e pushkatuar”.<sup>35</sup> Shumë prej emrave të mësipërm vëmë re që janë qoftë të grupit të deputetëve të arrestuar sipas listash dhe të ekzekutuar, qoftë për bombën artizanale me dinamit që u hodh më 15 shkurt 1951 në oborrin e Ambasadës Sovjetike, por që nuk bëri asnjë dëm. Në lidhje me këtë ngjarje u mbledh Byroja Politike më

30 AIDSSH, Dosja Formulare e Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 23: Permbledhje e Matrijalit korrispdences te Prof. Eqrem Çabej. Datë. 23. IX, 1947.

31 Po aty.

32\* Gjergj Ashta i dënuar më dhjetë vjet burg. AISKK, F. I, V. 2012, D. 1, Fl. 743; Gazeta Zyrtare, nr. 89, 15 shtator 1948, fq. 3. Cituar sipas: *Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit komunist*. Vëll. I: A-Ç. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit 2012, f. 131.

33\* “Mjeku Radiolog nga Dibra Irfan Pustina kishte studiuar në Padova të Italisë. Ai u arrestua më 15 maj të vitit 1947, dhe me vendim 212, datë 30 mars 1948, Gjykata e Lartë Ushtarake e dënoi me vdekje, me pushkatim, humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet kohë, si dhe konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si krijues të një grupi «me tendeca kundra Pushtetit dhe për ta rrëzuar këtë me dhunë». Por, me kërkesë të Prokurorisë, me vendim 180, datë 21 prill të vitit 1948, Gjykata e Lartë Ushtarake e modifikoi dënimin ndaj tij dhe ia ktheu në privim lirie për jetë dhe konfiskim së pasurisë së luajtshme e të paluajtshme. Më 1949, dënimi iu zbrit në 15 vjet heqje lirie. U lirua në vitin 1954. Shërbeu në repartin e radiologjisë të Spitalit Rajonal të Vlorës për 30 vjetë.” Burimet: Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Lartë Ushtarake, Nr. 127 i Regjistrit Themeltar, Nr. 180 i Vendimit, Datë 21/IV/1948; F. I, Viti 2017, D. 98, f. 794; Gazeta Zyrtare, nr. 40, 19 maj 194. Cituar sipas: *Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit komunist*. Vëll. VI: N-P. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit 2017, f. 398.

34 Disa nga personat e përmendur më sipër si Gjergj Ashta (i dënuar më dhjetë vjet burg), Sabiha Kasimati dhe Selahudin Toto bënin pjesë edhe në grupin që u pushkatuan pas proceseve të “grupeve të deputetëve” (1947-1948) dhe më vonë (1951) me rastin e “Bombës në Ambasadën Sovjetike” shih për më tepër tek: Uran Butka, *Bombë në Legatën Sovjetike*, Tiranë: Instituti Lumo Skëndo 2018.

35 AIDSSH, Dosja Formulare e Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 24: Permbledhje e Matrijalit korrispdences te Prof. Eqrem Çabej. Datë. 23. IX, 1947.

20 shkurt 1951.<sup>36</sup>

Le të kthehemi edhe një herë te dokumenti i mësipërm, në të cilin më tej thuhet, se Eqrem Çabej “okupacionin fashist e ka pritur mirë dhe duke e përhapur dhe deklaruar si mik të popullit tonë, ka punuar me mish e me shpirt për fashizmin dhe ka përkrahur njerëzit tuj. Për këtë u dërgua në Itali për studime, ku qëndroi deri në kapitullimin e Italisë. Mbas kapitullimit Eqremi u caktua ministër i arsimit, me gjithë se akoma nuk ishte kthyer nga Italia. gjatë okupacionit nazist u kthye në Shqipëri dhe filloi të bashkëpunojë me ta duke mbrojtur politikën e tyre.”<sup>37</sup>

Pra këto të dhëna në dosjen formulare qenë shënuar kur Çabej ishte tashmë pjesë e Institutit të Studimeve, në janar të vitit 1948, dhe gati dy vjet më vonë, këtyre të dhënave iu shtua edhe cilësimi “Armik i pushtetit popullor” për shkak se një burrë motre që kishte qenë eksponent i Ballit Kombëtar ishte arratisur dhe se “kishte një vëlla të vrarë nga partizanët, i cili kishte qenë prefekt në Kosovë [në fakt në Tropojë]”,<sup>38</sup> i cili në dokumentin e datës 23. 9. 1947, që është një shkresë e Seksionit të V-të të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, cilësohet si “i pushkatuar si kriminel lufte”<sup>39</sup>.

Gjitha këto të dhëna janë të shënuara në dokumente të ndryshme dhe përmenden pjesërisht edhe në raportin e propozimit të regjistrimit të Eqrem Çabejt në Kategorinë II B të kartotekës së elementit kundërshtar.<sup>40</sup> Ky regjistrim i Çabejt në elementet që duheshin vëzhguar duhet të ketë ndodhur gjatë viteve 50. Në këtë raport propozimi përveç tendencave naziste që i vishen personalitetit të tij thuhet edhe gjëra të tjera negative në lidhje me të. Këtë dokument

---

36 Mehmet Shehu, Ministër i Brendshëm, në lidhje me këtë ngjarje tha: “*Është një ngjarje politike e kalibrit të madh, bile edhe më e madhe se një atentat që mund t’i bëhej ndonjërit nga ne*”. Ai kërkoi masa represive të jashtëzakonshme, pa marrë parasysh ligjet në fuqi, meqenëse edhe herë tjetër “*kemi pushkatuar, jashhtë ligjeve në fuqi. Ju kujtohet si kemi vepruar kur u vra Bardhok Biba?*”. Të gjithë anëtarët e Byrosë Politike ishin dakord për masa të menjëhershme represive (AQSH - Procesverbali i Byrosë Politike, 20 shkurt 1951). Menjëherë pas kësaj u hartuan “listat e zeza” dhe nga të gjitha krahinat e Shqipërisë u arrestuan qindra të pafajshëm me biografi “perëndimore”. 22 intelektualë nga këto lista u dënuan pa gjyq, me vdekje, pasi i kaloi për nëpër duar për herë të fundit vetë Enver Hoxha.” *Fjalor enciklopedik i viktimitave të terrorit komunist*. Vëll. I: A-Ç. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit 2012, f. 35.

37 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 25. Shkresë e Seksionit të Tiranës drejtuar Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit, 9 janar 1948, shih: Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 209.

38 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 209-210.

39 AIDSSH, Dosja Formulare e Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 23: Permbledhje e Matrijalit korrispdences te Prof. Eqrem Çabej. Datë. 23. IX, 1947.

40 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem çabejt, fl. 6: Raport propozim (pa datë)

për shkak të rëndësisë së tij ia vlen ta japim të plotë:

### Raport Propozim

*Për aktivitet anti popullor kundra at'dheut dhe popullit propozoj të përpunohet dhe të regjistrohet në kat. II –B të kartotekës t'elementit kundërshtarë personin e poshtë-shënuar me tendenca Naziste.*

*Eqrem Çabej i biri i Hysenit dhe i Aishes, lindur me 1907 ne Gjirokaster dhe banues ne Tiranë me shërbim pranë Institutit studimeve, ka mbaruar studimet ne Austri, din gjuhen Gjermanisht, Frengjisht, Italisht, me nenshtetesi dhe kombesi shqiptare. Shresee e pasur qytetare. Gjate okupaciont Eqerem çabej ka ndjekur politikën naziste dhe qesnjihere nuk ka qene elemente i mire. Eqeremi qysh se ka qene ne Austri ka patur te tille tendenca.Nga vitit 1936-38 ka qene sekretar i pare ne Ministrine e Arsimit qysh ne kete kohe jetonte ne rrethe burgjeze, dhe gjat gjith regjimit te zogut ka qene funksionare dhe ka zbatuer politiken e zogut. Gjithashtu edhe familja e tij ka qene pro regjimit zogist, mbasi n'ate kohe njoheshin si njerz me influence dhe perkraheshin. Okupacionin Fashist e ka pritur mirë dhe si mike e popullit tonë dhe e deklaronte hapur. Punonte me gjithë shpirt për regjimin fashist dhe përkrahej nga njerëzit e fashizmit dhe si rrjedhojë ishte dërguar në Itali për studime. Kudo që ka qenë ka propaganduar në favor të Fashizmit italian, e gjithë kohën e okupacionit Italian e ka kaluar ne Itali. Mbas kapitullimit te Italis Eqeremi u caktua si Minister i Arsimit me gjith qe ishte akoma ne Itali. Gjatë okupacionit gjerman u kthye ne Shqiperi dhe filloi te bashkepunonte me ta duke mbrojtur politikën naziste. Rrethi i tij shoqeror ka qene i perbere prej intelektualesh dhe funksionarevet t' asaj kohe Sokrat Dod Biben ish minister dhe tash i arrestuar; i gjithë rrethi i tij ka qene kundërshtarë i luftës tone çlirimtare me Vedad Kokonën, ishfunksionar dhe familja e tij i përshtatesh çdo suate, Eqremi, rrethi i tija familjar dhe shoqëror mendonte keq për luftën tonë dhe propagandonte kundra saj. Mbas çlirimit të Shqipërisë e deri më sot nuk mbane qendrim të mirë politik, është me tendenca Naziste dhe politikën që ay mendon e komenton në rrethet e tija, është i prekur nga privilegjet e se kaluares, është dinak dhe i squar, tue dash që të përfitoj sot paraqitet si element indiferent.*



*Eqrem çabej është element i dyshimtë dhe ka patur lidhje me Selaudin Toton, Gjergj Ashten (tash i burgosur). Sot i gjithë rrethi familjar dhe shoqëror është i përbërë nga elementa kundërshtarë të Pushtetit, të prekur nga reformat e ndryshme që urrjnëë partinë dhe pushtetin. Në punën e përdishtme është i përpiktë dhe këtë e bënë për të maskuar qendrimin e tij.*

Pëlqehet

Propozuesi

Shef\* i sheksionit M.P.

Kapiten i II-të

Referent org. Masave

Koli Shuke (firma)

N/Toger Vaske Afezulli (firma)

Aprovohet

Kryetari Deges II-të

Kapiten I-rë

Rasim Dedja (firma)

*(- e shkruar me dorë, -Burri i motrës eksponent i ballit.- I vëllai ish prefekt nga ana jonë është vrarë nga ana jonë.)<sup>41</sup>*

Deklaratat e Çabejt, në lidhje me qëndrimin tij në Romë, të cilin Çabej e konsideron si gjysmë-internim dhe me qëndrimin e tij antifashist, të cilin e bën të ditur në një autobiografi, as që nuk u morën parasysh nga Sigurimi i Shtetit.<sup>42</sup>

Edhe shoqëria që Çabej kishte pasur me Sabiha Kasimatin<sup>43\*</sup> përbënte një problem në sytë e sigurimit të shtetit dhe shoqërimi me Kasimatin i njoftohej Sigurimit nga një përgjuese me emrin “Prurësja” që ishte e ngarkuar që të përgjonte Sabihanë. Në relacionin e përpiluar më 11, 10, 1950 të “Prurësës” flitet për “miqësi të ngushtë” ndërmjet Sabihasë dhe Eqremit, “që nuk

41 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 6: Raport propozim (pa datë)

42 AIDSSH, Dosja Formulare e Dosja Çabejt, fl. 10: Autorbiografia. (pa datë).

43\* Sabiha Kasimati, biologe dhe ihtologe, e cili kishte studiuar dhe ishte diplomuar në Torino, e punësuar në Institutin e Shkencave, ku në vitin bëri 1948 një studim mbi peshqit në ujërat shqiptare. Kjo vepër u botua më 1955, por me autorësinë e rusit Anatoli Poljakov dhe dy shqiptarëve fillestarë në fushën e ihtologjisë, Ndoc Filipi dhe Ndoc Rakaj. E kritikoi ballas diktatorin Enver Hoxha, me të cilin kishte njohje nga liceu: “*Ti po vret gjithë intelektualët. Dua të të pyes se me cilët ke ndërmend ta ndërtosh Shqipërinë, me teneqeshinjtë apo me këpucarët?*” Më 26 shkurt 1951, ishte e vetmja grua, mes 22 intelektualëve që u pushkatuan pa gjyq, me rastin e incidentit të sajuar të bombës në ambasadën sovjetike. Të dhënat janë marrë nga: *Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit komunist*. Vëll. IV: I-K. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe të Pasojave të Komunitetit 2015, f. 184-185.

ka karakter martese, por më tepër politike kulturele”<sup>44</sup> dhe se ata bisedonin mbi kulturën, shkencën dhe kryeveprat e veprat e letërsisë të shkrimtarëve borgjezë, dhe se e konsideronin kulturën marksiste si hiç gjë.<sup>45</sup>

Bashkëpunëtorja e Sigurimit “Prurësja”, e cila mesa duket ishte e brendshme e institutit dhe kjo shihet edhe në saktësinë dhe në nivelin e gjuhës që përdor, jep vlerësime edhe për punën e Çabejt brenda institucionit. Në raport, në lidhje me këtë gjë thuhet se “*punën që i ka ngarkuar pushteti e kryen vetëm se paguhet, tregon shumë pakënaqësi për punën jashtë orarit, mërzi të edhe indiferentizëm të madh në zhvillimin e konferencave të organizuara nga komiteti profesional, i quan si të kota dhe humbje kohe.*”<sup>46</sup> Në raportin e saj ajo shkruan që “*është shumë i pakënaqur me mënyrën e jetesës së deritanishme, por është shumë i rezervuar dhe pakënaqësitë e tij i çfaq vetëm në njerëzit e rrethit të tij dhe aty me shumë rezerva.*”<sup>47</sup>

Si përfundim “Prurësja” e mbyll relacionin e saj me konkluzionin që “*Çabej është armik i pushtetit popullor, por deri më sot tek ky njeri nuk shifet ndonjë aktivitet i zgjeruar anti pushtet dhe kjo ndoth tek ky person pse ka shumë frikë. Ay shokëve të rrethit të tij u rekomandon që të mos pranojnë kurrë për të punuar jashtë orarit pse puna e tyre nuk shihet ose studjohet nga asnjëri*”.<sup>48</sup>

Si rrjedhojë edhe e këtyre spiunimeve Sigurimi i shtetit në fund të vitit 1952 e rriti nivelin e “*elementit kundërshtar Eqrem Çabej*” nga niveli II B, në të cilin ishte, në nivelin II A, sipas raporteve që bënë edhe kategorizimin e tij, Çabej kryente “*Aktivitet Antipopullor, kundra atdheut dhe popullit*”<sup>49</sup> arsyetimi për kalimin në nivelin II A ishte, sipas atyre që kishin përpiluar këtë raport në shkollimin e Eqremit në Vjenë, ku sipas tyre rridhnin edhe tendencat naziste<sup>50</sup>, të cilat Eqremi i kishte përforcuar gjatë viteve në Itali në kohën e

44 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 26. Relacion i “Prurësës” për Sigurimin e Shtetit, më 11 tetor 1950, fl. 26.

45 Po aty. Shih: Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 210.

46 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 26. Relacion i “Prurësës” për Sigurimin e Shtetit, më 11 tetor 1950, fl. 26.

47 Po aty.

48 Po aty.

49 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, NR. 2383, fl. 6. Raport propozimi për survejim në nivelin II B për Eqrem Çabej, Data mungon, po aty, fl. 16, Raport kategorizimi në II A për Eqrem Çabej, më 6 tetor 1952, shih: Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 210.

50 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 6: Raport propozim (pa datë).

luftës II Botërore, si përfaqësues i “Ernest Koliqit”. Sipas Sigurimit të Shtetit, veprimtaria armiqësore e Çabejt që vijonte edhe më tej konsistente edhe në shoqërimin me elementë të dyshimtë dhe në armiq të popullit siç ishin Sabiha Kasimati, Rrok Zojzi (fashist me damkë)<sup>51</sup>, Shyrete Turkeshi (e përjashtuar nga partia)<sup>52</sup>, Sejfulla Malishova (tradhtar i partisë), Isa Çeka (edhe ky fashist), Fatbardh Prodani, Anton Krajni, Filip Ndocaj, Spiro Belkove, etj. Dosja e Çabejt që kaloi pastaj nga niveli II B në nivelin II A, kishte pasur një shënim nga Mehmet Shehu, në atë kohë gjeneral lejtant, i cili shënimi vonë u evidentua nga nëntoger, Taip Rada.<sup>53</sup>

Me kalimin nga niveli II B në nivelin II A u vu në lëvizje një aparat i tërë bashkëpunëtorësh të sigurimit të shtetit apo spiunësh, me gjuhën e popullit, që e përgjonin Çabejn hap pas hapi, dhe që kishin nofka të tilla si *Taraboshi*, *Çajupja*, *Drojtja*, *Prurësja*, *Edija Dhëlpërija*, etj.<sup>54</sup> Në një dokument të vitit 1952, ku bëhet edhe propozimi i kalimit në nivelin II A, flitet edhe për një “organizatë demokratike”, në të cilën bënte gjoja pjesë edhe Eqrem Çabej. Në këtë organizatë sipas këtij dokumente bënin pjesë edhe Rrok Zojzi, shtëpinë e të cilët e frekuentonin si Eqremi ashtu edhe të tjerë si Filip Ndocaj, Ndoc Ashta dhe Spiro Belkove, etj.<sup>55</sup> Si rrjedhojë me shënimin e titullarit të dikasterit, Gjeneral Mehmet Shehut bëhet edhe propozimi i kalimit nga Niveli II B në përpunim aktiv të Nivelit II A. Propozuesi ishte nëntoger Taip Rada. Propozimi pëlqehet nga shefi i seksionit, kapiten i parë Koli Shuke dhe aprovohet nga majori Rasim Dedja.<sup>56</sup> Krahas përgjimit të tij personal i përgjohej edhe shtëpia, dhe raportohej se kush hynte e dilte në banesën e tij e më vonë, në vitin 1953, përgjimit iu shtua edhe mbikëqyrja e korrespondencës me persona brenda dhe jashtë shtetit.<sup>57</sup> Kjo periudhë e përgjimit të dendur nga viti në vit erdhi duke u intensifikuar sa arriti deri në shtatë plane masash dhe vijoi ndërmjet viteve 1952-1955 dhe vazhdoi deri në tetor të vitit 1958.

51 AIDSSH, Dosja Formulare e Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 24: Permbledhje e Matrijalit korrispdnences te Prof. Eqrem Çabej. Datë. 23. IX, 1947.

52 Po aty.

53 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 211.

54 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 211.

55 AIDSSH, Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, NR. 2383, fl. 24: Permbledhje e Materialit korrispdnences te Prof. Eqrem Çabej. Datë. 23. IX, 1947.

56 Po aty.

57 Ledia Dushku, “Armik i pushtetit popullor”, f. 211.

Në një raport të datës 24.12.1953, të përpiluar nga bashkëpunëtori i sigurimit “Dhëlpëria”, ndër të dhëna të tjera, bëhet fjalë edhe për besimin fetar të Eqrem Çabejt. Me sa duket nga dokumenti i përmendur, bashkëpunëtori (a bashkëpunëtorja) me pseudonimin “Dhëlpëria” ishte i ngarkuar që të përgjonte edhe Lasgush Poradecin, sepse në raportin e tij përmenden marrëdhëniet e Çabejt me Poradecin. Në këtë raport thuhet më tej se *“Nga e shoqja e Lasgush Poradecit tërthurazi kemi marrë vesh se si Lasgushi ashtu dhe Eqeremi besojnë në egzistencën e Zotit dhe lexojnë libra të shenjtë, si dhe libra që miren me magnetizëm, spiritizëm e magji. Si pas saj ata besojnë në spritizëm dhe magnetizëm dhe besojnë gjithësisht se një i gjallë mund të vihet në komunikim me shpirtin e një të vdekuri.”*<sup>58</sup> Pas vitit 1958, si rrjedhojë e mosgjetjes së asgjëje të dyshimtë dhe mosrealizimit të objektivave të planifikuara nga Sigurimi i Shtetit, niveli i survejimit ra përsëri në II B.<sup>59</sup>

Nga dokumenti dy faqesh i dosjes mësojmë se si Çabej ishte përgjuar edhe gjatë vitit 1961, kur ishte takuar me persona gjermanë që kishin ardhur si turistë. Ndër ta mund të përmendim këtu edhe linguisten Karla Vidali (në fakt në dokument e shkruar gabimisht si “Karlo Vidali”), e cila dyshohej nga Sigurimi i Shtetit si agjente gjermane (si kuadër i zbulimit gjerman).<sup>60</sup> Ky rast përmendet edhe vite më vonë, në një dokument të mëvonshëm ku “Karla Vidali” nuk specifikohet më si lingviste, por si turiste gjermane. Në dokument thuhet që *“...nga ndjekja e atëhershme e përpunimit të tij ka rezultuar se veç agitacionit dhe propagandës amiqësore që ka zhvilluar, për të kanë lindur dyshime që të jetë vënë në shërbim të zbulimit të huaj. Kështu në Gusht të vitit 1961 Eqremi duke qenë me pushime në plazhin e Durrësit, është takuar disa herë me një femër turiste gjermane perëndimore dhe në një rast e ka marrë atë për vizitë në vilën e tij, ku ka qëndruar dy orë. Këto takime me të lartpërmendurën kanë lënë dyshime, duke qenë se vetë turistja kishte vetë dyshime si kuadër i zbulimit”*<sup>61</sup>

58 AIDSSH, Dosja Formulare e Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 53: Raport i datës. 24. XII, 1953. Dhënë Bp “Dhëlpëria”.

59 AIDSSH, Dosja Formulare e Dosja Formulare e Eqrem Çabejt, fl. 83: Vendim mbi uljen nga kategoria II-A në II-B të dosjes formulare të të Eqrem Hysen Çabej. Tiranë, më 25. X. 1958.

60 AIDSSH: Vendim mbi Arshivimin e Dosjes në 2/B, të Eqerem Çabejt. Datë 24.10.1963, fl. 2.

61 AIDSSH: Vendim mbi Arshivimin e Dosjes në kontroll operativ 2/B, të Eqerem Çabejt. Datë 1. 1.1981, fl. 2

Më datë 24.10.1963 e ashtuquajtura dosje formulare u arkivua përkohësisht<sup>62</sup>, por me sa duket hapet përsëri, pasi siç do e shohim edhe nga të dhënat e mëposhtme, dosjes i shtohen edhe shkresa të tjera, të cilat i përkasin viteve '70. Nga kjo dosje mësojmë se përgjimi i Eqrem Çabejt ishte bërë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Vjenë ku kishte shkuar të kuronte djalin e tij të sëmurë në vitin 1970. Të dhënat në lidhje me përgjimin e tij në Vjenë i ishin përcjellë Sigurimit të Shtetit nga një person, emri i të cilit në dokument është i fshirë. Ky person punonte në ambasadën e Shqipërisë në Vjenë si shifrant. Nga përgjimi i Vjenës, dokumenti jep të dhëna se Eqremi atje kishte pasur “*kontakte me mjaft të huaj, si me Shvanken (apo Shvaken), lidhje e ngushtë e Komunitetit “Shqipëria e Lirë” i cili ka shkruar në gazeta kundër Shqipërisë*”<sup>63</sup>. Dokumenti vazhdon më tej, se Eqremi me këtë person ishte takuar edhe në një vilë jashtë Vjenës ku ka qëndruar rreth katër orë me të.<sup>64</sup>

Këtu me siguri duhet të bëhet fjalë për doktor Robert Schwanke-n, (Dr. phil. et jur., i lindur në vitin. 1910), i cili ishte bashkëpunëtor shkencor në Institutin Austriak për Evropën Lindore dhe Juglindore në Vjenë (Ost-und Südosteuropa-Institut Wien) dhe që në vitet '60 kishte shkruar artikuj<sup>65</sup> dhe punime të shumta që preknin shumë çështje në lidhje me Shqipërinë nën diktaturë. Mund të përmendim këtu një ndër artikujt e tij të shkruar në bashkëpunim me Otto Rudolf Ließ me titull “Shqipëria – një çerek shekulli komunizëm” (*Albanien ein Vierteljahrhundert Kommunismus*)<sup>66</sup> apo një ndër punimet e tij me titull “Shqipëria ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit” (*Albanien zwischen Ost und West*)<sup>67</sup>. Sigurisht Schwanke, ky studiues i spikatur i shkencave politike, i cili e njihnte Shqipërinë e periudhës komuniste në të gjitha aspektet e saj, ishte i njohur për organet e Ambasadës së Shqipërisë së asaj kohe, edhe pse në dokumentin e sipërcituar nuk jepen të dhëna të mëtejshme në lidhje me të. Edhe në lidhje me shpenzimet që Eqremi bënte në Vjenë, dokumenti në fjalë jep të

62 AIDSSH: Vendim mbi Arshivimin e Dosjes në 2/B, të Eqrem Çabejt. Datë 24.10.1963, fl. 1.

63 Po aty, fl. 2.

64 Po aty.

65 Robert Schwanke, “Bildung von Nation und Staat in Albanien”, në: Österreichische Osthefte: Zeitschrift für Mittel-, Ost- und Südosteuropaforschung (Wien). Vol. 3/1961, 6, f. 453-462.

66 Otto Rudolf Liess/ Schwanke, Robert, “Albanien: ein Vierteljahrhundert Kommunismus” në: *Aus Politik und Zeitgeschichte: APuZ (1969) 44*, f. 29-54.

67 Otto Rudolf Ließ/ Robert Schwanke, *Albanien zwischen Ost und West*. Hannover: Nieders. Landeszentrale f. Politische Bildung 1968.

dhëna, si për shembull blerja e katër orëve të dorës, gjë që e kalonte mundësinë financiare të tij.<sup>68</sup>

Në lidhje me përgjimet e Çabejt gjatë takimeve të tij me personalitete të tjera të huaja ka edhe të dhëna të mëvonshme. Këtu mund të përmendim për shembull rastin e takimit të tij me linguistin dhe albanologun austriak Hermann Ölberg (1922-2017)<sup>69\*</sup> i cili erdhi në Shqipëri edhe gjatë kohës së diktaturës. Dokumenti i dosjes në lidhje me takimin e Çabejt me këtë personalitet përmend një rast në vitin 1970. Përgjuesi kishte qenë një bashkëpunëtor i Sigurimit, me pseudonimin “Noli”, i cili më 10. 11. 1970 raporton për takimet jashtëzakonisht të shpeshta e Çabejt me Ölbergun, i cili në Tiranë po qëndronte në hotel “Dajti”.<sup>70</sup> Në dokument shkruhet më tej që: “Qysh sa kishte ardhur Olbergu (Ölberg) në Hotel Dajti, pa kaluar pesë minuta, Eqremi kërkoi në telefon që të mësonte numrin e dhomës së Olbergut, për t’i “uruar mirëseardhjen”. Olbergu ishte doktor austriak në fushën e gjuhësisë dhe gjatë kontrollit të tij kur ishte në vendin tonë, la dyshime si kundërzbulimi, ardhur me detyra të caktuara.”<sup>71</sup>

Përfundimisht, siç mund të vihet re edhe nga dokumentet që cituam më sipër, Sigurimi i shtetit nuk pati në dorë asnjë fakt që ta akuzonte Eqrem Çabejn për “*tradhti ndaj atdheut*”, a “*bashkëpunim me agjentina e huaja*”, apo akuza të ngjashme që Sigurimi apo struktura të tjera të diktaturës i prodhonin për shtetas të ndryshëm në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë së asaj kohe. Nëpër dokumente janë vetëm hamendësime dhe fjalë boshe pa fakte në lidhje me personin e Çabejt, i cili duke e ditur se përgjohej gjatë gjithë kohës diti të ruhej nga ai sistem. Dosja e Eqrem Çabejt u arshivua përfundimisht më 16. 1. 1981 gjashtë muaj pas vdekjes së tij (më 16. 8. 1980).

### **Përfundime**

Si konkluzion mund të themi që Eqrem Çabej, edhe pse nuk u persekutua nga organet e diktaturës, ashtu si intelektualët e tjerë që ishin miq të tij dhe që bënë pjesë qoftë në grupin e deputetëve të arrestuar në vitet 1947-48, qoftë në grupin e atyre personave që u arrestuan dhe më vonë u ekzekutuan me rastin e hedhjes së bombës në Legën e Bashkimit Sovjetik në vitin 1951, prapëseprapë ishte

i përgjuar vazhdimisht nga Sigurimi i Shtetit dhe nga spiunët që vepronin nëpër ambiente të ndryshme. Fakti që ai nuk u persekutua nga sistemi diktatorial, duhet të lidhet së pari me kujdesin e tij të madh për t'u ruajtur, dhe për të mos u marrë me politikë. Së dyti duhet të përmendet këtu edhe përgatitja e tij shkencore, për të cilën shteti i atëhershëm kishte nevojë. Megjithatë në lidhje me këtë pikë mund të thuhet se sa e sa intelektualë që kishin përfunduar studimet nëpër universitetet Evropës Perëndimore përfunduan gjithsesi të persekutuar, të burgosur e madje edhe të pushkatuar, siç e pamë më sipër në rastin Sabiha Kasimatit, dhe të tjerëve. Mbase disa janë të mendimit që origjina e Çabejt nga i njëjti qytet (Gjirokastra) me diktatorin Enver Hoxha mund të ketë ndikuar që ai të mos çënohej. Megjithatë duhet të thuhet se sa e sa intelektualë që ishin nga ky qytet u persekutuan, burgosën dhe madje u pushkatuan. Këtu mund të përmendim si shembull intelektualë gjirokastritë si Nedin Kokona i diplomuar për drejtësi në Francë, i dënuar e 10 vjet burg në vitin 1945<sup>72</sup>; Muntaz Kokalari, i shkolluar në Turqi dhe i pushkatuar pa gjyq më 12 nëntor 1944<sup>73</sup> apo gjirokastritja Musine Kokalari e dënuar me burg e më pas me internim<sup>74</sup>, etj. etj.

Këto pra ishin disa të dhëna dhe konkluzione në lidhje me survejimin e Eqrem Çabejt nga diktatura komuniste .

## Literatura e përdorur

BALIU, Begzad. “Profesor Eqrem Çabej dhe Norbert Jokli – Ndërlidhje Personale dhe Shencore”, në: *Studime Shqiptare 12*: Albanologu i Shqar austriak Norbert Jokli (1877-1942). Shkodër: Camai-Pipa 2003, f. 71-77.

ÇABEJ, Brikena. “Takimet e tim Eti me Enver Hoxhën”. URL: <https://gazeta-shqip.com/2017/03/08/brikena-cabej-takimet-e-tim-eti-me-enver-hoxhen/> (Aksesi: 1. 2. 2024)

ÇABEJ, Eqrem. *Italoalbanische Studien: Wiener Dissertation aus dem Jahr 1933*. Mit Beigaben von Oskar E. Pfeiffer und Joachim

---

<sup>72</sup> Fjalor enciklopedik i viktimitave të terrorit komunist. Vëll. IV: I-K. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe të Pasojave të Komunizmit 2015, f. 261-262.

<sup>73</sup> Po aty, f. 251.

<sup>74</sup> Po aty, f. 252.

Matzinger Herausgegeben von Heiner Eichner und Joachim Matzinger. Wiesbaden: Harrassowitz Verlag 2017 (= Albanische Forschungen nr. 34)

DOMI, Mahir. “Çabej, Eqrem”, në: Fjalor Enciclopedik Shqiptar. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH të Shqipërisë 1987, f. 147.

DOMI, Mahir. “Çabej, Eqrem”, në: Fjalor Enciclopedik Shqiptar. Botim i Ri. Vëllimi I. Tiranë: Akademia e Shkencave 2008, f. 368.

DUSHKU, Ledia. “Armik i pushtetit popullor” që shkencërisht “punon për ne”: Shteti komunist dhe studiuesi Eqrem Çabej (1944-1954)”, në: *Studime Historike* 3-4/ 2020, f. 197-222.

*FJALORI enciklopedik i viktimave të terrorit komunist në dymbëdhjetë vëllime*. I-XII. Tiranë: Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit. 2012-2023.

IKONOMI, Manol. “Fjala inaugurale e Dr. Manol Konomit, kryetar i Institutit të studimeve, mbajtur në Asamblenë e Përgjithshme të institutit, më 28-IV-1974”, në: Buletin i Institutit të Studimeve, Viti I-rë, qershor 1947/ Nr 1, f. 11.

LAFE, Emil, “Hermann Ölberg – albanolog i shquar dhe mik i përzemërt i popullit shqiptar”, në: *Gjurmime Albanologjike - Seria e shkencave filologjike*. Nr. 52/2022, f. 153-158.

LISS, Otto Rudolf / Robert, Schwanke. “Albanien: ein Vierteljahrhundert Kommunismus” në: *Aus Politik und Zeitgeschichte: APuZ* (1969) 44, f. 29-54.

LISS, Otto Rudolf / Schwanke, Robert, *Albanien zwischen Ost und West*. Hannover: Nieders. Landeszentrale f. Politische Bildung 1968.

MARTUCCI, Donato, “La «purezza della razza» e lo scandalo Cordgnano”, në: *Palaver* 5 n.s. (2016), n. 2, f. 232 (DOI 10.1285/i22804250v5i2p231)

ÖLBERG, Herman, M., “Eqrem Çabej dhe Austria”, në: Studime Shqiptare 9: Eqrem Çabej personalitet i shquar i shkencës dhe i kulturës shqiptare. (Në 90-vjetorin e lindjes). Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Sektori Shkencor i Albanologjisë. Tiranë: Çabej MÇM 1998, f. 160-163.

REXHA, Esat, “Zhvarroset në Gjakovë Selaudin Çabej, vëllai i Eqrem Çabejt”, Marr nga faqja zyrtare e Bashkësisë Islame - Gjakov> URL: <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=2936> (Akses: 25.10. 2023)



SCHWANKE, Robert, "Bildung von Nation und Staat in Albanien", nē: Österreichische Osthefte: Zeitschrift für Mittel-, Ost- und Südosteuropaforschung (Wien). Vol. 3/1961, 6, f. 453-462.

Jonida Xhyra

**EMËRUESI I PËRBASHKËT SHQIPTAR SI  
NJËSI ETNIKE DHE KULTURHISTORIKE NË  
PUNIMET E HERSHME TË ÇABEJT**

*Universi shqiptar si zanafillë*

Qysh në krye të studimit të tij *Për gjenezën e literaturës shqipe*, duke theksuar se “historia shpeshherë është rezultat i të dhënave gjeografike”, Çabej bën një përshkrim të fytyrës gjeografike të vendit dhe “anëve malësore” të tij. Ravijëzimi i gjallë i hartës gjeografike nga albanologu i atëhershëm tridhjetëvjeçar shpalos në të njëjtën kohë fare qartë objektin e studimit, universin shqiptar në tërësinë e tij. univers të cilit ai do t’i përkushtohet gjithë jetën.

Këtë univers Çabej e sheh qysh në krye të herës si, “një njësi etnike e kulturhistorike, të rrjedhur nga njësia gjeografike.”<sup>1</sup> Topika e kësaj njësie shtjellohet në punimet e tij të hershme “nën emëruesin e përbashkët shqiptar”, duke vënë gjithmonë në dukje veçoritë e pjesëve që e përbëjnë njësinë, po të vazhdojmë me gjuhën e Çabejt, të numëruesve, dhe njëkohësisht duke e dalluar këtë njësi “fort shprehimisht prej vendeve fqinje.”<sup>2</sup>

E përbashkëta e punimeve të para të Çabejt është karakteri i tyre gjithëpërfshirës dhe aspekti i gjerë filologjik në trajtimin e çështjeve kulturo-historike, etnografike dhe gjuhësore të popullit shqiptar si një njësi etnike. Ideja e qarqeve kulturore dhe letrare dhe vendi i letërsisë popullore në këtë përpjekje klasifikuese bëhet nisur nga një këndvështrim gjithëpërfshirës dhe në një aspekt të gjerë filologjik. Qëllimin e romantizmit në hapësirën shqiptare të shekullit të 19-

---

1 Çabej, E. (1994) Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare. Në: Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes. Tiranë, f. 25.

2 Po aty, f. 8.

të Çabej e formulon gjithashtu në stil të gjerë si më poshtë: “të përtërihet gjithësia e nacionit, duke filluar që nga alfabeti e gjer te mbrytja e një gjuhe letrare dhe te formimi i një literature të vet, në lëmë politike krijimi i një shteti.”<sup>3</sup>

Në një letër të vitit 1938 dërguar Çabejt, duke e falënderuar për dy punimet e dërguara, gjuhëtari danez Holger Pedersen (1867-1953) thekson gëzimin e tij “që tani, për herë të parë, një shqiptar i lindur trajton gjuhën dhe historinë e popullit të vet, duke zotëruar mirë metodën e zhvilluar në Evropën Perëndimore.”<sup>4</sup> Bëhet fjalë për punimet *Kostandin i vogëlith dhe kthimi i Odiseut* si dhe *Shqiptarët dhe sllavët në Italinë e Jugut*. “Metoda e zhvilluar në Evropën Perëndimore”, për të cilën flet Pedersen, rroket më qartë, nëse bëjmë një rekurs në problematikën e zhvillimit të filologjisë moderne brenda hapësirës intelektuale gjermanofolëse.

### ***Paradigma ndërdisiplinore në analizën filologjike***

Universiteti i Vjenës, në të cilin i përfundoi studimet e tij Çabej, është universiteti më i vjetër në hapësirën e sotme gjermanofolëse dhe dëshmon një traditë disashekullore. Nëse bëjmë një retrospektivë të filologjive moderne, ashtu siç paraqiten ato sot të inkuadruara në fakultetet përkatëse, së paku në universitetet gjermane, filli kohor na shpie aty nga fundi i shekullit të 19-të. Termi përmbledh drejtimin shkencor që ka të bëjë me gjuhësinë dhe letërsinë e një gjuhe të caktuar,<sup>5</sup> madje tradicionalisht më tepër me gjuhësinë.<sup>6</sup> Lindja e filologjisë moderne lidhet veçanërisht me emrin e filologut Jakob Grim (Jacob Grimm: 1785-1863)<sup>7</sup>, i cili njihet si themelues i filologjisë gjermane, por gjithashtu me një rëndësi të padiskutueshme edhe për lindjen e sllavistikës<sup>8</sup>. Filologjia moderne, e lëvruar nga Grimm-i, parakupton jo vetëm kërkimin shkencor të gjuhës dhe të letërsisë, por natyrisht edhe të kulturës së vendit e

3 Po aty, f. 97.

4 Demiraj, Sh. (1990) Eqrem Çabej. Një Jetë kushtuar shkencës. 8 Nëntori, Tiranë, f. 229.

5 Gemoll, W. (1908) Griechisch-deutsches Schul- und Handwörterbuch. Tempsky, Wien, f. 793: greq φιλολογία: dashuri për gjuhën. Adresa elektronike për materialin e digitalizuar në *Bibliotekën Shtetërore Bavarëze*: <http://www.mdz-nbn-resolving.de/urn/resolver.pl?urn=urn:nbn:de:bvb:12-bsb10930493-6>

6 P.sh. në hapësirën anglishtfolëse *philology* ka kuptimin e gjuhësisë historike.

7 Rölleke, H. (botues) (1985, botimi i parë 1812/I, 1815/II) Kinder- und Hausmärchen gesammelt durch die Brüder Grimm. Suhrkamp, Frankfurt am Main; Grimm, J. & Roethe, G. & Schröder, E. (2017, botimi i parë 1890) Deutsche Grammatik. Hanser, München.

8 Mojašević, M. & Rehder, P. (1824): Kleine serbische Grammatik. Übersetzt und mit einer Vorrede von Jacob Grimm. Otto Sagner, München.

njerëzve në të cilin flitet kjo gjuhë e shkruhet kjo letërsi.

Në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të 19-të, në universitetet gjermane nis të formësohet një mendësi e re lidhur me degët e shkencave shoqërore në përgjithësi dhe brenda filologjisë klasike në veçanti. Kësaj mendësie i referohet Maks Veberi (Max Weber: 1864-1920) në artikullin e tij programatik *Wissenschaft als Beruf* (Shkenca si profesion)<sup>9</sup>, duke i mëshuar konceptit normativ të çlirimit nga të vlerësuarit në shkencë. Fryma e artikullit të Weberit, mbajtur si ligjëratë në vitin 1917 dhe botuar për herë të parë në vitin 1919, përvijohet në tërësinë e problematikës së kohës, duke pasur parasysh hermeneutikën e Diltait (Wilhelm Dilthey: 1833-1911)<sup>10</sup>. Kjo hermeneutikë synon ndarjen dhe konsolidimin e shkencave shoqërore nga degët e tjera, duke përcaktuar si detyrë kryesore të këtyre shkencave kalimin nga sipërfaqja materiale e fenomeneve në thellësinë e tyre shpirtërore përmes interpretimit si metodë sunduese. Përveçse në hermeneutikën e Diltait, mendësia e re e përqokur më sipër, gjen shprehje dhe në estetizimin e *artit për art* të poetit Stefan George (1868-1933) dhe stilit kulturor të rrethit të tij si dhe në konceptin inovativ të filozofisë së kulturës të Niçes (Friedrich Wilhelm Nietzsche: 1844-1900)<sup>11</sup>

Elementi thelbësor i *qarkut hermeneutik* (hermeneutischer Zirkel) të Diltait, i konkretizuar në raportet e pjesëve me të tërën dhe anasjelltas, gjen shprehje në punimet e hershme të Çabejt në zbatimin e rezultateve të teorisë kulturo-historike dhe interpretimin e mbështetur në një perspektivë holistike. Duke lëvruar në një kuadër gjithëpërfshirës filologjik ai nisët nga faktet konkrete të historisë për interpretimin e elementeve letrare.

Interesant në këtë aspekt është dhe përcaktimi konkret i Çabejt për filologjinë në një artikull të hershëm të vitit 1929, botuar për herë të parë në monografinë e vyer të Shaban Demirajt<sup>12</sup> për të. Ai e quan filologjinë si "një nga dituritë më të shtrëngueshme (severe)

---

9 Tenbruck, H. F. (1994) Die Wissenschaftslehre Max Webers. Voraussetzungen zu ihrem Verständnis. Në: Wagner, Gerhard (1994) Max Webers Wissenschaftslehre: Interpretation und Kritik. Suhrkamp, Frankfurt am Main, f. 367-389.

10 Dilthey, W. (1981, botimi i parë 1910) Der Aufbau der geschichtlichen Welt in den Geisteswissenschaften. Suhrkamp, Frankfurt a.M.

11 Gumbrecht, Hans Ulrich (2003) Die Macht der Philologie. Suhrkamp, Frankfurt am Main, f. 124-125.

12 Demiraj, Sh. f. 220-222.

e më ekzakte që mund të jenë në botë”<sup>13</sup>, duke vijuar konkretisht me karakterin gjithëpërfshirës të filologjisë, në rastin konkret për gjuhën shqipe, me apelin shkencor aq aktual: “Kush do të shkruaj për shqipen, më parë duhet të jetë marrë me studimin e gjuhëvev indoeuropiane përgjithësisht, e pastaj duhet të ketë studiuar gjithë shkrimtarët shqiptarë e gjithë albanologët e huaj, numëri i të cilëvev është aq i math, sa studimi i tyre lyp vite me radhë pune të pareshtur. Se filologjia nuk është zbavitje, është larg nga diletantismimi. Është dituri, dhe që të kapesht me dituri duhet të dish!”<sup>14</sup>

Një apel intelektual të cilit Çabej i mbeti besnik tërë jetën dhe që për fat të keq edhe tani pas gati një shekulli vë gishtin në plagë dhe është aktual më shumë se kurrë.

### ***Përvijimi i njësisë shqiptare në krahasim me fqinjët***

Duke e parë romantizmin jo vetëm si fenomen letrar, por edhe si fenomen politik dhe kulturo-historik, Çabej nënvizon se kjo lëvizje zhvilloi në gjithë Evropën Lindore dhe Juglindore më fort anën nacionale-politike, sesa anën thjesht letrare. Në një kontekst të gjerë krahasues ai rendit tiparet e munguara të romantizmit në Evropën Lindore e Juglindore, si p.sh.: mungesën e themelit filozofik të poezisë, e kultit të individit në kontrastin e tij me mjedisin, e largimit të poetit nga realiteti në kohë dhe vise të largëta, e kultit të gruas, e ndjenjës religjioze dhe idealizmit mistik, e ironisë romantike, dhe i mëshon nga ana tjetër veçantive të përftuara, si punimin e gjuhës amtare, studimin e poezisë popullore dhe folklorit përgjithësisht, duke arritur në përfundimin se: “ç’humbi këtu në përmbajtje të brendshme poetike, romantizmi e fitoi në efektin e tij në pikëpamje sociale-politike.”<sup>15</sup> Lidhur me kombet e Ballkanit, në mënyrë të thukët Çabej ravijëzon shkëputjen nga blloku osman, individualizimin nacional, krijimin e një shteti kombëtar, e një literature të vet dhe atë të një gjuhe letrare.<sup>16</sup>

Në kuadrin e mësipërm krahasues shpalimi i romantizmit shqiptar bëhet mbi bazën e gjeografisë dhe karakterit të vendit, fuqive centrifugale në historinë e popullit shqiptar, karakterit të tij, njësisë dhe shpirtit të kombit, Shqipërisë midis Lindjes dhe

---

13 Po aty, f. 221.

14 Po aty, f. 221v.

15 Çabej, E. (1994) f. 79.

16 Po aty, f. 97.

Perëndimit<sup>17</sup>, elemente këto të parashtruara në aspektin etnografik dhe kulturo-historik nga Çabej tek *Gjeneza*.

Njësia dhe shpirti i kombit përimitohen nga Çabej mbi bazën e veçantisë gjeografike të truallit shqiptar, si “çelësi i Adriatikut dhe si pikë takimi e botës romane me botën greke e sllave”<sup>18</sup>, duke konkluduar në mënyrë lapidare se “ky qëndrim i ndërmjetëm midis Perëndimit dhe Lindjes, i bashkuar me ruajtjen e ngulur të natyrës së vet etnike, i ka gdhendur Shqipërisë përgjithmonë natyrën e saj të veçantë.”<sup>19</sup>

Veçantia e njësisë dhe shpirtit të kombit parashtrihen në aspektin e kulturës materiale dhe asaj shpirtërore duke filluar me fisin si një grumbull etnik kompakt<sup>20</sup>, banesën, me kriterin themelor të saj: mundësinë e mbrojtjes<sup>21</sup>, me ngjyrën e bardhë si ngjyrën kombëtare të veshjes shqiptare<sup>22</sup>, me karakterin shqiptar, shpirtin e energjisë, karakterin rezolut, natyrën e ushtarit si një atribut konstant të kombit<sup>23</sup>, rezervimin, në situata të veçanta kokëfortësinë, tenacitetin, dëshirën për shtegtim dhe mallin e tokës.

Edhe në qasjen që i bën poezisë popullore Çabej vë në dukje anën nacionale dhe atë ballkanike, duke theksuar se e para nxjerr në pah shpirtin e kombit, kurse e dyta ndërlidhjet kulturore.<sup>24</sup>

Në përqokjen e të gjithë elementeve të mësipërm Çabej përvijon fizionominë e njësisë kombëtare shqiptare përballë popujve ballkanikë, duke vënë njëkohësisht në pah faktin, që përmes lidhjeve me këta popuj, populli shqiptar “bën pjesë në njësi ballkanike më të madhe, që përfshin disa popuj së bashku.”<sup>25</sup>

### ***Makrokozmosi dhe mikrokozmoset***

Duke mbajtur gjithmonë parasysh njësinë, Çabej shtjellon brenda kësaj njësie dhe individualitetin e krahinave të ndryshme, mikrokozmoset, që përmes të përbashkëtave dhe dallimeve e formësojnë makrokozmosin shqiptar.

---

17 Po aty, f. 93.

18 Po aty, f. 18.

19 Po aty, f. 19.

20 Po aty, f. 20.

21 Po aty, f. 25.

22 Po aty, f. 26.

23 Po aty, f. 27

24 Po aty, f. 32

25 Çabej. E. (2011) Diana dhe zana. Studime kulturhistorike. Botime Çabej, Tiranë, f. 117.

Lidhur me lashtësinë e shqiptarëve ai veçon si dy faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar në ruajtjen e tij, karakterin e vendit dhe tenacitetin e banorëve. Faktori i dytë është për Çabejn konstant për krejt Shqipërinë, kurse i pari ndryshon bashkë me krahinat. “Atje ku, si në Shqipërinë e Veriut, male të pakalueshme pothuajse e mbyllin dhe e veçojnë banorin nga bota që e rrethon, institucionet e vjetra kanë mundur të ruhen pothuaj të pavdara.”<sup>26</sup> Përkundrazi, krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut kanë qenë gjeografikisht më të hapura dhe për pasojë të tilla edhe nga ana kulturore, duke pësuar më shumë ndikime nga jashtë. Lidhur me zhdukjen e fisit, duke sjellë si shembull rastin e Labërisë, Çabej vëren që ai megjithatë nuk është zhdukur krejt në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut.

Përkimet midis Veriut dhe Jugut shtjellohen prej tij në një kuadër gjithëpërfshirës, i cili ngërthen në vetvete elemente të kulturës materiale, shpirtërore dhe sociale të njësisë, makrokozmosit shqiptar. Përrallat p.sh. janë për të një dokument i kulturës sociale, i ruajtjes së gjurmëve të dokeve dhe zakoneve të lashta. Duke nënvizuar fytyrën vetiake të përrallës shqiptare, në krahasim me përrallat ballkanike, Çabej vëren njëkohësisht edhe ndryshimet krahinore që dëshmon shtresa sekundare e tyre. “Po të krahasojmë përrallat gege veriore të Malësisë me ato të Toskërisë Jugore, do të na shfaqet te të parat më shumë jeta naive epike me ruajtjen e botës primitive të demonëve dhe me mbajtjen e mitologjisë popullore.”<sup>27</sup> Në përrallën e Jugut përkundrazi Çabej vë në dukje paraqitjen e jetës së qyteteve, të zejeve të ndryshme, figurat e barinjve, punëtorëve shtegtarëve dhe njerëzve të zanatit.

Në lëmin e kulturës materiale Çabej merr si shembull banesën dhe kostumet. Për banesën ai nënvizon faktin që shkenca e banesës shqiptare ndodhet në fillimet e saj, duke përmendur kontributin e Nopçës (Franz von Nopcsa: 1877-1933) për shtëpitë e Shqipërisë Veriore dhe atë të Urbanit (Jan Urban Jarník: 1848-1923) për ato të Shqipërisë Jugore. Si tipar të qenësishëm të njësisë shqiptare në rastin e banesës, Çabej vë në dukje mundësinë e mbrojtjes, e cila merr formë konkrete në rastin e kullës, që me rritjen e familjes së madhe zgjerohet në lagje fisi deri në një katund fisnor. Në vijim të

---

<sup>26</sup> Çabej, E. (1994) f. 22.

<sup>27</sup> Po aty, f. 33

dallimeve në lëmin social ai arrin në përfundimin se: “ç’është për malësorin fisi dhe familja e madhe, është për qytetarin familja.”<sup>28</sup> Me largpamësi Çabej tërheq vëmendjen, se analogjive midis zakoneve të krahinave të ndryshme u duhet kushtuar një vëmendje e madhe, për të nxjerrë në dritë “atë që ka qenë dikur e përbashkët në zakonet shqiptare”.<sup>29</sup>

Paraqitja e shkurtër e raporteve të “emëruesit të përbashkët shqiptar” si njësi në dallim nga fqinjët, por edhe në kuadrin e veçorive të pjesëve që e përbëjnë këtë njësi në punimet e hershme të Çabejt, vë në dukje fare qartë, edhe sot pas gati një shekulli, aktualitetin e dijës gjithëpërfshirëse të albanologut në fjalë në shtrimin e pyetjeve dhe të dilemave për universin shqiptar. Puna kërkimore shkencore e çfarëdolloj drejtimi, për më tepër dhe ajo filologjike, është “një sfidë shpirtërore pa pasur detyrimin për një reagim të atypëratyshëm apo madje një zgjidhje të shpejtë”<sup>30</sup>. Një rilexim dhe konsultim i vazhdueshëm i Çabejt do të ishte ndoshta mënyra më e thjeshtë, por edhe më kuptimplotë për ta vlerësuar dhe kësisoj edhe përkujtuar veprën e tij.

### **Bibliografia:**

Çabej, E. (2011) Diana dhe zana. Studime kulturhistorike. Botime Çabej, Tiranë.

Çabej, E. (1994) Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes. MÇM, Tiranë.

Demiraj, Sh. (1990) Eqrem Çabej. Një Jetë kushtuar shkencës. 8 Nëntori, Tiranë.

Dilthey, W. (1981, botimi i parë 1910) Der Aufbau der geschichtlichen Welt in den Geisteswissenschaften. Suhrkamp, Frankfurt a.M.

Grimm, J. & Roethe, G. & Schröder, E. (2017, botimi i parë 1890) Deutsche Grammatik. Hanser, München.

Gumbrecht, H. U. (2003) Die Macht der Philologie. Suhrkamp, Frankfurt am Main.

---

28 Po aty, f. 28.

29 Po aty, f. 29.

30 Gumbrecht, H. U. (2003) Die Macht der Philologie. Suhrkamp, Frankfurt am Main, f. 137: “sich einer geistigen Herausforderung stellen zu dürfen, ohne zu einer raschen Reaktion oder gar zu einer schnellen ‘Lösung’ verpflichtet zu sein.”



Mojašević, M. & Rehder, P. (1824): Kleine serbische Grammatik. Übersetzt und mit einer Vorrede von Jacob Grimm. Otto Sagner, München.

Rölleke, H. (botues) (1985, botimi i parë 1812/I, 1815/II) Kinder- und Hausmärchen gesammelt durch die Brüder Grimm. Suhrkamp, Frankfurt am Main

Tenbruck, H. F. (1994) Die Wissenschaftslehre Max Webers. Voraussetzungen zu ihrem Verständnis. Nö: Wagner, Gerhard (1994) Max Webers Wissenschaftslehre: Interpretation und Kritik. Suhrkamp, Frankfurt am Main.

Mimoza Kore

## **QËMTIME NË “STUDIME ETIMOLOGJIKE NË FUSHË TË SHQIPES” TË EQREM ÇABEJT**

### *Vërejtje të përgjithshme*

Studimet tona albanistike kanë njohur arritje të shënueshme në dekadat e fundit, por kreun e vendit në to e zë, pa dyshim, vepra madhore e emërtuar thjesht nga Eqrem Çabej, “Studime Etimologjike në fushë të shqipes”. Kjo vepër në 7 vëllime e pa dritën e botimit dorajdorës, derisa në vitin 2014 u realizua edhe botimi i vëllimit V, botim që plotësoi gjithë këtë korpus të punës prej katër dekadash të Eqrem Çabejt, që u prit me ngazëllim nga gjuhëtarët e veçanërisht ata të fushës, çka gjen shprehjen më të mirë në kumtin e B. Demirajt: “Consummatum est ~ u kompletua!”

Puna për studimin etimologjik të leksikut të shqipes filloi në trajtë artikujsh prej tij të cilët u botuan fillimisht në “Buletinin e Universitetit Shtetëror të Tiranës” prej vitit 1960 deri më 1963 dhe në revistën “Studime Etimologjike” prej 1964 deri më 1968. Në vitet që pasuan E. Çabej i plotësoi më tej ato derisa në fundin e viteve ’70 filloi puna për botimin e veprës “Studime Etimologjike në fushë të shqipes”.

Për nevoja të momentit i ishim drejtuar kësaj vepre për të konsultuar etimologjinë e ndonjë fjale të veçantë, jetën e saj, por përpara 2 vitesh, së bashku me dy kolege, u përkujdesëm për redaktimin e të gjithë veprës për ta përgatitur edhe një herë për një botim të ri. Të rrokurit me punë dhe vështrim të kujdesëm të gjithë kësaj ngrehine madhore që mund të quhet enciklopedi e shqipes, na bëri të kuptojmë më mirë filozofinë e punës, metodën dhe parimet

e ndjekura, zgjidhjet racionale e të mbështetura shkencërisht, mesazhet shkencore që arrijnë deri në ditët tona, të cilat i japin ende kësaj vepre vlerën e bashkëkohësisë.

*Së pari*, qysh në krye të herës E. Çabej përcakton qartë se ky punim ka një karakter të dyfishtë, ai është njëkohësisht kritik e ndërtimtar. Ky është një mesazh për këdo që nis një punë shkencore.<sup>1</sup> Dokumentimi kritik, mbajtja qëndrim, paraqitja e gjendjes së studimit etimologjik të shqipes, vlerësimi objektiv i punës së mëparshme, kjo përbën njërën anë të dukshme të karakterit të përgjithshëm të kësaj vepre. Për këtë me skrupulozitet shkencor, me objektivitet dhe i mbështetur mbi parimet e avancuara të kohës ai shqyrtoi etimologji të dhëna më parë nga studiues të huaj si: G. Meyer, N. Jokl, Stieri, F. Miklosichi, H. Schuchardt, K. Brugmanni, A. Thumbi, W. MeyerLübke, H. Helbigu, G. Weigandi, M. Lambertzi, C. Treimeri, M. Vasmeri, M. Bartoli, A. M. Seliščevi, P. Skoku, H. Barići, S. Puşçariu, O. Densusianu, A. Philippide, A. Rosetti, V. Pisani, V. Georgievi, V. Popovići, C. Tagliavini, S. Manni, W. Cimochowski, H. M. Ölbergu etj. Edhe pse përballë kishte gjuhëtarë të mëdhenj, ai shqyrtoi me kujdes shpjegimet e tyre etimologjike shumë prej të cilave konstatoi se ishin të sakta e të pranueshme, shumë të tjera të diskutueshme e deri të dyshimta e të tjera të shpjeguara pa kujdes ose në mënyrë spekulative. Për shembull, lema *pështýj*, *pështymë* ishte shpjeguar nga G. Meyer, Meyer-Lübke prej lat. *\*sputire* për *sputare*. Po kështu sipas tyre kishin shkuar edhe Weigandi, Puşçariu, Tagliavini. E. Çabej e shpjegon si fjalë e mbarë gjuhës, e cila del qysh te Buzuku dhe bazën e ka te një onomatope. Po kështu fjala *rend* II. “vrapij, eci me vrap”, të cilën G. Meyer e sillte prej greqishtes e kjo pas sllavishtes. Me këtë pajtohej edhe G. Weigandi. E. Çabej vlerëson shpjegimin e N. Jokl që shihte një fjalë vendi. Për fjalën *kaçe* “në shpinë, kaliqafë, kaliboç” fjalë e toskërishtes jugore (Gjirokastër) shënuar së pari te Hahni (210). Jo nga turq. *kiç* “pjesë e mbrapme, vithe” (G. Meyer 182 te kaç), po nga kal-çe, prej kalë + turq. çe. Edhe sinonimet e kësaj: *kaliqafë kalaqafë, kaliboç, kalapiç, kalikaç*, përmbajnë fjalën *kalë*, gjithashtu optikalas; sh. *kaliqafë, optikalas*. Për sufiksin turk -çe në shqipen sh. A. Xhuvani

---

1 E. Çabej, *Studime etimologjike nw fushw tw shqipes*, Bleu I, f. 26.

– E. Çabej. (29v.)<sup>2</sup> E mund të vazhdojmë me *çerdhe* f. të cilën G. Meyeri (446) e mendonte për një huazim të vjetër prej sll. \**čerda*=sll. e vj. kishtare *črēda*, kurse E. Çabej e shënon si fjalë vendi.

Përveç shqyrtimit të punës së të tjerëve, E. Çabej ndërtoi të gjitha format e fjalës brenda shqipes e nga ana tjetër siç shprehet dhe vete, në rastet kur etimologjia e një fjale, e dhënë prej të tjerëve, paraqitet e drejtë, ai përsëri e përforcoi atë me të dhëna të reja. Në këtë mënyrë ai vlerësoi dhe trashëgiminë e studiuesve shqiptarë edhe pse nuk mund të flitej deri atëherë për studime të mirëfillta etimologjike mbështetur në parime të rrepta shkencore, si: P. Mazreku, N. Keta, E. Mashi, V. Dorsa, J. De Rada, Th. Mitko, N. Gazulli dhe sidomos Dh. Kamarda, K. Kristoforidhi, M. Camaj, A. Xhuvani. Zgjidhjet që kishin dhënë shpesh ishin arbitrare, intuitive, megjithatë ai i vlerësoi dhe shumë prej tyre i pranoi.

Koha në të cilën punoi, kishte dhe kufizimet e veta, por ai me guxim dhe paanshmërinë e shkencëtarit mori në shqyrtim dhe citoi deri në detaj edhe punën e atyre që sistemi i konsideroi të padëshirueshëm, madje i kishte dënuar. Edhe pse nuk u pasqyruan në botimin e kësaj vepre, duke u censuruar, në skedat vetjake të E. Çabejt (për të cilat falenderojmë të bijën që na i vuri në dispozicion) gjejmë emrat: B. Palajt, B. Dema, V. Volaj, Sh. Bardhi, M. Camaj<sup>3</sup>, veprën « Lahuta e Malcis » e shumë zgjidhje të paraqitura në to i ka pranuar si të drejta. Sigurisht, siç e shpjegon dhe vetë, parimisht ka kaluar në heshtje sprovat e kota të diletantëve pa kompetencë.

Mbështetjen më të madhe në nxjerrjen e konkluzioneve të tilla E. Çabej e gjeti te njohja e mirë e gjuhës amtare, e dialekteve e të folmeve shqipe në të gjitha trevat ku jetonin shqiptarë, të dhëna për të cilat vit pas viti që ai punonte, po shtoheshin e për këtë kanë meritë gjithë gjuhëtarët e kësaj periudhe. Mbështetjet, gjithashtu në materialin e trashëgimisë shkrimore të shqipes prej të cilave vinin

---

2 E. Çabej, *Studime etimologjike nw fushw tw shqipes*, Bleu V, 2014.

3 **pela-t** fsh. “dallgët, tallazet”. Këtë fjalë të geg. veriore e dëshmon B. Palaj (HD X 84 shën. 27) si *pelat* “tallazet e mëdha”, “majet e tallazeve, qi, tână shkumë rrxohen nëpër valë” për Brebullë të Berishës: *s’lanë pelat me dalë kush Drinin; f. 301: kuri* “vend i thelluar në dhe” që ka Puka (B. Palaj f.282 Bleu VI).

Për kuptimin e parë do pasur *parasysh kuri* “vend i thelluar në dhe” që ka Puka (B. Palaj), M. Camaj *kori* “çarranik a thark për bulmet, përpara shtëpisë” në Qerret të Pukës, f.283 B.Vi

fjalë të vjetra e të pavëna re në studimet e mëparshme.

E. Çabej nuk kishte qëllim që në këtë punim madhor të studionte shqipen si qëllim në vetvete e për vetevete, por synimi ishte më i gjerë se kaq, të përcaktohej nga ana e leksikut karakteri specifik i shqipes dhe vendi i saj në rrethin e gjuhëve të tjera indoeuropiane me një formulim më të prerë nga ç'është bërë gjer më sot, thotë ai. Një punë e tillë duhet të kryhet dhe për sistemin fonetik e sistemin morfologjik të saj, për të arritur në një gjykim më përfundues në këtë çështje<sup>4</sup>. Kjo bëri që në këtë vepër shqipja të gjente një ridimension së brendshmi, të shqyrtoheshin fjalë e trajta të tyre në të gjitha të folmet, dialektet, tekstet e hershme. Kështu për fjalën **Çup** “kënd, qoshe” ai jep të gjitha variantet në të folmet e shqipes: çep “sqep; kënd, çip, qoshe”, *cep* “skanj; qoshe, kënd i dalë; sup; sqep”, *qep, sqep, thep, çip* “kënd, qoshe”, *s-qup, sup*. Sigurisht që këto okurrenca albanologët e huaj nuk mund t'i jepen dot.

Duke njohur mirë gjuhën amtare, jetën që kishte bërë fjala, rruhdjen e përdorimit të saj, variantet parake e ato të vonshme, shtrirjen brenda e jashtë trevave politike aktuale, të gjitha këto bënë që gjuhëtari ynë të dilte në përfundime të rëndësishme për historinë e gjuhës shqipe, për trevat ku ishin shtrirë shqiptarët e të parët e tyre.

Objektiviteti shkencor e përshkon gjithë këtë vepër. E. Çabej nuk mori në shqyrtim vetëm fjalë të cilat mund t'i analizonte, krahasonte e në fund të jepte një përfundim bindës. Ai nuk iu shmang edhe atyre që mbeten ende të pazgjidhura, duke lënë një derë të hapur për ata që do të vijonin të merreshin me etimologji. Nga ana tjetër nuk i vuri vetes detyrë të shtonte me çdo kusht përqindjen e elementit të trashëguar të leksikut prandaj edhe për disa fjalë të shpjeguara si vendase E. Çabej tregoi burimin e huaj, p.sh. edhe pse Meyer, Helbig e Bariç fjalën *foshnjë* e shpjegojnë si të shqipes E. Çabej e lë të diskutuar, megjithese pranon që shtrihet në të gjitha të folmet. Po kështu *gjegjem* për të cilën pranon se është fjalë e gjuhës mbarë, sot e vjetruar, por pranon se etimologjitë e gjertanishme janë të gjitha për të hedhur poshtë. U mungon ose mbështesa formale ose kuptimore, disa krejt fantastike.<sup>5</sup>

4 E. Çabej, Bleu I. f.27.

5 E. Çabej, Bleu IV, f.267

### Pasqyrë dhe analizë e vëllimit III

Për të parë më konkretisht e shqyrtuar më në detaj, morëm në shqyrtim Bleun III (C , Ç, D) të gjithë kësaj vepre, përzgjedhur në mënyrë të rastësishme prej nesh, ku mund të jepet dhe një pasqyrë e etimologjisë së lemave të përzgjedhura prej tij. Këtij vëllimi për fat të mirë, E. Çabej arriti t'i jepte dorën e fundit, ndryshe nga vëllimet e tjera që mbetën në dorën e parë.

Duke pasur parasysh që ai nuk është një fjalor etimologjik në kuptimin klasik (si p.sh. Fjalori etimologjik i K. Topallit) në të gjenden lema që E. Çabej e gjeti të arsyeshme t'i shqyrtojë duke diskutuar punën e paraardhësve, po kështu gjenden të tjera që nuk kanë përdorim në gjuhën shqipe, por mund të kenë dalë në veprën e dikujt dhe janë bërë objekt analize nga etimologë të mëparshëm, madje dhe ndonjëra e kuptuar gabim prej të huajve, p.sh. *dētónj* “i kam një borxh dikuj”. Kjo fjalë-shpjegon E. Çabej- nga sa dimë, nuk ekziston në Shqipëri. G. Meyeri pas gjithë gjasësh e ka marrë prej Zef Kamardës, ose *dëshýll* m. “humbje në luftë, thyemje” fjalë e përdorur nga Fan Nolit, *dëshylli-i Beratit*, “Historia e Skënderbeut” (1921) formim pas frgj. *désastre*, it. *disastro*: nuk ka hyrë në përdorim të gjuhës.

Me këtë duam të theksojmë se një pasqyrë e tillë paraqet pjesërisht gjendjen reale të shqipes kur është shkruar vepra. Kështu do të pritej që pas lemës foljore *di* të vinin *diabet*, *diademë*, *diafragmë*, *diagnozë*, *diagonale*, *dialekt*, *dialog* etj. Përkundrazi vinë lema të tilla që sot nuk përdoren dhe shumicës nuk iu dihet kuptimi, ndihen të vjetruara e shumë prej tyre vinë prej turqishtes : *dibá* f. “lloj kumashi i mëndafshhtë”, *dibét* m. “cipë e zezë e ndritshme, *dibël* mb. “i ligshhtë etj. Kjo u realizua prej tij me qëllim për të parë karakterin historik të fjalëve.

Në këtë vëllim janë parë 849 njësi leksikore (= C 174, Ç 263, D 412), duke përfshirë variantet dialektore të lemës kryesore, të cilat shpjegohen te shkronja përkatëse e lemës bazë, p.sh. *caçpuríq* m., mb. lihet pa sqaruar, sepse është variant i *Spurdhíq* ; *cagë* f.: sh. *cak*, *caherë* ndf.: sh. *ca* ; **çeshtëj**: sh. *teshtëj* ; *dýzllúk* m.; sh. *Tozllúk* etj.

Po i paraqesim të klasifikuara më poshtë lemat e këtij vëllimi :

	C	Ç	D	
fjalë shqipe	119	92	149	=360
greqizma (të gjitha etapat)	13	5	16	=34
latinizma	2	2	24	=28
sllavizma	17	35	44	=96
turqizma	5	107	122	=234
veneciane	7	.....	4	=11
italianizma	4	7	21	=32
arab	.....	.....	1	= 1
anglisht	.....	.....	1	= 1
arumune	3	.....	.....	= 3
spanjisht	1	.....	.....	= 1
etimologji të diskut.	3	12	23	= 38
etimologji dyfishe	.....	3	7	<u>=10</u>
				<b>849</b>

Kjo pasqyrë na krijon një ide të raportit të fjalës vendase me fjalët e huaja, e cila nga vëllimi në vëllim pa dyshim është e ndryshme (shih për vëllimin V B. Demiraj) <sup>6</sup> përveç këtij përpjestimi, kjo pasqyrë është shprehje e historisë së popullit tonë, e kontakteve me kultura e popuj të tjerë, ku dallohet ndikimi më i madh nga gjuhët e pushtuesve historikë, si sllavishtja, turqishtja. Kjo i jep kësaj vepre jo vetëm karakterin e një fjalori thjesht etimologjik, por dhe atij historik e tregon qartë se nuk kemi qenë një popull i izoluar, por jemi përballur me kontakte intesive e të gjata. Këtë e bën më të qartë dallimi prej autorit edhe të fazave nëpër të cilat ka kaluar fjala. Ai bën një shtresëzim kohor të leksikut, kështu e njëjta fjalë ka hyrë fillimisht nga latinishtja e më vonë përsëri nga italishtja duke i dhënë etimologji të dyfishtë fjalës latin, *desperare*, dhe it. *desperare*.

Në klasifikimin që kemi bërë kemi përdorur vetëm termin *sllavizma*, por shumë prej tyre janë periferike e të serbishtes, kurse në Jug mbizotërojnë ato prej bullgarishtes, duke nënkuptuar përsëri një faktor historik: Fjala *cep* m. II. “vile rrushi e vogël”, Çabej e cilëson : Huazim krahinor prej sllavishtes. Në Veri prej

6. B. Demiraj, Eprem ÇABEJ: Studime etimologjike në fushë të shqipes, Bleu V (K-M), SHB Çabej, Tiranë 2014, 478 f.; ISBN 978-99956-35-20-6

serbokroatishtes, në geg. jugore prej maq. *Cepka*.

Kur sqarimi i etimologjisë të ndonjë zëri të veçantë si në rastin e fjalës *druaj druej* “kam frikë ” qëllimisht futet në tjetër hulli nga studiues të huaj E. Çabej mban qëndrim, madje me tone të ashpra, që nuk është në natyrën e gjuhës së tij, e thotë është një dështim pseudoshkencor, pjellë e një përpjekjeje sistematike shovene për të mohuar me çdo kusht ndikime të shqipes në rumanishten<sup>7</sup>

Ka zëra në këtë vepër që nga përmasat e trajtimit, argumentet e shumta, shembujt nga të gjitha arealet e shqipe, krahasimet me indoevropianishten e gjuhët e tjera mund të përbënin një artikull shkencor siç ka ndodhur me *lemën* e porsapërmendur sqarimi i së cilës shtrihet nga f. 413-f. 416.

Në këtë vëllim sikurse në të gjithë veprën e tij janë trajtuar përveç leksikut të përgjithshëm edhe një varg etnonimesh, antroponimesh e toponimesh që shërbejnë si argumente për probleme themelore siç janë çështja e autoktonisë së shqiptarëve dhe e vendit të formimit të gjuhës shqipe, fjalë e terma të besimeve fetare që hedhin dritë për kohën dhe rrugët e depërtimit të krishterimit: *Drin* m., emër lumi (shq), *Drisht* m. emër qyteti (shq), *Dorsa* familje arbëreshe (shq), *Dodë* emër personal (lat), *Dedë* m., emër personal (shq) etj. E. Çabej në studimet e tij e kishte shpallur si një parim themelor idenë se “Gjuhët nuk janë madhësi që ekzistojnë në vetvete; ato janë të lidhura ngushtë me njerëzit që i flasin, me popujt si bartësit e atyre gjuhëve, prandaj historia e gjuhëve në thelb është pasqyrë e historisë së popujve e të kulturave”<sup>8</sup>.

Në këtë Ble për shumë zëra janë treguar jo vetëm lëvizjet e fjalëve brenda gjuhës shqipe, por edhe shtegtimi i tyre në gjuhët fqinje: *car* m. “vend i thurur me thupra ” fjale e shqipes që ka hyre dhe në arumanisht, rumanisht e greqishte nga njw “thark ”<sup>9</sup>; *ciladó* *ciladó* e shqipes ka hyre dhe në arumanishte etj; *cerma*, ka shkuar

7 E. Çabej, Shpjegimi i fjalës rumune prej një \**drugia* të “substratit”, e afër kinse me irl. *drong* “çetë”, sll. e vj. kishtare *drugъ* “shok” etj. te Russu (CL VII 120, Revue de Ling. VIII 2 265, Die Sprache der Thrako-Daker 238v., El. aut. 96v.) është një dështim pseudoshkencor, pjellë e një përpjekjeje sistematike shovene për të mohuar me çdo kusht ndikime të shqipes në rumanishten, Bleu III, f.415.

8 Çabej, *Studime gjuhësore*, V, Prishtinë 1975, f. 10.

9 E. Çabej, “Ndërkaq fjalë greke e aromune (e rumune) nga ana e tyre rrjedhin prej një \**car*-u të shqipes, trajtë më e vjetër e *thark*-ut të sotëm”, Bleu III, f. 16.



prej shqipes dhe në greq. e re, τσέρμα; *cime*, lloj peshku i vogel ka shkuar dhe në gr. e re veriore, τσίμα; shqip *dosë* ka shkuar dhe në disa gjuhë fqinje; skr. *Dasanče*; *dashur* ka shkuar dhe tek aromunët, *dašur*, *debe* f. “enë druri në formë të një gjymi” të vogël ka shkuar dhe në serbokroatishten; *degë* ka shkuar dhe në aromunishten, *deagă*; *dorëzanë* ka shkuar dhe në dialektet e serbishtes, *dromsa* sh. “thërrime”, me *s* si në çamërishten, forma që ka hyrë prej shqipes në greqishten e Moresë, ντρόμζες “groshë të holla”.

I gjithë studimi ngërthen punën e palodhur e të përkushtuar të këtij dijetari në të gjitha fushat e studimit historik të gjuhës: fonetikë dhe gramatikë historike të saj, leksikologji dhe dialektologji historike si dhe histori e kulturës shqiptare. Njohja shumë e mirë e tyre bëri që materiali të trjatohet midis maturisë dhe lirisë së kombinimit, duke i dhënë gjithë punës së tij karakteristika unike, vetjake, prandaj i gjejmë me vend fjalët e gjuhëtari austriak H. Ölberg ”Është për të ardhur keq që Çabej nuk formoi një shkollë gjuhësore indoeuropiane të tijën”

Do ta përmbyllim këtë kumtesë me vlerësimin domethënës të I. Ajetit: “Veptra e rëndësishme e E. Çabejt shënon një kontribut të pazëvendësueshëm në studimet e historisë së gjuhës dhe të kulturës shqiptare. Ai i la popullit shqiptar dhe kulturës së tij një vepër, e cila do të mbetet e gjallë si sot, si në motet që do të vijjnë.”<sup>10</sup>

## Literatura

Ajeti, I. (1982) Studime etimologjike në fushë të shqipes, I, Prishtinë.

Çabej, E. (1975) *Studime gjuhësore*, V, Prishtinë

Çabej, E. (1982) *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, Bleu I, Tiranë.

Çabej, E. (1996) *Studime etimologjike në fushë të shqipes* Bleu IV, Tiranë.

Demiraj, B. (2014) “Eqrem ÇABEJ: Studime etimologjike në fushë të shqipes”, Bleu V (K-M), SHB Çabej, Tiranë.

---

10 I. Ajeti, Studime etimologjike në fushë të shqipes, I, 1982, f. 32.

Albert Riska

## APOFONIA E SHQIPES NË QËMTIMET ETIMOLOGJIKE TË JOKLIT REFERUAR NGA ÇABEJ

Prof. Çabej e përkufizon apofoninë, në mënyrë shumë konçize, si “alternimi i rregullt i disa vokaleve të caktuara në fjalë që lidhen etimologjikisht në mes të tyre”.<sup>1</sup>

Duke u mbështetur në analizat etimologjike në fushë të shqipëse, ai provon se kemi gjurmë të të dyja tipeve të apofonisë: apofonisë kualitative (cilësore) dhe apofonisë kuantitative (sasiore).

Për apofoninë kuantitative shprehet se është ndërrimi i shkallëve të ndryshme të të njëjtit vokal në fjalë etimologjikisht të afërta dhe mendonte se këto shkallë janë katër: shkalla (ose grada) normale ose e plotë, shkalla e zgjatur, shkalla e reduktuar dhe shkalla e zhdukjes; duke dhënë për shembull kundërvënien latinisht *dōnum* ~ greqisht *dosis*, e para me /o/ të gjatë, e dyta me /o/ të shkurtër. Këtë tip të apofonisë e lidh me akcentin dinamik.

Apofonia kualitative është parë si ndërrimi ose alternimi i dy vokaleve të ndryshme, shkaktuar, sipas tij, në instancë të fundit prej akcentit muzikal. Përndarja e vokaleve është e tillë që zakonisht /e/-ja i përket verbit, /o/-ja emrit.

Apofoninë kuantitative, duke referuar G. Meyer-in, e gjen në foljet shqipe që provojnë kundërvënie fonetike në temat e të tashmes dhe aoristit, në të cilat kundërvënien e sotme *e/je-o* i përgjigjet kundërvënies së hershme /e/ ~ /ē/ dhe, sipas tij, /e/ i ka takuar të tashmes dhe /ē/ i ka takuar aoristit: *mbledh-mblodha*, *djeg-dogja*, *heq-hoqa*. Po ashtu edhe *bie-bora* që kishte parë N. Jokl-i, apo edhe

*mat/mas-mot/moshë e djeg-ndez.*<sup>2</sup>

Apofoninë kualitative në gjuhën shqipe Prof. Çabej e gjen në disa çifte folje-emër, si *bie-bar*, *vjer-var*, ku vëren se kundërvënia e sotme *ie/je – a* i përgjigjet kundërvënies së hershme *e – o*. Sipas rregullave fonetike të shqipes, *e*-ja e theksuar u reflektua në shqip në *ie/je*, ndërsa *o*-ja u reflektua në *a*.

Mund të vihet re se Prof. Çabej e përcakton apofoninë si një ndërrim ose alternim i rregullt fonetik, duke parë si shkak të alternimit tipat e theksave, pra, sheh një dukuri morfonologjike me burim të natyrës fonetike.

Në një konceptim të tillë, pra, duke u parë natyra e theksit si shkak i dukurisë së apofonisë, dallohen si shkallë të ndryshme të apofonisë kuantitative një *shkallë e reduktuar* dhe një *shkallë e zhdukjes*.

Veçse, në qëndrimet e mëvonshme të dijetarëve indoevropianistë çështja e natyrës së *shkallës zero* dhe *shkallës së reduktuar* apo të *dobësuar*, hap terren për t'u diskutuar, konkretisht, nëse kemi të bëjmë me dy shkallë të ndryshme të apofonisë sasiore, apo kemi të bëjmë me të njëjtën shkallë apofonike në dy faza të ndryshme kronologjike që emërtohet konvencionalisht në mënyra të ndryshme. Ky konceptim i dytë do të duhet të nënkuptonte shfaqjen e *schwa secundum* /ə/ e cila “përcaktohet si një element zanor që shfaqet herë pas here në shkallën zero të ablautit kuantitativ indoevropian si vijim i zanores ablautive në pozicion ndërmjet dy bashkëtingëlloresh (kryesisht mbylltore)”<sup>3</sup>.

Gjithsesi, nga interpretimet etimologjike të Çabejt do të veçonim si me interes të veçantë gjykimet mbi disa raste kur besohet se në fjalët e sotme shqipe shfaqen gjurmë të shkallës zero të apofonisë indoevropiane dhe do të kërkoheshin detyrimisht rrethanat fonetike që mundësuan shfaqjen e këtyre gjurmëve.

Kështu, në disa rindërtime të Joklit e të mbështetura nga Çabej

---

2 E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1976, f. 242-243; *Studime gjuhësore* 3, Rilindja, Prishtinë, 1976, f. 124; *Studime për fonetikën historike të gjuhës shqipe*, Tiranë, 1988, f. 37-38 dhe *Hyrje në indoevropianistikë* (Leksionet e Prishtinës), Botimet Çabej, Tiranë, 2008, f. 134-139.

3 Mendim i Guntert, referuar nga B. Demiraj, *Numërori katër në gjuhën shqipe në vështrim historik*, SF 3, 1989, f. 93; D. Luka, *Studime për historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2010, f. 168.

baza indoevropiane e fjalës është menduar me shkallë vokalike zero dhe me dridhësen /r/ me vlerë rrokjeformuese. Për raste të tilla është parë me shumë interes ideja e Joklit që nga /r/ silabike të jetë fituar -ur-.

Në mbështetje të kësaj ideje do të shihej këtu fakti që një zhvillim i tillë është përcaktuar nga disa rrethana të caktuara fonetike.

Si një rrethanë e parë duhet menduar ndikimi i një dybuzoreje paraprirëse, /p/, /b/ apo /m/. Pas humbjes së aftësisë rrokjeformuese të bashkëtingëllores silabike dhe, për pasojë, me shfaqjen e *schwa secundum* /ə/, nën ndikimin e dybuzores paraprirëse, nga një /r/ të paraprirë nga *schwa secundum* /ə/ do të prisnim në shqipe -ur-.

Nga Çabej kemi një trajtim të gjatë etimologjik të fjalës *burg*, nga ku do të veçonim mendimin se “në çdo rasë *burg* nga një bazë \*b<sup>h</sup>orgh- ose \*b<sup>h</sup>rg- me shkallë apofonie të reduktuar, pra me një r silabike që dha ur në gjuhën shqipe.<sup>4</sup>

Në qoftë se do të shihej si fjalë vendi dhe në shpjegimin e fjalës do të shkonim me Çabejn, atëherë do të duhet të mendonim se bëhet fjalë për një rrënjë që buron nga një bazë indoevropiane \*b<sup>h</sup>ergh-, e cila shfaqet me shkallë të ndryshme apofonike edhe në gjuhët gjermanike.<sup>5</sup> Për lemën indoevropiane \*b<sup>h</sup>ergh-, që mendohet se duhet të ketë pasur kuptimin në gjermanisht “beachten, bewahren” (vëzhgoj, ruaj)<sup>6</sup>, mund të supozohet një trajtë me shkallë vokalike zero dhe me një /r/ silabike \*b<sup>h</sup>rg-, më pas, me humbjen e aftësisë rrokjeformuese të /r/-së do të mendonim shfaqjen e *schwa secundum* /ə/ e do të kishim \*b<sup>h</sup>ərg-, nga ku *burg*.

Një rindërtim të tillë mund të bëhet edhe për fjalën *buzë*. Në trajtimin që i bën Çabej fjalës *buzë*, ndër gjykimet e mëhershme që referon, veçohet ideja e Joklit, i cili, duke u nisur nga kuptimi “gojë” i çamërishtes, *buzë*-n e përqs me lituanishten *burnà* “gojë”, me armenishten *beran* “gojë”, me latinishten *foramen* “brimë” etj. dhe e sheh si refleks të një baze \*b<sup>h</sup>rzë, me /r/ silabike të indoevropianishtes që vjen në shqip -ur-.<sup>7</sup>

E njëjta dukuri mund të pranohet edhe për rastet ngjashme *burë*,

4 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II*, Tiranë, 1976, 380.

5 O. Szemerényi, *Introduzione alla linguistica indoeuropea*, Unicopli, Milano, 1990, f. 113.

6 H. Rix, *Lexikon der indogermanischen verben*, Wiesbaden, 2001, f. 79.

7 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II*, Tiranë, 1976, f. 400-402.

*burmë, purth, mund* etj

Si një rrethanë e dytë duhet menduar prania e bashkëtingëlloreve labiovelare /k<sup>w</sup>/ apo /g<sup>w</sup>/ që paraprijnë një bashkëtingëllore silabike. Në të njëjtën mënyrë /r/ e indoevropianishtes vjen në shqipe -ur-, pas humbjes së aftësisë rrokjeformuese të bashkëtingëllores dridhëse, me shfaqjen dhe me zhvillimin e *schwa secundum* /ə/ në /u/, nën ndikimin e përbërësit buzor të labiovelareve.

Për fjalën shqipe *kurth* Çabej shkruan se Bariç-i e afron me gjermanishten e lartë të vjetër *hurt* “thurimë”, prusishten e vjetër *korto* “gardhiqe”, greqishten *κυρτος* “thurimë xunkthash”, prusishten e vjetër *korto* “gardhiqe” e brenda shqipes me *qerthull*, që Jokli më parë e pat venduar po në këtë grup fjalësh... Si bazë e *kurth*-it mund të caktohet një *kort-*, me atë *r* silabike që dha *ur* në shqipen, si shpeshherë.<sup>8</sup>

Ky shpjegim etimologjik do të nënkuptonte që *kurth* të vijë nga lema \*k<sup>w</sup>ert- me zanore rrënjore në shkallë apofonike zero, pra nga një \*k<sup>w</sup>ɪrt-, me ndërmjetësinë e një \*k<sup>w</sup>ərt- dhe e njëjta dukuri mund të pranohet edhe për rastet ngjashme, si *kur* nga \*k<sup>w</sup>er, *gur* nga \*g<sup>w</sup>er-etj.

Si një shembull interesant do të sillnim këtu edhe rrënjën *kul*, që mund ta veçojmë në disa fjalë shqipe, si *kulem*, *përkul*, *n-gull/sh-kul*, nga një \*k<sup>w</sup>el-. Folja *përkul*, sqaron Çabej, sikundër ka treguar Jokli, lidhet brenda gjuhës edhe me *kulpër* e me *sjell* e *qell* dhe, si refleksi i një baze \*k<sup>w</sup>el-n-, qëndron në lidhje të një apofonie kualitative me *sjell*, nga një \*k<sup>w</sup>el-. Ndërkohë Çabej shprehet se mund të ketë një afri midis shqipes *përkul* dhe greqishtes *κυλλος* “i përkulur, i shtrembëruar, ulok”, të cilën e shpjegojnë po nga baza indoevropiane \*k<sup>w</sup>el-<sup>9</sup>, por nuk mendon një shkallë zero dhe e mendon *u*-në si shkallën e reduktuar të trajtave të lashta të shkallës /o/.

Me shumë gjasa për *kul* duhet pranohet zhvillimi me të njëjtat norma nga shkalla zero \*k<sup>w</sup>ɪ- e lemës indoevropiane \*k<sup>w</sup>el-, me fazën ndërmjetëse \*k<sup>w</sup>əl-.

Si një rrethanë e tretë do të mendohej sjellja e dyfishtë e gjysmëzanosës /u/

Duke iu referuar një kumtimi të Joklit (në leksione), Çabej thotë

8 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*, Tiranë, 2014, f. 180.

9 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes VI*, Tiranë, 2002, f. 195-196.

se, përemri i vetës së parë njëjës *u, unë* paraqet shkallën e reduktuar (në pozicion të patheks) të përemrit vetvetor *ve-*, në *vetë*, nga baza *\*sue*, shkallë identike me atë të përemrit vetvetor *u*.

Në këtë mënyrë mund të mendohet se në trajtën *-vjell* (zhdër-*vjell-ët*) duhet të kemi gjurmë të shkallës normale *\*uel-*, ndërsa *ul* përbën një trajtë të zhvilluar nga shkalla zero *\*ul-*. Çabej tregon se Jokli të i *zhdërvjellët*, por edhe të *zhdrivilloj* e *zhvilloj*, *-vjell* e sheh si fjalë vendi dhe e bie të ardhur prej bazës indoevropiane *\*vel* “rrotulloj, sjell, përdredh, rrokullej”.<sup>10</sup>

Në këto raste mund të zbulohet një normë e tillë që kur gjysmëzanorja */u/* takohet me një zanore, vjen si bashkëtingëllore */v/*, ndërsa, kur takohet me bashkëtingëllore, vjen si zanore */u/*.

Kjo dukuri mund të pranohet edhe për rastet *ujë* e *vesë* nga *\*ued-*, *udhë* e *vjedh* nga lema *\*ueġh-*, *urë* e *vjer* nga *\*uer-*, *urrë* e *ver* nga *\*uern-* etj.

Në qoftë se nuk provohet ndonjë nga rrethanat e mësipërme, si, për shembull, kur paraprihet nga një okluzive, megjithëse e dëshmuar me pak raste, mund të mendohet se zanorja e reduktuar *schwa secundum*, */ə/*, e shfaqur në rrënjë të fjalës si zanore rrokjeformuese, zhvillohet në gjuhën shqipe në */a/*. Po prej Joklit, Çabej përmend faktin se *karpë* brenda shqipes lidhet, në radhë të parë, me *krep*.<sup>11</sup>

Këtë model Çabej e sheh edhe te *darkë* ~ *drekë* e *dardhë* ~ *dredh*. Do shtuar se e njëjta dukuri mund të shihet edhe te *dhëndër*.

Si përfundim do të shprehim mendimin se edhe nga qëmtimet etimologjike në fjalë të veçanta të Joklit e Çabejt mund të fitohen ide për një përfytyrim më të qartë të gjurmëve që gjejmë në gjuhën shqipe prej kësaj dukurie indoevropiane mjaft interesante, siç është apofonia.

---

10 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes VII*, Tiranë, 2006, f. 305.

11 E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes V*, Tiranë, 2014, f. 139-140.

Genc Lafe

**“HYRJE NË STUDIMIN KRAHASUES TË  
GJUHËVE INDOEVROPIANE” - NJË VEPËR  
E RËNDËSISHME DHE PAK E VLERËSUAR E  
ÇABEJT**

Gjuhësia indeuropiane që nga lindja e saj ka qenë për një kohë të gjatë kryesisht një disiplinë shkencore gjermanishtfolëse, e cila ende sot vijon t'i qëndrojë disi trysnisë gjuhësore të anglishtes. Çabej, i formuar në shkollën gjermanishtfolëse të gjuhësisë së krahasuar, e cila njohu një zhvillim të vrullshëm pikërisht në vitet e formimit të tij, u udhëhoq në tërë veprimtarinë e tij shkencore nga parimet dhe metodat e saj. Fryt i këtij formimi është edhe njëra nga veprat më të rëndësishme dhe më pak të njohura e të vlerësuara të tij, “Hyrje në studimin krahasues të gjuhëve indoevropiane”.

Kjo vepër, e botuar për herë të parë në Prishtinë më 1986, në vëllimin e 7-të të opusit të dijetarit, përmbledh një cikël ligjëratash të mbajtura në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës gjatë vitit akademik 1971-1972. Por ajo i kapërcen së tepërmi kufijtë e ngushtë të një kursi universitar. Ky cikël leksionesh u hartua në një periudhë kohore të mungesës së lirisë (*Unfreiheit*) akademike dhe jo vetëm dhe kufizimesh të shumëllojshme, kur Çabej nuk kishte qasjen e mjaftueshme në literaturën bashkëkohore, ndërsa kontaktet njerëzore dhe profesionale me kolegët

e tij në botën gjermanishtfolëse e më gjerë ishin mjaft të kufizuara. Rrjedhimisht ai nuk kishte mundësi të ndiqte zhvillimet më të fundit të kërkimeve në këtë fushë, por gjithsesi nxori nga pena e vet një vepër befasuese për nga pasuria dhe gjerësia e trajtimit të subjektit. Ajo vijon të mbetet e vlefshme edhe sot e gjithë ditën duke mbetur e vetmja e llojit të vet në gjuhësinë shqiptare, sepse me gjithë zhvillimin dhe përsosjen e hulumtimeve në fushën e gjuhësisë indoeuropiane gjatë pesëdhjetë vjetëve të fundit, ruan vlera të rëndësishme jo vetëm në rrafshin historik, por edhe në atë bashkëkohor për sa i përket evolucionit të gjuhës shqipe dhe ndriçimit të lidhjeve të saj me familjen gjuhësore indoeuropiane.

Vepra paraqet një strukturë të plotë. Ajo hapet në kreun e parë me një histori të shkurtër të gjuhësisë indoeuropiane. Këtu pasqyrohet historia e zhvillimit të kësaj disipline që nga zanafilla e deri në fillimin e viteve '70 të shekullit të kaluar. Ky kapitull është me interes për lexuesin shqiptar, pasi një përmbledhje e tillë e qartë dhe e thukët nuk gjendet në botime të tjera në gjuhën shqipe. Gjuha e rrjedhshme dhe qartësia e paraqitjes së argumenteve e bëjnë leximin të këndshëm dhe të frytshëm. Vlen të theksohet po ashtu se aspekti historik i zhvillimit të kësaj disipline tashmë thajse nuk trajtohet më në manualët e gjuhësisë indoeuropiane, përveçse shkarazi dhe vetëm në lidhje me argumente të veçanta. Kjo veçanti ia shton vlerën kësaj vepre.

Në kreun e dytë jepet një pasqyrë e të gjitha gjuhëve indoeuropiane të njohura deri atëherë. Ky kapitull ka një vështrim më së shumti historik, duke qenë se gjuhët më të rëndësishme janë ato që janë dëshmuar shumë herët në të shkruar dhe njohja e historisë së tyre është një parakusht i rëndësishëm për të njohur procesin e zhvillimit të strukturave të tyre fonologjike, gramatikore e leksikore e për të zbritur në kohë drejt një gjendjeje gjuhësore të përbashkët, një nga e cila u zhvilluan të folmet që kanë dhënë gjuhët e veçanta indoeuropiane.

Në kreun e tretë shpjegohet hollësisht metoda



krahasuese për rindërtimin e gjuhës së përbashkët. Çabej merr këtu për ilustrim shembuj nga fjalët e shqipes, duke i krahasuar ato me barasvlerësit e rrënjëve përkatëse në gjuhët klasike, sanskritisht, greqishte e vjetër dhe latinisht. Këtu ai shpjegon qartë dhe thjesht tre parimet e metodës krahasuese: duhen marrë parasysh trajtat gramatikore dhe më pak elementet leksikore, elementet që krahasohen nuk duhen marrë të izoluar, por duhen vështruar në tërësinë e tyre dhe trajtat nuk duhet të kundrohen në vetvete, por si variacione të përbashkëta. Çabej bën edhe një histori të zhvillimit të metodës krahasuese, duke arritur në përfundimin se rindërtimi i gjuhës indoeuropiane nuk është qëllim, por mjet. Njësia e gjuhës indeuropiane duhet të merret gjithnjë si relative. Me rëndësi janë shpjegimet e tij për të shpjeguar përhapjen e gjuhëve indeuropiane në territoret në të cilët ato fliten sot. Duke u nisur nga analogjia me përhapjen e latinishtes, e cila, për arsye historike të njohura, u mor nga popuj që më parë flisnin gjuhë të tjera, Çabej e hedh poshtë konceptim e pandashmërisë së popullit dhe të gjuhës, e cila sipas këndvështrimit romantik të shek. XIX mbetkësh e pandryshueshme në kohë. Gjuhët duhen shikuar në zhvillimin e tyre historik.

Në kreun e katërt jepet një pasqyrë e grupimit të gjuhëve indeuropiane. Çabej paraqet këtu drurin gjenealogjik të Schleicher-it duke bërë edhe kritikën e këtij koncepti natyralist. Më pas jepet koncepti i teorisë së valëve të Johannes Schmidt-it dhe ndarja e gjuhëve indoeuropiane në *kentum* dhe *satem*, argument i cili në hulumtimet e sotme nuk e ka më rëndësinë e dikurshme. Në këtë kapitull Çabej shpalos erudicionin e vet në lëmin e dialektologjisë indoeuropiane duke shpjeguar tiparet e ndryshme fonetike dhe morfosintaksore që i dallojnë të folmet e ndryshme indeuropiane nga njëra-tjetra dhe duke përdorur në çdo rast tipare dhe fakte gjuhësore të shqipes të krahasuara me elementet e barasvlershme të gjuhëve të tjera indoeuropiane për të ilustruar shpjegimet e tij.

Kreu i pestë, i cili zë vendin qendror dhe praktikisht

përbën veprën e mirëfilltë, mban titullin “Skicë e gramatikës krahasuese të gjuhëve indeuropiane”. Ai hapet me një vështrim të shkurtër historik mbi katër gramatikat më të para të historisë gjuhësore: gramatika indase, ajo greke, arabe dhe hebraike, me plot informacione të vlefshme për të kuptuar lindjen dhe zhvillimin e traditës së studimeve gjuhësore në qendrat kryesore kulturore të botës së vjetër. Çabej thekson rëndësinë që ka krahasimi dhe vështrimi historik për gramatikat krahasuese, historike dhe përshkruese, sepse pa këtë vështrim mund të bëhet një përshkrim, por nuk mund të arrihet në atë që logjikisht quhet shpjegim. Çabej natyrisht është si të gjithë të tjerët bir i kohës së vet, i formuar në një periudhë kur gjuhësia historike-krahasuese zinte ende kryet e vendit, por ky pohim e ruan rëndësinë edhe sot, për të shpjeguar, siç ilustron ai, rregulla të tilla si shpërngulja e theksit në *dhëndër – dhëndurë*, ose shndërrimet zanore në *vjel – vola* apo ato supletive si në *shoh – pashë*, të cilat gramatika përshkruese nuk arrin t’i shpjegojë.

Më tej në këtë kapitull trajtohet fonetika e indoeuropianishtes, e ndarë në nënkapitujt *Vokalizmi*, ku trajtohen zanoret e shkurtra, ato të gjata, diftongjet, sonante, apofonia dhe laringalet; *Konsonantizmi*, me labialet (buzoret), dentalet (dhëmboret), guturalet, velaret e thjeshta, spirantet, nazalet (hundoret) dhe likuidet dhe *Gjysmëzanoret*. Në këtë nënndarje trajtohet edhe theksi (akcenti).

Për nga mënyra e konceptimit këtu bëhet fjalë mirëfilli për një fonetikë historike të shqipes që ka si pikënisje indoeuropianishten, dhe për sa dimë, është punimi i parë i plotë i këtij lloji për gjuhën shqipe. Zhvillimet fonetike të mirëfillta të shqipes trajtohen këtu në vijimësi organike, duke plotësuar kuadrin e përgjithshëm të fonetikës historike të saj. Teksti natyrisht pasqyron gjendjen e gjuhësisë indoeuropiane të fundit të viteve ’60, duke mbajtur parasysh edhe vështirësitë e autorit për t’u përditësuar në këtë lëmë. Prandaj janë të mirëkuptueshme pohime që sot nuk janë më aktuale në indoeuropianistikë, si pranimi i një tingulli

*schwa* (ə) për një periudhë shumë të lashtë. Sot në vend të *schwa*-së përdoren gjerësisht simbolet e tri laringaleve që pranohet se kanë ekzistuar në paraindeuropianishte. Megjithatë koncepti i *schwa*-së indeuropiane vijon ende të shfaqet edhe më pas, madje edhe në botimin e katërt (1990) të *Einführung in die vergl. Sprachwissenschaft* të indoeuropianistit të njohur Oswald Szemerényi.

Por natyrisht ka edhe përfundime që sot nuk qëndrojnë, p.sh. pohimi i Pedersenit, i tumirur nga Çabej, se sonanti *ŋ* silabik, ose rrokjeformues, në shqipe ka dhënë *e* (khs. *esëll* < \**ŋsillë*). Sot mendohet se refleksi i saj në shqipe është *a*, khs. *afër* < \**ŋfar* ‘jo larg’, *mat* edhe emërvendi dhe hidronimi *Mat* < \**mnt* ‘mal’, etj. Për *esëll* mendohet se *e*-ja nistore është rezultat i metafonisë së shkaktuar nga *i*-ja e rrokjes vijuese.

Një rëndësi të veçantë Çabej i ka kushtuar dukurisë së apofonisë, e kundruar në kuadrin e përgjithshëm të gjuhëve ie. dhe në gjuhën shqipe. Çabej e zgjeron vështrimin edhe jashtë familjes gjuhësore ie. mbi këtë dukuri morf fonetike, duke e përafuar atë me variacionet e zanoreve në gjuhët semite, ose siç emërtohen sot, gjuhët afro-aziatike e duke sjellë shembuj të njohur për lexuesin shqiptar nga fjalë të arabishtes që kanë hyrë në shqipe përmes turqishtes, si *qatip-qitap*. Gjithashtu Çabej sjell në vëmendje edhe harmoninë zanore të turqishtes dhe të gjuhëve ugrofine. Këto përafrime nuk gjenden në doracakët e sotëm të gjuhësisë indeuropiane.

Për gjuhët indeuropiane Çabej dallon apofoninë kualitative dhe atë kuantitative. I ilustron ato me shembuj nga gr. e vj. dhe latinishtja dhe shpjegon apofoninë e-o në gjuhën shqipe përmes *bie* (shkalla e) dhe *bart, bar, barrë* (shkalla o). Sipas Çabejt apofonia kualitative ka lidhje me theksin muzikor, ndërsa ajo kuantitative me theksin dinamik. Duke u ndalur tek kjo e fundit ai vë në dukje katër shkallët e saj, normale ose e plotë (Vollstufe), e zgjatimit (Dehnstufe), e reduktimit (Schwundstufe) dhe e zhdukjes (Nullstufe), duke i përkthyer për herë të parë këto terma në

shqipe dhe duke i ilustruar me shembuj nga latinishtja dhe shqipja. Çabej, në pajtim me nivelin e kohës të zhvillimit të disiplinës, nuk ka mundur të shpjegojë lidhjen e ngushtë të apofonisë me laringalet, sidomos për shkallën e zgjatimit të zanoreve (Dehnstufe), edhe pse Saussure-i qysh në 1879 kishte hamendësuar ekzistencën e koeficienteve sonantikë, të cilët duhet të ishin shkak i zgjatjes së zanoreve të rrënjëve ie. Në kohën kur u hartua kjo vepër teoria e laringaleve ende nuk kishte arritur në zhvillimin e sotëm dhe jo pak gjuhëtarë e kundronin me dyshim atë ose nuk e pranonin. P.sh. gjuhëtari i njohur gjerman Kronasser nuk e pranonte fare atë ndërsa, të tjerë shprehnin rezerva. Edhe Szemerényi deri në fund (në botimin e vitit 1990) nuk u ngrit në nivelin e abstraktimit të tri laringaleve, siç pranohen gjerësisht sot. Ai pranonte vetëm një laringale dhe vetëm atje ku kjo dëshmohej në hetitiste. Çabej gjithsesi tregohet mendjehapur në trajtimin e thukët prej një faqeje që u bën laringaleve, duke theksuar se shpjegimi i dukurive që lidhen me praninë e tyre i përket një periudhe paraetnike të gjuhëve indeuropiane e duke mos e lidhur këtë problem me gjuhë të veçanta. Më tej pohon se “sikur të vërtetohej që laringalet kanë ekzistuar dikur, kjo do të revoluciononte mbarë fonetikën historike të gjuhëve ie.”. Në këtë kuadër Çabej sjell në mënyrë të qartë e të mirëfilltë shpjegimin e vetë Saussure-it mbi idenë revolucionare të *koeficientëve sonantikë*, e cila përmbante parashikimin teorik të ekzistencës së laringaleve të zbuluara më pas në hetitisten, shpjegim i cili në tekstet e sotme mbi gjuhësinë ie, jepet shkarazi dhe i larguar nga termat origjinalë të autorit.

Në pjesën që i kushtohet konsonantizmit përfundimet e Çabejt në përgjithësi i kanë qëndruar kohës, me ndonjë përjashtim të vogël (një *s* ndërzanore indoeuropiane nuk mund të ketë dhënë *s* në shqip, siç mendonte Pedersenin dhe miratonte Çabej për fjalën *nuse* nga një formë e rindërtuar *\*snusam*). Me përjashtim të laringaleve, kuadri fonologjik i indeuropianishtes, i skicuar këtu nga Çabej, nuk ka pësuar ndryshime të qenësishme në ditët e sotme. Me një akribi

të admirueshme Çabej e plotëson dijen indoeuropiane me të dhëna mjaft interesante nga gjuha shqipe, duke pohuar njëkohësisht se ndërrimet fonetike nuk duhen shikuar të veçuara në vetvete, të izoluara, por të lidhura me sistemin morfologjik, si një tërësi.

Në pjesën kushtuar morfologjisë jepet së pari përkufizimi i formave tematike dhe atematike të temave emërore dhe foljore. Çabej këtu sjell një përkufizim të thjeshtuar, sipas të cilit format tematike janë ato që mbarojnë me zanore dhe format atematike me bashkëtingëllore. Pas afirmimit të teorisë së laringaleve ky përkufizim është përditësuar, duke vendosur si kriter të tipit tematik eptimin me apofoni dhe mungesën e saj tek format atematike (khs. Benjamin W. Fortson IV, *Indo-European Language and Culture* 2010, 126: *Thematic nouns, like thematic verbs, are characterized by the presence of an ablauting system \*e/o to which the case-endings are added.*). Çabej e përmend këtë kriter tek temat foljore, por jo tek ato emërore.

Në shpjegimin e kategorive të ndryshme emërore Çabej e zgjeron vështrimin edhe mbi gjuhët joindeuropiane. Në shpjegimin e kategorive gramatikore emërore dukuritë e shqipes ndërthuren në mënyrë të natyrshme në kuadrin e përgjithshëm të gjuhëve ndoeuropiane, si gjinorja më *-e*, e cila vjen nga një *ō*, ose krahasorja indoeuropiane më *-tero* që ruhet në emërvendet *Curraj i Epër/i Poshtë*.

Në trajtimin e përemrit vetor *unë* Çabej tregon se sa e rëndësishme është njohja me themel e kuadrin të përgjithshëm dialektor të një gjuhe të veçantë edhe në hulumtimet indoeuropiane. Përemri vetor *unë*, forma më e vjetër *u*, ka qenë gjithmonë një problem i vështirë për etimologët dhe indeuropianistët pa formim albanologjik, duke qenë se nuk arrihen paraforma bindëse të tij që të rrjedhin qartësisht prej rrënjës së rindërtuar *\*egōh<sub>2</sub>*, *\*egh<sub>2</sub>-om* ‘unë’ të indoeuropianishtes. Çabej argumenton se këtu kemi të bëjmë me përemrin e dikurshëm vetvetor *u*, që sot përdoret për të formuar pësore-vetvetoren (p.sh. *u lava*), me kuptimin ‘vetë’ dhe sjell shembuj nga dialekte të ndryshme

ku *vetë* ka kuptimin ‘unë’ (*e di vetë, vetë jam i madh*). Kjo tezë sot pranohet nga disa studiues, por has në kundërshtime nga të tjerë.

Në pjesën e foljes Çabej po ashtu synon të vërë në dukje lidhjet e sistemit foljor të shqipes me atë indoeuropian. Çabej thekson në veçanti izoglosën shqiptaro-greke-sanskrite të formimit të mesores (pësore-vetvetores).

Ndër argumentet që trajtohen këtu me interes është çështja e paskajores. Çabej vë në dukje se paskajorja është një risi e gjuhëve të veçanta indoeuropiane që shfaqet në periudhat historike të tyre, duke qenë se nuk mund të rindërtohet një formë e vetme dhe e përgjithshme e saj. Paskajoret në gjenezën e tyre janë emra abstraktë, emra foljorë që më pas hyjnë në kategorinë e foljes. Çabej argumenton se në gjuhë si sanskritishtja, greqishtja e vjetër dha latinishtja paskajoret janë dhanore të lashta, po ashtu në greqishten e vjetër tipi më i vjetër i paskajores është një lokativ pa mbaresë. Duke analizuar paralelisht zhvillimet në gjuhët e ndryshme indoeuropiane dhe në shqipe Çabej arrin në përfundimin se këtu vihet re një zhvillim paralel i pjesores dhe paskajores dhe se paskajorja e gegërishtes është një pjesore me *me*, por një pjesore e një periudhe më të vjetër, pjesore e substantivuar. Ai paraqet një hipotezë interesante të zhvillimit të saj, nga gjinorja *me të shkruemit e letrës* në kallëzore *me të shkruemit letrën* e së këtejmi *me shkruie letrën*. Një zhvillim analog vihet re sipas tij edhe në paskajoren e indishtes së vjetër, ndërsa një argument me peshë është paralelizmi në evolucionin e supinit të rumanishtes *ce hai de făcut?* me paskajoren e geg. *çka me ba?* Ndërsa teza se paskajorja ka ekzistuar dikur në mbarë shqipen është sipas Çabejt shumë problematike.

Çabej ndalet gjithashtu në formantet foljore, tek pjesët e pandryshueshme, kompozitat dhe sintaksa. Pra në mënyrë të ngjashme me kuadrin fonologjik edhe këtu kemi të bëjmë me një skicë të gramatikës historike të shqipes nga këndvështrimi i indoeuropianishtes. Veprën e mbyllin dy kapituj të shkurtër kushtuar leksikut dhe zhvillimit të

mëtejme të gjuhëve indeuropiane.

Kjo është e para dhe e vetmja vepër e plotë mbi gjuhësinë indoeuropiane në gjuhën shqipe. Fatkeqësisht ajo mbeti e pabotuar deri më 1986, kur e pa së pari dritën e botimit në Prishtinë, por për lexuesin e Republikës së Shqipërisë mbeti përgjithësisht e panjohur, si për shkak të pamundësisë së komunikimit normal ndërmjet dy pjesëve të kombit, ashtu edhe për shkak të shpërfilljes ndaj kësaj dege interesante të gjuhësisë, së cilës shqipja i kishte dhënë jo pak. Ajo është shkruar në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme edhe për lexuesit që nuk janë të rysur në çështjet e gjuhësisë së krahasuar dhe asaj indoeuropiane. Stili është i rrjedhshëm dhe vepra lexohet me ëndje. Lexuesi nuk do të gjejë këtu pamjen e sotme të disiplinës indoeuropiane, rrënjët me simbole algjebrike, që bëjnë të stepen shumë lexues me interesa për këtë temë, por që nuk kanë formimin e plotë akademik dhe as kohën e nevojshme për t'u thelluar e në të fshehtat e kësaj discipline. Nga ky këndvështrim mund të themi se, përveçse një cikël leksionesh universitare, kjo është një vepër popullarizuese, mjaft e nevojshme edhe për sot. Natyrisht si çdo vepër edhe kjo mban vulën e kohës. Ajo sigurisht pasqyron gjendjen e gjuhësisë së krahasuar të periudhës kur është shkruar dhe ka vlera kryesisht historike, por ruan edhe vlera bashkëkohore. Prandaj mendojmë se do të ishte i nevojshëm një ribotim i saj i plotësuar me shpjegime dhe komente për të përditësuar çështjet tashmë të vjetruara e për të sqaruar ato që kanë nevojë të rishqyrtohen. Vepra vërtet është ribotuar në Tiranë për herë të parë më 2008, por me shumë vonesë, kur sipas profecisë së Çabejt gjuhësia indoeuropiane tashmë paraqitej e *revolucionuar*. Ky botim fatkeqësisht nuk shoqërohet me aparatit shpjegues dhe përditësues të domosdoshëm për të rrokur thelbin e kësaj vepre të vetme të llojit të vet në gjuhën shqipe dhe për të kuptuar rëndësinë e saj; përkundrazi, paraprihet nga një parathënie e mjegullt në formë pamfleti, që e trajton atë nga këndvështrimi i zhvillimeve gjuhësore të shek. XX, por në thelb nuk ka fare lidhje me gjuhësinë indoeuropiane dhe atë

krahasuese.

Veçantia e shqipes si gjuhë indoeuropiane qëndron në faktin se ajo është një degë e veçantë brenda kësaj familjeje të madhe gjuhësore, e vetmja trashëgimtare e gjendjes gjuhësore të Lashtësisë paraklasike të Ballkanit. Si e tillë ajo qëndron denjësisht krahas degëve të tjera të gjuhëve indoeuropiane dhe ka gjithmonë ç't'i ofrojë disiplinës përkatëse. Rrjedhimisht do të ishte në nderin e gjuhësisë shqiptare që edhe në trojet arbërore të ngrihej një bërthamë ose një qendër studimesh indoeuropiane, e cila të merrej ndër të tjera edhe me sistemimin dhe studimin e trashëgimisë shumë të vyer e të pazëvendësueshme të studimeve të Çabejt në këtë lëmë të dijes. Këto *Leksione të Prishtinës* do të ishin një gur i denjë themeli për të.



Elda Boriçi

## HUAZIMET DHE ELEMENTET LATINE TË GJUHËS SHQIPE NË STUDIMET E PROF. EQREM ÇABEJT

Huazimet latine dhe elementi latin në gjuhën shqipe, si pjesë përbërëse e historisë së saj të jashtme dhe të brendshme, kanë qenë objekt studimi për gjuhëtarin, historianin dhe etimologun tonë të shquar të gjuhës shqipe, prof. E. Çabejin.

Duke qenë një njohës i thellë i leksikut të shqipes, përmes një analize objektive dhe kritike, Çabej arrin të nxjerrë në pah karakteristikat e huazimeve latine të shqipes dhe elementet latine.

Studimi i tyre ngërthen një sërë problemesh lidhur me inventarin e tyre, shtrirjen gjeografike, kronologjizimin etj., të cilat janë trajtuar nga prof. Çabej në punime kushtuar këtij objekti studimor, sidomos më gjerësisht në veprën e tij madhore “*Studime etimologjike në fushë të shqipes*”.

Detyra e parë që ka përmbushur albanologu Çabej është konstatimi zonës gjuhësore të ndikimit kulturor latin dhe përcaktimi i saktë i pozitës së këtij ndikimi si kundrejt rumanishtes ashtu edhe kundrejt gjuhëve romane perëndimore.

Një tjetër detyrë e tij është ajo e periodizimit të elementit leksikor thjesht latin, veçimi i tij nga elementi i vendit ashtu edhe nga elementi roman<sup>1</sup>.

Nga pikëpamja historike ndikimi gjuhësor i latinishtes ka zgjatur shtatëqind vjet, filloi që në kohën para pushtimit të Ilirisë Jugore e të

---

<sup>1</sup> Çabej, Eqrem. Studime etimologjike në fushë të shqipes, f. 6

Epirit nga ana e romakëve, i cili u krye në shekullin II para erës së re, dhe nuk reshti me ardhjen e sllavëve<sup>2</sup>.

Nga pikëpamja e hapësirës ky ndikim është ushtruar në një trevë në veri ose në të dyja anët e kufirit gjuhësor midis greqishtes dhe latinishtes në Gadishullin Ballkanik.

Nga pikëpamja gjeografike pjesa më e madhe e huazimeve latine shtrihen mbi mbarë trevën gjuhësore të shqipes, ndërsa huazimet italiane kanë një përhapje me kufi dialektor<sup>3</sup>.

Në këndvështrimin kulturor vihet re se ndikimi latin shtrihet në shumicën e sferave të fushës leksikore të shqipes, jo vetëm në atë të botës konkrete e të kulturës materiale, por sidomos edhe në ato të jetës mendore e sociale<sup>4</sup>.

Pas shqyrtimit objektiv të materialit, prof. Çabej konstaton se shqipja, në trajtimin e elementit të huazuar prej latinishtes, si gjeografikisht, ashtu edhe gjuhësisht zë një vend të ndërmjetëm midis latinitetit ballkanik – të brendshëm e kontinental, që përfaqësohet me rumanishten dhe latinitetit bregdetar-adriatik, që përfaqësohet me dalmatishten<sup>5</sup>.

Elementi latin i gjuhës shqipe përbën një nga objektet më me rëndësi për studimin e historisë së shqipes në shkallë të ndryshme të zhvillimit të saj. Së pari konstatohet se ndikimi latin mbi gjuhën shqipe ka nisur disa shekuj më vonë se ndikimi i greqishtes së vjetër. Si rrjedhojë ky element ndihmon në rindërtimin e strukturës antike të shqipes, duke u vendosur kështu midis prehistorisë së shqipes dhe fazës së saj mesjetare<sup>6</sup>.

Çabeji veçon elementin latin nga elementi vetjak i shqipes në njërën anë dhe nga huazimet e tjera jolatine nga ana tjetër, dallon elementin latin nga elementi grek i vjetër në leksikun e shqipes apo veçimin e elementit latin prej elementit roman, respektivisht nga italishtja dhe rumanishtja e dialektet e saj. Ai në këtë tematikë trajton edhe çështjen e caktimit të kufijve që ndajnë elementin latin të gjuhës shqipe nga trashëgimia e saj<sup>7</sup>.

---

2 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 256

3 Çabej, Eqrem. Po aty, f. 255

4 Çabej, Eqrem. Elementet latine, f. 290

5 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 256

6 Çabej, Eqrem. Elementet latine, f. 295

7 Çabej, Eqrem. Po aty, f. 296-298

Elementi latin për shkak të vjetërsisë që ka, vihet re se ka pësuar në gjuhën shqipe një ndryshim thuajse po aq të madh sa edhe leksiku vendës i trashëguar dhe huazimet nga greqishtja e vjetër, me të cilat përputhet shpeshherë në pikëpamjen e vjetërsisë. Ndërsa huazimet italiane nuk trajtohen shumë ndryshe nga ato të sllavishtes dhe të greqishtes së re, duke marrë kështu pjesë së bashku në zhvillimin e tingujve të shqipes në periudhën e mesjetës<sup>8</sup>.

Ndër karakteristikat e huazimeve latine në **fushën e vokalizmit**, albanologu konstaton rënien e zanoreve të patheksuara në fillim të fjalës dhe rënien e zanoreve të shkurtra të patheksuara në fund të fjalës, reduktimin dhe shpesh edhe rënien e zanoreve të patheksuara në trup të fjalës, metafoninë e shpesh të *a:e*, ndërrimin e *u-së* së gjatë në *y*, difongimin e *e-së* së shkurtër të çelët në *je* dhe të grupit *on* në *ua ue*, hundorëzimin e zanoreve orale (gojore) + *n*; në konsonatizëm, evidenton rënien e bashkëtingëlloreve të zëshme në pozicion ndërzanor dhe lidhur me të edhe kontraksionin dhe zgjatimin e zanoreve fqinjë, ndryshimin dhe reduktimin në shkallë të gjerë të grupeve të bashkëtingëlloreve, asimilimin e *dj-së*, ndërrimin e *s-së* në *sh* dhe rregullimin e tingujve *l* ashtu siç e përcaktoi Pedersen.

Në lidhje me grupin **ct** të latinishtes konstatohet se në shqipe guturali **k** mori tri rrugë zhvillimi:

- 1) U ndërrua në spirantin labial **f**
- 2) Në **j**; 3) **kt** u thjeshtua në **t**: pra **ct** dha **ft**, **jt** dhe **t** si në shembujt vijues: *lucta* (lat.): *luftë* (shq.); *directus* (lat.): *drejt* (shq.); *fructus* (lat.): *fryt* (shq.); *facture* (lat.): *fytyrë* (shq.).

Paralel me zhvillimin e **ct-së** është ai i **ks** (x) në shqipe: në shqipe ka dhënë **fsh** e **sh**: *coxa* (lat.) : *kofshë* (shq.); *fraxinus* (lat.): *frashën frashër* (shq.).

Në pikëpamjen fonetike vihet re se në elementin latin të shqipes në vokalizëm ruhet **u-ja** e shkurtër dhe e hapët latine: *furca* (lat.): *furkë* (shq.); *mustum* (lat.); *musht* (shq.)<sup>9</sup>.

Në lidhje me theksin evidentohet se shqipja vendin e theksit latin përbrenda fjalës e ka ruajtur në mënyrë shumë të rregullt: *pollicaris*: *pulqër* “gishti i madh i dorës”, *cannata*: *kënatë* “enë dheu për ujë, shtamë” etj.

8 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 267

9 Çabej, Eqrem. Po aty, f. 267-268, shih edhe Huzimet latine, f. 54

Duhet nënvizuar se theksi shpeshherë përbën një gur prove për dallimin e huazimeve latine nga ato greket<sup>10</sup>.

Duke u mbështetur në kriteret e lartpërmendura me të drejtë janë shpjeguar prej latinishtes fjalët: *bëkój*, *brekë*, *femën*, *-ër*, *frë*, *gjeshtër* “*gjineshtër*”, *këmishë*, *këshill*, *korb*, *mushkonjë*, *murtajë*, *rrëshinë-rë*, *shenj*, *shenjt*, *balshëm balçëm*, *çimkë*, *grek*, *këndellë* “*llambë*, *shandan*”, *këndellem knellem* “*kuqem*, *ndizem*, *marr*, *marr zjarr*, *digjem*; *përtërihem*, *marr fuqi*, *çelitem*, “*këprësh koprësh* “*kapistër*”, *kurtinë* “*perde*”, *lundër* “*Mustela lutra*, *vidër*” etj<sup>11</sup>.

Emrat e përveçëm: *Pål nga lat. Paulus*; *Ndre-Andreas*; *Ndue-Antonius*, *Gjon-Johannes*; *Jozéf Zef-Josephus*, *Mëri-Maria*.

Ndikimi latin ka depërtuar edhe në **sistemin gramatikor**, sidomos në zgjedhimin e foljes, është koha e kryer me foljen ndihmëse kam i tipit *kam shkuar*, sipas modelit të latinishtes *habeo scriptum*, por këtu kemi një kalk gramatikor.

Trajta e kohës së shkuar me foljen *kam*: *kam shkuar*, rum. *am vazut* “*kam parë*”, gr. e re *εχω δεμέ* “*kam lidhur*”, buron prej romanitetit ballkanik.

Në formim të kësaj trajte latinishtja u bë model jo vetëm për gjuhët e një treve, siç është Gadishulli Ballkanik, i cili iu nënshtrua shumë gjatë dhe intensivisht ndikimit romak. Për shqipen ky ndikim duhet pranuar së paku për kohën e kryer të foljes kalimtare e pastaj edhe të foljeve jokalimtare<sup>12</sup>.

Në lidhje me **trajtimin e formave gramatikore** Çabej konstaton se gjinia e emrit të latinishtes është ruajtur në shqipe në mënyrë konsekuente.

Femëroret e të ashtuquajturit lakim i tretë i tipit *sortem*, *civitetem*, përdoren në shqipe si të tilla me hiferezë të *e-së* fundore, dhe vetëm në fazën më të re të gjuhës kanë kaluar në mashkullore (në dialekte edhe në femëroret më *-e* osë më *-ë*): *short*, *shortja*, *qytët qytetja*, sot *short-i m.*, *qytët-i m.*, krahas me këto edhe *shorte*, e *qytetë-a*.

Vjetërsia e elementit latin në shqipe evidentohet edhe në një tipar të sistemit morfologjik: Asnjanësi latin, i cili në periudhën e latinishtes vulgare në të shumtën e rasteve ishte shkrië me

10 Çabej, Eqrem. Po aty, f. 278

11 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine, f. 268

12 Çabej, Eqrem. Po aty, f. 278-279

mashkulloren e pjesërisht me femëroren dhe që në gjuhët romane nuk ekziston më askund si një gjini më vete, në literaturën e vjetër shqiptare del e ruajtur mirëfilli krahas me asnjëset e fondit të trashëguar: *damnum: damtë, fallium* (në vend të *fallum*): *faj, frenum: frētë, iudicium: gjyq, pignus: penktë, saeculum: shekull* të cilat në përmendoret e vjetra të shkrimit dalin herë si asnjëset, herë si mashkullore; ndryshe nga *argentum: argjánd, aurum: ār, evangelium: ungjill, peccatum: kat mpkat mēkát*, të cilat aty paraqiten si mashkullore dhe nga *caelum: qiell, infernum: ferrë ferë*, që shfaqen aty vetëm si femërore<sup>13</sup>.

Ndikimi latin në gjuhën shqipe është shtrirë edhe në **fjalëformimin e shqipes**. Bëhet fjalë për disa prapashtesa që shqipja më së shumti i ka të përbashkëta me rumanishten dhe që i ka marrë prej latinishtes ballkanike, të cilat janë bërë mjaft produktive në gjuhë si: *-im* lat. *-imen*; lat. *-etum*; shq. *-et.*, ku shtrirja e kësaj prapashtese latine në shqipe ka lidhje me ekzistencën e një prapashtese vendëse me trajtë të ngjashme me të; apo ndeshja e prapashtesës latine *-tor* me një *-tor –tuar* të lashtë të shqipes me burim indoeuropian – *tēr*=gr. τήρ si në βατήρ “prak, bazë”<sup>14</sup>.

Ndër prapashtesat më produktive paraqitet *-et* (prej lat. *-etum*), prapashtesë me funksion vendi, me përhapje më fort në anën perëndimore të Shqipërisë veriperëndimore e të mesme: *Kallmēt, Shkozēt, shkonēt shkurrēt* “vend me shkurre e me driza” etj.). Karakteristikë për Ilirinë Jugore janë edhe dy prapashtesa latine: *-aster*, shq. *-ashtë* në emra bimësh si *mēgashtēr* “sherebelë” e *noshtēr* “filiz, njomëz”; *-aticum*, në *pasturaticum* (*pasture* “kullotë”); *pashtrák* “gjobë për shpërdorimin e kullotës së huaj”; *agraticum* “tatim për përdorim të një are për tokë buke” (*ager* “arë”). Kjo prapashtesë i përket latinishtes së vonë të viseve ballkanike<sup>15</sup>.

Janë përftuar forma të reja fjalësh, ku huazimi vlen vetëm për burimin më të parë, për temën e tyre. Në këtë rast vlen të përmendet fjala *përgjoj* e cila ka dalë nga *dëgjoj*, kjo vjen nga lat. *intelligere*, me zëvendësim të elementit *dë-* me *për-*, duke u marrë ajo e para

13 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 279-280 shih edhe Elementet latine fq. 294

14 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 280

15 Çabej, Eqrem. Elementet latine, f. 298

gabimisht sikur të ishte një parashtesë. Po ashtu edhe fjala *dhuratë* e *detyrë* nuk rrjedhin nga bazat latine të rindërtuara \**donatum* e \**debitura*, por e para nga *dhuroj* kjo prek latinishtes *donare* dhe e dyta nga *detores* prej latinishtes *debitorem*, me anë të prapashtesave –*atë* dhe –*tyrë* (lat. – *tura*)<sup>16</sup>.

Sikundër dihet ndikimi i latinishtes në leksik është më i fortë se në të gjitha fushat e tjera.

Përmendim barazime të tilla si: *hasta: heshtë; implëre: mbloj; flaccus: flak; flare: fle; initiare: nis; intelligere: gjegjem; inter: ndër; in toto: dot* (pjesëz që përdoret për të përforcuar mohim); *intrudere: ndrydh; intus: ndë; levis: i lehtë; litium: lule; lin: lyej; ludo: luaj; lugarius lucarius: luar; capitare: kapërcëj; chylus: qull; dritare: gërthás; curare: qyrónj “këqyr”; alterare: ndërój; arista: rreshtë “asht” etj.*<sup>17</sup>.

Ky ndikim kapërthen shumicën e **sferave të fushës leksikore** të shqipes, jo vetëm atë të botës konkrete e të kulturës materiale, por sidomos edhe ato të jetës mendore e sociale. Ndikimi i latinishtes në leksik ndahet në këto sfera të jetës: pjesët e trupit, shtëpia, kafshë shtëpiake, vegla, armë e luftë, emra afërie (gjirje), emërtime të kohës, jeta kishtarë, jeta shoqërore e tregëtia, bujqësi e pemë, blegtoria, punimi i verës e i vajit, besimet popullore. Më poshtë po paraqesim disa shembuj:

**Pjesët e trupit:** Flokë, kokë, mendje, faqe, fytyrë, shpatull, fshikë, këmbë, kofshë, gjëndër gjandër, shëndet, shëndoshë.

**Shtëpia:** Shtëpi, kulm, tra, qepër, gëlqere, pëllas “pallat”, portë, mur, tjegull, shkamb, furrë.

**Kafshë shtëpiake:** Qen, pulë, gjel, lepur, pëllumb, kafshë.

**Vegla:** Farkë, furkë, parmendë, fushnje, qerre

**Armë e luftë:** Luftë, armë, shpatë, shyt, shigjetë, mbroj (te Buzuku përonj).

**Emra afërie:** Prind, ungj (ungl), njerku, kunat, thjeshtër fjeshtër, fëmijë, kushëri, krushk, kumtër, ndrikull, fijan, mashkull, femër femën.

**Emërtime të kohës:** Dimër, vjeshtë (vjel), shtator (britm i parë) rrjedhin nga latinishtja. Këtu Çabeji duke përsëritur mendimin e

16 Çabej, Eqrem. Studime etimologjike në fushë të shqipes: A – O. – s.l., 1986, f. 11.

17 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 281

Meyer-it vë re se në gjuhën shqipe ndër ditët e javës “e marta, e mërkura dhe e shtuna janë emra latinë, ndërsa *e diela* dhe *e hëna* janë përkthime kalk nga latinishtja, kurse emrat e së enjtes dhe të së premtes janë të errëta. Çabeji pohon se emri i së *dielës* ka ruajtur refleksin e emrit latin më të vjetër: *dies solis*.

**Jeta kishtarë:** Kishë, klishë, prift, mëkat, djall, kreshmë, qelq, mblatë, ipeshky, këngë kangë, kuvend, pagëztoj, shëlboj, :shpëtoj”, shpirt, mrekuilli, bekoj, kelshëjt.

**Jeta shoqërore dhe tregtia:** Letër, fqinj, mik, armik anmik, shok, shërbes, mjeshtër, mjek, gjind, qytet, pushtet, mbret.

**Bujqësia e pemë:** Bujk bulk, pemë, gështenjë, kërp kamp, li, tërshërë tërshanë (prej trimensana “tremuajshe”), pyll.

**Blegtoria:** Ftujë, mërzej, kullostër.

**Punimi i verës e i vajit:** Musht, mëti, voj vaj, ulli.

**Besimet popullore:** Latinishtja ka ushtruar ndikimin e saj edhe në fushën e folklorit e të besimeve popullore: kuçedër kulshedër nga lat. *shersydus*; dragua drangue nga *draconem*; orët; zana, tosk. (Labëria) zëra nga Diana, hyjnesha e gjahut që e kanë edhe rumunët (zina)<sup>18</sup>.

Ndikim i latinishtes spikat edhe tek emrat e përveçëm si: shq. *Jozéf, Zef, Ndrë, Ndue, Shtjefën, Shqefër* dhe ndoshta edhe *Pjetër* burojnë nga format latine *Josephus, Andraeas, Antonius, Stephanus, Petrus*; *Gjon* dhe *Mëri* vijnë nga *Johannes* dhe *Maria*.

Disa elemente latine si: *corvinus, \*crupta, crypta, curtus, exsütus, fagus, oraculum, pedanea, planus,pratum, rivulus, Slavinica, subterranea, valles bona, villa, vinealis (terra)*, gjenden në këto toponime të kësaj rrjedhe si: *Kurbî Groftat, Shkortull, Prroni Sift, Fag, Frakull, Pëdhanë, Plan Pland, Prat, Rrjoll, Shqinikë, Shutrrija, Valbonë, Vilë, Vinjall*<sup>19</sup>.

Çabeji dha një ndihmesë të madhe duke shqyrtuar çështjen e vendit që zë elementi latin i shqipes në rrethin e gjuhëve romane dhe lidhjet e afrive të tij në këtë rreth. Ky element së bashku me rumanishten, me dalmatishten dhe me elementet latine të serbokroatishtes e të greqishtes së re, bën pjesë në romanitetin

---

18 Çabej, Eqrem. *Huazimet latine*, f. 55

19 Çabej, Eqrem. *Albanische Beiträge zur Kenntnis...*f. 371-372

lindor<sup>20</sup>.

Brenda romanitetit lindor shqipja afrohet më shumë me rumanishten.

Ndikimi i latinishtes në Shqipëri, siç dihet ka nisur tre shekuj më parë se në truallin e Rumanisë. Lidhjet me botën romane dhe me rrymat e saj kulturore kanë vazhduar në gjuhën shqipe edhe pas nguljes së sllavëve në Ballkan<sup>21</sup>. Termi “*latinishte ballkanike*” është mjaft me vend, kur rroken me një vështrim përmbledhës dhe objektiv afrime ndërmjet rumanishtes, shqipes, dalmatishtes dhe gjuhëve të tjera ballkanike në fushën e elementeve latine<sup>22</sup>.

Vlen të përmendim afrimet me rumanishten si: lat. *aburare*: rum. *abura*, shq. *avull*; lat. *alica*: *alcă alkë ajkë*, lat. *astrucare*: *astruca strukem*; *balica*: *baliga balgë bajgë*; *farrimen*: *fārimā thërrime*; *grumulus*: arom. *grumur* shq. *grumbull* etj. Edhe në leksikun e dalmatishtes gjinden përkime me shqipen, megjithëse dalmatishtja është e dokumentuar në masë të pakët: lat. *altare* dalm. *oltar* shq. *ltër*; *missa*: *masa meshë*; *molinum*: *mllin mulli*; *paganus*: *pogan pëgërë*; *persica*: *breskva pjeshkë*, këto gjenden edhe në gjuhët romane perëndimore, sidomos në italisht.

Disa përkime më specifike janë serbokr. *polača* “*pallat*” shq. *pëllás* “*pallat*” prej lat. *palatium*. serbokr. *kobla* “*kubël*” shq. *kubël kulbë*, serbokr. *trakta* “*rrjetë peshkimi, traktë*” shq. *trajkë* “*rrjetë peshkimi*” nga *tractus*.

Ndër karakteristikat e huazimeve latine të shqipes spikasin edhe marrëdhëniet e saj me sardishten, në të cilat shpeshherë merr pjesë edhe rumanishtja. Përveç dukurive fonetike, konstatohen edhe disa barazime leksikore: lat. *certare*: sard. *celtare* shq. *qërtój* rum. *certa*; lat. *sanitosus*: sard. *sanidosu* shq. *shëndoshë* r. *sānātos*; *oleastrum*: shq. *voshtër* “*Ligustrum vulgare*” sard. *ollastu* “*ulli i egër, ullastër*; *linea*: sard. *lindza* shq. *linjë* rum. *lie* “*këmishë grash*” etj.<sup>23</sup>.

Midis elementit latin të shqipes dhe gjuhëve iberoromane ekzistojnë disa përkime, të cilat e gjejnë shpjegimin nëpërmjet rrethanave të përgjithshme të gjeografisë gjuhësore. Duke shqyrtuar

---

20 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 260

21 Çabej, Eqrem. Po aty, f. 261

22 Çabej, Eqrem. Elementet latine të gjuhës shqipe f. 292

23 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine f. 263-264



izoglosat latine të iberoromanishties dhe të shqipes, në të cilat merr pjesë shpeshherë edhe rumanishtja, mund të përmenden:

*angustus*: span., port. e vj. *angusto*, shq. *ngushtë*, rum. . *îngust*.

*conventus* “marrëveshje”: span. e vj. *conviento*: shq. *kuvend* “bisedë, bisedim; marrëveshje”, rum. *cuvînt* “bisedim, fjalë”.

*sacrare* “shenjtëroj”: port., span., katalan., provencal. *Sagrar*, it. *sacrare*: shq. *shëkrój* “shuguroj, dorëzoj prift”.

*spartum*: span., port. *esparto* shq. *shpartë* “gjineshtër” etj.<sup>24</sup>.

Duhet theksuar se jo më pak të rëndësishme janë ato elemente latine që kanë depërtuar në gjuhën shqipe nëpërmjet greqishtes së mesme apo greqishtes së re. Në këto huazime të tërthorta bëjnë pjesë: *alivisë* “finjë”, *aspër* “monedhë e vjetër e argjentë; të holla, para”, *fasule*, *flamur*, *kalique* “nallën”, *kallamar*, *kandil*, *kapistër*, *kusár*, *llukanik* “suxhuk”, *manale*, *rrogë* etj. Fjala *vistár* (sot *visár*), e cila së bashku me rum. *vistier* “arkë e visarit; ruajtës i visarit” rrjedh prej βιστάριον, βιστιάριον, βεστιάριος, e kjo nga lat. *vestiarius* “ruajtës petkash”<sup>25</sup>.

Janë të pakta elementet latine që kanë hyrë në gjuhën shqipe nëpërmjet sllavishtes ballkanike si: *bozilók* *borzilók*; *kolendra* sh. “nata para natës së kërshëndellave; dita e fundit e vitit krahas fjalës: *kullana këllana* “dita e fundit e vitit, nata e motmotit të ri; bora e parë” dhe *kallënduor kallënduer* “kallnuer”. Te *bozilók* dhe te *kolendra* o-ja në vend të a-së tregon burimin e tyre nga sllavishtja. E njëjta gjë vlen edhe për fjalën *konop*, kundrejt fjalës *kanëp kërp*, e cila rrjedh nga latinishtja *canapis*<sup>26</sup>.

Si përfundim mund të pohohet se elementi latin zë një vend kryesor në mes të huazimeve të ndryshme të gjuhës shqipes si nga pikëpamja e vjetërsisë, përmasave dhe rëndësisë kulturore. Ky ndikim ka përfshirë si fushat konkrete të leksikut të gjuhës shqipe ashtu edhe fushën abstrakte mendore. Megjithëse është pak më i vonë sesa elementi që buron nga greqishtja e vjetër, elementi latin është më i rëndësishëm për shkak të të pasurisë së tij.

Ndikimi i huazimeve dhe elementeve latine nuk do të konsiderohet si depërtimi i një sistemi gjuhësor në një tjetër, por si përshkrim intensiv i leksikut, ku si rrjedhojë ka dhënë emra, mbiemra e folje, pastaj një ndikim në fjalëformim me anë të prapashtesave. Ato kanë rëndësi të madhe për kronologjinë e ndërrimeve fonetike

të vjetra të shqipes e si rrjedhojë për historinë e brendshme të gjuhës.

Me anë të një analize të re të materialit dhe një interpretimi të gjendjes gjuhësore nëpërmjet historisë, arrihet në një rregull e qartësi më të madhe të rindërtimit të latinitetit ballkanik<sup>27</sup>.

## **Bibliografi**

Çabej, Eqrem. Albanische Beiträge zur Kenntnis des Lateinischen Wortschatzes. – Firenze : Leo S. Olschki Ed., 1976. – Ekstrakt nga: Bolletino dell'Atlante Linguistico Mediterraneo, 13-15, 1973, f. 365-377.

Çabej, Eqrem. Elementet latine të gjuhës shqipe. – Në Studime gjuhësore. – Nr. 4, 1977, f. 290-300

Çabej, Eqrem. Huazimet latine. – Në: Studime gjuhësore 3. – Prishtinë : Rilindja, 1976, f. 50-55

Çabej, Eqrem. Iberoromanishtja dhe shqipja, izoglosat e tyre latine. – Në: Studime Filologjike. – Nr. 4. – 1976, f. 69-72

Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe. – Në: Studime Filologjike. – Nr. 2, 1974, f. 13-54

Çabej, Eqrem. Studime etimologjike në fushë të shqipes: A – O. – s.l., 1986, 390 f.

---

27 Çabej, Eqrem. Karakteristikat e huazimeve latine, f. 287

Brikena Kadzadej, Vezire Krasniqi

## **EQREM ÇABEJ NË KËNDVËSHTRIMIN E FRANZ BABINGERIT**

### **Hyrje**

Ky punim, duke u bazuar në fushën e hulumtimit të letrave, do të paraqesë personalitetin e Eqrem Çabejt nëpërmjet letërkëmbimit me studiuesin Franz Babinger.

Në fillim do të japim një vështrim të shkurtër teorik për komunikimin me shkrim, funksionet e tij që do të na shërbejë si bazë burimore për analizën dhe interpretimin e letërkëmbimit Çabej–Babinger.

Më pas, në ndihmë të hipotezës së shtruar në këtë punim, do të paraqesim në vija të përgjithshme veprimtarinë e Babingerit. Duke u nisur nga kjo do të hedhim dritë në raportin *Çabej– Babinger*, temat e tyre të diskutimit, rrethanat kohore, politiko–shoqërore dhe pozicionimin e tyre.

Është për t'u theksuar fakti që ne disponojmë vetëm letrat e kthimit nga Babinger, dhe jo letrat e dërguara nga *Çabej*.

### **1.Letra, letërkëmbimi dhe funksioni i tij**

Letra, letërkëmbimi është burimi hulumtues i këtij artikulli për këtë arsye, duke u mbështetur kryesisht në punimet e Matthews–Schlinzig, Marie Isabel [u.a.] (Handbuch Brief, 2020), Csáky, Moritz: (Budapester Beiträge zur Germanistik 2005), Ebert, Helmut: (Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Germanistische Reihe. 62/2001.), Nickisch, Reinhard M.G (Brief.Stuttgart: Metzler 1991), do të përpiqemi të sqarojmë këtë koncept në kontekstin teorik

për një analizë shkencore të letërkëmbimit.

Nickisch e përshkruan natyrën e letrës si një proces komunikues midis dy individëve, në të cilin ndërtohet një deiksis hapësirë–kohë dhe që shkon paralelisht me një situatë komunikimi të krijuar në mënyrë karakteristike. (Metzler 1991/260: 9)

Sipas Ebert: “Në kuptimin prototip, komunikimi me letra është një formë e komunikimit me shkrim që vonohet në kohë dhe lidhet me një instancë transmetimi ndërmjet një shkruesi personalisht përgjegjës i drejtpërdrejtë, dhe një marrësi të vetëm të caktuar opo të disave” . (Ebert 2001: 21)

Csáky nga një këndvështrim kulturoro–teorik, e sheh letrën si një komunikim ose mesazh të shkruar me përmbajtje të pacaktuar që përfshin një dërgues dhe një marrës. Ai përmend edhe distancën fizike ndërmjet pjesëmarrësve, e cila e bën të pamundur shkëmbimin verbal, prandaj duhet përdorur një formë e shkruar e komunikimit. (Csáky 2005: 17)

Më tej ai shpjegon se kultura mund të shihet si një hapësirë komunikimi dhe se dërguesi dhe marrësi janë për këtë arsye në një hapësirë të përbashkët komunikimi që përfshin një kontekst social. Brenda kësaj hapësire flitet e njëjta gjuhë, si të thuash, duke përdorur disa kode të njohura për të dy.

Shprehjet, format e të drejtuarit dhe përshëndetjet, pasqyrojnë mjedisin ekzistues të jetesës së të përfshirëve. (Csáky 2005: 17)

Matthews–Schlinzig dhe të tjerë në veprën e tyre “Handbuch Brief” i mbështesin këto përcaktime dhe bëjnë të qartë se puna me letrat tregon ndërdisiplinartitet shkencor dhe lejon përparësi të ndryshme. Në thelb ata si edhe Eberti e shohin letrën si “medie të komunikimit me shkrim kryesisht personal i vonuar në kohë në distancë hapësinore. (Matthews–Schlinzig et.al 2020, S. XI ). Si tipare të pandryshuara të kësaj medie Matthews–Schlinzig dhe të tjerë e shikojnë letrën si (1) tekst, (2) objekt material dhe (3) ngjarje ose veprim.

Sipas Nickisch si funksion i parë bazë i letrës është përcjellja e informacionit. Ai është, si të thuash, bartës i përmbajtjeve të ndryshme, të cilat mund të jenë faktike, për çështje biznesi, shkencore apo personale. Më pas vjen funksioni i saj apelues. Gjë që lejon që të formulohen dëshirat, urdhërat, kërkesat ose rregullat.

Sipas Nickisch, funksioni i tretë bazë i letrës është ai i vetë-shprehjes. Këtu shprehet vetvetja e shkrimtarit dhe letra shërben si mjet për atë që Nickisch e quajti “vetëshprehje”, “vetëportretim”, “vetëreflektim” dhe “vetëinterpretim”.

Ebert shton se “vetëpërfaqësimi apo vetë-portretizimi” me letra nuk është thjesht një “qëllim në vetvete”, pasi shkrimtari i tregon edhe personit tjetër se si do të donte të perceptohej dhe si duhet ta haste. (Ebert 2001: 27)

Csáky është i mendimit se letrat japin një pasqyrë të mjedisit social dhe kulturor të shkrimtarit dhe pasqyrojnë mentalitetet dhe botëkuptimet e asaj kohe dhe për këtë arsye janë gjithashtu dëshmi kulturore. Në këtë kontekst ai përmend “përmbajtjet e një tradite” që mund të mos përmenden në mënyrë eksplicite, por megjithatë janë të pranishme në “memorien sociale. (Csáky 2005: 21)

Në mënyrë të përmbledhur mund të thuhet se letra ofron një sërë mundësish në diskutim. Në thelb, është një media e shkruar me karakterin e një mesazhi që të kujton një bisedë dhe lejon autenticitet dhe individualitet. Mes dy individëve krijohet në distancë, si të thuash, një hapësirë komunikimi, me anë të së cilës mund të mbulohet mungesa e tjetrit. Letra ka edhe një rol, i cili mund të shpjegohet me konstituimin e vetes dhe të tjetrit.

Letrat mund të shërbejnë si bartës informacioni, si një apel dhe si mjet vetëshprehjeje dhe kështu të veprojnë si zëvendësues i asaj që flitet. Ato gjithashtu përcjellin kontekstin social dhe kulturor të shkrimtarëve dhe ofrojnë hapësirë për subjektivitet, reflektim dhe diskutim, me funksionin psikologjik që merr rëndësi me kalimin e kohës.

## **2. Veprimtaria e Babingerit në sqarim të hipotezës**

Franz Babinger (15 janar 1891 në Weiden në Oberpfalz–1954 Durrës) Profesor i Historisë për Lindjen e Afërt dhe Turkologjisë në Universitetin e Mynihut, anëtar i Akademisë që nga viti 1954, vdiq më 23 qershor 1967 në Durrës, si i ftuar i Universitetit të Tiranës.

Lufta e Parë Botërore në misionin ushtarak gjerman në Turqi ishte një përvojë e madhe për të. Ai mësoi të donte këtë vend, kulturën e tij, kështu studimet turke dhe osmane u bënë pjesë e jetës së tij.

Më 1921 mbrojti gradën shkencore në Berlin për Islamizimin, ku në vitin 1924 u emërua Profesor i asociuar në Universitetin e Berlinit.

Në vitin 1934 regjimi i kohës e liroi nga detyra. Ai shkoi jashtë vendit dhe gjeti mundësi të reja për mësimdhënie dhe kërkime në Universitetet rumune të Bukureshtit etj.

Në vitin 1948 ai punoi në katedrën e sapokrijuar për këtë fushë të Universitetit të Mynihut.

Merita e Babingerit është në Studimet orientale, të cilat deri atëherë ishin të orientuara fuqishëm drejt studimeve semite, ai u thellua në studimet turkologjike dhe osmane. Për t'u përmendur është manuali "Historianët e osmanëve dhe të veprave të tyre" 1927. Në këtë kontekst ai bashkëpunoi për studimet ballkanike.

"Ai e donte provokimin dhe disa mund të mendonin, se e donte për hir të tij/ për hir të tyre. Por provokimi i tij ishte gjithmonë një shprehje e dëshirës së tij më të thellë për komunikim, për një përgjigje, një shprehje e vetmisë së tij. Kush i përgjigjej, sidomos ata i që përgjigjeshin me stil, mund të mbështeteshin tek ai, të kishin respektin e tij, ndihmën e tij dhe madje edhe besimin e tij, i cili ishte i vështirë për t'u fituar. Ai ishte një njeri, asgjë njerëzore nuk ishte e huaj për të, sigurisht që jo njerëzimi i vërtetë" (Hans-Georg Beck, 197).

### **3. Letërkëmbimi Çabej-Babinger**

Goethe është përpjekur të bëjë një nga përcaktimet e para për letrën. Ai e shikon letrën si një nga monumentet më të rëndësishme të qenies njerëzore individuale, të cilat kanë një rëndësi të madhe për pasardhësit, megjithëse nuk janë të konceptuara për ta. (Henke 2007: 176)

"Shpesh kur i shkruan një miku është më shumë rasti, sesa tema e letrës[...]" (Goethe an Wnckelmann 1891:11).

Në fillim do të paraqesim strukturën e shtrirjes kohore dhe tematikën e këtij letërkëmbimi.

Ky letërkëmbim që na u besua nga znj. Çabej përfshin periudhën kohore janar-korrik 1963 (1.1.1963, 19.2.1963, 12.7.1963 tri letra të shtypura me makinë shkrimi nga Profesor Babinger).

Jemi të mendimit se këto tri letra janë vijim i letërkëmbimit të

rregullt të Profesor Çabejt me Profesor Babinger, kjo duke u nisur nga përmbajtja e tri letrave, të cilat nuk na japin asnjë shenjë, ku mund të dyshojmë që kemi të bëjmë me fillimin e një letërkëmbimi, përkundrazi që në fillim të letrës që daton 1 janar 1963 Profesor Babinger i përgjigjet urimeve të Profesor Çabejt për vitin e ri dhe ia kthen atij familjarisht: Ihre freundlichen Grüßen zum Jahreswechsel haben mich erreicht und sehr erfreut. Ich erwidere sie, versteht sich, herzlich für Sie und Ihre Familie.

Kjo dëshmon një njohje të mirë familjare dhe këmbim urimesh në vijim.

Ajo që të bie në sy në kokën e letrës është fraza e vetme në frengjisht për të adresuarin “Pour Monsieur le professeur Ekrem Çabaj–Për zotin professor [...]”. (Ndoshta frëngjishtja dhe anglishtja ishin asokohe për komunikimet zyrtare) dhe më pas letra hapet me formën nominale të të drejtuarit “Lieber Herr Kollege– I dashur zoti koleg, formë nominale që shoqërohet me atë pronominale ju të respektit “Sie”, Ihre Familie etj. dhe që dëshmon për një raport kolegial.

Të sjellurit me respekt, forma formale dhe neutrale tregohet dhe në formën e ndarjes [1.1.1963] “Mit allen Ihren Grüßen und Wünschen, Ihr erg. “[Mit vielen Grüßen bin ich Ihr ergebener Diener–përunjesisht].

Pjesa e parë e kësaj forme ndarjeje vijon të jetë një formë klasike me karakter formal dhe neutral dhe të përdoret ndaj institucioneve publike dhe autoriteteve dhe është e përshtashme pothuaj në të gjitha kontekstet. Pjesa dytë e ndarjes Ihr erg. shkurtim i “Mit vielen Grüßen bin ich Ihr ergebener Diener” ka qenë përdorur në këtë periudhë në komunikimin me shkrim formal, shprehte respekt dhe neutralitet, sot është e vjetëruar dhe ka efekt ironik.

Në letrat në vijim të letërkëmbimit përdoret e njëjta formë drejtimi dhe në mbyllje kemi format e mëposhtme [19.2.1963] “Mit der Bitte, mich allen, die sich meiner freundlich noch erinnern, aufs beste zu empfehlen, begrüße ich Sie mit allen guten Wünschen herzlich und verbleibe ihr. Erg. [12.7.1963] “Ich wünsche Ihnen alles Gute und bitte empfehlen Sie mich Ihrem Haus und Ihren Herren, soweit Sie sich meiner erinnern können und wollen.

Kemi përdorimin e formave formale që sigurojnë një raport

simetrik komunikimi dhe nëse bëjmë një përjasje të tri formave të ndarjes konstatojmë që nga një ton me respekt dhe formal bëhet më i afërt, i besueshëm dhe i fokusuar tek adresuesi, Profesor Çabej, kjo është e lidhur me një sqarim të marrëdhënies mes shkruesve, dhe distancim me të tjerët që trajtohen në subjektin e letrave, referuar kjo rrjedhës së ngjarjeve të paraqitura nga Franz Babinger.

Si përfundim mund të konstatojmë se përdoren kode gjuhësore të pranura dhe të kushtëzuara nga raportet midis tyre dhe këto kode veprojnë si një kornizë për një hapësirë në të cilën bëhet shkëmbimi me shkrim.

#### **4. Rrethanat kohore, shoqërore e politike të këtij letërkëmbimi**

Hapësira kohore e këtij letërkëmbimi është e lidhur ngushtë me rrethanat shoqërore dhe politike të tij dhe pasqyrohet drejtpërdrejt apo nëpër rreshta në të.

Ky komunikim zbulon marrëdhënie të caktuara midis veprimtarisë njohëse individuale dhe kolektive, si dhe historike.

Sipas Lacan “Gjuha kryen një komunikim në të cilin dërguesi merr mesazhin e tij në formë të anasjellë nga marrësi. Kjo tregon se dërguesi dhe marrësi pasqyrohen, nga ana tjetër, ndodh një dërgim dhe marrje e njëkohshme, ose e thënë ndryshe: “Çdo thënie tashmë nënkupton një përgjigje për personin tjetër, edhe nëse ai nuk ka folur fare, por flet vetëm atëherë kur flet edhe dërguesi.” (Widmer 1997: 66)

Në vitin 1948 pas prishjes me Jugosllavinë e Titos arsimit dhe shkencën iu nënshtrua metodave të mësimdhënies sovjetiko–marksiste.

Nga viti 1955 rusishtja u bë gjuhë e huaj e detyrueshme në arsimin shqiptar, i cili orientohej nga modelet sovjetike. Me ndihmën e Bashkimit Sovjetik, në vitin 1951 u hapën tri institucione të reja të arsimit të lartë: Institut Pedagogjik, Politeknik dhe ai Bujqësor. Më vonë ai Instituti Mjekësor, Ekonomik dhe Juridik.

Gjashtë vjet më vonë, më 16 shtator 1957 u hap universiteti i parë shtetëror i Tiranës USHT, si qendër jo vetëm për trajnimin e specialistëve të ardhshëm, por njëherazi edhe kërkimore.

Në 1972 u krijua Akademia e Shkencave nën drejtimin e Profesor A. Budës, Çabej ishte një ndër anëtarët themelues të



ASHSH-së. Me krijimin e Universitetit të Tiranës (1957) Çabej rifilloi veprimtarinë e tij pedagogjike dhe shkencore këtu.

Rrethanat politike-shoqërore në të cilat punuan këta shkencëtarë ishin ato të një shteti të diktaurës së proletariatit, ku të gjitha fushat e jetës duhet të përshkoheshin nga ideologjia marksiste-leniniste. Shkenca dhe arsimi ishin nën kontrollin e shtetit dhe mjet i rëndësishëm për indoktrinimin ideologjik të brezit të ri.

Madje dhe detyra e ASHSH-it ishte mbështetja e rindërtimit socialist të vendit nën drejtimin e parimeve marksiste leniniste.

Për të mbajtur nën kontroll gjithçka, shteti përdorte Sigurimin e Shtetit, agjitacionin e propogandën, luftën e klasave etj.

Profesorët me formim jashtë vendit dhe mendje të hapur ishin një problem shqetësues për këtë Diktaturë dhe vetkuptohet që survejoheshin pandërprerë, pra edhe letërkëmbimet e tyre i nënshtroheshin kontrollit të Sigurimi i Shtetit.

Ky është në vija të përgjithshme konteksti historik, politiko-shoqëror që na ndihmon për të kuptuar përmbajtjen e këtij letërkëmbimi.

Në letrën e shkurtër të 01.01.1963 fillon tematika që do të thellohet në 2 letrat vijuese. Këtu mësojmë që Babinger ka mundur të marrë një shumë nga shteti për sigurimin e librave të autorëve gjermanë, austriakë dhe zviceranë për Universitetin, gjë të cilën e kishte premtuar në sallën e Parlamentit dhe për këtë gjë i ka shkruar me hollësi kolegët Buda.

Letra mbyllet me fjalinë që beson që si ai dhe kolegët e tjerë të jenë shumë të interesuar për blerje të reja. Në letërkëmbimin në vijim (19.02.1963) mësojmë që thirtjes së Babingerit për tituj librash nuk i ishte përgjigjur askush, as Kryetari i Akademisë, as Rektori i Universitetit të Tiranës dhe se i vinte shumë turp për këtë situatë dhe i kërkon mbështetje direkt Profesor Çabejt (Vielleicht haben SIE die grosse Güte, sich in dieser Angelegenheit einzusetzen! Herr Koll. Buda scheint das nicht zu tun. warum, weiss ich nicht. -Ndoshta keni mirësinë ju, të ndërmjetësoni në këtë çështje. Z. kolegu Buda duket se nuk e bën këtë. Përse, nuk e di.).

Letra e fundit 12.07.1963 është një letër, që paraqet më së qarti problematikën kryesore të studjuesve shqiptarë, survejimin dhe moskompetencën për vendimmarrje.

Mbyllja e letrës është e trishtë. Babinger është shumë i ngarkuar nga e gjithë kjo situatë, të cilën nuk është në gjendje ta kuptojë, është jashtë mendësisë normale dhe proteston që do i kthejë të gjitha tek donatori. (Niemand kann von mir verlangen oder auch nur erwarten, dass ich mich lächerlich mache oder den Eindruck eines Aufschneiders erwecke. Ich wünsche Ihnen alles Gute. Bitte empfehlen Sie mich Ihrem Haus und den Herren, soweit sie sich meiner erinnern können oder wollen. – Askush nuk mund të kërkojë dhe as të presë që unë të bëhem gazi botës, ose të lë përshtypjen e një mburraveci. Ju uroj gjithë të mirat. Ju lutem, përshëndetni familjarët, zotërinjtë për aq sa munden, apo duan të më kujtojnë.)

Babinger dallon në letërkëmbim Profesorin, si njeri, studiues korrekt, të aftë dhe mendjehapur që nuk nguron të shkëmbejë me të për etimologjinë e fjalës, si historian, duke vënë përballë gjithë institucionin shqiptar që kërkonin libra apo të dërgonin studiues dhe më pas nuk reagonin nga frika.

Kontributi i tij shkencor për gjuhën shqipe, përqendrimi i tij në hulumtimin e saj, shmangia e provokimeve, bëri që ai të mbijetojë.

Siç është shprehur albanologu gjerman Fiedler “...Historia e Albanologjisë është në masë të madhe histori e gjuhësisë historike shqiptare.” (Fiedler 2006:14)

## **Bibliografi**

Csáky, Moritz (2005): Zwischen Oralität und Literalität. Überlegungen zum Brief aus einer kulturtheoretischen Perspektive. In: Der Brief in der österreichischen und ungarischen Literatur. Hrsg. v. András F. Balogh und Helga Mitterbauer. Budapest: ELTE Germanistisches Institut. (= Budapester Beiträge zur Germanistik. 45.) fq. 17–29.

Ebert, Helmut (2001): Zum Zusammenhang von Strategie, Struktur und Stil am Beispiel der>Anatomie< eines Privatbriefes. In: Ich an dich. Edition, Rezeption und Kommentierung von Briefen. Hrsg. v. Werner M. Bauer, Johannes John und Wolfgang Wiesmüller. Innsbruck: Inst. für Dt. Sprache, Literatur u. Literaturkritik. (= Innsbrucker Beiträge zur Kulturwissenschaft. Germanistische Reihe. 62.) fq. 21–35.

Fiedler, Wilfried (2006): Geschichte der albanischen historischen Sprachwissenschaft. Meißen. Fiedler.

Goethe Werke. Goethe an Winckelmann, Weimarer Ausgabe, 46. Band, 1891.

Henke, Silvia (2007): Eigensinnige Briefe. Zwischen Literatur- und Medienwissenschaft. In: Weiterlesen. Literatur und Wissen. Hrsg. v. Ulrike Bergermann und Elisabeth Strowick. Bielefeld.

Matthews–Schlinzig, Marie Isabel [u.a.] (Hrsg.) (2020): Handbuch Brief. Von der frühen Neuzeit bis zur Gegenwart. Band 1: Interdisziplinarität – Systematische Perspektiven – Briefgenres. Berlin, Boston: de Gruyter.

Nickisch, Reinhard M.G. (1991): Brief. Stuttgart: Metzler. (= Sammlung Metzler. 260.)

Widmer, Peter (1997): Subversion des Begehrens. Eine Einführung in Jacques Lacans Werk. Wien: Thuria + Kant.

<https://badw.de/fileadmin/nachrufe/Babinger%20Franz.pdf>

Sonila Sadikaj, Marisa Janku

## KONTRIBUTI I PROF. ÇABEJT NË FUSHËN E FRAZEOLOGJISË SHQIPE

Në këtë përvjetor të lindjes së Profesor Eqrem Çabejt duam të sjellim në fokus të vëmendjes një kontribut të tijin të botuar në gjuhën gjermane në vitin 1936 me titull “Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen” (shqip: “Shprehje dhe thënie (frazologjizma) paralele në gjuhët e Ballkanit”) në revistën “Revue internationale des études balkaniques” (nr. II, f. 226-331).

Ky artikull i botuar kur vetë Çabej ka qenë në moshë të re, 28 vjeç, ka qenë asokohe i një rëndësie të veçantë për faktin, sepse botohej në një periudhë kur rrallë ndonjë autor shqiptar para tij do t’i kishte trajtuar njësitë frazeologjike si objekt të një studimi të mëvetësishëm, madje kur termi *frazologji* ende nuk ishte i mirëpërcaktuar dhe kur shkencën e frazeologjisë ende nuk ishte lëvruar si duhet mbi baza metodologjike dhe as në mënyrë sistematike jo vetëm brenda albanologjisë por as për gjuhët e mëdha evropiane, si gjuhët gjermanike apo ato me bazë latinishten. Gjithsesi ky punim i Prof. Çabejt, ndoshta edhe për faktin se është shkruar në gjuhë të huaj, gjermanisht, nuk është perceptuar në rrethet e gjera të publikut shkencor shqiptar. Qëllimi i kësaj kumtese është hedhja dritë mbi punimin në fjalë në disa aspekte: sa i takon metodologjisë dhe qasjes ndaj frazeologjisë, terminologjisë së përdorur, vendit që zë në kërkimin shkencor frazeologjik të kohës dhe rrjedhimisht statusit si risi në studimet albanologjike të viteve 30-të të shekullit të 20-të.

Më së shumti Prof. Çabej njihet për studimet e thelluara dhe kontributin kolosal sa i takon historisë dhe prejardhjes së gjuhës

shqipe, gramatikës historike, etimologjisë së shqipes, dialektologjisë, gjykimeve për folklorin dhe letërsinë, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera të Ballkanit etj., por shumë pak njihet si mbledhës dhe studiues i shprehjeve frazeologjike.

Artikulli, të cilin do të shqyrtojmë, bën pjesë në botimet e tij të para. Vetëm tre vjet më parë ai kishe mbrojtur doktoraturën në Vjenë në moshën 25-vjeçare me titull “Studime italo-shqiptare” (Italoalbanische Studien) dhe botimet pasardhëse deri në 1936-ën trajtojnë si aspekte e tema nga fusha e folklorit dhe e letërsisë, ashtu edhe marrëdhëniet e shqipes me gjuhët e tjera, kryesisht me gjuhët latine (p.sh. rumanishten). Në këtë vazhdë vjen edhe punimi “Shprehje dhe thënie paralele në gjuhët e Ballkanit”, në të cilin shqipja krahasohet me rumanishten, greqishten e re dhe bullgarishten dhe që vetë autori e konsideron si një “kontribut sado të vogël” në studimet e Ballkanologjisë.

1. Për çdo njohës të mirë të historikut të frazeologjisë shqipe, për hir të së vërtetës që në titull punimi të çon mbrapa në kohë, në vitin 1908, kur ishte botuar në Leipzig të Gjermanisë dizertacioni i studiuesit rumun Pericle Papahagi me një titull krejt të ngjashëm “Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, Albanesischen, Neugriechischen und Bulgarischen” (shqip: Shprehje dhe thënie (frazeologjizma) paralele në gjuhët rumune, shqipe, greqishte e re dhe bullgare). Dhe vetë Çabej e koncepton kontributin e tij, që në hyrje të botimit, si “shënime e komente rreth punimit të vyer të Per. Papahagit” duke renditur disa plotësime sa u takon shembujve nga gjuha shqipe, të cilët konkretisht Çabej i ka përzgjedhur nga dialekti i vendlindjes së tij, Gjirokastrës. Pra ngjashmëria në titull me dizertacionin e Papahagit është e qëllimshme dhe gjithashtu një tribut për studiuesin rumun.

Para se të evidentojmë këtu vlerat e këtij studimi komplementar të Çabejt në fushën e frazeologjisë shqipe, le t'i kthehemi pas një historiku të shkurtër të disiplinës së frazeologjisë në Evropë për të kuptuar më mirë rrethanat dhe kontekstin në të cilin janë hartuar punimi i Papahagit dhe ai i Çabejt të ri.

## 1. Frazeologjia evropiane në fillim të shek. XX-të

Në fillim të shekullit të 20-të frazeologjia si disiplinë shkencore ishte krejt e re dhe një meritë të veçantë për zhvillimin e saj e patën pa diskutim linguistët sovjetikë të cilët ndoqën traditën ruse të shekullit të 19-të (Fleischer 1997, 4), e cila u kishte atribuar frazeologjizmave një status të veçantë në gjirin e llojeve të ndryshme të togjeve/grupeve të fjalëve. E megjithëse këto zhvillime u ndikuan dukshëm nga studimi i Ch. Bally-t “*Traité de stylistique française*”, ky kontribut i jashtëzakonshëm i Bally-t nuk u çua me tej e nuk gjeti rezonancë në gjuhësinë e Evropës Qendrore dhe Perëndimore (Pilz 1978, 166.), por u përpunua gjerësisht e thellësisht nga frazeologët rusë. Ishin pikërisht studimet e gjuhëtarit Vinogradov (nga 1946 e në vazhdim) ato që kontribuuan që frazeologjia të konsolidohej si një nëndisiplinë e mëvetësishme në gjuhësinë sovjetike.

Edhe për frazeologjinë e gjuhës gjermane studimi i parë i plotë panoramik do të vinte nga një autore sovjetike, Irina Černyševa (1970). Natyrisht që mbledhja, grumbullimi dhe botimi i shprehjeve popullore, fjalëve të urta apo togfjalëshave të ngurosur etj. (sic quheshin asokohe), kishte nisur për gjermanishten shumë më herët, që në fillimet e shekullit të 17-të (p.sh. nga M. Luther, M. F. Peters, J. G. Schottel, J. C. Gottsched), por ende nuk mund të flitej për një studim të mirëfilltë lingvistik i cili të përcaktonte terminologjinë, kriteret e klasifikimit të këtyre njësisve leksikore, dallimin e tyre nga fenomene të tjera të ngjashme gjuhësore e kështu me radhë. Kështu p.sh. deri në fillim të shekullit të 20-të ende shprehjet frazeologjike trajtoheshin si të ngjashme me fjalët e urta. Deri në dekadat e para pas Luftës II-të Botërore trajtimi i thënieve e shprehjeve popullore, ose ai i fjalëve të urta për gjuhën gjermane kishte më shumë karakter koleksionues, historiko-etimologjik ose etnografik e kulturor (Fleischer 1997, 15) dhe kështu në Kongresin e Parë të Gjermanistikës gjermano-lindore (RDGJ) mbi ‘Çështjet e Leksikologjisë’, i cili u mbajt në Leipzig, në vitin 1967, ende kërkohet për të ardhmen hedhja e themeleve teoriko-shkencore për hulumtimin dhe përshkrimin mbi baza lingvistike të frazeologjizmave të gjuhës gjermane. E kështu trajtimi i parë i mëvetësishëm e tërësor i frazeologjisë gjermane do të vinte në vitin 1970 nga gjuhëtarja sovjetike Irina Černyševa.

## 2. Punimi i Pericle Papahagi-t në kontekstin e studimeve frazeologjike

Dizertacioni në gjuhën gjermane i P. Papahagi-t “Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, Albanesischen, Neugriechischen und Bulgarischen” (shqip: Shprehje dhe thënie paralele në gjuhët rumune, shqipe, greqishte e re dhe bullgare) i botuar në Leipzig në vitin 1908 (dhe i hartuar nën udhëheqjen shkencore të gjuhëtarit e ballkanologut të njohur Gustav Weigand), ka në fokus evidentimin e ngjashmërive në thënie e shprehje të caktuara të gjuhëve të sipërpërmendura ballkanike me qëllimin kryesor për të hedhur dritë mbi lidhjet e forta, marrëdhëniet influencuese dhe elementet e përbashkëta mes gjuhëve të popujve ballkanikë, për të dhënë një ndihmesë në sqarimin e mëtejshëm të çështjes së prejardhjes dhe shtrirjes gjeografike të këtyre popujve dhe gjuhëve të tyre. Siç shprehet dhe vetë Papahagi:

“Studime të tilla janë të rëndësishme për njohjen e historisë së popujve të tjerë të Ballkanit, sidomos të shqipëtarëve [albanezëve]. Prej hedhjes dritë mbi të shkuarën e errët [të paqartë] të rumunëve, varet edhe qartësimi i së shkuarës po aq të errët [të paqartë] të shqipëtarëve, dhe në ndonjë kontekst tjetër, veçanërisht gjuhësor, qartësimi i së shkuarës së bullgarëve dhe serbëve dhe madje i vetë grekëve modernë...” (Papahagi 1908, 114).

Qëllimi i Papahagit në vetvete nuk ishte përpilimi i një punimi me karakter të mirëfilltë frazeologjik, pra është evidente që ai nuk ndërmerr aspak një përcaktim apo përkufizim terminologjik të atyre fenomeneve gjuhësore që ai i quan *Ausdrücke* (shprehje) apo *Redensarten* (mënyra të thëni”). Papahagi nuk synon as sqarimin e prejardhjes së këtyre shprehjeve, çka bazuar në stadin e kërkimeve shkencore gjuhësore të asaj kohe do të ishte vërtet e vështirë, përkundrazi rezultati i punës së tij është dëshmia e pamohueshme se marrëdhëniet mes popujve të Ballkanit kanë qenë shumë të ngushta, të thella e të shumëllojshme për shumë shekuj me radhë (Papahagi 1908, 168). Ai arrin në konkluzionin se:

“E njëjta frymë u jep shpirt gjuhëve të këtyre popujve; kështu që mund të supozohet se këto gjuhë vetë formojnë së brendshmi një njësi; dallimi i vetëm konsiston në formën e jashtme; por në të gjitha gjuhët njëherësh shfaqen të njëjtat shprehje, mënyra të thëni,

fjalëformime” (po aty, 168). [Përkthim i autoreve]

Papahagi është i bindur për ekzistencën e një uniteti sa i takon formës së brendshme gjuhësore të popujve të Ballkanit (innere Sprachform): “Marrëdhëniet mes këtyre popujve, qofshin miqësore apo armiqësore, nuk janë ndërprerë asnjëherë plotësisht në rrjedhën e kohës. Vetëm kështu mund të kuptohet uniteti i formës së brendshme gjuhësore të popujve të Ballkanit” (po aty).

Me interes për albanologjinë dhe çështjen e autoktonisë së shqiptarëve është pohimi i Papahagit në kapitullin hyrës të punimit të tij:

“Pasardhësit e autoktonëve, shqiptarët (albanezët), flasin, siç rezulton nga hulumtimet modeste të këtij punimi, një gjuhë e cila në formën e saj të brendshme në përgjithësi nuk dallon nga gjuhët e tjera ballkanike. Madje ngjashmëritë mes gjuhëve ballkanike në këtë aspekt janë aq të mëdha e të dukshme, saqë me zor mund të konstatohet çfarë është karakteristike për secilën, për të mos folur pastaj për atë çka është autoktone”. (Papahagi 1908, 116) [Përkthim i autoreve]

Dizertacioni kompilues i Papahagit ofron në të 57 faqet e tij një shtjellim teorik hyrës prej 4 faqesh të plota, një kapitull qendror prej 50 faqesh i cili përmban në rendin alfabetik listën e shprehjeve paralele në gjuhët ballkanike (gjithsej 451 shprehje) dhe mbyllet me 1 faqe konkluzione dhe 2 faqe shkurtesa dhe referenca bibliografike.

Renditja alfabetike e shprehjeve paralele bazohet në leksema të veçanta të shprehura në gjermanisht, të cilat janë pjesë e këtyre shprehjeve. Gjithsesi, ndoshta edhe për shkak të mungesës asokohe të një kuadri të mirëfilltë teorik e terminologjik sa i takon frazeologjisë, te shprehjet apo te të ashtuquajturat *Redensarten* të listës së Papahagit jo gjithmonë bëhet fjalë për shprehje në formë fraze, togfjalëshsi apo idiome, pra lista përmban edhe frazeologjizma (nga këndvështrimi i sotëm), por jo vetëm. Shpesh bëhet fjalë për një leksemë të vetme, e cila në gjuhët ballkanike mund të përdoret në disa kuptime të figurshme, ndryshe nga gjuha gjermane, dhe këto kuptime figurative janë të njëjta në të gjitha gjuhët e analizuara.

Për çdo fjalë kyç të gjuhës gjermane, jepen shprehje në gjuhët e sipërpërmendura dhe shpjegohet shkurt në gjermanisht kuptimi i tyre i përbashkët. Pa mohuar vlerat e padiskutueshme të kësaj vepre



studimore ballkanologjike dhe gjithashtu rëndësinë që ka në fushën e albanologjisë, duam të evidentojmë shkurtimisht si janë trajtuar shprehjet e gjuhës shqipe në të:

- Vihet re se Papahagi jo gjithmonë jep shembuj nga gjuha shqipe (pra mungon përqsja).

- Në rastet e shembujve shqip evidentohet se ata nuk janë të unifikuar sipas një standardi të gjuhës së shkruar, pasi ky asokohe ende nuk ishte kthyer në normë, por edhe sepse shembujt e shqipes autori i merr në të shumtën e rasteve nga botimet e Hahn-it, Pedersen-it, Gustav Meyer-it, duke dhënë referencën përkatëse. Ka edhe shembuj, të cilët mungon burimi dhe mund të mendohet se ata e kanë burimin të njohuritë e gjuhës shqipe të vetë Papahagit.

- Fakti që shembujt shqip vijnë nga burime të ndryshme, shpjegon arsyen se përse ata herë paraqiten në gegërisht e herë në toskërisht. Madje shkrimi i shqipes në këtë botim ngjason më tepër me një transliterim/transkriptim të sistemit fonetikor të shqipes, në mënyrë që ta lexojë syri i një të huaji evropian. Shembujt janë të shkruar në alfabetin latin, por gjejmë edhe gërma nga alfabeti gjerman si p.sh. “ü” (përsüsem – ik andejza se mos me persüset puna; mar ñi sü ñume), ose nga alfabetet e tjera “š”, apo bashkime gërmash latinisht për tinguj të veçantë të shqipes: dz xh.

- Ndoshta prej kriterit të mësipërm (besnikëria ndaj burimit origjinal të shembujve), vihet re se shprehjet shqipe nuk jepen në një formë emërtuese të njësuar. P.sh. në rastin e shprehjeve foljore ato herë jepen në vetën e parë, herë në atë të dytë, ose edhe në vetën e tretë. (12. Avulohem; 17. T’s pune me bere!; 18. Bej punen t’ime; 37. mar ñi sü ñume; 153. e more ne kafe; 155. Nuke mbanene kembete; 171. Doli i lik; 280. Mer kartene; 291. Me plase džane)

### **3. Shkrimi kontrastiv i E. Çabejt mbi shprehjet dhe thëniet paralele në gjuhët e Ballkanit**

Shkrimi i Çabejt „Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen“ është konceptuar nga autori në formën e një shtese plotësuese të botimit të hershëm të Papahagit, ku për çdo shprehje frazeologjike jepen edhe sqarime të hollësishme. Madje Çabej skrupuloz e quan të vonuar botimin e tij, megjithëse ai ishte vetëm 28 vjeç, por ndoshta me anë të këtij komenti ka dashur të shprehë

keqardhjen për këtë boshllëk në kërkimin shkencor krahasues mes shqipes e gjuhëve të tjera të Ballkanit, sa i takon frazeologjisë. Me shumë modesti e cilëson kontributin e tij si të vogël, por gjithashtu nxjerr në pah nevojën e këtyre studimeve në fushën e ballkanologjisë. Shembujt plotësues që ka përzgjedhur, e kanë prejardhjen nga dialekti i tij, ai i Gjirokastrës.

Megjithëse punimi me një volum prej 6 faqesh nuk përmban shtjellime teorike rreth fushës së frazeologjisë, dhe as shtjellime mbi qasjen metodologjike, siç ndodh rëndom në publikimet bashkëkohore të ditëve të sotme, vihet re se Çabej kishte kriteret e tij të qarta e mirëmenduar, se si do t'i qasej kësaj çështjeje.

Më së shumti ai rendit shprehje të mirëfillta frazeologjike të cilat në respekt të kriterit të besnikërisë ndaj origjinalit dhe për të mundësuar krahasimin për personat e interesuar, mbajnë numrin rendor korrespondues me botimin e Papahagit. Pra *kriteri i parë* i Çabejt është plotësimi i listës së Papahagit me shembj nga gjuha shqipe, kur këta mungojnë në origjinal dhe njëkohësisht shembujt e përzgjedhur janë pothuajse të gjithë shprehje frazeologjike me tiparet tipike si: polileksikaliteti, ngurosja/stabiliteti, idomaticiteti dhe leksikalizimi/riprodhueshmëria.

Vërejmë pra, se megjithëse objekti i studimit nuk përkufizohet shprehimisht, Çabej i njeh mirë këto njësi të veçanta të leksikut të shqipes.

Ndryshe nga Papahagi, Çabej i ri ka si qëllim të hulumtojë prejardhjen e shprehjeve në fjalë, çka përbën *qëllimin e dytë* kryesor të punimit të tij. Në këtë aspekt pasqyrohet qartë formimi i tij i thellë si poliglot, albanolog dhe ballkanolog. Në disa shprehje të shqipes ai e gjen burimin te greqishtja e në rastin e shprehjeve të tjera është i mendimit se pikërisht shqipja ka qenë gjuha dhuruese për greqishten, sidomos në shprehje greqisht shtrirja gjeografike e të cilave kufizohet brenda territorit të Epirit (p.sh. *e ngriti në gjyq*, gjerm. *jn. vor Gericht klagen/verklagen; ishte me barrë/ ishte mbarsë; s' ishte një barrë, por një anë*). Shohim që shkrimi i Çabejt karakterizohet nga skrupuloziteti dhe objektiviteti shkencor dhe jo nga prirje subjektive nacionaliste. Në dy-tre shprehje të tjera ai detekton rumanishten si gjuhë dhuruese (*një her' e mirë – una-bunna*).

Me interes të madh janë gjetjet apo konstatimet e Çabejt në rastin e shprehjeve „shkopi dolli ka Parraisi/il bastone venne dal Paradiso” dhe „gjith njeri“ (secili, çdo njeri), për të cilat ai dëshmon se gjenden dhe janë të ruajtura tek shqiptarët e Italisë (f. 227, 229), pra në dialektin arbëresh. Ky fakt dokumenton kështu ekzistencën e lashtë të këtyre shprehjeve në gjuhën shqipe.

Për hir të kuriozitetit shkencor Çabej nuk nguron edhe të shtrojë hapur pyetje, kur nuk ka informacion për paralelet e mundshme të shprehjeve të caktuara, si p.sh. *me bark në buzë* (për një grua shtatzanë pranë datës së lindjes). Ai pohon në këtë rast, se nuk e di nëse ka shprehje të ngjashme me këtë në gjuhët e tjera të Ballkanit.

Është e qartë se që në moshë të re Eqrem Çabej kishte prirjen dhe dëshirën për t’u bërë orakulli i shqipes në fushën e etimologjisë.

*Së treti* Çabej i shton listës edhe shprehje të tjera në shqip, të cilat janë sinonime me shprehjen frazeologjike të krahasuar me gjuhët e tjera të Ballkanit, pra ai e pasuron listën: ti do kalë jeshil – ti do kallëz në zborë; njeri me perde/njeri pa perde – i plasi dell i ballit – njeri pa cipë – i plasi perdeja. Vihet re se të shprehjet foljore kryesisht jepet forma e vetës së tretë njëjës.

*Së katërti* bie në sy përpjekja e Çabejt për të dhënë sqarime rreth fushës së përdorimit të shprehjeve frazeologjike (*me shami më nj’ anë* – përdoret për të emërtuar koketërinë femërore), pra të dhëna për aspektin stilistikor (*e madhe punë; trim djalë* – përdoren në ligjërimin e theksuar), për përdorimin e drejtë gramatikor, si p.sh. rendi i gjymtyrëve brenda shprehjes, të dhëna për variantet fonetike (*para të thiera/thyera*) etj.

Me seriozitetin që e karakterizonte, profesor Çabej korrigjon edhe ndonjë keqkuptim të autorëve të mëparshëm, sa i takon semantikës së shprehjeve të shqipes (*nga hera* – gjithmonë; e keqkuptuar nga Pedersen si *herët*).

Punimi përfundon pa konkluzione dhe pavarësisht se nuk ofron shtjellime teorike të fushës së frazeologjisë, ka vlera të veçanta, sepse duke marrë parasysh sa më lart, jep praktikisht një model të mirë për trajtimin leksikografik të shprehjeve frazeologjike të shqipes. Është domosdoshmëri dhe praktikë e konsoliduar tashmë që në fjalorët frazeologjikë të jepen me patjetër të dhëna leksikografike si kuptimi i shprehjes, prejardhja apo etimologjia e saj, rastet dhe

fushat e përdorimit, variantet gramatikore dhe leksikore, të dhënat diastratike dhe diatopike e kështu me radhë.

Nga viti 1936 u desh edhe shumë kohë që frazeologjia të kthehej në një disiplinë të veçantë brenda albanologjisë, ku merita për këtë i takon në radhë të parë profesorit të nderuar Jani Thomai, i cili që në fillim të viteve 60` u mor në mënyrë sistematike e metodologjike me hedhjen e themeleve të kësaj shkence.

Edhe pse në vitet e mëpasshme Çabej nuk u fokusua më veçanërisht te frazeologjia, ai në librin e tij “Hyrje në Historinë e Gjuhës Shqipe” (1960) shprehet se „[frazeologjia është] një fushë e afrimit të gjuhëve ballkanike që paraqet interes të veçantë“ dhe se „disa nga frazat ballkanike e kanë burimin në besimet popullore e në përralla“ (po aty) dhe e cilëson kësioj folklorin ballkanik të krahasuar si një „degë me rëndësi të shkencave shoqërore“ (po aty, f. 92).

Me modestinë që e karakterizonte, Çabej ende në vitin 1960 i referohet me përlujë punimit krahasues të Papahagit duke lënë pa përmendur kontributin e tij personal të vitit 1936.

### **Bibliografi:**

Çabej, Eqrem (1936): Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen. Në: Revue internationale des études balkaniques, nr.II, f. 226-331.

Çabej, Eqrem (1960): Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike e shqipes. Universiteti i Prishtinës. Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i krahinës socialiste autonome të Kosovës. Prishtinë.

Fleischer, Wolfgang (1997): Phraseologie der deutschen Gegenwartssprache. 2. durchgesehene und ergänzte Auflage. Tübingen: Niemeyer.

Papahagi, Pericle (1908): Parallele Ausdrücke und Redensarten im Rumänischen, Albanesischen, Neugriechischen und Bulgarischen. Në: Weigand, Gustav (botues): 14. Jahresbericht des Instituts für rumänische Sprache. Rumänisches Seminar zu Leipzig. Leipzig: Barth. f. 113-170

Pilz, Klaus Dieter (1978): Phraseologie. Versuch einer interdisziplinären Abgrenzung, Begriffsbestimmung und Systematisierung unter besonderer Berücksichtigung der deutschen Gegenwartssprache. Göppingen: Kümmerle. (2 vëllime)

Adriatik Derjaj

## NDIHMESAT E EQREM ÇABEJT PËR TURKOLOGJINË SHQIPTARE

Eqrem Çabej vinte nga një familje e kulturuar gjirokastrite, por ai nuk pati lindur në Gjirokastër, siç është thënë rëndom, madje edhe nga ai vetë. Çabej ka lindur në Turqi, në Eskishehir, ku i ati, i diplomuar në Dar-ul-Hukuk të Stambollit për drejtësi<sup>1</sup>, ushtronte asokohe (1908), me sa duket, detyrën e kadiut.

Të bën përshtypje fakti që prof. Shaban Demiraj, në librin kushtuar jetës dhe veprës së gjuhëtarit të madh, nuk e shënon Gjirokastrën si vendlindjen e tij.<sup>2</sup> Po ashtu edhe Nelson Çabej, kushëriri i tij, në artikullin me titull *Kontributi i Eqrem Çabejt në albanologji*, ndonëse e mban si bir të një “dere të parë” gjirokastrite, nuk na thotë se Çabeji kishte lindur në Gjirokastër.<sup>3</sup> Vetë Çabej nuk është mburrur ndonjëherë me këtë rrethanë rastësore të jetëshkrimit të vet, përkundrazi, ai është përpjekur ta mbajë të fshehtë; mbase ngaqë ka dashur t’ia kursejë vetes andrallat me autoritetet shqiptare ose, ndoshta, ngaqë druhej se do t’u dukej më pak shqiptar se ç’ ishte kombëtaristëve tanë të të gjitha kohërave.

Gjithsesi Çabej qëndroi fare pak vite në Gjirokastër. Ai kreu atje vetëm arsimin fillor.<sup>4</sup>

Falë aftësive të tij të veçanta, mori prej Bashkisë së këtij qyteti një bursë për ta vijuar shkollimin jashtë shtetit, në Austri.<sup>5</sup>

Në St. Pölten (në familjen Rienmüller) kreu tetëvjeçaren, në Klagenfurt gjimnazin dhe në Grac e Vjenë, studimet e larta.

Pas mbarimit të studimeve dhe mbrojtjes së tezës së doktoratës me “*Studime italo-shqiptare*” (*Italo-albanische Studien*), kthehet në atdhe.<sup>6</sup>

Në Vjenë gjirokastriti 400-derhemësh pati fatin të ishte student

i albanologut më të madh të kohës, Norbert Jokl-it, dhe të kishte udhëheqës teme një nga helenistët më të mëdhenj të të gjitha kohërave, Paul Kretschmer-in, me të cilët lidhi miqësi të ngushtë, siç mësohet edhe nga letërkëmbimi që kishin mes tyre.

Ende fare i ri, Çabej, me një varg punimesh në fushën e folklorit, etnografisë, mitologjisë dhe historisë së letërsisë shqipe, të cilat u botuan nëpër faqet e revistave të specializuara evropiane, e tregoi veten si një studiues i thellë, i përmasave të mëdha. Janë për t'u përmendur artikujt *Sitten und Gebräuche der Albaner (Tradita dhe doke të shqiptarëve)* (1935); *Rumänisch-albanische Lehnbeziehungen (Marrëdhënie huazimi rumuno-shqiptare)* (1936); *Albaner und Slaven in Süditalien (Shqiptarë dhe sllavë në Italinë e Jugut)* (1938); *Miszellen (Shkrime të ndryshme)* (1938), në "Revue Internationale des études balkaniques"; *Mundartliches aus Italien (Elemente dialektore nga Italia)* (1936) në "Glotta"; *Volkstum und Volksname der Albaner (Karakterit kombëtar dhe emri kombëtar i shqiptarëve)* dhe *Kult und Fortleben der Göttin Diana auf dem Balkan (Kulti dhe mbijetesa e perëndeshës Diana në Ballkan)* (1941) në "Leipziger Vierteljahrsschrift für Südosteuropa"; *Der albanische Dichter Gjergj Fishta* (1941) (*Poeti shqiptar Gjergj Fishta*) në "Südost-Forschungen".

Ai mori pjesë si bashkëpunëtor edhe në hartimin e *Enciklopedisë Kroate (Hrvatska Enciklopedija)* botuar në vitin 1941. Me këto punime Çabej u bë zëri më i dëgjuar, në mos i vetmi, i shkencës shqiptare në Evropë, qysh në vitet '30 të shekullit të kaluar.<sup>7</sup>

Duket se në këtë kohë studiuesi i ri po endej andej-këndeje për ta gjetur veten diku. Në të vërtetë, do të bënim mirë ta kundronim këtë periudhë si fazë përgatitore akumulimi të gjithanshëm që do t'i paraprinte asaj që do të ishte kauza e jetës dhe e veprimtarisë së tij – ndriçimi i historisë së formimit të popullit shqiptar dhe i gjuhës së tij. Me akribinë që e karakterizonte, ai e rrëzoi tezën e Gustav Weigand-it lidhur me prejardhjen e shqiptarëve. Jo më kot, emri i Çabejt u bë, që nga vitet '60 të shekullit të shkuar, sinonimi i autoktonisë së shqiptarëve në Ballkan.

Krahas punës së pandërprerë në fushën e historisë së gjuhës dhe të etimologjisë, në vitet '50 ai u mor edhe me probleme të drejtshkrimit dhe leksikografisë shqipe, duke e lënë shenjën e vet te *Ortografia e gjuhës shqipe* (1951) si bashkautor me Xhuvanin

---

7 Shih Nelson R. Çabej, vep. e cit.

e Cipon, por edhe te *Fjalori i Gjuhës Shqipe* (Tiranë, 1954), ku ai shfaqet si pjesë e grupit që punoi për hartimin e fjalorit. Kësaj periudhe i takojnë, si bashkautor me Aleksandër Xhuvanin, edhe veprat për fjalëformimin e shqipes, *Parashtesat e Gjuhës Shqipe* (1956) dhe *Prapashtesat e Gjuhës Shqipe* (1962).

Është për t'u shënuar se porosia e madhe e Çabejt, dhënë në kuadrin e debateve të ndezura mbi ecurinë e procesit të standardizimit të shqipes (1952), sipas së cilës “në punë të normës ne duhet të ecim me këpucë plumbi”, e nxjerrë nga konteksti dhe duke ia tjetërsuar kuptimin, “u shërben” edhe sot fanatikëve të '72-shtit në përpjekjet e tyre për t'i bërë bisht çdo lloj ndërhyrjeje në standard. Lidhur me këtë problematikë, Çabej do të mbahet mend edhe për aksiomën: “të shkruarit në dy variante të ndryshme dialektore nuk duhet parë si fatkeqësi, por si *diversité dans l'unité*.”

Pjesë e rëndësishme e punës së tij përgatitore për studimet në fushën e etimologjisë së shqipes ishte dhe transkriptimi e transliterimi i *Mesharit* të Gjon Buzukut, që mund të konsiderohet si punimi më i rëndësishëm filologjik i tij, të cilin e përfundoi që më 1958, por që për shkak të mangësive tona, me karakter teknik të asaj kohe, do të botohej dhjetë vjet më vonë, më 1968, në Bukuresht.

Botimi është pajisur me një hyrje dhe me një studim kritik, thellësisht shkencor, për gjuhën dhe vlerat e librit dhe të autorit. Ky studim për historinë dhe dialektologjinë e shqipes do t'i shërbente atij si pikë referimi në përpjekjet për rindërtimin e formave më të hershme të fjalëve shqipe<sup>8</sup>. Sa për kronikë po themi që një fat aspak më i mirë do ta priste edhe *Atlasin Dialektologjik të Gjuhës Shqipe* (ADGJSH), puna për hartimin e të cilit kishte mbaruar që në fund të viteve '80, por që për të njëjtat arsye, u botua në Napoli në vitet 2007-2008. E meqë jemi këtu lipset të themi se Çabej është edhe autori i të parit pyetësor dialektologjik, me të vërtetë shkencor, për gjuhën shqipe, të hartuar nga një shqiptar – *Atlante linguistico* (1943).

Në vitet '60 ai nisi botimin e një serie të gjatë artikujsh te Buletini i Universitetit Shtetëror të Tiranës (Seria Shkencat Shoqërore), të cilët dolën edhe në dy vëllimet e para të veprës së tij 6-vëllimshe *Studime Gjuhësore*, botuar në Prishtinë, në vitin 1976.

Çabej hyri në studimin e historisë së gjuhës shqipe në një kohë kur ishte sqaruar se gjuha shqipe ishte pjesëtare e familjes së madhe

---

8 Shih Nelson R. Çabej, vep. e cit.

të gjuhëve indoevropiane, por ende mbeteshin jo pak probleme për t'u zgjidhur, si:

1) Saktësimi i fondit themelor të trashëguar indoevropian të shqipes dhe raporti i tij me huazimet nga gjuhët e huaja, latinisht, turqisht, sllavisht e greqisht.

2) Prejardhja e gjuhës shqipe dhe, lidhur me të, lidhja e shqipes me ilirishten dhe trako-dakishten.

3) Koha e formimit të dy dialekteve të mëdha të shqipes.

4) Vendi i formimit të gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar.

5) Kontributi i ilirishtes në gjuhët latine dhe greke.

Në të gjitha këto drejtime ai dha ndihmesat e tij të shënuara dhe, në shumë raste, vendimtare.<sup>9</sup>

Në punën e tij për etimologjinë e fjalëve shqip dhe rindërtimin e formave të mëparshme të tyre, Çabej zbatoi jo vetëm metodën e krahasimit me kognatet (fjalët e ngjashme dhe me prejardhje të përbashkët) me gjuhët e tjera indoevropiane, por e plotësonte atë me metodën e rindërtimit të brendshëm, nëpërmjet krahasimit të formave të ndryshme brenda shqipes.<sup>10</sup>

Ndryshe nga shumë gjuhëtarë të mëparshëm, ai udhëhiqej nga parimi që më parë duhej të hetohej nëse fjala mund të shpjegohej brenda shqipes dhe me mjetet e saj. Vetëm kur të provohej se kjo nuk të shpie te burimi, mund të shihej nëse ajo ishte huazuar nga gjuhë të tjera fqinje, latine, sllave, greke, turke etj.

Për Çabejn, në qoftë se një fjalë mund të shpjegohej po aq mirë edhe si fjalë e trashëguar e shqipes, edhe si huazim nga një gjuhë tjetër, parimi shkencor i parsimonisë na tregon se duhet parapëlqyer shpjegimi i parë, si një fjalë e trashëguar e shqipes.<sup>11</sup>

Eqrem Çabejt i takon merita e madhe e plotësimit të zbrazëtisë që kishte lënë mungesa e shqipes në studimet e gjuhësisë ballkanike. Më shumë se kushdo tjetër, ai bëri të njohur rolin dhënës të shqipes në këto gjuhë.

Meritë e pamohueshme e Çabejt në fushën e gjuhësisë historike shqipe është fakti që me njohuritë e tij të thella në historinë e gjuhës dhe me punën e tij vetmohuese, ai vërtetoi karakterin e trashëguar të disa qindra fjalëve nga fondi themelor i shqipes, të cilat ishin lënë pa

9 Shih Nelson R. Çabej, vep. e cit.

10 Shih Nelson R. Çabej, vep. e cit.

11 Shih Nelson R. Çabej, vep. e cit.



shpjegim ose qenë trajtuar si huazime të sajat nga gjuhët me të cilat ka qenë në kontakt, prej albanologëve të huaj.<sup>12</sup> Por, nga ana tjetër, “në dallim parimor nga disa të tjera rryma linguistike, jemi larg nga synimi për t’i veshur fondit të trashëguar [fjalë që nuk i takojnë atij], për të shtuar me çdo kusht përqindjen e elementit të trashëguar të leksikut; kështu, edhe për disa fjalë që i kanë marrë më parë për të vendit, kemi treguar burimin e huaj”<sup>13</sup>.

Ndihmesat e Çabejt i prekin të gjitha fushat e albanologjisë, që nga historia e gjuhës shqipe, gramatika, leksikografia, morfologjia e saj e deri te folklori, mitologjia dhe letërsia fetare dhe artistike shqiptare. Por, pa dyshim, vepra e tij e jetës është seria 7-vëllimshë *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, e botuar në Tiranë, duke nisur që nga viti 1982 deri në vitin 2006, kurorëzimi i punës së tij gjithjetësore në fushën e historisë së fjalës e të gjuhës shqipe. Për nga niveli, vëllimi dhe rëndësia shkencore, ajo përfaqëson korpusin më të madh e më të rëndësishëm që është krijuar deri sot në historinë treshkulllore të shkencave albanologjike.<sup>14</sup>

Jashtë vëmendjes së Çabejt nuk mund të mbeteshin as turqizmat e shqipes. Duke u mbështetur në të dhënat që japin sidomos të folmet e arbëreshëve të Italisë dhe veprat e autorëve më të vjetër të letërsisë shqipe, ai bëri një shtresëzim kronologjik të huazimeve nga gjuha turke në gjuhën shqipe. Kështu mundi të veçojë turqizmat që kishin hyrë në shqipe para shpërnguljeve të mëdha të arbërve në gadishullin Apenin dhe para botimit të veprave të shkrimtarëve tanë veriorë. Si shtresën më të vjetër të turqizmave në shqipe, Çabej mban *beg/bej*, *daulle*, *dufek*, *duf*, *fital*, *gajtan*, *nerënxë*, *pexher*, *tel etj.*, të cilat hasen edhe tek arbëreshët e Italisë.<sup>15</sup>

Ai vuri re, gjithashtu, se turqizmat ndeshen edhe tek 4 B-të e mëdha të kulturës sonë që ishin priftërinj katolikë dhe jetuan e punuan në treva që i takonin këtij besimi.<sup>16</sup> Nisur nga lënda që mori në shqyrtim, Çabej arriti në përfundimin se ndikimi më i madh i gjuhës turke mbi shqipen vërehet në “gjërat” që kanë të bëjnë me jetën e qytetit dhe është më i vogël, ndonëse nuk mungon krejt,

---

12 Shih Nelson R. Çabej, vep. e cit.

13 Shih Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. I, Tiranë, 1982, f. 45.

14 Shih Nelson R. Çabej, vep. e cit.

15 Shih Shaban Demiraj, vep. e cit., f. 71.

16 Shih Shaban Demiraj, vep. e cit., f. 71.

tek ato që lidhen me botën e fshatit. Nga ana tjetër, Çabej dha një ndihmesë të çmuar edhe për identifikimin e mjaft turqizmeve, por edhe për aklimatizimin e tyre fono-morfologjik e semantik në shqipe.

Në kuadër të punës për prapashtesat e shqipes, ai inventarizoi edhe prapashtesat turke në shqipe dhe vuri re se ato kanë hyrë në gjuhën tonë bashkë me fjalët e ardhura nga turqishtja, si dhe që përgjithësisht përdoren në huazimet turke të shqipes, si p.sh. *merak-li, namus-li, aga-llëk, araba-xhi, kurbet-çi*; megjithse ndonjë syresh bashkohet edhe me fjalë të burimit joturk, si p.sh. *vend-çe, fshat-çe, lab-çe*. Po ashtu, Çabej vuri re se në raport me turqishten shqipja nuk është vetëm një gjuhë marrëse; ajo sillet hera-herës edhe si gjuhë dhënëse. Për Çabejn i tillë është rasti i fjalës shqipe *lug* që i ka kaluar turqishtes, me sa duket me të njëjtin kuptim, për t'iu kthyer sërish gjuhës shqipe si *ulluk*.

Rolin e shqipes si gjuhë dhënëse, Çabej e kishte vërejtur edhe në raport me gjuhët e sllavëve të Jugut, greqishten dhe rumanishten.

## Bibliografia

Shaban Demiraj, *Eqrem Çabej (një jetë kushtuar shkencës)*, Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1990.

Nelson R. Çabej, *Kontributi i Eqrem Çabejt në albanologji*, botuar nga Klan Kosova, 2016.

Eqrem Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes*, vëll. I, Tiranë, 1982.

Umberto Eko, *Si bëhet një punim diplome*, Botime Përpjekja, Tiranë, 1997.

Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistikë e shqipes*, Shtëpia Botuese “Morava”, Tiranë, 2009.

Luçia Çezarini Martineli, *Filologjia*, Medaur, Tiranë, 2002.

Evalda Paci

## **PREMISA TË NJË BOTIMI TIPIK KRITIK E FILOLOGJIK NË PARASHTRESAT STUDIMORE TË EQREM ÇABEJT**

Para ftesës për të nderuar studiuesin e vyer, të çmuar në kuptimin e mirëfilltë të fjalës dhe të dashur për arsye të orientimeve largpamëse që ka ofruar për jo pak breza, nuk ishte e lehtë të zgjidhje në pikëpamje të dimensioneve që Eqrem Çabej përftoi çdo herë që iu kushtua studimeve mbi gjenezën e literaturës sonë, mbi topose të konfigurimit të tipareve qenësore mes popullsisë të Ballkanit dhe botës italike, mbi elementet latine të gjuhës shqipe, mbi studimet etimologjike në fushë të shqipes, por dhe mbi tekstet e vjetra shqipe, duke qenë se këto të fundit i ka parë në disa vështrime. Në një kohë të afërt me përmbylljen e disa trajtesave mbi librin e parë të njohur deri më sot në traditën e studimeve mbi historinë e shkrimit shqip, Eqrem Çabej përmbloodhi një sërë pikëpamjesh në një shkrim tematik të botuar në fund të viteve '50 të shekullit të kaluar, duke e introduktuar atë me një panoramë të gjerë analitike mbi arealet e përndarjes së dokumentimit shkrimor të gjuhës sonë, shoqëruar dhe me përveçimin e traditave që kanë qenë ndikuese dhe në lidhje me këto të fundit.<sup>1</sup> Në të vërtetë, një konsiderim gjeokulturor i një hapësire që do të kishte dhe nëndarje të shpjegueshme me disa faktorë përbën një premisë të domosdoshme dhe kur duhet të trajtohet qoftë dhe në mënyrë të përgjithshme një platformë e evidentimit, si dhe e metodologjisë së botimit të teksteve të mëhershme në një gjuhë të caktuar. Çabej rinënvizon, por në të vërtetë shtron si të domosdoshme

---

<sup>1</sup> Çabej, E. (1959) Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre, në BUSHT, n.2.

çështjen e paravendosjes dhe të disponimit të kriterëve të mirëfillta të botimit të teksteve, që për studimet tona ishin e janë themelore, në veçanti nëse bëhet fjalë për të përcaktuar kufij kohorë të një dëshmimi shkrimor që ka një domethënie të përveçme për çdo disiplinë të orientimit historik e diakronik.

Në gjysmën e parë të shekullit të kaluar ishin botuar dhe shkrime domethënëse në fushë të studimit të teksteve të mëhershme dhe në kontekste të tjera, ndër të cilat spikasin kontributet e filologut frëng Mario Roques (1875-1961), tashmë një figurë akademike me një profil të qartë dhe njëherësh shumëdimensional, në kuptimin e shtrirjes së vëmendjes së tij ndaj disa disiplinave. Në rrugëtimin e tij të gjatë shkencor, qoftë dhe kur ndërmerre të analizonte tërësinë e kontributeve të institucioneve shkencore akademike franceze në disiplina si epigrafia, paleografia, papirologjia, arkeologjia dhe historiku i monumenteve, filologjia dhe studimi i teksteve zinin një vend të rëndësishëm, duke u reflektuar në hapësirën që i përkiste në compte-rendus që dhe sot e kësaj dite janë një model i analizës së mirëfilltë të veprimtarisë shkencore institucionale. Emri dhe pikëpamjet e këtij filologu, të interesuar ndjeshëm dhe ndaj çështjeve të gjurmimit të teksteve të vjetra shqipe, do të jenë të pranishme dhe të konsideruara dhe në trajtesat e Eqrem Çabejt mbi historikun dhe aspektet më specifike të hulumtimit të përmbajtjes, por dhe të sistemit grafematik, që pikërisht në këtë vepër shfaqet në një veçanësi të shpjgueshme me disa arsye.<sup>2</sup> Ndërkohë, vetë Roques, në shkrime tematike mbi librat e orëve të shekullit XVI e me një përkatësi të qartë ndaj traditës së shkrimeve të shenjta në gjuhë sllave, orienton dhe studiuesit e kërkuesit e kohës të kenë referencë dhe të dhënat që burojnë nga dëshmitë më të hershme shkrimore në gjuhën tonë, si për arsye të afërsisë në kohë, ashtu dhe për praninë në tekstet përkatëse të shenjave grafematike që përbëjnë diversitet në krahasim me shkronjat latine që përdorshin më së shumti në

---

2 Shih në veçanti Çabej, E. (1968) Personaliteti i autorit në dritën e veprës, në Meshari, Hyrje, kreu II, botim kritik, Tiranë, f.33: M.Roques ka vënë në dukje ndikimet e Venetikut në formimin e këtij shkrimtari e në veprën e tij, dhe më lart u fol për gjurmët veneciane në këtë. Pa qenë vendi këtu të rroket as kjo çështje në tërësi, për rëndësinë që ka do të preket sado shkurt që të jetë. Sepse me punën e gjurmëve të dialektit të Venetikut lidhet një vlerësim më i drejtë i librit dhe problemi i vendit të botimit të tij, si dhe disa çështje të transkribimit; lidhen edhe disa pyetje që i përkasin biografisë së autorit dhe orientimit të tij kulturor.

arsenalin e tipografive të arealit italic të asaj kohe.<sup>3</sup>

Sa herë shtrohet çështja e referencialitetit të teksteve që përmbahen në librin e Gjon Buzukut, natyrshëm vëmendja zhvendoset ndaj një botimi orientues, që ndër të tjera ofron dhe modelin e një shkolle filologjie në pikëpamje parimesh e kriteresh. Shkrime të një natyre të qartë analitike, me vëmendje ndaj sfidave kryesore me të cilat përballej dhe disa dekada më parë gjuhëtari, studiuesi i teksteve dhe i letërsisë së shkruar, i materialeve të pashtypura apo i atyre të mbledhura në rrugë gojore, janë dhe njëfarë reflektimi i pikëpamjeve që një hulumtues si Eqrem Çabej mbas një peshimi të arsyetuar shtjellonte për bashkëkohësit, por dhe për gjeneratat mbasardhëse.

Ndër të tjera, siç edhe është reflektuar në studime paraardhëse mbi çështje të dokumentimit shkrimor të gjuhës sonë dhe trashëgimisë përkatëse të disponueshme deri më sot, vetë ubikimi i kësaj të fundit dhe mundësia e hulumtimit të drejtpërdrejtë të burimeve përkatëse ka qenë deri vonë një problem i pazgjidhur dhe në këtë vështrim marrim në konsideratë dhe vetë përpjekjet e studiuesve të fushave të përafërta të studimit, që deri disa dekada më parë, kishin më të ndërlikuar përafrimin me një dokumentacion ad hoc, siç janë dhe ato që lidhen me aktet përkatëse mbi libra të ndaluar apo të bërë objekt rishikimi nga censura e disa shekujve më parë.

Që me shfaqjen e shkrimeve të para mbi çështje të historisë së gjuhës e të literaturës sonë, Eqrem Çabej diti të ndërthurte dimensione të njohjes në themel të problemeve me domosdoshmërinë e thellimit të kësaj të fundit në të mirë të disa disiplinave. Sa i thellë në trajtimin e çështjeve mbi të cilat ndërtohen linjat themelore për fonetikën historike, gjuhësinë e krahasuar dhe atë i.e., po aq i kujdesshëm studiuesi ynë u shfaq në qëmtimin e tipareve që shpian natyrshëm në reflektime mbi prirje të përbashkëta e elemente qenësore të një bote të hershme, që ka lënë gjurmë në materiale epigrafike, monumete funerare të lashtësisë, por dhe në vetë mendësinë e popullsisë që i trashëgojnë këto të fundit. Ndër të tjera, konsiderimi në pikëpamje rëndësie i ekzemplarëve më të hershëm të shkruar në gjuhën shqipe, të ekspozuar ndaj një përafrimi metodologjik në çështje kriteresh

---

3 Roques, M. (1932) Deux livres d'heures du XVI<sup>e</sup> siècle en cyrillique bosniaque, në *Revue des études slaves*, v.12, n. 1-2,, f. 49-69.

të leximit, brendësismit, por dhe interpretimit në disa vështrime përbën një prej sfidave që prej studiuesit tonë u rrok në kohën e duhur dhe me një vëmendje që do të reflektohet në studimet hyrëse të zgjeruara me analiza mbi tipare gjuhësore që qëmtohen në tekste, mbi kontekstin kulturor që pasqyrohet që në elementet ikonografike të konfigurimit libror, mbi kontributet e deriatëhershme mbi çështje të njohjes së historishkrimit të shqipes në një traditë gjurmimesh evropiane e ballkanike. Studimi i gjerë që do të introdukojë vëllimin e parë të njohur si variant i transliterimit të teksteve të librit të Gjon Buzukut do të përbëjë në mënyrë decizive një traktat të mirëfilltë të shtjellimit të një pasqyre njohëse e analitike mbi identitetin e autorit, interpretuar më shumë mbi bazë të brendisë së veprës, në mungesë të dhënash biografike aq të nevojshme dhe në këtë rasë, në kushtet e kërkimit të një skenari më konkret mbi realizimin e një ekzemplari të rrallë, emërtuar që në vitet '30 si libër orësh e meshar.<sup>4</sup>

E trajtuar në shkallën e rëndësisë që natyrshëm zë në një kuadër analitik mbi një libër të tillë, çështja e modelit a e modeleve që përpiluesi duhet të ketë pasur burim referencial është shtjelluar në sythe të caktuara të parathënies me të cilën pajiset botimi kritik e filologjik që sheh dritën e shtypit në vitin 1968.

I kujdesshëm në faktin që mes shembujsh e krahasimesh me disa tekste mund të arrihet në konstatime mbi ndërtime në gjuhën e përpiluesit dhe mbi ndikimet e mundshme në këtë të fundit, Çabej ofron një panoramë të gjerë sinoptike, duke bërë të mundur të vihen pranë njëri-tjetrit shembuj përdorimi që shpien te vetë teksti përkatës në gjuhën shqipe. Konteksti i konfigurimit të një vepre të tillë, me gjasë jo fort fatlume për nga mundësia e vënies në praktikë mbas përfundimit të punimeve të Koncilit të Trentit (1545-1563) nënvizohet jo rrallë nga studiuesi ynë e jo vetëm thjesht për konstatim. Nëse ka një botim në studimet tona në të cilin do të mund të gjinden të ndërthurura dhe të peshuara në masën e duhur elementet e një historiku kompleks dhe të ndikuar nga zhvillime specifike, si dhe hulumtimet në disa nënsisteme themelore të ndërtimeve gjuhësore, është pikërisht botimi i vitit 1968, i artikulluar në dy vëllime, i pasur në shënime dhe në orientime ndaj një pasurie të tërë burimesh referenciale, të domosdoshme kur ndërmerren analiza të tekstit dhe

---

<sup>4</sup> Roques, M. (1932) Recherches sur les anciens textes albanais, Paris, f.10.

të brendisë së tij.<sup>5</sup>

Një kontekst i tillë do të përbënte dhe përgjigjen për shumë pyetje dhe hipoteza që rridhnin nga mosdisponimi i një ubikimi të qartë të vendit e të identifikimit të vetë tipografit që mbështetës i daljes në dritë të shtypit të një libri të tillë, që për nga përmbajtja orienton ndaj qasjesh me disa modele librare, duke filluar nga librat e orëve dhe më tej, me të tjerë libra, më të rëndësishëm për nga referencialiteti kanonik.

Ndër të tjera, tekste si psalmet e pendesës përbëjnë dhe një objekt për të konstatuar vështirësinë e qartë për të përshtatur të njëjtat tekste në përbërje të një meshari, e në lidhje me këto të fundit shënimet përkatëse nga ana e studiuesit tonë në pjesën e dytë të botimit kritik të sipërcituar e rinëvizojnë këtë çështje. Duhet thënë dhe këtu që të tilla tekste vënë në provë kompetencën e përpiluesit dhe të vetë shqipëruetit, duke qenë në mes dhe çështja e burimit referencial parësor.

Për sa mbetet themelore të njohim e të orientohemi ndaj ekzemplarëve të veprave të letërsisë së vjetër shqipe, të dëshmuara në ekzistencën e tyre në biblioteka të rëndësishme të botës kulturore evropiane, po aq thelbësor paraqitet dhe përafrimi me tekstet përkatëse mbi bazë botimesh që të realizuara mbi kritere të përcaktuara qartë, lehtësojnë receptimin e brendisë duke qenë dhe besnike ndaj aspekteve grafematike e fonetike. Përcaktimi i ndikimeve në gjuhën e autorit, duke marrë parasysh dhe aspekte të formimit të tij më të hershëm ose gjurmë të ngulitjes së hershme të ndërtimeve të caktuara orienton dhe në zgjidhjet apo vlerat grafike që filologu u jep shenjave të përveçme, jo gjithnjë lineare dhe kur bëhet fjalë për librin e Gjon Buzukut.

Për këdo që ka nevojën t'i rikthehet një pasqyre të mirëfilltë të arritjeve të studiuesve në lidhje me shkrimet e vjetra shqipe, me disponimin e të dhënave mbi vendndodhjen e ekzemplarëve, apo ribotimet e mundshme, apo dhe me vetë historikun përkatës në rasë veprash më të veçanta, do të gjejë te studiuesi ynë më të mirin burim gjetjesh që kanë të bëjnë me vetë veprat përfaqësuese të letërsisë së vjetër shqipe, e trajtuar në mjaft studime tematike dhe gjatë

---

5 Çabej, E. (1968) Meshari i Gjon Buzukut (1555), botim kritik punuar nga Eqrem Çabej, Pjesa e parë (hyrje dhe transliterim); Pjesa e dytë (transkribim), Tiranë.

viteve '50, pikërisht kur do të dilte në dritë të shtypit dhe një botim i tematizuar mbi historinë e letërsisë shqipe, me krerë të përcaktuar në të cilët kjo letërsi dhe prurjet që lidhen me të kishte një hapësirë e një sërë sythesh të veçanta.

Qasjet krahasuese mes punimeve të kësaj periudhe mund të jenë dëshmi e interesit të shfaqur si ndaj vetë dëshmimeve të shkrimit shqip, ashtu dhe ndaj vetë problematikave që paraqiste nevoja e një historie të letërsisë së shkruar shqipe, të kushtëzuara si nga çështje të njohjes së teksteve të caktuara, ashtu dhe nga vetë kontekstualizimi i tyre në punime të një formati kolegjal, evidentues e gjithëpërfshirës të kësaj të fundit. Konsiderimet e arsytuara në përbërje të parathënies të cituar dhe në këtë trajtesë tonën kanë pjesë të vetën dhe kontekstualizimin e realizimit të librit të Gjon Buzukut në një kuadër të zhvillimit të teknologjisë së shtypshkrimit dhe veçorive përkatëse në areale në të cilat njohjet dhe kompetencat e shtypësve (stampatorëve) duhen marrë në vlerësim e në njëfarë evidentimi, për të ndarë çka është e teknografit nga ajo që mund të jetë e autorit. Kësaj çështjeje, me rëndësi në rasë të përvijimit në pikëpamje profili që një vepër mbart në kushte mungese të disa elementeve të domosdoshme për ta përfaqësuar, studiuesi ynë i ka dhënë peshën dhe vendin e duhur, duke e bërë të dallueshme dhe nga të tjera argumente, që radhiten natyrshëm kur bëhet fjalë për ta pasur më të plotë historikun e kësaj të fundit. Në të tilla vepra gabimet e shtypit kanë një rol dhe në evidentimin e profilit të shtypësve dhe të vetë përkatësisë së tyre. Në të mirë të mbështetjes së tezës që kjo e fundit duhet të jetë shtypur në Venedik, Çabej rendit dhe disa prej këtyre gabimeve, duke i dalluar në çdo rasë prej lapsuseve që i duhen atribuar përpiluesit apo përgatitësit të saj për botim.<sup>6</sup>

Eqrem Çabej rishtron me të drejtë nevojën e përdorimit efikas në funksion studimor të materialeve në format dorëshkrimi, ashtu siç parashtron në një perspektivë aktualiteti dhe domosdoshmërinë e disponimit të botimeve të mirëfillta kritike të veprave të letërsisë

---

6 Në librin e Gjon Buzukut ka tekste në të cilat trajta të caktuara mund të rimerren me modifikime të ndjeshme, por ka dhe pjesë që të përsëritura në pasazhe të ndryshme të tij, të reflektojnë përdorime jo të njëjta në pikëpamje përvëçimesh apo emërtime. Ky fakt, i trajtuar dhe në studime tematike mbi veprën e sipërcituar, jo vetëm rikthen vëmendjen ndaj faktit që përpiluesi dispononte më se një tekst referencial për pjesë të caktuara, por rishtron dhe rikonceptimin e autorësisë së saj në kuptimin e mirëfilltë fjalës.



së vjetër shqipe, të cilat ishin botuar më se një herë në disa rasa, ose përmendeshin për ekzemplarët e kopjet përkatëse në regestet e bibliotekave më të rëndësishme evropiane.

Çështja e modeleve të konsultuara apo dhe e njohurive gjuhësore që reflektohen në tekstet e kësaj vepre lidhet natyrshëm dhe me atë të autorësisë e të mundësisë që pjesë të veprës të jenë parë me vëmendje në faza të caktuara të përgatitjes për shtyp.<sup>7</sup>

Në botimin kritik e filologjik të veprës së vitit 1555, cilësuar shpesh dhe në lidhje me emrin e klerikut që shfaqet në pasthënien e saj, tekstet përbërëse janë në të vërtetë një burim i pasur në kuptimin e vjeljes së të dhënave mbi një sërë çështjesh që ndërtojnë me sa mund të disponohet deri më sot vetë historikun e saj.

Edhe pse të ndryshme për nga vendi që zënë në funksion të kreyt punës së Çabejt me këto tekste, transliterimi e transkribimi janë pjesë të një njësie, të plotësuar më së miri si nga burimet kishtarë (pjesët nga Besëlidhja e Vjetër, nga Besëlidhja e Re), ashtu dhe nga vërejtjet që studiuesi ynë do t'i vendoste në introduktim të kësaj pune madhore, të vijuar më tej dhe në vëllimet që përbëjnë studimet etimologjike të shqipes. Qëmtohet një harmonizim i natyrshëm mes trajtesave të studiuesit tonë, që u ka kushtuar vëmendje dhe ka shtjelluar me mjaft përgjegjësi një sërë çështjesh që siç u tha më sipër, cekin argumente qenësore në kufij disiplinash themelore të dijes, duke lënë të hapur një perspektivë të qartë hulumtimi për pasardhësit.

Saktësimet e gjetjes së teksteve biblike që renditen në libër, po që në një pjesë të mirë të rasteve nuk evidentohen siç do të duhej prej përpiluesit, janë një tjetër linjë e thellimit të ndihmesës së tij që të tilla fragmente, të rëndësishme dhe për nga përkatësia në libra të caktuar biblike, të gjurmohen dhe për arsye krahasimi në burimin e duhur.<sup>8</sup>

Në sfidat që po kalojnë dija mbi albanologjinë dhe kërkimi përkatës shkencor, paqartësitë në lidhje me orientimet që janë të

---

7 Ndër të tjera, vetë zgjedhjet e autorit a përpiluesit për të reflektuar me shkronja të caktuara fonema që ndeshen jo gjithnjë në të njëjtin pozicion në fjalë të ndryshme janë dëshmuese të një kompetence që nuk është e lehtë të gjykohej në kushtet e vështirësive objektive në proces të kësaj përgatitjeje.

8 Do të duhet të nënvizonim dhe në rasë të parashtrimit të një trajtese të tillë që Eqrem Çabej ka mbajtur mbi supë dhe përgjegjësinë e njohjes së brezave me peshën e rolit me të cilin vishej kushdo që në ato vite merrej me lëndën gjuhësore e burimore të një trashëgimie komplekse, e cila dhe në vijimësi mbart gjurmë të rëndësishme identitare për të gjithë ne.

nevojshme për të gjithë ne, me forcimin e paarsyeshëm të prirjeve për të thjeshtëzuar çdo gjë që në parim duhet mbështetur në metodë e gjykime të matura, organizimi i një veprimtarie shkencore ad hoc, me objekt hulumtimin e një aspekti qenësor në rrugëtimin e një personaliteti si Eqrem Çabej është një dritë shprese në një atmosferë që mund të ishte pas gjase shumë më shpresëdhënëse se sa paraqitet.

Të tregosh nderim e njohje të vetëdijshme të një kontributi të pamatë që reflektohet në botime tematike, artikuj të veçantë për nga përmbajtja, trajtesa që janë kthyer në referime themelore për disiplina të veçanta të studimeve gjuhësore, është dhe përmbushje e një detyre të përhershme, që studiuesit të albanologjisë i përket në përditshmëri.

## **BIBLIOGRAFI**

Demiraj B. (2008) *Dictionarium latino-epiroticum* (Romæ, 1635), per R.D. Franciscum Blanchum, Botime Françeskane, Shkodër.

Demiraj B.(2017) *Areali kulturor i Veriut në shek.XVI-XIX*, Botime Onufri, Tiranë.

Camaj, M. (1960) *Il « Messale » di Gjon Buzuku, contributi linguistici allo studio della genesi*, Shêjzat, Romë.

Çabej, E.(1959) *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT, n.2.

Çabej, E.(1966) *Pjetër Budi dhe gjuha e tij*, në *Studime filologjike*, n.4.

Çabej, E.(2006) *Studime etimologjike në fushë të shqipes VII (S-ZH)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Çabej, E.(2006) *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, Botime Çabej, Tiranë.

Paci, E.(2017) *Studime mbi tekstet e vjetra shqipe*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë.

Paci, E.(2020) *Gjurmime mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe (përmbledhje studimesh filologjike dhe tekstologjike)*, Botime Françeskane, Shkodër.

Paci, E.(2021) *Letërsia e vjetër shqipe, një periudhë me rëndësi për historinë e studimeve tona letrare*, në *Hylli i Dritës*, n.1.

Roques, M.(1926) *Le plus ancien document de la langue albanaise*, në *Romania*, v.52, n.205-206.

Roques, M.(1932) *Deux livres d'heures du XVIe siècle en cyrillique bosniaque*, në *Revue des études slaves*, v.12, n. 1-2.

Roques, M.(1932) *Recherches sur les anciens textes albanais*,

Librairie orientaliste P.Geuthner, Paris.

Roques, M.(1932) Le dictionnaire albanais de 1635, Paris, Librairie orientaliste Paul Geuthner.

Shuteriqi, Dh.(2005) Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë.

Zamputi, I.(1995) Çështje të shkrimit dhe të fillimit të letërsisë në gjuhën shqipe, në Hylli i Dritës, n.1-2.

Irda Dervishi

## **PERSONALITETI I EQREM ÇABEJT NË VEPRËN E SHABAN DEMIRAJT ‘EQREM ÇABEJ, NJË JETË KUSHTUAR SHKENCËS’**

Në veprën e Shaban Demirajt “Eqrem Çabej, një jetë kushtuar shkencës”, shpërfaqet figura e plotë e këtij gjuhëtari dhe filologu, i cili mori një formim gjuhësor e kulturor në një mjedis evropian dhe la një trashëgimi shkencore të vyer në studimin e gjuhës shqipe në disa rrafshë, duke dhënë kështu një ndihmesë në zhvillimin e shkencës gjuhësore shqiptare.

Që në moshë të vogël ai largohet nga Shqipëria për të qëndruar në një familje austriake e cila e ndihmoi shumë në mësimin e gjermanishtes por edhe në mbrytjen me një kulturë evropiane. Pas përfundimit të gjimnazit me rezultate të shkëlqyera, Çabej regjistrohet në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Gracit, në të cilin studioi për dy semestra (1927-1928), mandej vazhdoi studimet në Universitetin e Vjenës, ku u njoh me studiues, profesorë dhe indoevropianistë të shquar. Gjatë kohës së studimeve por edhe më pas, Çabej mbajti lidhje me N. Joklin, një albanolog që ka hartuar disa vepra për etimologjinë e gjuhës shqipe, duke dhënë kështu një kontribut të çmuar për historinë e saj. Në këtë Universitet, në vitin 1933, ai merr edhe gradën *doktor*, me një disertacion që trajtonte temën e studimeve italo-shqiptare, me vlerësimin “shkëlqyeshëm”, i dhënë nga tre profesorët më në zë të këtij universiteti: prof. dr. P. Kreçmer, prof. dr. N. Jokli dhe prof. dr. L. Paçi. Nisur nga rezultatet e larta, Çabejt iu propozua që të ishte asistent i N. Joklit në Universitetin e Vjenës, por ai zgjodhi që të kthehej në Shqipëri.

Pas kthimit në vendlindje ai ndeshet me disa vështirësi që vinin qoftë nga gjendja shëndetësore, qoftë nga postet profesionale të ndryshme që iu dhanë për të ushtruar, disa prej të cilave ishin në pozicione drejtuese, që ai nuk i pranoi. E. Çabej thotë: “Kam hedhur poshtë çdo propozim për bashkëpunim me të huajin, çdo gjë që nuk pajtohej me nderin tim si shqiptar dhe me të mirën e vendit dhe të popullit”<sup>1</sup>. I kudondodhur, ka shfaqur gjithmonë interes për studimet gjuhësore, por kushtet politike të viteve ’40 ndikuan që ai të largohej përsëri drejt Romës dhe të rikthehej në atdhe pas çlirimit të vendit.

Historiku i zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipërinë e asaj kohe nuk ishte fort i pasur. Ai merr një rrjedhë tjetër me themelimin e Universitetit të Tiranës në vitin 1957 dhe me kontributin e çmuar të Çabejt dhe të disa figurave të tjera të shquara në fushën e pedagogjisë, të cilët dhanë ndihmesën e tyre në formësimin dhe përsosjen e sistemit të arsimit të lartë në atë periudhë. Si pedagog në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Çabej zhvilloi lëndët *Linguistikë, Albanologji, Hyrje në historinë e gjuhës shqipe* dhe *Fonetikë e shqipes*, tekste pedagogjike të cilat janë përdorur për një kohë të gjatë në fushën e mësimdhënies. Për shumë kohë ai ka qenë punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Sh. Demiraj pohon se prodhimtaria e dënuar shkencore e Çabejt mund të ndahet në dy faza kryesore: Faza deri në prag të Çlirimit të Shqipërisë prej pushtuesve të huaj dhe faza e dytë nis pas vitit 1945.<sup>2</sup> Gjatë kësaj kohëzgjatjeje, jeta shkencore e tij paraqitet mjaft e pasur me studime në rrafshin historik, në fushën e etimologjisë, fonetikës dhe gramatikës historike, dialektologjisë, prejardhjes së gjuhës shqipe, po aq sa edhe në folklor, etnografi e në histori të letërsisë. Po ashtu, vlen të përmendet edhe puna që ai ka bërë me gjuhëtarë të tjerë për realizimin e disa veprave të rëndësishme, siç është bashkëpunimi me A. Xhuvanin, sikundër edhe me pjesëtarë të grupit të punës për hartimin e *Fjalorit serbo-kroatisht-shqip* (1947).

Sipas Sh. Demirajt, nisur nga diskutimet mes gjuhëtarësh, studiuesish vendas e të huaj për prejardhjen e gjuhës shqipe, Çabej nisi sqarimin e disa çështjeve veçanërisht të rëndësishme për historinë e saj. Në fund të shek. XIX mes shkencëtarëve të

1 Demiraj, Shaban (1990): Eqrem Çabej: një jetë kushtuar shkencës. Tiranë, f. 27.

2 Po aty. f. 30.

gjuhës qarkullonin dy teza për gjenezën e gjuhës sonë. Në njërin anë ishin J. Thumani, G. Hani, G. Majeri, H. Pedersen etj., të cilët mbronin tezën se shqipja vjen nga ilirishja dhe nga ana tjetër H. Hirti, G. Weigandi, V. Georgievi etj., që nëpërmjet argumenteve gjuhësore jepnin të dhëna se shqipja kishte një prejardhje nga gjuha e trakasve të vjetër, që banonin në viset lindore të Ballkanit, apo nga e ashtuquajtura dakomizishtja e Ballkanit Qendror. (Demiraj:62).

Me artikuj shkencorë<sup>3</sup> me kumtesa të mbajtura në kongrese e në konferenca kombëtare e ndërkombëtare, si edhe përmes veprave të botuara<sup>4</sup>, Çabej gjithnjë ka mbështetur dhe përforcuar tezën e prejardhjes së gjuhës shqipe nga ilirishja duke dhënë po aq sqarime me vlerë edhe për çështjen e autoktonisë së shqiptarëve. Disa nga çështjet që ai ka shtjelluar janë: evolucioni i toponimeve të vjetra të Shqipërisë, mungesa e pretenduar e termave të vjetër të lundrimit në këtë gjuhë, mospërmendja e shqiptarëve para shek. XI të erës sonë, lidhjet e vjetra mes shqipes dhe rumanishtes, mungesa e pretenduar e huazimeve nga greqishtja e vjetër dhe e huazimeve të lashta latine etj. (Demiraj:64). Në lidhje me këto çështje, Çabej shprehet se: “Gjuhët nuk janë madhësi që ekzistojnë në vetvete; ato janë të lidhura me njerëzit që i flasin, me popujt si bartësit e atyre gjuhëve, prandaj historia e gjuhëve në thelb është pasqyrë e historisë së popujve e të kulturave”.<sup>5</sup> Kështu që, sa i takon prejardhjes së toponimeve paralatinë dhe latine në gjuhën shqipe, se ato duhet të kishin trajta fonetike të njëjta në këto gjuhë, ashtu siç janë përdorur nga përdoruesit më të hershëm të gjuhës shqipe, Çabej i përgjigjet duke argumentuar se shqiptarët kanë të njëjtën rregullsi të theksimit të rrokjes nistore si në ilirishte si p.sh.: *Dyrrhachion/Dyrrhachium* sot *Dúrrës*, *Isamnus* sot *Ishëm*, etj., po ashtu edhe në emrat *emën(ë)/emër(ë)* etj. (Demiraj:64). Ndërsa në toponimin *Aulon* në *Vlorë*, ai ka sqaruar edhe rëniën e zanores nistore të patheksuar *A-*, ndërkaq

---

3 Instituti i Shkencave (1958): Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve. BUSH. SSHSH. Nr. 2. Tiranë, f. 54-62.

Instituti i Shkencave (1962): Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe. BUSH. SSHSH. Nr. 4. Tiranë, f. 117-148. etj.

4 Çabej, Eqrem (1959): Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike e shqipes. Tiranë.

5 Çabej, Eqrem (1970): Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike. Në: Studime Filologjike. Nr. 4. Tiranë, f. 3.

edhe në trajtat e vjetra si *Ulkinion, Drinus, Scodra* etj., prof. E. Çabej sqaron se ato kanë evoluar në bazë të rregullave të evolucionit historik të sistemin fonetik të gjuhës shqipe, duke kaluar brez pas brezi deri në ditët e sotme.

Më tej ai mban të njëjtin qëndrim me Waigandin, sa i përket pranisë së fjalëve të burimit të huaj në fushën e lundrimit dhe të peshkatarisë, duke cilësuar se ato janë të pranishme në pjesën teknike, në terma të mjeteve të lundrimit dhe pjesëve të tyre përbërëse si dhe në emrat e peshqve dhe të veglave të peshkimit, por sa i takon termave të anijes, peshkut dhe pjesëve të trupit të tij, detit dhe të disa veglave të peshkimit, Çabej thekson se ato janë të gjuhës shqipe, të tilla si: *det, valë, shkullm, anije* etj. Gjithashtu ai shprehet se mungesa e një baze historike e argumenteve të paraqitura edhe për autoktoninë e shqiptarëve e bën këtë tezë jo të drejtë.

Sh. Demiraj thekson se studimet e prof. Çabejt mbi çështjen e burimit të shqipes, janë përqendruar edhe në marrëdhëniet e gjuhës sonë me gjuhët fqinje dhe me gjuhët e tjera indoevropiane dhe joindoevropiane. Kështu ai paraqet fakte dhe teori të mbrojtura me argumente shkencore se në gjuhën shqipe janë të pranishme huazime nga greqishtja, sllavishtja, turqishtja, latinishtja dhe gjuhët romane. Në veprën e tij më të rëndësishme "*Studime etimologjike në fushë të shqipes*" u ka kushtuar një vëmendje të veçantë burimit të fjalëve në gjuhën shqipe, krahas studiuesve të huaj si Majeri, Pedersen dhe Jokli.

Marrëdhëniet që shqiptarët kanë pasur që herët me rumunët dhe prania e një numri të madh fjalësh të ngjashme në këto gjuhë, i ka bërë një grup gjuhëtarësh që të hartojnë tezën e tyre në kundërshtim të tezës ilire. E. Çabej në artikullin *Disa mendime mbi marrëdhëniet gjuhësore rumune-shqiptare*, ka paraqitur argumentet e tij në kundërshtim të tezës se shqipja buron nga një gjuhë e lashtë e Ballkanit Lindor, e afërt me trakishten, duke u shprehur se, nisur nga kontaktet që këta popuj kanë pasur me njëri-tjetrin, është e kuptueshme që aty do të ketë edhe prani të një leksiku të ngjashëm.

Ndërsa për huazimet e shqipes nga greqishtja e vjetër, Çabej mban një qëndrim pranues duke i argumentuar ato si një rezultat i lëvizjeve të njerëzve nëpërmjet rrugëve bregdetare. Por ai thekson se duhet pasur parasysh edhe një ndarje në periudha të këtyre

huazimeve, pra koha e përfshirjes së tyre në shqipe (greqishte e vjetër dhe greqishte e re).

Prania e huazimeve nga latinishtja në shqipe, sipas Çabejt është argumentuar si një ndikim që i ka ardhur gjuhës sonë nga kushtet social-historike, duke prekur përgjithësisht gjuhën kishtare apo ‘gjuhën intelektuale’. Ai vëren se procesi i ndikimit të shqipes nga latinishtja zë fill që nga përfundimi i ndikimit që erdhi nga perandoria romake, derisa italishtja u bë me po aq ndikim. Ai pohon se: “I vështruar në tërësinë e tij, ky ndikim do të shikohet jo si depërtimi i një sistemi gjuhësor në një tjetër, porse si një përshkrim intensiv i leksikut, ku ka dhënë më fort emra, mbiemra e folje, po sporadikisht edhe ndonjë parafjalë, pastaj si një ndikesë në fjalëformim, me anë të disa sufikseve.”<sup>6</sup> Njëpërmjet të gjithë argumenteve të tij shkencore dhe kundërgjegjeve të bazuara në fakte objektive, E. Çabej thekson se shqipja është formuar brenda truallit të saj gjuhësor dhe nuk ka një vendosje të vonë të shqiptarëve në viset bregdetare (Demiraj:76-77).

Një vëmendje të posaçme ai iu ka kushtuar edhe huazimeve sllave në gjuhën shqipe, duke theksuar se këto huazime kanë karakter dialektor dhe se sllavizmat jugore kanë depërtuar nga bullgarishtja, ndërsa sllavizmat veriore kanë hyrë nëpërmjet serbokroatishtes. Rrjedhimisht ai ka dalë në një përfundim të rëndësishëm se edhe disa fjalë shqipe kanë depërtuar në këto gjuhë.

Sa i takon huazimeve nga turqishtja, Çabej saktëson se këto huazime ndahen në periudha të ndryshme kohore duke bërë kështu edhe një shtresim diakronik të tyre. Ai veçon shtresën e vjetër të tyre, të cilën e ka ndeshur në të folmet arbëreshe në Itali, sikurse edhe shtresën e huazimeve të pranishme në tekstet e autorëve të vjetër shqiptarë duke përmendur këtu edhe hyrjen e disa prapashtesave turke dhe fjalëve të prejardhura të krijuara prej tyre në gjuhën shqipe.

Qëndrimi shkencor objektiv i mbajtur prej Çabejt dhe hulumtimi për të gjetur fakte gjuhësore për të dhënë përgjigje të argumentuara shkencërisht, i ka dhënë përgjigje mjaft studiuesve dhe ka kundërshtuar hipotezat që e përkufizonin gjuhën shqipe si ‘gjuhë të përzier’ (Demiraj:87). Kështu ai klasifikon disa fjalë si: të burimit

---

6 Çabej, Eqrem (1974): Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe. Në: Studime Filologjike. Nr. 2. Tiranë. f. 50.



indoevropian, të huazuara (huazime të mirëfillta apo kalke) dhe të zhvillimit të brendshëm të gjuhës shqipe, duke treguar edhe rrugën e hyrjes së huazimeve në shqipe, nëse kanë hyrë drejtpërdrejt apo nëpërmjet një gjuhe tjetër. Duke qenë se gjuhët janë në një ndikim të vazhdueshëm me njëra-tjetrën, E. Çabej thekson se edhe disa gjuhë ballkanike kanë huazuar fjalë nga gjuha shqipe.

Historiku i fjalëve, mjedisi ku janë përdorur, zhvillimi i tyre, aftësia për të krijuar forma dhe kuptime të reja, apo për të dalë nga përdorimi (vjetrimi i tyre), lidhja që ato krijojnë me fjalët e tjera, rindërtimi i formës dhe i semantikës së saj, shërbejnë si një dokument edhe për zhvillimin e vetë gjuhës, njëkohësisht përbëjnë edhe objektin dhe metodën e punës së këtij studiuesi. Kryesisht E. Çabej është përqëndruar në krahasimin historik të brendshëm të fjalëve të shqipes e mandej për të vazhduar në krahasimin historik të jashtëm, duke qenë se shqipja është një gjuhë e dokumentuar vonë, ai ka rindërtuar një pjesë të elementeve të krahasimit, përtej shek. XV.

Sqarimi i origjinës së fjalëve që Çabej ka realizuar ndër shekuj, ka përfshirë edhe studimet për evolucionin e sistemit fonetik, të cilat lidhen ngushtë me studimet e tij etimologjike. Kështu, ndihmesa e tij përfshin studimin e sistemit zanor të shqipes duke u përqëndruar te theksi, saktësisht te theksimi nistor që ai e gjykon të hershëm tek ata emra që janë të trashëguar. Gjatësia e zanoreve argumentohet prej tij si një gjatësi që ka qenë e mëhershme, një dukuri e një periudhe para-shqiptare, por edhe si një rezultat i shkrirjes së disa tingujve, i cili u shkaktua sidomos nga zhdukja e rrokjes që vinte pas. (Demiraj:101).

Sakaq, zhvillimin historik të zanores ë të theksuar, E. Çabej e cilëson si të dokumentuar te Buzuku dhe tek autorët veriorë, te numërori *nja* ose *nji*. Te diftongjet dhe togjet zanore të shqipes ai argumenton se ato kanë karakter dialektor ndërsa ato indoevropiane janë reduktuar që herët në zanore të thjeshta. Po ashtu në vëmendjen e këtij studiuesi kanë qenë edhe studimi i bashkëtingëlloreve si: *z*-ja e shqipes së dokumentuar, si edhe disa bashkëtingëllore të pranishme në tekstet e autorëve të vjetër si: *n*-ja nistore dhe *n*-ja e butë (*nj*). E rëndësishme është, ndër të tjera, edhe studimi i metafonisë dhe i thyerjes *a:e:i*. Ai i është përmbajtur mendimit të disa gjuhëtarëve

para tij se ajo është shkaktuar nga ndikimi asimilues prapavajtes i një *i*-je fundore, e cila me kohë është zhdukur fare ose ka lënë edhe ndonjë gjurmë tjetër në qiellzorizimin e bashkëtingëllores së saj, khs: *dash ~ desh < dash < dash-i* etj. (Demiraj:107). Çabej thekson se: “[...] pamja e pozicionit të shqipes në rreth të gjuhëve motra ka marrë konture më të qarta. Disa konkordanca të veçanta, që janë caktuar më parë me njëjërën ose tjetërën nga ato gjuhë, duke qenë të gabuara bien poshtë, disa të tjera, të pavëna re më parë, ua zënë vendin atyre, e disa të tjera duhet të merren si relevante në punë të këtij pozicioni”<sup>7</sup>

Sh. Demiraj ka paraqitur ndihmesën e këtij gjuhëtari edhe në fushën e gramatikës historike të shqipes. Vendin kryesor në këto studime e zë çështja e nyjave si edhe shumësi i singularizuar. E. Çabej duke zotëruar njohuri të konsiderueshme për strukturën gramatikore të shqipes dhe për zhvillimin e saj në kohë të ndryshme, ka paraqitur argumente shkencore për çështjen e nyjave të përparme dhe të prapme të shqipes. Në kundërshtim me Pedersenin, ai ka paraqitur tezat e tij për vjetërsinë e këtyre nyjave.

Nëpërmjet vjeljes së materialit gjuhësor nga gjuha e shkruar (materiale nga autorët e vjetër dhe nga studimet e mëparshme në këtë fushë) dhe nga gjuha e folur, ai ka trajtuar edhe çështjen e shumësit të singularizuar të shqipes. Një çështje më vete është edhe studimi i gjinisë së gjuhës shqipe, se si ajo është zhvilluar në kohë, duke përbërë kështu një vlerë të shtuar në studimet në fushën e morfologjisë historike.

Zhvillimi historik i dialekteve të shqipes ka qenë gjithashtu në vëmendjen e E. Çabejt që kur nisi hulumtimet për historinë e gjuhës shqipe. Të folmet që ruanin trajta arkaike të fjalëve të gjendura në tekste të autorëve të vjetër apo në materialet që ai vetë kishte mbledhur për këtë çështje, e ndihmuan atë që të rindëronte trajta që nuk ishin të dokumentuara për gjuhën tonë. Kështu ai u përqendrua më së shumti në të folmet arbëreshe të Greqisë (shek. XIV) dhe tek arbëreshët e Italisë (shek. XV). Drejtimi i vëmendjes nga dialektologjia dëshmohej edhe me hartimin e të parit *Pyetësor* për *Atlasin gjuhësor shqiptar* (1943). Përqendrimi në studimin

---

<sup>7</sup> Çabej, Eqrem (1970): Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes. Në: Studime Filologjike. Nr. 2. Tiranë. f. 94.

e të folmeve të arbëreshëve të Italisë, solli edhe një përpjekje për klasifikimin e tyre nga pikëpamja diakronike, pra se çfarë është arkaike (ruajtja e gjinisë asnjënjëse e emrit, ruajtja e rasës rrjedhore të shquar të numrit shumësh etj.) dhe se çfarë është e trashëguar. Nga ana tjetër evidentohen trajtat më të reja që njohin një krijim më të vonë të tyre (pas vendosjes në Itali). Në bazë të hulumtimeve të tij, Çabej arriti në përfundimin se të folmet arbëreshe takohen me gegërishten por edhe me toskërishten jugperëndimore (Demiraj:124). Objekt i studimeve të dialektologjisë historike kanë qenë trajtat më të vjetra të leksikut të së folmes arbëreshe, të cilat kanë dalë nga përdorimi, por edhe të disa turqizimeve. Kështu afritë që dialektet e shqipes kanë me njëri-tjetrin në periudhën e para pushtimit osman dhe në fazën e parë të këtij pushtimi, kanë bërë të mundur edhe hartimin e argumenteve në kundërshtim të tezave që dyshojnë origjinën e gjuhës shqipe dhe autoktoninë e shqiptarëve. Në veprat shkencore të tij me karakter teorik e praktik vërejmë interesin e Çabejt edhe kah jetës së fjalës d.m.th. anës sociologjike të saj, duke gjetur mjaft herë shqyrtime etimologjike të disa fjalëve dialektore e nëndialektore, struktura semantike dhe fusha e përdorimit e të cilave gjëllin në të folme të ndryshme të shqipes.

Puna filologjike për studimin dhe shpjegimin e teksteve të vjetra të letërsisë shqiptare të shek. XVI-XVIII, vlerësohet si një kontribut që E. Çabej i dha shkencës gjuhësore shqipe. Nëpërmjet ribotimit të librit më të vjetër të gjuhës shqipe “Meshari” i Gj. Buzukut në vitin 1968, me vëllimin e parë me transliterim dhe vëllimin e dytë me transkribim, studiuesi arriti në disa përfundime me vlerë për fillimet e shkrimit shqip. Ai mendon se ekzistenca e një tradite të shkrimit të shqipes mund të jetë e hershme, nisur nga ortografia e paraqitur në vepër, sikurse edhe koha prej 10 muajsh që iu desh Buzukut për ta përkthyer e për ta shkruar këtë libër. Por studimi i veprës së Buzukut dhe i autorëve të vjetër të shqipes, e kanë ndihmuar E. Çabejn edhe në sqarimin e disa çështjeve të gramatikës historike dhe të leksikut të shqipes.

Ky studiues përveç studimit të gjuhës shqipe në aspektin historik është përqëndruar edhe në disa çështje të rrafshit sinkronik të saj. Përmes zbulimit dhe studimit të fjalës që nis nga shfaqja e parë me trajtën dhe kuptimin fillestar të saj në kohën dhe vendin e

dokumentimit, ai vijon me studimin e fjalës në fazat e mëvonshme me të gjitha ndryshimet që ajo ka paraqitur. Mandej përdorimi aktual i fjalës dhe shtrirja e saj gjeografike në mbarë shqipen shërbeu për studime të rrafshit sinkronik të saj.

Sh. Demiraj veçon kontributin e E. Çabejt posaçërisht në hartimin e veprave të rëndësishme sa i takon standardizimit të gjuhës shqipe, duke qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e *Udhëzuesit drejtshkrimor* (1948, 1951, 1953, 1956, 1967, 1973); *Fjalorit të Gjuhës shqipe*, 1954; *Parashtesat e gjuhës shqipe*, 1956; *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, 1962. E. Çabej është shprehur edhe për faktorët që kanë ndikuar në formimin e gjuhës standarde shqipe duke argumentuar se ajo qëndron mbi dialektet, pra ka një karakter mbidialektor. Po ashtu ai ka hartuar edhe disa artikuj, ku trajton çështje të pastërtisë së gjuhës shqipe, ku thekson rëndësinë e materialit autokton të gjuhës sonë, por jo duke e mbivlerësuar atë deri në zëvendësimin e çdo fjale të huaj me një fjalë në shqipe. Ai cilëson *maturinë* si një ndër parimet që duhet të mbështetet nga çdokush që përpiket ta zëvendësojë atë, por duke pasur parasysh që terminologjia shkencore ndërkombëtare nuk mund të preket nga kjo dukuri. Pra fjalë që vështrohen si pjesë e gjuhës shkencore në disa gjuhë të tjera, të mos zëvendësohen me fjalë shqipe. Sipas tij ato nuk përbëjnë ndonjë shqetësim për gjuhën tonë, por vëmendja mund të jetë më e përqëndruar ndaj fjalëve të leksikut në fushat e dijes që janë pjesë e një leksiku shoqëror.

Ndër fushat e studimit të këtij studiuesi është edhe kultura popullore dhe folklori. Disa nga temat e kumtesave dhe artikujve të tij përfshijnë studime për poezinë popullore të vendeve të Ballkanit, duke zbuluar elementet e ngjashme dhe të ndryshme ndërmjet tyre. Kështu, ai bën një përjasje ndërmjet legjendës së Odiseut dhe asaj të Kostandinit, ku gjeti disa pikëtakime, të cilat u bënë pjesë e studimeve të tij të mëvonshme. Dalja në përfundime me bazë shkencore ishte veçanërisht e rëndësishme në pikëpamjen e origjinës së shqiptarëve (kemi parasysh këtu kundërshtimin e tezës së disa gjuhëtarëve të huaj që shqiptarët kanë qenë barinj endacakë). E. Çabej shprehet se: “Mendimi që [...] kemi të bëjmë aty me një popull barinjsh shtegtarë, lëvizjet e të cilëve si të tilla që ishin, nuk tërhoqën vëmendjen e bashkëkohasve, jo vetëm që nuk është mjaft

real nga pikëpamja ekonomike, e përgjithshme, por nuk pajton as me faktet kulturhistorike e sociale konkrete, mbështetet prandaj po aq më një vështrim të njëanshëm sa edhe gjykimi i gjendjes mesjetare.”<sup>8</sup> Pjesë e studimeve në fushë të folklorit ka qenë edhe hartimi i disa veprave dhe artikujve ku shqyrtohen edhe disa figura të besimeve popullore.

Ai zotëronte njohuri të gjera për letërsinë, prandaj veprimtaria shkencore dhe krijuese e E. Çabejt përfshin edhe trajtimin e disa çështjeve të letërsisë, duke u kushtuar disa artikuj autorëve dhe poetëve si: Lasgush Poradeci, J. de Rada, N. Frashëri, A. Z. Çajupi etj.

Sh. Demiraj ka paraqitur edhe disa artikuj, studime e kumtime të E. Çabejt, duke shpërfaqur në të njëjtën kohë edhe fushën e studimeve të tij si: *Nga “Studime etimologjike në fushë të shqipes”;* *Mbi poezinë e Lasgush Poradecit, Dy fjalë për gjuhën e Petro Luarasit; Fan Noli ynë; Dy fjalë kujtimi për profesor Aleksandër Xhuvanin; Në 30-vjetorin e vdekjes së Norbert Joklit; Paul Kreçmer; Maksimilian Lamberc në 75-vjetorin e ditëlindjes; Kënga e Leonorës në poezinë popullore shqiptare; Kostandini i vogëlth dhe kthimi i Odiseut; Vatra dhe bota në poezinë e De Radës; Kundër pseudofilologëve* etj. (Demiraj:175-252).

Me mjaft vlerë dhe interes në veprën e Sh. Demirajt na paraqiten edhe disa letra nga koha e letërkëmbimit të E. Çabejt me Joklin, Kreçmerin, Pedersenin, Lambercin, A. Leottin etj. Vërehet se ai ka bashkëpunuar me studiues shqiptarë edhe të huaj, me albanologë, ballkanologë e indoevropianistë nga vende të ndryshme të botës duke përqasur mendimin gjuhësor shqiptar me atë evropian.

Sh. Demiraj në këtë vepër ka shpërfaqur personalitetin e E. Çabejt në disa fusha të dijes, i cili ka dhënë një kontribut të pamatë në disa disiplina gjuhësore, etnografi, folklor etj., me dëshmimin e origjinës së shqipes dhe të popullit shqiptar, me pasurimin e studimeve të mëparshme me të dhëna objektive, të plotësuara me fakte shkencore e këndvështrime të reja, realizoi kështu një shqyrtim kritik të tyre, njëkohësisht solli ndihmesa të reja në shkencën e gjuhës. Vepra e E. Çabejt shërben edhe sot si një burim i çmuar, e

---

8 Çabej, Eqrem (1972) : Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe. Në: Studime Filologjike. Nr. 4. Tiranë. f. 12

cila përdoret edhe nga albanologët e ditëve të sotme që merren me studimin e historisë së gjuhës shqipe. “Metoda e rreptë shkencore e niveli i lartë me të cilën është hartuar, përfundimet e rëndësishme që janë arritur, e reja që sjell në konceptimin e trajtimeve etimologjike, kontributet e shumta që jep edhe për fonetikën e gramatikën historike të shqipes, e bëjnë atë një vepër themelore për albanistikën, me interes të veçantë edhe për ballkanistikën e teorinë e përgjithshme të studimeve etimologjike.”<sup>9</sup>

## Bibliografi

Çabej, Eqrem (1959): Hyrje në historinë e gjuhës shqipe. Fonetika historike e shqipes. Tiranë.

Çabej, Eqrem (1970): Kontributi i shqipes në formimin e lidhjes gjuhësore ballkanike. Në: Studime Filologjike. Nr. 4. Tiranë.

Çabej, Eqrem (1970): Mbi disa rregulla të fonetikës historike të shqipes. Në: Studime Filologjike. Nr. 2. Tiranë.

Çabej, Eqrem (1972) : Problemi i vendit të formimit të gjuhës shqipe. Në: Studime Filologjike. Nr. 4. Tiranë.

Çabej, Eqrem (1974): Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe. Në: Studime Filologjike. Nr. 2. Tiranë.

Demiraj, Shaban (2008): Eqrem Çabej: një jetë kushtuar shkencës. Tiranë.

Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1980): Prof. Eqrem Çabej – figurë e shquar e shkencës shqiptare (7.XVIII.1908 – 13.XVIII.1980). Në: Studime Filologjike. Nr. 3. Tiranë.

Instituti i Shkencave (1958): Problemi i autoktonisë së shqiptarëve në dritën e emrave të vendeve. BUSHT. SSHSH. Nr. 2. Tiranë.

Instituti i Shkencave (1962): Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe. BUSHT. SSHSH. Nr. 4. Tiranë.

---

9 Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë (1980): Prof. Eqrem Çabej – figurë e shquar e shkencës shqiptare (7.XVIII.1908 – 13.XVIII.1980). Në: Studime Filologjike. Nr. 3. Tiranë. f. 19.

Shpëtim Zymberaj

## **EQREM ÇABEJ – FIGURË E SPIKATUR NË HEDHJEN E BAZAVE NË GJUHËSINË SHQIPE. NDIHMESA TIJ NË FUSHËN GRAMATIKORE**

### **Hyrje**

Prof. Eqrem Çabej, një pionier i Albanologjisë, studiues i thellë i Ballkanologjisë, ka dhënë një kontribut të çmueshëm në të gjitha fushat e gjuhësisë.

Veprimtaria e tij shkencore karakterizohet edhe nga pasurimi i gjuhësisë shqiptare me vepra e studime të një niveli të lartë shkencor. Sipas Prof. Mahir Domit karakteristikë e punimeve të prof. Çabejt është se vrojtimitet e tij marrin pikënisjen nga faktet konkrete gjuhësore dhe paraprake, shpesh nga paraqitja e gjendjes së studimit të çështjeve a problemeve përkatëse nga shqyrtimi kritik<sup>1</sup>.

I përkushtuar më tërë energjinë e tij për hulumtime shkencore, na ka lënë një trashëgimi të pasur veprash kërkimore studimore, sidomos në fushën e studimeve etimologjike (Studime etimologjike në fushë të shqipes, vëll. I – VII, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1976–2014) dhe të fonetikës historike të gjuhës shqipe (Fonetikë historike, 1958), pastaj edhe vepra të tjera shkencore si “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe” 2008, ”Meshari i Gjon Buzukut” 1968, ”Shqiptarët midis perëndimit dhe lindjes” 1944, etj.

Prof. E. Çabej e çmonte tej mase punën kërkimore-shkencore në grup. Ai është bashkautor në një varg veprash ku trajtohen çështje të gjuhësisë së sotme si: ”Fjalori i gjuhës shqipe” 1954, ”Rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe” 1972, ”Fjalori drejtshkrimor” etj.

Në një punim të tij shkencor “Aleksandër Xhuvani dhe Gjuhësia

Historike Shqiptare” midis të tjerash thekson, se bashkimi i rrugëve të kërkimit në një sistem, metodë e zbatuar prej tij në mënyrë konsekuente, vihet re edhe në dy punimet “Parashtesat e Gjuhës shqipe” e “Prapashtesat e Gjuhës Shqipe”, tema të trajtuara prej autorit që më 1906.

Nga dy punimet në fjalë i pari u botua më 1956 dhe u ribotua më 1975, i dyti si botim më vete, në vitin 1962, kur Aleksandër Xhuavani ishte ndarë prej nesh.

Në të dyja këto punime sipas Çabej materiali i grumbulluar prej shumë burimesh i shtrohet një analize gjuhësore për të arritur në një sintezë, në një rrokje sa më të plotë e më të drejtë të sistemit fjalëformues të shqipes<sup>2</sup>

Prof. Çabej, një studiues me një formim të thellë filologjik, i tejkaloi kufijtë e shtetit, pikërisht nëpërmjet artikujve të tij rreth dukurive të përbashkëta të gjuhëve të Ballkanit e më gjerë.

Dimensionet studimore të Prof. Çabejt zgjeroheshin vazhdueshëm në thellimin e dijes në fushat e ndryshme të hulumtimeve të tij, sidomos në atë të etimologjisë së gjuhës shqipe. Përgatitja e lartë teorike, intuita dhe kultura e gjerë e një studiuesi të mprehtë, bënë që teorinë e gjuhës të mos e shikonte vetëm në planin mikrolinguistik (teoria e gjuhës të mos shihej si shkencë më vete dhe për vete), por edhe në atë makrolinguistik (teoria e gjuhës të kërkohet e gjurmohet edhe në raport me shkencat jogjuhësore), Sociolinguistikë, Psikolinguistikë, Etnolinguistikë, Komunikim, Pragmatikë etj,

### **1.Ndihmesa e Prof. Çabejt në gramatikën e shqipes**

Vënia në përdorim dhe zbatimi i metodave bashkëkohore ndihmuan që ky personalitet të arrinte suksese jo vetëm në fushën e studimeve etimologjike, por edhe në fusha të tjera hulumtuese.

Prof. Eqrem Çabej duke shfrytëzuar metodën shkencore – krahasimtare dhe parametra të reja metodologjike, ka dhënë një kontribut të çmueshëm edhe në fushën e sintaksës.

Disa nga veçoritë sintaksore të gjuhëve indoevropiane Prof. Çabej i ka vështruar në përfaqje me ato të shqipes. Ndër çështjet për

---

2 Eqrem Çabej: Aleksandër Xhuvani dhe Gjuhësia Shqiptare, Studime Filologjike 1, Tiranë, 1980, f. 59.



t'u veçuar në këtë fushë janë: Fjalja nominale; fjalitë foljore; topika e fjalëve në fjali; dukuritë prozodike; fjalitë kushtore; bashkërenditja dhe nënrenditja; eptimi dhe fjalja lidhore.

Fjalja emërore (nominale), sipas Çabejt, është ajo fjali që nuk ka këpujë, sidomos në vetën e tretë të njëjësit. Ka një denduri përdorimi në gjuhët e vjetra indoevropiane. Duke qenë një tip shumë i vjetër fjalish, e ndeshim në mbishkrimet e akemenitëve, në persishten e vjetër, në indishten e vjetër, por edhe në latinisht, sidomos në sentenca, në proverba e shprehje<sup>3</sup>.

Në ndërtimet e sotme sintaksore fjali emërore janë ato që shprehin kallëzuesinë me anë të intonacionit, si: vjeshtë, mbrëmje, qetësi.

Pra, fjala (emri) pushon së qeni fjalë, merr intonacion mbarimi, bëhet fjali. Përveç fjalive emërore, Prof. Çabej trajton edhe fjalitë foljore (verbale) duke theksuar edhe mungesën e subjektit të tyre. Elementin kryesor të këtyre fjalive e përbën folja. Parë nga ky këndvështrim Prof. Xhevat Lloshi thekson se folja është bërthama e fjalisë, është pjesa ndërtimore e ligjërimit, po edhe më e epshmj<sup>4</sup>.

Sipas Prof. Çabej për të kuptuar se për kë bëhej fjalë, i referohej gjithnjë foljes përkatëse p.sh. nëse kemi të bejmë më subjekt të gjinisë mashkullore apo femërore, nëse është i kësaj apo i asaj rase, shumë apo njëjës.

Kur thonë latinisht *Quad scripsi, scripsi*, "Atë që shkrova, shkrova", nuk ka kryefjalë, sipas tij s'kishte nevojë. Prandaj edhe në fjalitë foljore kryefjala përemrore shumë herë në gjuhën e periudhave të antikitetit mungon<sup>5</sup>.

Në shqipen standarde kur shërbejnë si kryefjalë, përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë nuk përdoren duke zëvendësuar gjymtyrët tjera të fjalisë, përemrat kanë një rol të veçantë në ndërtimin e kumtimit të saj.

Nga ana e gjuhëtarit kërkohet së pari identifikimi i fjalëve (i gjymtyrëve) me qëllim që të saktësohet më tej struktura e fjalisë.

---

3 Dr.Eqrem Çabej: Studime gjuhësore VII, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 125–130.

4 Xhevat Lloshi: Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 67.

5 E. Çabej, vepra e cituar, f. 126.

Topikën, rendin a vendin e fjalëve në fjali, Prof. Çabej e lidh me eptimin (fleksionin). Pra, sa më e pasur është një gjuhë në sistem të eptimit (fleksionit), aq më e lirë është topika. Sa më shumë varfërohet eptimi, topika bëhet më e shtrengueshme, më e ngulitur. Ai i jep shembuj nga latinishtja: *Civis diligit patriam* (qytetari do atdheun)<sup>6</sup>.

Kemi ketu rendin S+P+O

Po ta përmbysim topikën, në këtë rast, kuptimi nuk ndërrohet të themi: *Patriam civis diligit*. Në këto lloj fjalish, topika është e lirë. Vendosja e një fjale para ose pas tjetrës, ka të bëjë jo vetëm me qëllimet sintaksore, por edhe me ato stilistike. Duke folur rreth topikës së fjalëve në fjali në veprën e tij, Prof. Hasan Mujaj thekson se çështja e vendit të fjalëve në fjali dhe e fjalive në njësi më të gjera gjuhësore, si në shumë gjuhë të tjera edhe në gjuhën shqipe, paraqet interes të konsiderueshëm për kërkime filologjike<sup>7</sup>.

Duhet të kihet parasysh fakti se si do të aktualizohen modelet sintaksore duke u përvijuar nga struktura e aktit të komunikimit dhe nga struktura e aktit të të menduarit. Prof. Çabej fiksimin e topikës e sheh si pasojë të vobektësimit të eptimit. Sipas tij, te gjuhët perëndimore moderne sot sidomos te gjuhët neolatine romane edhe disa nga gjuhët gjermanike shumë herë kryefjala vihet në krye.

Dallohen në këtë aspekt gjuhët balto – sllave (lituanishtja, letonishtja, gjuhët sllave) të cilat kanë një eptim më të pasur. Shqipja ka gjithashtu një eptim të pasur.

Intonacioni është një element që në gjuhën e folur i jep më shumë peshë njëres fjalë brenda fjalisë, prandaj në gjuhën e folur topika e fjalëve është më e lirë se në të shkruarën, konstaton Çabej dhe sipas tij, gjuhët letrare kanë një tendencë për fiksime të topikës, p.sh. në indishten e vjetër, sanskritishtja ka një topikë më pak të lirë se vedishtja<sup>8</sup>.

Gjuhët klasike kanë një topikë më të shtrengueshme. Në gjuhët e vjetra indoevropiane, fjala që bart kuptimin kryesor, vihet në krye, ndërsa Greqishtja e vjetër ka një tendencë, që foljen ta vendosi në

---

6 E. Çabej, *Vepra e cituar*, f. 126

7 Hasan Mujaj: *Stilistika gjuhësore në Epikën Kreshnike*, Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 205.

8 E. Çabej, *Vepra e cituar*, f. 127

mes. Një mendim të këtillë edhe Wolfgang Dressler, një gjuhëtar austriak.

Në periudhën e hershme të gjuhëve indoevropiane, sipas Çabejt, shumë prej fjalive pyetëse ishin pa pjesëza pyetëse, ato dalloheshin vetëm nëpërmjet intonacionit (fjali asindetike, lidhja pa lidhëza).

Një shembull të tillë e gjejmë te fraza e famshme e Cezarit: Veni, Vidi, Vici (erdha, pashë, fitova. Fjalitë asindetike (fjalitë pa lidhëza) dhe bashkërenditja njihen si mënyrë për të dhënë shpejtësinë e ngjarjeve etj.

Midis të tjerash, Prof. Çabej ka trajtuar edhe çështjen e bashkërenditjes dhe të nënrenditjes. Ai ka saktësuar se në periudhat e para mbizotëronte bashkërenditja, nënrenditja është shumë më e vonshme. Në ndërtimet e sotme sintaksore vërejmë që nënrenditja e fjalive ndihmon të dallohet ideja kryesore nga ideja jo kryesore e një periudhe.

Ndonjëherë fjalitë e nënrenditura ndryshojnë formën në sintaksë dhe funksionojnë si togëfjalësha.

E vetmja fjalë që haset në gjuhët e dëshmuara që moti, është fjalia e varur lidhore (relative). Kjo është mjaft e shpeshtë në fazën e vjetër të greqishtes, të indishtes së vjetër dhe të latinishtes<sup>9</sup>.

P. Kretchmer ka vënë re që fjalitë kushtore pa një lidhëz, kanë qenë fjali pyetëse, të cilat u zhvilluan pastaj në fjali kushtore. Këto i gjejmë edhe në disa proverba shqipe si: Ngordhi kau, u prish parmenda. Vihet re se te këto proverba ka një ngritje të tonit te pjesa e parë, ngritje e cila është barazi me atë të fjalisë pyetëse.

Pas gjithë këtij hulumtimi shkencor, na lind pyetja, se cilët faktorë bënë të mundur që Prof. Eqrem Çabej të merrte guximin e t'i përvish një veprimtarie sa të vështirë, aq edhe të rëndësishme. Ai e kishte kuptuar me kohë se gjuha është gjëja më e çmuar e një populli dhe për popullin shqiptar, është i vetmi thesar.

Studimet në Austri, formimi i tij filologjik, i mundësuan atij të mbante letërkëmbime me elitën e gjuhësisë indoevropiane. Janë afër 25 letra të botuara që gjuhëharët e huaj i dërgonin Prof. Eqrem Çabejt.

Duhet të përmendim këtu emrat e albanologëve më të mëdhenj të shekullit XX: Norbert Jokl, Holger Pedersen, Paul Kreçmer, linguisti

---

9 E. Çabej, Vepra e cituar, f. 129.

italian Devoto, Prof. Georgiev, Prof. Vitore Pisani, albanologu polak Cimohovski etj.

Për A. Leott, Eqrem Çabej është albanologu më i shquar i të gjitha kohërave<sup>10</sup>.

## 2. Përfundim

Puna kërkimtare e tij jo vetëm në fushën e studimeve etimologjike, por edhe në historinë e gjuhës shqipe, disiplinat e saj, marrëdhëniet e saj me gjuhët motra indoevropiane, gjuhët ballkanike e gjuhë të tjera, me gjuhën e sotme me fjalorin, drejtshkrimin dhe pastërtinë e saj nga një anë, puna me folklorin, etnografinë dhe historinë e letërsisë nga ana tjetër, bëjnë që prof. Çabej si dijetar të mbetet një ndër themeluesit e Albanologjisë dhe të shkollës gjuhësore në Shqipëri.

### Literatura:

Ajeti, Idriz (2005): Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Studime Dialektore dhe Etimologjike, Tiranë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (2002): Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Gramatika e Gjuhës shqipe 2, Tiranë.

Demiraj, Shaban (1990): Eqrem Çabej – një jetë kushtuar shkencës. Shtëpia Botuese „8 Nëntori“, Tiranë.

Çabej, Eqrem (1976-2014): Studime etimologjike në fushë të shqipes, Vëll. I – VII, Akademia e Shkencave, Tiranë.

Çabej, Eqrem (1980): Aleksandër Xhuvani dhe gjuhësia historike shqiptare, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Studime Filologjike I, Tiranë.

Xhuvani, Aleksandër (1956, 1962): E. Çabej, Parashtesat e gjuhës shqipe, Tiranë, 4.

---

10 Idriz Ajeti: Shaban Demiraj në 80 – vjetorin e lindjes; Shaban Demiraj, Gjuha shqipe, probleme dhe disa figura të shquara të saj, Tiranë, 2003, f. 12.

## **Autorët e punimeve**

**Prof. dr. Matteo Mandalà - Facoltà di Lettere e Filosofia presso l'Università di Palermo, Itali.**

**Prof. dr. Emil Lafe** - Fakulteti Historisë dhe Filologjisë Universiteti i Tiranës

**Prof. dr. Akademik Seit Mansaku** - Fakulteti Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës

**Prof. dr. Akademik Floresha Dado** – Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës

**Prof. dr. Akademik Ethem Likaj/Dr. Albana Avrami** - Fakulteti Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik I Tiranës.

**Prof. dr. Akademik Gjovalin Shkurtaç** - Fakulteti Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës

**Prof. dr. Anila Omari** - Akademia e Studimeve Albanologjike Tiranë

**Prof. dr. Mario de Matteis** - Universiteti Bohumit, Gjermani

**Prof. dr. Dhori Q. Qirjazi** – “Universiteti Aristotel” i Selanikut, Greqi

**Prof. dr. Dieter Nehring** - Universiteti “Humboldt” Berlin, Gjermani

**Prof. dr. Bardhyl Demiraj** - Universiteti “Ludwig-Maximilian” Mynih, Gjermani

**Prof. dr. Valbona Toska** - Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”  
Shkup, Maqedonia e Veriut

**Prof. dr. Shezai Rokaj** - Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë,  
Universiteti i Tiranës

**Prof. dr. Berton Sulejmani** - Universiteti i Tetovës, Maqedonia  
e Veriut

**Ben Andoni** – Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti  
i Tiranës

**Prof. Asoc.dr. Edmond Malaj** - Universiteti i Tiranës

**Prof. Asoc. Dr. Jonida Xhyra-Entorf** - Mynih, Gjermani

**Prof. dr. Mimoza Kore** - Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë,  
Universiteti i Tiranës

**Prof. dr. Albert Riska** - Universiteti “Aleksandër Xhuvani”  
Elbasan.

**Dr. Genc Lafe** - Universiteti i Salentos, Itali

**Dr. Elda Boriçi** - Biblioteka Kombëtare Tiranë

**Prof. dr. Brikena Kadzadej /Vezire Krasniqi** Fakulteti i  
Gjuhëve të Huaja, Tiranë

**Prof. Asoc. dr. Sonila Sadikaj/Dr. Marisa Janku** - Fakulteti i  
Gjuhëve të Huaja, Universiteti Tiranës

**Prof. Asoc. dr. Adriatik Derjaj** - Fakulteti i Gjuhëve të Huaja,  
Universiteti i Tiranës

**Prof.Asoc.dr. Evalda Paci** - Akademia e Studimeve  
Albanologjike Tiranë

**Dr. Irda Dervishi Nesimi** - Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë,  
Universiteti i Tiranës

**Prof.Asoc.dr. Shpëtim Zyberaj-** Universiteti “Ukshim Hoti”  
Prizren, Kosovë

Universiteti i Tiranës

Prof. E. Çabej përmes letërkëmbimit me kolege dhe kolegë të gjuhës

gjermane : punime të konferencës shkencore ndërkombëtare /  
Universiteti i Tiranës, Universiteti i Gjuhëve të Huaja.

– Elbasan : Ramagraf, 2024

... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-381-15-6

1.Çabej, Eqrem 2.Gjuha shqipe

3.Njerëz të shquar dhe kultura 4.Gjuhëtarë

5.Konferenca 6.Shqipëri

811.18 (062)

929(496.5) [Çabej, Eqrem] (062)